Matematika 3 Libri i mësuesit/es

PËR MËSUESIN/EN

dukagjini
shtëpia botuese publishing house

Pleurat Rudi, Vlora Bunjaku,
Antonije Bytyqi, Majlinda Haxhikadrija-Ramadani

MATEMATIKA

Për klasën e tretë të arsimit fillor

3

PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes 10
Hyrje 12
Planifikimi vjetor 23
Plani dymujor: shtator—tetor 24
Plani dymujor: nëntor—dhjetor 33
Plani tremujor: janar—shkurt—mars 40
Plani tremujor: prill—maj—qershor 48
Mësimi 1: Numërimi dhe leximi 56
Mësimi 2: Krahasimi dhe renditja e numrave 58
Mësimi 3: Krahasimi dhe renditja e numrave (ushtrime) 60
Mësimi 4: Mbledhja e numrave 62
Mësimi 5: Mbledhja e numrave deri në 100 (ushtrime) 64
Mësimi 6: Zbritja e numrave 66
Mësimi 7: Lidhja ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes 68
Mësimi 8: Mbledhja dhe zbritja (ushtrime) 70
Mësimi 9: Shumëzimi i numrave 72
Mësimi 10: Vetitë e shumëzimit 74
Mësimi 11: Shumëzimi i shumës dhe i ndryshimit - vetia distributive 76
Mësimi 12: Shumëzimi i numrave 78
Mësimi 13: Shumëzimi i numrave 80
Mësim 14: Pjesëtimi. 82
Mësimi 15: Lidhja ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit 84
Mësimi 16: Lidhja ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit (ushtrime) 86
Mësimi 17: Lidhja ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit (ushtrime) 88
Mësimi 18: Modele figurash 90
Mësimi 19: Vargje numrash 92
Mësimi 20: Modelet (ushtrime) 94
Mësimi 21: Modeli kubik dhe plani 96
Mësimi 22: Bashkësitë dhe elementet 98
Mësimi 23: Paraqitja e bashkësive me kllapa 100
Mësimi 24: Nënbashkësia 102
Mësimi 25: Elementet e përbashkëta të dy bashkësive - prerja 104
Mësimi 26: Relacionet 106
Mësimi 27: Prerja, relacionet (ushtrime) 108
Mësimi 28: Drejtëza, gjysmëdrejtëza dhe segmenti 110
Mësimi 29: Drejtëzat prerëse 112
Mësimi 30: Drejtëzat normale 114
Mësimi 31: Drejtëzat paralele 116
Mësimi 32: Ushtrime 118
Mësimi 33: Këndi dhe llojet e këndeve 120
Mësimi 34: Këndi dhe llojet e këndeve (ushtrime) 122
Mësimi 35: Qindëshet e mijëshes së parë 124
Mësimi 36: Krahasimi i qindësheve 126
Mësimi 37: Krahasimi i qindësheve (ushtrime) 128
Mësimi 38: Mbledhja dhe zbritja me qindëshe 130
Mësimi 39: Shkrimi dhe leximi i numrave deri në 1000 132
Mësimi 40: Shkrimi dhe leximi i numrave deri në 1000 134

Mësimi 41: Shkrimi dhe leximi i numrave deri në 1000 (ushtrime) 136
Mësimi 42: Paraqitja e numrave treshifrorë në formë të zgjeruar 138
Mësimi 43: Mbledhja dhe zbritja me qindëshe 140
Mësimi 44: Mbledhja dhe zbritja me qindëshe (ushtrime) 142
Mësimi 45: Euro 144
Mësimi 46: Euro (ushtrime) 146
Mësimi 47: Mbledhja dhe zbritja me qindëshe 148
Mësimi 48: Zbritja e numrit njëshifror nga një numër treshifror 150
Mësimi 49: Mbledhja e numrave treshifrorë me dhjetëshe të plota 152
Mësimi 50: Zbritja e dhjetësheve të plota nga një numër treshifror 154
Mësimi 51: Zbritja e dhjetësheve të plota nga një numër treshifror (ushtrime) 156
Mësimi 52: Mbledhja e numrave treshifrorë me një numër dyshifror 158
Mësimi 53: Zbritja e numrit dyshifror nga numri treshifror 160
Mësimi 54: Zbritja e numrit dyshifror nga numri treshifror (ushtrime) 162
Mësimi 55: Mbledhja e numrave treshifrorë 164
Mësimi 56: Zbritja e numrave treshifrorë 166
Mësimi 57: Mbledhja dhe zbritja e numrave treshifrorë (ushtrime) 168
Mësimi 58: Zbritja e numrave treshifrorë 170
Mësimi 59: Varësia e ndryshimit nga i zbritshmi dhe zbritësi 172
Mësimi 60: Pandryshueshmëria e shumës dhe e ndryshimit. 174
Mësimi 61: Mbledhja e numrave treshifrorë me një numër dyshifror 176
Mësimi 62: Pozita e objekteve në rrjetin koordinativ 178
Mësimi 63: Koordinatat e pikave 180
Mësimi 64: Figurat simetrike ndaj një drejtëze të dhënë 182
Mësimi 65: Zhvendosja e figurave 184
Mësimi 66: Zhvendosja e figurave (ushtrime) 186
Mësimi 67: Metri dhe centimetri 188
Mësimi 68: Decimetri 190
Mësimi 69: Milimetri 192
Mësimi 70: Milimetri (ushtrime) 194
Mësimi 71: Kilometri 196
Mësimi 72: Kilometri 198
Mësimi 73: Mbledhja e numrave treshifrorë pa kalim 200
Mësimi 74: Mbledhja e numrave treshifrorë pa kalim (ushtrime) 202
Mësimi 75: Mbledhja e numrave treshifrorë me një kalim 204
Mësimi 76: Mbledhja e numrave treshifrorë me një kalim (ushtrime) 206
Mësimi 77: Mbledhja e numrave treshifrorë me një kalim (ushtrime) 208
Mësimi 78: Mbledhja e numrave treshifrorë me dy kalime 210
Mësimi 79: Mbledhja e numrave treshifrorë me dy kalime (ushtrime) 212
Mësimi 80: Zbritja e numrave treshifrorë pa prishje të dhjetëshes 214
Mësimi 81: Zbritja e numrave treshifrorë pa prishje të dhjetëshes (ushtrime) 216
Mësimi 82: Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të dhjetëshes 218
Mësimi 83: Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të dhjetëshes (ushtrime) 220
Mësimi 84: Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të qindëshes 222
Mësimi 85: Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të qindëshes (ushtrime) 224
Mësimi 86: Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të dhjetëshes dhe qindëshes 226
Mësimi 87: Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të dhjetëshes
dhe qindëshes (ushtrime) 228

Mësimi 88: Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të dhjetëshes
dhe qindëshes (ushtrime) 230
Mësimi 89: Shumëzimi i numrave me 10 dhe 100 232
Mësimi 90: Pjesëtimi i shumëfishave të numrit 10 me numrin 10 234
Mësimi 91: Pjesëtimi i shumëfishave të numrit 10 me numrin 10 (ushtrime) 236
Mësimi 92: Shumëzimi i numrave me dhjetëshe dhe qindëshe të plota 238
Mësimi 93: Pjesëtimi i shumëfishave të numrit 10 me dhjetëshe të plota 240
Mësimi 94: Pjesëtimi i shumëfishave të numrit 10 me dhjetëshe të plota 242
Mësimi 95: Vetitë e shumëzimit të numrave 244
Mësimi 96: Vetitë e shumëzimit të numrave 246
Mësimi 97: Vetitë e shumëzimit të numrave 248
Mësimi 98: Vetitë e shumëzimit të numrave 250
Mësimi 99: Vetitë e shumëzimit të numrave 252
Mësimi 100: Vetitë e shumëzimit të numrave 254
Mësimi 101: Kilogrami dhe dekagrami 256
Mësimi 102: Kilogrami dhe dekagrami 258
Mësimi 103: Grami 260
Mësimi 104: Grami 262
Mësimi 105: Tonelata 264
Mësimi 106: Tonelata 266
Mësimi 107: Shumëzimi i numrit dyshifror me numër njëshifror 268
Mësimi 108: Shumëzimi i numrit dyshifror me numër njëshifror me një kalim 270
Mësimi 109: Shumëzimi i numrit dyshifror me numër njëshifror me dy kalime 272
Mësimi 110: Shumëzimi i numrit dyshifror me numër njëshifror me dy kalime 274
Mësimi 111: Shumëzimi i numrit treshifror pa kalim 276
Mësimi 112: Shumëzimi i numrit treshifror me një kalim 278
Mësimi 113: Shumëzimi i numrit treshifror me dy kalime 280
Mësimi 114: Shumëzimi i numrit treshifror me dy kalime 282
Mësimi 115: Shumëzimi i numrit treshifror me dy kalime 284
Mësimi 116: Shumëzimi i numrit treshifror me dy kalime 286
Mësimi 117: Matja e kohës 288
Mësimi 118: Matja e kohës 290
Mësimi 119: Njësitë për matjen e kohës 292
Mësimi 120: Njësitë për matjen e kohës (vazhdim) 294
Mësimi 121: Matja e kohës (ushtrime) 296
Mësimi 122: Pjesëtimi i numrave dyshifrorë me numër njëshifror 298
Mësimi 123: Pjesëtimi i numrave dyshifror me numër njëshifror (vazhdim) 300
Mësimi 124: Pjesëtimi i numrave dyshifrorë me numër njëshifror (ushtrime) 302
Mësimi 125: Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifror 304
Mësimi 126: Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifror (vazhdim) 306
Mësimi 127: Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifror (vazhdim) 308
Mësimi 128: Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifror (vazhdim) 310
Mësimi 129: Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifror (vazhdim) 312
Mësimi 130: Pjesëtimi me mbetje 314
Mësimi 131: Pjesëtimi me mbetje (vazhdim) 316
Mësimi 132: Pjesëtimi me mbetje (ushtrime) 318
Mësimi 133: Shprehjet me dy veprime 320
Mësimi 134: Shprehjet me dy veprime (ushtrime) 322

Mësimi 135: Shprehjet shkronjore 324
Mësimi 136: Barazimet (barazimet me mbledhje dhe zbritje) 326
Mësimi 137: Barazimet (barazimet me shumëzim) 328
Mësimi 138: Barazimet (barazimet me pjesëtim) 330
Mësimi 139: Zgjidhje e barazimeve me mbledhje 332
Mësimi 140: Zgjidhja e barazimeve me zbritje 334
Mësimi 141: Zgjidhja e barazimeve me shumëzim dhe pjesëtim 336
Mësimi 142: Zgjidhja e barazimeve me mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtim 338
Mësimi 143: Jobarazimet 340
Mësimi 144: Grumbullimi dhe leximi i të dhënave 342
Mësimi 145: Grumbullimi dhe leximi i të dhënave (vazhdim) 344
Mësimi 146: Paraqitja e të dhënave 346
Mësimi 147: Paraqitja e të dhënave (vazhdim) 348
Mësimi 148: Paraqitja dhe analiza e të dhënave (ushtrime) 350
Mësimi 149: Probabiliteti - Njohuri fillestare 352
Mësimi 150: Eksperimenti dhe rezultatet e pritshme (ngjarjet) 354
Mësimi 151: Eksperimenti dhe rezultatet e pritshme (ngjarjet) (ushtrime) 356
Mësimi 152: Thyesat si pjesë të barabarta të një njësie 358
Mësimi 153: Thyesat ekuivalente (të barabarta) 360
Mësimi 154: Thyesat ekuivalente (të barabarta) (ushtrime) 362
Mësimi 155: Caktimi i pjesës së një tërësie 364
Mësimi 156: Caktimi i pjesës së një tërësie 366
Mësimi 157: Caktimi i pjesës së një tërësie (ushtrime) 368
Mësimi 158: Krahasimi i thyesave 370
Mësimi 159: Krahasimi i thyesave (ushtrime) 372
Mësimi 160: Mbledhja e thyesave me emërues të njëjtë 374
Mësimi 161: Zbritja e thyesave me emërues të njëjtë 376
Mësimi 162: Zbritja e thyesave me emërues të njëjtë 378
Mësimi 163: Mbledhja dhe zbritja e thyesave me emërues të njëjtë (ushtrime) 380
Mësimi 164: Sipërfaqja dhe perimetri 382
Mësimi 165: Centimetri katror 384
Mësimi 166: Centimetri katror (ushtrime) 386
Mësimi 167: Metri katror 388
Mësimi 168: Perimetri 390
Mësimi 169: Sipërfaqja e drejtkëndëshit 392
Mësimi 170: Sipërfaqja e drejtkëndëshit (ushtrime) 394
Mësimi 171: Trupat me qoshe 396
Mësimi 172: Trupat me qoshe (ushtrime) 398
Mësimi 173: Trupat e rrumbullakët 400

Të dashur mësues dhe mësuese,

Ky libër është hartuar me qëllimin për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë perdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimimi t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuuar në shoqëri. Për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" aplikon metodologji bashkëkohore të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësuesve, që ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Republikës së Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe të të nxënit, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehi të të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.

Cilësia e re e të nxënit dhe e mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por nga ju kërkohet edhe të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen maksimalisht në mësim.

Modeli i këtyre librave dhe mësimet janë hartuar me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES
për konceptimin e mësimeve model

Faqja në të majtë

Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.

Rezultatet e të nxënit të temës janë në koherencë me ato të fushës.

Mësimi synon që përmes rezultateve të të nxënit të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.

Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.

Janë zbërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Mësimi 1

ASPEKTE TE PËRGJITHSHME TE PLANIT TE ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 Klasa: III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000 dhe përcakton vlerën e çdo shifre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4,5; III.1,3,4,5; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.4,5; 2.1.2; 3.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TE PLANIT TE ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Numërimi dhe leximi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Lexon numrat deri në 1000.
- Shkruan numrat deri në 1000.
- Plotëson vargjet numerike duke përcaktuar rregullën e vargut përkatës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Matematika 3a, fletore, etiketa, shufra, kube.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Art figurativ; Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikime:
Përgatitja për të nxënët
Metoda/puno në dyshe/situata grupi.

Nxënësit i udhëzojmë të punojnë në dyshe dhe ju shpërndajmë; etiketa, shufra, kube.
Brenda dyshes, njëri nxënës do ta formon një numër, sipas dëshirës me anë të shufrave dhe kubeve kurse nxënësi tjetër do ta shkruan atë numër me fjalë dhe me shifra. Brenda dyshes ndërrohen rolet, nxënësi i dytë e formon numrin me shufra e kube kurse i pari e shkruan me fjalë dhë shifra. Disa dyshe i prezantojnë numrat në forma të ndryshme para klasës.
Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrën 1 në tekst, ku duke numëruar do të zbulojnë numrin e fshehur me figurë. Librat shkëmbehen me shokun/shoqen e bankës për t'u kontrolluar e më pas komentohen numrat e fshehur para klasës.

Për mësuesin/en
54

Paraqitja e faqes së librit të nxënësit, ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes duke ia bërë më të lehtë atë.

Të gjitha mjetet dhe materialet, e çdo lloji, që shërbejnë për konkretizim në ndihmë të të nxënit.

Zakonisht mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera të cilat evidentohen.

Metodologjia e mësimit ndërtohet në hapa, të cilët mund të jenë tre ose edhe më shumë. Tri figurat jepen së bashku, çka sugjeron që mësimi duhet të ndërtohet mbi të mëparshmen, për të vijuar më pas me dije e shkathtësi të reja.

Faqja në të djathtë

Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes duke ia bërë më të lehtë atë.

Figurat, tabelat, diagramet etj., janë ndihmë për të gjithë mësimdhënësit në aspektin pamor, për sukses në zhvillimin e mësimit.

Për të përforcuar dijet dhe shkathtësitë, në fund të mësimit jepen detyra për t'u kryer në shtëpi.

Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.


Përfundimi i njohurive:
Përgatitemi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Nxënësve udhëzohen ta analizojnë detyrën 2 duke ju ndihmuar me pyetjet;
Çfarë paraqet numri 877 (*paraardhësin e numrit 88*). Po numri 897 (*pasardhësin e numrit 88*).
Çfarë kemi për të shkruar në kutizat boshe?
Nxënësit plotësojnë të pavarur shembujt të shtyllës së parë

Detyrën 3 - Nxënësit udhëzohen ta analizojnë tabelën e parë. Cili numër duhet shkruar mbi numrin 35? (*numri 25*). Po nën të? (*numri 45*). Në të majtë të tij? (*numri 35*). Për sa duhen të rriten numrat në secilin rresht? (*për 1*). Po nëpër shtylla? (*për 10*).
Nxënësit plotësojnë të pavarur tabelën e parë.
Nxënësit udhëzohen ta plotësojnë të pavarur tabelat në detyrën 5. Pas plotësimit përgjigjen në pyetjet: Çfarë kanë të përbashkët këto 2 tabela? (*numra dyshifrorë*). Ku është dallimi?

Përfocimi:
Konsolidimi i të nxënit
Cili është ai numër?

67	63	43	50	100
98	58	51	55	88
58	59	89	80	73

Detyra 6 - Nxënësit udhëzohen që nga numri 37 të kërcejnë nëpër fusha sipas shigjetave të dhëna. Ata punojnë në dyshe. Numrat e gjetur duhet të jenë këta:

Detyra 8 - Nxënësit udhëzohen të vërejnë tre numrat e dhënë në vargun e parë dhe të tregojnë **Për sa numra pa rriten numrat e dhënë?** (*për 3*). **Cila duhet me qenë rregulla për plotësimin e vargut numerik?** (+3). Nxënësit plotësojnë vargun numerik të pavarur sipas rregullës së caktuar.
Nëse ka kohë punohet edhe në gjetjen e rregullës për plotësimin e vargut të dytë. Çfarë po vëreni nëse i krahasojmë numrat e dhënë? Për sa po rriqëhen? Cila është rregulla? (-3)

Vlerësimi i nxënësve:
Nxënësi vlerësohet për lexim dhe shkrim e numrave deri në 1000 si dhe për plotësim e vargjeve numerike sipas rregullës së gjetur.

Detyrë:
Punohen dy shembujt e mbetur të detyrave 2 dhe 3; detyra 4, 7 dhe vargjet 3 dhe 4 të detyrës 8 të tekstit.

Reflektime për rregullën e orës mësimore:

Për mësuesin/en
55

Pas pjesës hyrëse, vijon hapi tjetër për pjesën kryesore të mësimit, ku përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, të nxënët bëhet më tërheqës dhe nxënësit janë aktivë në përfshirjen gjatë veprimtarive të ndryshme.

Veprimtaritë në këtë hap, a hapa të mësimit, udhëhiqen nga mësimdhënësi dhe nxënësit i kryejnë sipas udhëzimeve apo duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

Hapi i fundit është praktikë e pavarur ku nxënësit inkurajohen që të vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur dhe inkurajohen duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimit

Rezultatet e të nxënit të temës: Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe të rezultateve të të nxënit për këtë temë. Në këtë rast mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe të programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy, a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënit të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore - kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënit dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zbërthehen në rezultate të të nxënit. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënit: Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimit, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënit të temës të cilat janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit: Janë zbërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës - hapat e zhvillimit të mësimit: Mësimi zhvillohet përmes hapave, duke nxitur të menduarit logjik e kritik te nxënësit, duke pasur parasysh fazat e zhvillimit sipas Piazhesë.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimit?

Mbillet një farë. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi/ja vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të ecur më tej përpara.

Parashikimi: Përgatitja për të nxënët
Në fazën e parashikimit mbillet një farë në një truall pjellor. Mësimi duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.

Kjo është faza e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të të nxënit; kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj çka di rreth temës së mësimit, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes
Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kjo është faza e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënit dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përftimit të kuptimit të njohurive, gjithashtu ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.

Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit
Mësimi përfundon me fazën e përforcimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxënësit konsolidojnë të nxënët e ri dhe, në mënyrë të gjallë, ristrukturojnë skemën e tyre për të përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin/en

MATEMATIKA 3

Fusha e matematikës ka si qëllim të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik, me idetë bazë për strukturat matematikore, si dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë për llogaritje dhe zgjidhje të problemeve në jetën e përditshme. Matematika promovon përvetësimin themelor të koncepteve matematikore, përforcim dhe zhvillim, në identifikimin e simboleve, kryerjen e veprimeve themelore, matje me instrumente jostandarde dhe standarde, formën e figurave dhe trupave gjeometrikë, grumbullimin e të dhënave, leximin dhe paraqitjen e grafikëve të thjeshtë, si dhe vendosjen e një baze të njohjes dhe qëndrimeve pozitive ndaj matematikës.

Fusha e matematikës, gjithashtu ka si qëllim zhvillimin e aftësive, të shkathtësive dhe të shprehive të nxënësve për të menduar në mënyrë kritike, zhvillimin e personalitetit të tyre, për të punuar në mënyrë të pavarur dhe sistematike, nxitjen dhe inkurajimin e ndërtimit të njohurive të reja me qëllim të zbatimit dhe integrimit të tyre në fushat e tjera dhe zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme.
Po ashtu, edhe një nga qëllimet e fushës së matematikës është funksionalizimi i dijeve përmes integrimit të saj me të gjitha fushat, lidhjes ndërkurrikulare dhe arsimimit të qëndrueshëm përmes të cilave zotërohen kompetencat kryesore.

Udhëzime metodologjike

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të fushës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes tematike mësimore dhe të rezultateve të kompetencave për shkallën e parë kurrikulare, me bazën didaktike dhe me nivelin e formimit të nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë maksimumin e potencialit që zotëron brenda vetes.

Mësimdhënësi është i lirë të përdorë metoda mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash. Këto metoda duhet të jenë në funksion të nxitjes së mendimit të pavarur, kritik e krijues. Metodat dhe teknikat e punës me nxënës lipset të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit dhe të zbatimit në jetën e përditshme.

Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënët

Libri që keni në duar është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathtësive. Ai trajton temat mësimore në përputhje me "Kurrikulën Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës" (2016), si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënit të fushës, rezultatet specifike të të nxënit të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecurinë metodologjike të orës së mësimit e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*.
Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe në rastet kur nuk mund t'i arrini ato, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është bërë kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënit - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënit - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet "trekëndësh magjik". Trekëndëshi paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxënit, veprimtaritë e mësimdhënies/të nxënit dhe vlerësimin. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëritjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathtësive.



Zgjeroni dhe thelloni dijet *Për më shumë lexoni në: Musai. B. (2014) Metodologji e mësimdhënies.Tiranë: CDE, faqe 101-128.*

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimit të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimit ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues, është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e zhvillimit proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve, apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënia mund të japë rezultate dhe ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimit midis së mërzitshmes dhe të së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimi të japë rezultat.

Zgjeroni dhe thelloni dijet *Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi.Tiranë: CDE, faqe 47-51.*

Burimi: Nga Psikologji edukimi, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE

Zgjeroni dhe thelloni dijet
Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 32-36

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 2

I	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv
1.	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
2.	Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.
3.	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje: pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
4.	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
5.	Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.
7.	Shpreh në formë verbale dhe të shkruar, fjali të thjeshta në gjuhë të huaj dhe përkthen në gjuhë amtare fjali të tjera të thjeshta që i dëgjon nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi në gjuhë të huaj të dhëna si detyrë.
8.	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

II.	Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ
1.	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse.
2.	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).
3.	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
4.	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.
5.	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.
6.	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore-historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
7.	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyre të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.
8.	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitave në kohë e hapësirë) dhe bashkëveprimit të tyre.

III.	Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm
1.	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.
2.	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
3.	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).
4.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.
5.	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.
6.	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.
7.	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
8.	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.
9.	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

IV.	Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv
1.	Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet për fusha të caktuara duke i gjetur të përbashkëtat me profesionet e dëshiruara.
2.	Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.
3.	Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.
4.	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.
5.	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë-laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.
6.	Identifikon ushqimet më të shpeshta, materialet e tjera shpenzuese të familjes apo harxhimet vetjake dhe llogarit shpenzimet për një javë, të dhënat e gjetura i paraqet në formë tabelare/grafike apo në një formë tjetër.
7.	Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë-adekuat.
8.	Paraqet në formë tabelare, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

V.	Kompetenca personale – Individ i shëndoshë
1.	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike-lojëra lëvizore dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan drejt, menaxhon emocionet e veta dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore pas realizimit të një aktiviteti fizik apo loje sportive.
3.	Përgatit një listë (me njërën nga format e shprehjes, shkrim, vizatim etj.) me ushqime të cilat i konsumon familja duke i renditur ato sipas kalorisë dhe më pas i klasifikon në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme.
4.	Lexon të dhënat në paketim të ushqimit dhe diskuton në grup për këto të dhëna (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.).
5.	Identifikon përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse.
6.	Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal, duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.
8.	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
9.	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

VI	Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1.	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni.
2.	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
3.	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.
4.	Manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe me shembull konkret tregon përdorimin e tyre në klasë/shkollë, në familje e në komunitet.
5.	Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.
6.	Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërës rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.
7.	Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.
8.	Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet-mënyra e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrjen në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.
9.	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhen manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS SË MATEMATIKËS Shkalla 2

I.	**NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË** që zhvillohen te nxënësi/ja përmes përvojave mësimore që ndërlidhen me:
1.	Zgjidhjen e problemave;
2.	Arsyetimet dhe vërtetimet matematike;
3.	Komunikimin në/përmes matematikë/s;
4.	Lidhjet matematike;
5.	Përfaqësimin matematik;
6.	Promovimin e modelimit matematik;
7.	Strukturimin e të menduarit matematik;
8.	Përdorimin e TIK-ut në/për matematikë.

1.	**Zgjidhja e problemave:**
	Zgjidhja e problemave është një proces që zhvillon njohuritë e nxënësve në matematikë përmes detyrave ku rezultati dhe procedura e zgjidhjes nuk është e njohur më parë. Nxënësi ndërton njohuri, përshkruan dhe zgjidh situata problemore që krijohen brenda matematikës dhe në kontekste nga fushat e tjera si dhe nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme. Nxënësit i mundësohet që të zbatojë dhe të përshtatë një shumëllojshmëri të strategjive për të zgjidhur problemat. **Nxënësi/ja:**
1.	Identifikon kërkesat e problemave të thjeshta.
2.	Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme.
3.	Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë.
4.	Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave.
5.	Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.

2.	**Arsyetimet dhe vërtetimet matematike:**
	Arsyetimi është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësve në matematikë përmes koniunkturave matematike, nxjerrjes së konkluzioneve logjike, hipotezës dhe të të menduarit të tyre kritik, justifikimit të ideve, analizimit të provave dhe ndërtimit të argumenteve. Nxënësve u mundësohet përdorimi për arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës. **Nxënësi/ja:**
1.	Nxjerr rregullat, arsyeton konceptet dhe modelet e thjeshta matematikore, për të hapur rrugën për koncepte të reja;
2.	Zhvillon dhe zbaton shprehi të arsyetimit, si: klasifikimi, dallimi i marrëdhënieve, përdorimi empirik i kundërshembullit;
3.	Hamendëson dhe gjykon hamendësime;
4.	Argumenton dhe mbron argumentin.

3.	Komunikimi në/përmes matematikë/s
	Komunikimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për t`i shprehur idetë matematike me rrjedhje logjike, që i justifikon ato në audiencë dhe në shoqëri përmes të folurit dhe të shkruarit për atë që e bëjnë me simbole, terma, grafikë, modele dhe shprehje matematikore. Nxënësve u mundësohet përdorimi i komunikimit nëpërmjet shenjave, të folurit, të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit dhe të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik.
	Nxënësi/ja:
1.	Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet matematikore për t'i organizuar faktet, konceptet, idetë dhe veprimet themelore në matematikë; për të diskutuar me bashkëmoshatarët për rezultatet dhe sfidat e punës së tij;
2.	Përforcon strukturat mendore të ndërtuara më parë, të përshtatshme për matematikën duke parashtruar, pranuar dhe përgjigjur pyetjeve;
3.	Përdor algoritmin e veprimeve me numra për të bërë njehsime me mend;
4.	Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: gjuhën e përditshme, fjalorin fillestar matematik, paraqitje të ndryshme;
5.	Komunikon të menduarin e tij matematik, duke përdorur simbole matematike;
6.	Krijon paraqitje të koncepteve matematike me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame;
7.	Lidh konceptet mes tyre dhe i zbaton në zgjidhje problemash.

4.	Lidhjet në matematikë
	Lidhja matematike është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për t'i lidhur idetë dhe njohuritë matematike, brenda fushës së matematikës dhe jashtë saj. Nxënësve u mundësohet për të njohur dhe për të përdorur lidhjet e ideve matematikore, për të kuptuar se si idetë matematikore ndërtohen njëra mbi tjetrën dhe për të prodhuar një tërësi koherente, si dhe zbatimi i matematikës në kontekste brenda dhe jashtë fushës së matematikës.
	Nxënësi/ja:
1.	Bën lidhje mes njohurive paraprake dhe të reja për ndërtimin e koncepteve të reja në lidhje me numrat deri në shtatëshifrorë, të formave 2D dhe objekteve 3D;
2.	Bën lidhje të njohurive dhe shprehive matematike me situata ose dukuri të marra nga jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.;
3.	Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

5.	Përfaqësimet matematike
	Përfaqësimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të përfaqësuar objektet matematikore dhe veprimet, duke përfshirë numra, forma dhe marrëdhëniet. Përfaqëson dhe analizon situata dhe struktura matematikore. Nxënësve u mundësohet për të krijuar dhe për të përdorur përfaqësitë për të organizuar, regjistruar dhe komunikuar idetë matematikore, zgjidhur, përkthyer dhe zbatuar përfaqësimet që kanë të bëjnë me zgjidhje problemash matematikore, përdorur përfaqësimet për modele dhe interpretime të fenomeneve sociale, natyrore dhe matematikore.
	Nxënësi/ja:
1.	Identifikon rregullat themelore për njehsimet me numra; kupton përdorimin e ndryshoreve për zgjidhjen e problemave nga matematika dhe nga jeta e përditshme.

6.	Modelimi matematik
	Modelimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të kuptuar format, modelet në kontekste të ndryshme, marrëdhëniet dhe funksionet, paraqitjen dhe analizimin e strukturave matematikore. Nxënësve u mundësohet për të krijuar dhe për të përdorur modele të ndryshme, për të paraqitur modelet dhe rolin e tyre në kontekst, për të përdorur modelet për të përfaqësuar dhe për të kuptuar marrëdhëniet sasiore, interpretuar me modele fenomenet sociale, natyrore dhe matematikore. **Nxënësi/ja:**
1.	Përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situata të përditshme (p.sh., ekonomisë familjare, statistika elementare për jetë etj.), që lidhen me numrat deri në gjashtëshifrorë, format 2D dhe objektet 3D;
2.	Identifikon rregullat themelore për njehsimet me numra;
3.	Kupton përdorimin e ndryshoreve për zgjidhjen e problemave nga matematika dhe jeta e përditshme.

7.	Strukturimi i të menduarit matematik
	Të menduarit matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të parashtruar pyetje dhe pritjet nga përgjigjet e mundshme. Nxënësve u mundësohet për t'u ndërgjegjësuar për mënyrën, formën, qasjen dhe për llojet e pyetjeve që e karakterizojnë matematikën si dhe llojet e përgjigjeve të pritshme. **Nxënësi/ja:**
1.	Demonstron të menduarit të pavarur dhe shprehi pune; forcon strukturat mendore të ndërtuara më parë, relevante për matematikën, duke parashtruar, duke pranuar dhe duke iu përgjigjur pyetjeve.

8.	Përdorimi i TIK-ut në/për matematikë
	Përdorimi i teknologjisë është një proces që zhvillon njohuritë dhe aftësitë e nxënësve për të përmbushur rezultatet e të nxënit të fushës së matematikës dhe ta bëjë të suksesshëm edhe përtej shkollës. Nxënësve u mundësohet për të përdorur teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar informacione. **Nxënësi/ja:**
1.	Interesimi për matematikën - nëse ata e shohin atë si të dobishme në jetën reale;
2.	Gatishmëria për t'u angazhuar në matematikë ka të bëjë me qëndrimet emocionale dhe besimin personal që e shpie nxënësin drejt përfitimit.

II.	**VLERAT DHE QËNDRIMET** që zhvillohen
	Qëndrimet e individit, bindjet dhe emocionet luajnë një rol të rëndësishëm në interesimin e tij, përgjigjen ndaj matematikës dhe përdorimin e saj në jetën e tij. Qëndrimet e nxënësve ndaj matematikës i vendosin ata drejt angazhimit produktiv të tyre në matematikë, si: 1. Interesimi për matematikën - nëse ata e shohin atë si të dobishme në jetën reale. 2. Gatishmëria për t'u angazhuar në matematikë ka të bëjë me qëndrimet emocionale dhe besimin personal që e shpie nxënësin drejt përfitimit.
	Formimet relevante në këtë fushë janë përfshirë te:
a.	Kurioziteti;
b.	Motivimi për mësim;
c.	Imagjinata në kreativitetin për zgjidhjen e problemeve;
d.	Insistimi, këmbëngulja dhe fuqia në fokusimin e problemave;
e.	Pavarësia në mendime dhe veprime;
f.	Iniciativa dhe interesi për qasje të ndryshme;
g.	Organizimi i të menduarit;
h.	Besimi në forcat vetjake;
i.	Besimi në përdorimin e teknologjisë;
j.	Dëshira për njohuri matetematike;
k.	Formimi human dhe zhvillimi i personalitetit;
l.	Kritikat konstruktive;
m.	Pavarësia në mendime;
n.	Gatishmëria për bashkëpunim;
o.	Prania e kritikave dhe gatishmëria për kritika konstruktive;
p.	Gatishmëria për gara të ndershme;
q.	Kuraja për të kërkuar përkrahje/ndihmë;
r.	Qëndrimi i hapur ndaj përkrahjes së të tjerëve;
s.	Qëndrimi ndaj pyetjeve dhe kërkesave;
t.	Vullneti;
u.	Toleranca;
v.	Respekti për saktësinë, përpjekjet personale dhe ato në grup.

III.	**AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË** që zhvillohen:
1.	Identifikim;
2.	Përshkrim;
3.	Zbatim;
4.	Njehsim;
5.	Matje;
6.	Vlerësim;
7.	Skicim;
8.	Krijim modelesh;
9.	Qasje ndaj problemeve nga perspektiva të ndryshme.

IV.	**KONCEPTET SPECIFIKE DHE NJOHURITË**
	Numrat, algjebra dhe funksioni, forma, hapësira, matja dhe gjeometria, përpunimi i shënimeve dhe probabiliteti;
1.	Numrat natyrorë dhe të plotë;
2.	Veprimet themelore me numra;
3.	Ekuacionet, inekuacionet dhe funksionet;
4.	Forma e figurave të regullta (trekëndëshi, katrori, drejtkëndëshi dhe rrethi);
5.	Hapësira – objektet gjeometrike dhe trupat e rregullt gjeometrikë (kubi, kuboidi, piramida, prizmi dhe sfera);
6.	Matjet (e gjatësisë, perimetri dhe syprina) e figurave të rrafshëta;
7.	Të dhënat (elemente themelore të statistikës) grumbullim të shënimeve, mostra, prova, mesi aritmetik.

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Matematikë Klasa III

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkallë)
	GJYSMËVJETORI I		GJYSMËVJETORI II		
	shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor	
Matematikë	Numrat natyrorë Modelet Bashkësitë dhe relacionet Figurat gjeometrikë Vlerësim - ushtrime	Numrat natyrorë Ekuacionet dhe inekuacionet lineare me një të panjohur Figurat gjeometrike Vlerësim - ushtrime	Ekuacionet dhe inekuacionet Numrat natyrorë Njësitë matëse Numrat natyrorë Njësitë matëse Numrat natyrorë Vlerësim - ushtrime	Shprehjet shkronjore Të dhënat Probabiliteti Numrat thyesorë Sipërfaqja Trupat gjeometrik Vlerësim - ushtrime	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv I.1, I.2, I.3,4, I.5, I.6, I.7, I.8 Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ II.1, II.2, II.3, II.4, II.5, II.6, II.7, II.8 Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm III.1, III.2, III.3, III.4, III.5, III.6, III.7, III.8,9 Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv IV.1 IV.2, IV.3, IV.4, IV.5, IV.6, IV.7. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë V.1, V.2, V.3, V.4, V.5, V.6, V.7, V.8 Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm VI.1, VI.2, VI.3, VI.4, VI.5, VI.6, VI.7, VI.8
	43 orë	40 orë	57 orë	44 orë	

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Matematikë

Fusha e kurrikulës: Matematikë **Klasa:** III

Temat mësimore: Numrat natyrorë Bashkësitë dhe relacionet
Modelet Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*	
1.	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
2. A={44, 45, 46, 47}; 3. A={46, 56, 66}; 4. A={73, 74, 77, 78}; 5. A={45, 55, 65}



5 Plotësojmë.

2 Dh 3 Nj		
6 Dh 4 Nj		
8 Dh 9 Nj		
5 Dh 1 Nj		
8 Dh 7 Nj	87	tetëdhjetë e shtatë

Dh	Nj	19	
Dh	Nj	96	
Dh	Nj		tridhjetë e tre
Dh	Nj		nëntëdhjetë e tetë
Dh	Nj		shtatëdhjetë e katër

6 Ngjyros numrat të cilët janë, në rastin e parë, më të vegjël se 54, kurse, në rastin e dytë, më të mëdhenj se 72.

< 54		
67	37	56
22	33	87
98	48	47

> 72		
74	47	21
77	32	93
86	81	0

7 Të shkruajmë numrat çift që ndodhen ndërmjet numrave 27 dhe 46.

28

8 Të shkruajmë numrat tek që ndodhen ndërmjet numrave 41 dhe 60.

43

9 Të shkruajmë të gjithë numrat dyshifrorë, shuma e shifrave të të cilëve është 7. I renditim pastaj këta numra nga më i vogli deri te më i madhi.

Numrat e kërkuar janë:

Të renditur nga më i vogli deri te më i madhi:

Ushtrojmë

14

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Shqyrtojmë së bashku me nxënësit shembullin 2, 3 dhe 4, duke e plotësuar shembullin në libër individualisht secili nxënës dhe mësimdhënësi/ja sqaron se treshet e numrave në shembullin 2 në disa raste janë numra tek sipas radhës nga më i vogli te më i madhi dhe në disa raste çift nga më i vogli deri te më i madhi.

Gjithashtu së bashku me nxënësit e zgjidhim edhe shembullin 4 ku katrorët sipër duhet t'i shkruajmë numrat sipas vendit, ndërsa numrat poshtë duhet t'i lidhim me shigjetë për vendin e duhur sipas renditjes në boshtin numerik.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e drejtuar dhe në dyshe

Vazhdojmë më zgjidhjen e shembullit 5 në fq. 14; së pari sqarohet ideja e zgjidhjes në tabelë nga mësimdhënësi/ja dhe pastaj kërkohet nga nxënësit në dyshe të realizojnë zgjidhjen e pjesës së mbetur të këtij shembulli në libër.

Udhëzohen nxënësit që shembullin 7 dhe 8 ta zgjidhin në grupe, ku grupi 1, 3 dhe 5 do ta zgjidhin shembullin 7, ndërsa grupet 2 dhe 4 do ta zgjidhin shembullin 8. Për të saktësuar zgjidhjen dhe për ta plotësuar e gjitha klasa detyrën shembujt e mësipërm i zgjidhin edhe në tabelë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në krahasimin e numrave dyshifrorë, renditjen e tyre nga më i vogli te më i madhi dhe gjetjen e paraardhësit dhe pasaardhësit të tyre.

Detyrë:

Detyra 9 (faqe 14).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 4

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3; III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4,5; 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbledhja e numrave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen shumën e numrave pa kalim të dhjetëshes dhe me kalim të dhjetëshës;
- Zbulon rregullën për të njehsuar shumën e dy numrave;
- Argumenton mbledhjen e numrave në boshtin numerik.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kartat e shifrave, formuese me kafshë, lego.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Vizatohet boshti numerik në tabelë, ashtu që numrat në atë bosht të përshtaten me detyrat që duhet të zgjidhen, siç janë të paraqitura në detyrën 1 në faqen 15.
Pra, nëse fillojmë me identifikimin e numrit 25 në boshtin numerik dhe se atij numri duhet t'i shtojmë numrin 7, mund të presim nga nxënësit që t'i japin përgjigjet e tyre në lidhje me atë se deri ku duhet të shkojë ky numër në boshtin e lartcekur.


5 Njehsojmë në shtylla.

Me kalim të dhjetëshes.

	Dh	Nj
+	4	9
	2	7
	1'	16
	7	6

3 8 + 5 4 = ☐☐

6 4 + 2 7 = ☐☐

4 6 + 4 5 = ☐☐

6 9 + 2 6 = ☐☐

6 Zbulojmë rregullën dhe njehsojmë. Përshkruajmë rregullën me fjalë.

25 + 36 = ☐
26 + 36 = ☐
27 + 36 = ☐
28 + ☐ = ☐

25 + 36 = ☐
25 + 35 = ☐
25 + 34 = ☐
☐ + ☐ = ☐

41 + 29 = ☐
41 + 39 = ☐
41 + 49 = ☐
☐ + ☐ = ☐

Rregulla: _____

7 Njehsojmë dhe plotësojmë.

12 8 15 9 — 24 — 5 7 22

8 Ngjyra e njëjtë mbulon numrin e njëjtë. Zbulojmë numrat e mbuluar.

9 + ◆ = 35
◆ + ◆ = 42

13 + ◆ = 60
20 + ◇ = ◆

◆ + ◆ = 18
7 + ◆ = ◆
◆ + ◆ = ◇

Mësojmë

16

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Pjesën kryesore të orës e fillojmë me detyrën 2, në të njëjtën faqe, duke e vizatuar boshtin numerik me shkumësa me ngjyra. U sqarohet nxënësve se mbledhori i dytë fillimisht duhet të ndahet në dhjetëshe të plotë dhe në numrin adekuat njëshifror, e pastaj të fillohet me gjetjen e shumës.

Kalohet te detyra 3 ku kërkohet nga nxënësit të mbledhin pa kalim të dhjetëshes në shtyllë, e më pas te detyra 4-të fillohet me sqarimin e mbledhjes në shtyllë.
Për të plotësuar rubrikat e zbrazëta te detyra 5 duhet ta zbulojnë rregullën. Në tabelë i marrim disa shembuj të ngjashëm me njehsimin e shumës duke e zbatuar rregullën dhe pasi nxënësit ta kuptojnë rregullën e përdorur, fillohet me plotësimin e rubrikave në libër.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e drejtuar

Pjesa e reflektimit ndërlidhet më detyrën 6:
Në anën e majtë rubrikat plotësohen nga rreshti i parafundit e duke shkuar lart, ashtu që i mbledhim dy nga dy dhe shumat e tyre i shkruajmë në rubrikën sipër tyre. P.sh., 12 + 8 = 20, numrin 20 e shënojmë në rubrikën e majtë, pastaj në rubrikën e mesme 23, dhe në të djathtën numrin 24. Në këtë mënyrë vazhdohet me rubrikat e tjera.

Në anën e djathtë, së pari mbushet rubrika e zbrazët në rreshtin e fundit, ku kemi të dhënë mbledhorin e parë, që është 7, kemi shumën 24, ndërsa mungon mbledhori i dytë. Nga këtu del se 24 – 7 = 17, prandaj numrin 17 e vendosim në rubrikën e zbrazët. Të gjitha rubrikat e tjera plotësohen njëjtë si në rastin e parë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e shumës së numrave pa dhe me kalim të dhjetëshes, zbulimin e rregullës për të njehsuar shumën e numrave dhe argumentimin e mbledhjes së numrave në bosht numerik.

Detyrë:

Detyra 7 (faqe 16).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 5

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3,13; III.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2,4,5; 2.4; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbledhja e numrave deri në 100 (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën e numrave natyrorë deri në 100;
- Plotëson trekëndshin magjik, duke llogaritur shumën e numrave të dhënë;
- Argumenton mbedhjen e numrave duke përdorur boshtin numerik.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: karta të numrave, bosht numerik, shkumësa me ngjyra, fletë A4, lego.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Fillohet me një diskutim rreth detyrave të orës së kaluar dhe më pas paraqitet tabela si në libër e cila plotësohet së bashku me nxënësit.
Kërkohet nga nxënësit të mbledhin numrin dyshifror me një numër njëshifror dhe të zbulojnë rregullën duke analizuar shigjetat.
Numrat dyshifrorë në drejtimin vertikal rriten për numrin njëshifror 3, ndërsa në drejtimin horizontal rriten për numrin 4.





Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Ditari dypjesësh

Udhëzohen nxënësit të bëjnë mbledhjen e numrave dyshifrorë në boshtin numerik, e po ashtu bëhet një rikujtim nga ora e kaluar lidhur me rëndësinë e dallimit të njësheve dhe dhjetësheve.

Kërkohet nga nxënësit të njehsojnë shumën e numrave dyshifrorë me kalim të dhjetëshes dhe të përshkruajnë se si e kryejnë veprimin.

Detyra	Përshkrimi
17 + 35 = 52 15 + 27 = 42	

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari në dyshe

Pjesa e mbetur e orës mund të zhvillohet duke i ndarë nxënësit në dyshe dhe duke kërkuar të zgjidhin detyrën 4 (dy shembujt e fundit), përderisa për shembullin e parë jepen udhëzimet për mënyrën se si duhet të zgjidhet. Pra, vizatohet në tabelë:



Kërkohet nga dyshet të mendojnë se si mund të plotësohet trekëndëshi magjik në të cilin shuma e numrave në secilën brinjë është e njëjtë, ku vetë shuma paraqet numrin magjik. Pasi merren mendimet e dysheve, plotësojmë brinjët e trekëndëshit në tabelë me numrat e duhur. Pra, kemi këta numra:

Brinja në të majtë: 18 + 7 + 25 = 50
Brinja në pjesën e poshtme: 18 + 15+17 = 50
Brinja në të djathtë: 25 + 8 +17 = 50
Dy trekëndëshat e tjerë që u jepen nxënësve janë të ngjashëm por duhet pasur kujdes.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e shumës së numrave natyrorë deri në 100, plotësimin e trekëndëshit magjik dhe argumentimin e mbledhjes së numrave duke përdorur boshtin numerik.

Detyrë:

Punohet një detyrë, sipas modelit të detyrës 4.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 6

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave deri në 1000.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.3,7; III.4,5; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,5; 2.1; 3.4; 5.1; 6.2; 7.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e numrave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përdor boshtin numerik për të njehsuar ndryshimin e numrave;
- Llogarit ndryshimin e numrave në shtyllë me dhe pa prishje të dhjetëshes;
- Zbulon rregullën e njehsimit në detyrat e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Rrugë për të lexuarit në matematikë

Paraqesim në tabelë detyrën 1 nga teksti, ndryshimin e numrave: 32-7=__ të paraqitur në boshtin numerik dhe analizohet së bashku me nxënësit përmes pyetjeve: **Numri 32 sa dhjetëshe dhe sa njëshe ka? - Numrit 32 cilin numër po ja zbresim së pari?** (*Numrin 2*).- **Pse?** (Që të mbesin 3 dhjetëshe). - **Numrit 30 sa po ja zbresim?** (*5*). **Pra, si po ndahet numri 7?** (në 2+5). - **Sa qenka ndryshimi i numrave 32 - 7?** (*25*). - **Si quhet numri 32?** (*I zbritshmi dhe paraqet tërësinë*). - **Po numri 7 çka paraqet?** (*Zbritësin apo pjesën që largohet*). - **Numri 25 si quhet?** (*Ndryshimi, pjesa që mbetet*).
Nxënësit udhëzohen që në dyshe të punohet detyra 2 në tekst. Udhëzohen që së bashku ta zgjidhin ndryshimin e parë përmes boshtit numerik, pastaj njëri nga ta e shpjegon metodën që e kanë përdorur



4 Njehsojmë në shtylla.

Me prishje të dhjetëshes.

Dhj	Nj
5	12
6	2
2	4
3	8

− 6 3 / 3 8 = ☐☐

− 8 4 / 4 7 = ☐☐

− 6 2 / 3 5 = ☐☐

− 7 5 / 2 6 = ☐☐

5 Zbulojmë rregullën dhe njehsojmë. Përshkruajmë rregullën me fjalë.

53 − 27 = ☐
54 − 28 = ☐
55 − 29 = ☐
56 − ☐ = ☐

63 − 28 = ☐
53 − 28 = ☐
43 − 28 = ☐
☐ − ☐ = ☐

81 − 26 = ☐
81 − 36 = ☐
81 − 46 = ☐
☐ − ☐ = ☐

Nëse të zbritshmit dhe zbritësit u shtojmë të njëjtin numër, ndryshimi mbetet i njëjtë.

6 Plotësojmë tabelat.

+		31		41	
54	77				
		78			
26					70
				73	
19			56		

−		27		38	
75	52				
				48	
94					49
		72			
100			70		

7 Në një shëtitje në bjeshkët e Rugovës, morën pjesë 46 nxënës të klasave të dyta dhe 38 nxënës të klasave të treta. Në klasat e dyta dhe të treta janë gjithsej 93 nxënës. Sa nxënës nuk kanë shkuar në shëtitje?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

Mësojmë

19

për njehsimin e detyrës. Gjithashtu veprohet njëjtë edhe me shembullin 2.

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Shkruhet në tabelë ndryshimi i numrave 98-64 në shtyllë dhe njëri nxënës e komenton me fjalë ecurinë e zbritjes. Parashtrohet pyetja: **Çfarë zbritje kemi?** (*Pa prishje të dhjetëshes*). Nxënësve u kërkohet ta njehsojnë ndryshimin në të dy shembujt e detyrës 3 në tekst. Njëjtë veprohet edhe për detyrën 4 duke e analizuar zbritjen me prishje të dhjetëshes.

Te detyra 5 nxënësit e përshkruajnë me fjalë rregullën e zbuluar. **Cila është rregulla te shembulli i dytë?** (*Nëse i zbritshmi zvogëlohet për një numër po për atë numër do të zvogëlohet edhe ndryshimi*). - Cila është rregulla e shembullit 3? (*Nëse zbritësi rritet për një numër, ndyshimi do të zvogëlohet për të njëjtin numër*).

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Shkëmbe problemin

Nxënësit u kërkohet ta përdorin mbledhjen dhe zbritjen në zgjidhjen e problemit nga jeta shkollore. Ata i udhëzojmë ta lexojnë problemin me fjalë në detyrën 7, të mundohen ta shkruajnë si barazim dhe ta zgjidhin. Pasi të zgjidhet i shkëmbejnë librat me shokun/shoqen e bankës dhe diskutojnë rreth zgjidhjes. Puna e tyre e pavarur vlerësohet. Në fund, paraqitet zgjidhja nga ana e një nxënësi në tabelë.

Zgjidhja është: 93 - (46+38) = 93-84 = 9. Pra, 9 nxënës nuk kanë shkuar në shëtitje.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përdorimin e boshtit numerik për të njehsuar ndryshimin e numrave, llogaritjen e ndryshimit të numrave në shtyllë dhe zbulimin e rregullës së njehsimit në detyrat e dhëna.

Detyrë:

Detyra 3 dhe 4 (faqe 19)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 7

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri në 1000.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.4,7; III.1,3,4,5; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.1,4; 3.1; 6.1; 7.1.


LIDHJA NDËRMJET MBLEDHJES DHE ZBRITJES

Po e paraqesim shumën e numrave 12 dhe 7 me modelin e mëposhtëm.

njëra pjesë, pjesa tjetër, tërësia
12, 7, 19
12 + 7 = 19

Kujtojmë
Ne mbledhim kur duam t'i bashkojmë pjesët në një tërësi.

Për të shkruar një barazi me zbritje, që ndërlidhet me barazinë 12 + 7 = 19, në fillim sqarojmë çka paraqet secili nga numrat në barazinë me mbledhje.

Mendojmë pastaj kuptimin e zbritjes.

pjesa që mbetet, pjesa që largohet
12, 7, 19, 19 – 7
19 – 7 = 12

Kujtojmë
Ne zbresim kur duam të largojmë një pjesë nga tërësia.

tërësia, pjesa që largohet, pjesa që mbetet
19 – 7 = 12

pjesa që largohet, pjesa që mbetet
12, 7, 19, 19 – 12
19 – 12 = 7

tërësia, pjesa që largohet, pjesa që mbetet
19 – 12 = 7

Fituam 4 barazi të ndërlidhura:

12 + 7 = 19
7 + 12 = 19
19 – 7 = 12
19 – 12 = 7

Kuptojmë
Nga cilado barazi rjedhin tri barazitë e tjera.

Të mbajmë në mend:
Barazitë e ndërlidhura formohen nga të njëjtët numra.

Një model i barazive të ndërlidhura.
19, 7, 12

1 Plotësojmë modelet me numrat që u mungojnë dhe shkruajmë barazitë e ndërlidhura:

49, 35 + 14
35 + 14 = 49
14 + 35 = 49
49 – 14 = 35
49 – 35 = 14

57 + 4

71, + 8

Mësojmë

20

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lidhja ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Argumenton lidhjen mes mbledhjes dhe zbritjes të numrave deri në 1000;
- Shkruan barazitë e ndërlidhura duke plotësuar modelet me numra që mungojnë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Lapsat në mes

Në tabelë shkruajmë tre numra: 19, 7, 12. Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe me nga 4 nxënës. Ata udhëzohen që me këta 3 numra, secili brenda grupit, duhet të shkruajë një barazim duke përdorur një ngjyrë të caktuar sipas dëshirës.
Pasi t'i shkruajnë, përzgjidhet një laps me ngjyrë të caktuar, brenda çdo grupi dhe nxënësi me lapsin e përzgjedhur e lexon barazimin e tij para klasës, ku shoku/shoqja e tij e shkruan në tabelë.
P.sh.: 12 + 7 = 19; 19 - 7 = 12;
7 + 12 = 19; 19 - 12 = 7.



Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Pyetja sjell pyetjen

Paraqitet në tabelë modeli i mbledhjes dhe i zbritjes si ai në tekst dhe sqarohet se çka paraqet secili nga numrat në barazimet e shkruara në fillim të orës.

Çka paraqet mbledhori i parë, numri 12? (*Njërën pjesë*).
Çka paraqet mbledhori i dytë, numri 7? (*Pjesa tjetër*).
Po shuma, numri 19? (*Tërësia*).
Çka paraqet i zbritshmi, numri 19 te barazimi 19-7? (*Tërësinë*).
Çfarë paraqet zbritësi, numri 7? (*Pjesën që largohet*).
Po ndryshimi, numri 12? (*Pjesën që mbetet*).
Paraqitet në tabelë modeli i barazive të ndërlidhura, si në tekst.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Mendo/shkruaj/thuaja grupit

Nxënësit udhëzohen të punojnë të pavarur detyrën 1 në tekst. Ata së pari do t'i plotësojnë modelet me numra që u mungojnë e pastaj do të shkruajnë 4 barazimet e ndërlidhura.



57 + 4 = 61
4 + 57 = 61
61 - 4 = 57
61 - 57 = 4

Nxënësit punojnë në dyshe, ku njëri plotëson shembullin e parë e tjetri shembullin e dytë. Pas plotësimit shkëmbehen librat mes vete që të kontrollohen dhe vlerësohen nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në argumentimin e ndërlidhjes së mbledhjes dhe zbritjes dhe shkrimin e barazimeve të ndërlidhura duke plotësuar modelet me numra që mungojnë.

Detyrë:

Punohet një detyrë sipas modelit të detyrës 1.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 8

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.4,7; III.1,3,4,5; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4; 2.2; 3.4; 4.2,3; 7.1.


Numrat magjikë

5 Njehsojmë ndryshimin. Çfarë modele numrash dallojmë?

21 – 12 = 42 – 24 = 41 – 14 = 62 – 26 =
43 – 34 = 64 – 46 = 52 – 25 = 73 – 37 =
76 – 67 = 75 – 57 = 85 – 58 = 84 – 48 =
87 – 78 = 97 – 79 = 96 – 69 = 95 – 59 =

6 < = > ?

41 + 9 ○ 63 – 7 93 – 5 ○ 88 + 5
76 + 3 ○ 84 – 3 53 – 7 ○ 54 + 5
80 + 3 ○ 90 – 7 42 – 6 ○ 35 + 3
37 + 4 ○ 52 – 4 83 – 5 ○ 69 + 7

7 Mbi tavolinë janë tri enë qelqi me bonbone. Në enën e parë janë 15 bonbone, në të dytën 26 dhe në të tretën 18. Erinda mori 12 bonbone nga ena e dytë. Ajo i vendosi 8 bonbone në enën e parë, kurse pjesën tjetër në enën e tretë.

1. Sa bonbone kanë mbetur në enën e parë?
Njehsojmë:
Përgjigjja:

2. Sa bonbone kanë mbetur në enën e dytë?
Njehsojmë:
Përgjigjja:

3. Sa bonbone kanë mbetur në enën e tretë?
Njehsojmë:
Përgjigjja:

4. Sa bonbone janë në të tria enët së bashku?
Njehsojmë:
Përgjigjja:

Ushtrojmë

22

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbledhja dhe zbritja (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson ndryshimin dhe shumën e numrave të dhënë;
- Demonstron shkathtësi në zgjidhjen e problemave duke zbatuar mbledhjen dhe zbritjen.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Mendo/puno në dyshe/thuaja grupit

Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe për plotësimin e skemës në detyrën 1, në tekst. Udhëzohen t'i përcjellin shigjetat. Nëse kanë vështirësi udhëzohen p.sh., së pari plotësohet pjesa e sipërme. **Shigjeta nga cili numër po niset?** (*Numri 17*) - **Te cili numër po arrin?** (*Numri 26*). - **Çfarë paraqet numri 17?** (*Mbledhorin e parë*). - **Po numri 26?** (*Shumën*). - **Çfarë na mungon?** (*Mbledhori i dytë*). Pasi ta njehsojnë vazhdojnë ta plotësojnë skemën. Në fund, një dyshe e komenton radhën e plotësimit.
Nxënësit në dyshe njehsojnë ndryshimin e numrave 82 – 28 =__, në detyrën 2, ku njëri punon njërën mënyrë të njehsimit kurse nxënësi tjetër mënyrën e dytë. Në fund, shkëmbehen librat mes dyshes dhe komentohen dy mënyrat e njehsimit.
Ku dallohen këto 2 mënyra mes vete?



8 Njehsojmë më shpejt.

34 + 19 =
28 + 19 =
72 + 19 =
61 + 29 =
45 + 39 =
37 + 49 =

Udhëzim
34 + 19 = ☐
=
34 + 20 − 1 = ☐

Udhëzim
86 − 49 = ☐
=
86 − 50 + 1 = ☐

86 − 49 =
92 − 49 =
78 − 49 =
45 − 19 =
64 − 29 =
54 − 39 =

9 Tri nga kutizat përmbajnë shprehje me vlera të barabarta. Identifikoni ato duke i ngjyrosur me ngjyrë të njëjtë.

58 − 29	65 − 39	47 + 40 − 1	57 + 30	65 − 40 + 1	66 − 40
59 − 30	58 + 29	58 − 30 + 1	47 + 39	58 + 30 − 1	46 + 40

10 Për numrat e dhënë plotësojmë modelin dhe shkruajmë barazitë:

72 45 27

☐ 15 99

11 Llogaritim përmendsh:

30
Shoqërojmë mbledhorët për të fituar dhjetëshe.
7 + 6 + 23 = ☐

14 + 15 + 16 = ☐
27 + 28 + 33 = ☐
13 + 38 + 7 + 5 + 12 = ☐
17 + 25 + 13 + 9 + 11 = ☐
19 + 5 + 12 + 21 + 18 = ☐

12 Përdorim tiketat me shifrat 1 2 3 6 për të shkruar numra dyshifrorë. Me këta numra shkruajmë:

- tri shprehje numerike me nga dy mbledhorë, vlerat e të cilave janë më të mëdha se 80,
- shprehjen numerike me dy mbledhorë që ka vlerën më të vogël,
- tri shprehje numerike me zbritje, vlerat e të cilave janë më të vogla se 20,
- shprehjen numerike me zbritje, që ka vlerën më të madhe.

63 + 21 > 80
Në çdo shprehje, secila shifër përdoret vetëm një herë.

Ushtrojmë

23

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
D.R.T.A.

Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe në detyrën 5, ku nxënësi 1 e njehson ndryshimin në 2 shtyllat e para kurse nxënësi 2 në dy të fundit. Pas njehsimit bashkëpunojnë në pyetjet, si: **Çfarë modele numrash dallojmë?** (*9, 18, 27, 36*).
A mendoni që kanë diçka të përbashkët?
Në detyrën 7 kërkohet zgjidhja për 4 raste, por fillimisht duhet njehsuar zhvendosjen e bomboneve nga njëra enë në tjetrën.
Përgjigjet në pyetjet janë:
1. Në enën e parë janë bërë 15 + 8 = 23 bombone.
2. Në enën e dytë kanë mbetur 26 - 12 = 14 bombone.
3. Në enën e tretë janë bërë 18+(12-8) =18+4=22 b.

Nga dy shembujt e detyrës 8 nxënësit njehsojnë më shpejt shumën dhe ndryshimin sipas udhëzimit të dhënë. Komentohet njehsimi para klasës. **Si e njehsuat shumën më shpejt?** (*Duke e rritur mbledhorin e dytë në numër të plotë më të afërt. Pastaj, shumës ia heqim aq për sa e kemi rritur mbledhorin e dytë*).

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Nxënësit udhëzohen që duke shoqëruar mbledhorët për të fituar dhjetëshe, të njehsojnë shumën në tre shembujt e detyrës 11. Ata punojnë të pavarur dhe puna e tyre vlerësohet.
Nxënësit në dyshe i përdorin etiketat e shpërndara me shifrat 1 2 3 6 për të shkruar numra dyshifrorë. Me këta numra do të shkruajnë: tri shprehje numerike me nga dy mbledhorë, vlerat e të cilave janë më të mëdha se 80 (kërkesa e parë në detyrën 12).
Pasi t'i shkruajnë paraqiten para klasës, në tabelë, p.sh., 21 + 63 > 80; 61 + 32 > 80; 62 + 31 > 80.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e ndryshimit dhe shumës së numrave dhe demonstrimin e shkathtësive në zgjidhjen e problemave.

Detyrë:
Detyra 9 dhe 10 (faqe 23)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 9

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Demostron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3,13,14; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.4; 4.5; 7.1.


SHUMËZIMI I NUMRAVE

Të kujtojmë:
Shumëzimi është shuma e mbledhorëve të barabartë.

5 • 3 =

+3 +3 +3 +3 +3
0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15 16 17

3 + 3 + 3 + 3 + 3 = 15
3 + 3 + 3 + 3 + 3 = 5 • 3

faktorët prodhimi
5 • 3 = 15

Numrat që formojnë një prodhim quhen faktorë të atij prodhimi.

Një interpretim:
Në figurë, 15 kristale janë ndarë në 5 grupe me nga 3 kristale.

numri i grupeve | numri në secilin grup | numri i tërësishëm
5 • 3 = 15

Kur shumëzojmë, bashkojmë grupet me numër të njëjtë të objekteve.

numri në secilin grup | numri i grupeve | numri i tërësishëm
3 • 5 = 15

15 kristale

1 Analizojmë figurën. Pjesën e katrorëve të ngjyrosur me ngjyrë të njëjtë e shprehim me barazi me shumëzim.

3 • 7 = 21
3 • 3 = 9

2 Përdorim saktësisht një herë secilën nga shifrat e dhëna dhe plotësojmë barazitë:

2 3 4
5 6 8

= 16
= 18
= 20

3 4 5
6 8 9

= 24
= 30
= 36

Mësojmë

24

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi i numrave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Kryen shumëzimin e numrave njëshifrorë;
- Shkruan barazi të shumëzimit bazuar në figurën e dhënë;
- Plotëson barazi duke përdorur shifrat e dhëna në detyrë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi/ja e rikujton së bashku me nxënësit tabelën e shumëzimit të mësuar nga viti i kaluar. Ua rikujtojmë nxënësve që shumëzimi i dy numrave njëshifrorë realizohet njëjtë sikurse gjatë realizimit të shumës së mbledhorëve të njëjtë si, p.sh.:

2·5=10 ose 2+2+2+2+2=10 ose 5+5=10

Aludojmë që rasti i parë, numri 2, mblidhet si mbledhor pesë herë me vetveten dhe në rastin e dytë, numri 5, dy herë me vetveten dhe fitohet shumë e njëjtë.


SHUMËZIMI I NUMRAVE

Të kujtojmë:
Shumëzimi është shuma e mbledhorëve të barabartë.

5 • 3 =

+3 +3 +3 +3 +3

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15 16 17

3 + 3 + 3 + 3 + 3 = 15
3 + 3 + 3 + 3 + 3 = 5 • 3

faktorët prodhimi

5 • 3 = 15

Numrat që formojnë një prodhim quhen faktorë të atij prodhimi.

Një interpretim:

Në figurë, 15 kristale janë ndarë në 5 grupe me nga 3 kristale.

numri i grupeve | numri në secilin grup | numri i tërësishëm

5 • 3 = 15

Kur shumëzojmë, bashkojmë grupet me numër të njëjtë të objekteve.

numri në secilin grup | numri i grupeve | numri i tërësishëm

3 • 5 = 15

15 kristale

1 Analizojmë figurën. Pjesën e katrorëve të ngjyrosur me ngjyrë të njëjtë e shprehim me barazi me shumëzim.

3 • 7 = 21
3 • 3 = 9

2 Përdorim saktësisht një herë secilën nga shifrat e dhëna dhe plotësojmë barazitë:

2 3 4
5 6 8

• = 16
• = 18
• = 20

3 4 5
6 8 9

• = 24
• = 30
• = 36

Mësojmë

24

Në lidhje me këtë aludim sqarojmë në shembullin fillestar në fq. 24 se si është fituar prodhimi 5·3=15

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Pyetja sjell pyetjen

Nga shembulli 1 në fq. 24 nxënësit në mënyrë individuale duhet që fushat e ngjyrosura me ngjyrë të njëjtë dhe duke numruar katrorët horizontalisht dhe vertikalisht ta kuptojnë për çfarë shumëzimi të numrave bëhet fjalë dhe cili është barazimi.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Mendo/ Gjej rezultatin/ Diskuto në grup

Për secilin grup të klasës të përbërë prej 4 nxënësve, përgatisim zarfe me nga 8 numra dyshifrorë të ndryshëm. Nxënësit në grupe së pari kanë për të tërhequr dy numra rastësisht nga zarfi dhe kanë për t'i krahasuar ata ndërmjet vete. Pastaj si detyrë e dytë ata kanë për t'i nxjerrë të gjithë numrat nga zarfi dhe duhet t'i rendisin: grupi 1 dhe 3, nga më i vogli deri te më i madhi, ndërsa grupet 2, 4 dhe 5 të kundërtën, nga më i madhi deri te më i vogli.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në kryerjen e shumëzimit të numrave njëshifrorë, shkrimin e barazive bazuar në figurë dhe plotësimin e barazive duke përdorur shifrat e dhëna në detyrë.

Detyrë:

Shkruhen pesë barazime të shumëzimit sipas modelit të detyrës 2.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 10

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta të bazuara në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave;
Përcakton vlerën numerike të shprehjeve të përbëra.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3,13,14; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.4; 4.5; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vetitë e shumëzimit



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Zbaton vetinë komutative dhe asociative të shumëzimit në barazimet e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Paraprakisht vizatojmë një bosht numerik në tabelë nga 0 deri në 20. Fillojmë me pyetjen për nxënësit: Nëse fillojmë nga zero dhe kalojmë 5 herë nga 4 njësi, a mund ta kuptoni se te cili numër do të arrijmë? Pra, duhet potencuar para nxënësve që të njëjtën pyetje mund ta realizojmë në dy rrugë të ndryshme, e para duke kaluar 5 herë nga 4 njësi dhe e dyta duke kaluar 4 herë nga 5 njësi.

Pas diskutimeve nga nxënësit fillojmë plotësimin e detyrës 1 në faqe 25. Pas plotësimit të detyrës 1,


VETITË E SHUMËZIMIT

Ndërrimi i vendeve të faktorëve - vetia komutative

1 Analizojmë paraqitjen grafike. Plotësojmë dhe njehsojmë.

Shuma e mbledhorëve të njëjtë

Prodhimi

Krahasojmë prodhimet:

Ndërtojmë një model:

4–shtylla

5–rreshta

5 • 4 = 20

5–shtylla

4–rreshta

4 • 5 = 20

5 • 4 = 20
4 • 5 = 20
mendojmë renditjen
5 • 4 = 4 • 5

Ndërrimi i faktorëve nuk e ndërron vlerën e prodhimit.

2 Pa njehsuar, plotësojmë.

7 • 9 = 9 • ☐
8 • 9 = ☐ • 9

☐ • 7 = 7 • 5
8 • ☐ = 7 • 8

☐ • 7 = 4 • ☐
7 • ☐ = ☐ • 6

Shoqërimi i vendeve të faktorëve - vetia asociative

3 • 5
3 • 5
2 • (3 • 5)
(2 • 3) • 5

1

(2 • 3) • 5 = 2 • (3 • 5)
Shoqërimi i faktorëve nuk e ndërron vlerën e prodhimit.

mendojmë shoqërimin
(2 • 3) • 5 = 2 • (3 • 5)
6 • 5 = 2 • 15
30 = 30

Hësojmë

25

sqarojmë para nxënësve që barazimi i mësipërm 4·5=5·4 quhet vetia e ndërrimit të vendeve apo vetia komutative.

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Vazhdojmë me pjesën e detyrës 2 nga vetë nxënësit, gjithmonë duke respektuar vetinë e ndërrimit të vendeve apo vetinë komutative që mësuam më sipër. Gjatë zgjidhjes së detyrës 3 së pari ne sqarojmë modelin e blloqeve, ku ky model tregon qartë vetinë e shoqërimit. Pra, u tregojmë nxënësve që numri jashtë kllapave te pjesa e shumëzimit, shoqëron të dy faktorët brenda kllapave. Vetia e dytë e shumëzimit është vetia e shoqërimit apo vetia asociative. Modelojmë një shembull për të parë se a është kuptuar nga nxënësit vetia asociative.

$$2\cdot(5\cdot4)=(2\cdot5)\cdot4$$
$$2\cdot20=10\cdot4$$
$$40=40$$

U tregojmë nxënësve që te vetia asociative, shoqërimi i faktorëve nuk e ndryshon vlerën e prodhimit:

$$2\cdot(5\cdot4)=(2\cdot5)\cdot4$$

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Mendo/ Gjej rezultatin/ Diskuto në grup

Për secilin grup të klasës të përbërë prej 4 nxënësve, përgatisim nga katër detyra që kanë të bëjnë me dy vetitë e mësuara më poshtë:
Duke zbatur vetitë komutative dhe asociative, zgjidhni:

2·8=__·2
6·_=__·6
__·__=__·__
2·(5·__)=(2·5)·__
8·(1·__)=(8·__)·__

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zbatimin e vetisë komutative dhe asociative në barazimet e dhëna.

Detyrë:

Zbatohet vetia komutative dhe asociative në pesë detyra me shumëzim.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 11

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta të bazuara në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave;
Përcakton vlerën numerike të shprehjeve të përbëra.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3,13,14; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.4; 4.5; 7.1.


Shumëzimi i shumës dhe i ndryshimit - vetia distributive

1 Shumëzimi i shumës.

2 Shumëzimi i ndryshimit.

3 Analizojmë figurat, njehsojmë dhe plotësojmë.

Mësojmë

26

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi i shumës dhe i ndryshimit - vetia distributive

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Zbaton vetinë distributive në barazimet e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Në pjesën hyrëse duhet të rikujtohet me ndonjë shembull vetia e ndërrimit të vendeve të faktorëve; nga ky arsyetim nisemi në vetinë që do ta sqarojmë ditën e sotme.



Shumëzimi i shumës dhe i ndryshimit - vetia distributive

1 Shumëzimi i shumës.

2 • 7 = 14
3 • 7 = 21
5 • 7 = 35

2 • 7 + 3 • 7 = 5 • 7
= (2 + 3) • 7

2 • 7 + 3 • 7 = (2 + 3) • 7
Mbledhim rreshtat, ndajshkruajmë shtyllat.

4 • 3 =
3 • 3 =
7 • 3 =

2 Shumëzimi i ndryshimit.

8 • 5 = 40
3 • 5 = 15
5 • 5 = 25

8 • 5 – 3 • 5 = 5 • 5
= (8 – 3) • 5

8 • 5 – 3 • 5 = (8 – 3) • 5
Zbresim rreshtat, ndajshkruajmë shtyllat.

7 • 7 =
4 • 7 =
3 • 7 =

3 Analizojmë figurat, njehsojmë dhe plotësojmë.

• 3 =
• 5 =
• =

• =
• =
• =

• 9 =
• 2 =
• =

Mësojmë

26

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Në këtë pjesë të orës mësimore vazhdojmë me sqarimin e pjesës së parë të detyrës 1 në faqe 26 duke diskutuar hap pas hapi shumëzimin e shumës së numrave të dhënë: (2+3)·7=2·7+3·7=14+21=35.

Që të konstatohet më qartë se sa është kuptuar kjo rregull, i udhëzojmë nxënësit ta zgjidhin pjesën e dytë të detyrës 1.

Zgjidhim së bashku me nxënësit edhe detyrën 2, gjithnjë duke u mbështetur në shembullin e sqaruar në pjesën e parë me anë të shumës dhe duke arsyetuar të njëjtën metodë me anë të ndryshimit të numrave:
(8-3)·5=8·5+3·5=40+15=55.

Që të konstatohet më qartë se sa është kuptuar kjo rregull, i udhëzojmë nxënësit ta zgjidhin pjesën e dytë të detyrës 2. Pas zgjidhjes përkufizojmë që faktori i jashtëm i prodhimit shumëzon dy mbledhorët apo të zbritshmin dhe zbritësin në kllapa, këtë e quajmë vetia distributive e shumës dhe ndryshimit të numrave.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Rishikim në dyshe

Detyra 3: Nxënësit udhëzohen që duke analizuar figurat, njehsojnë dhe plotësojnë detyrën e dhënë. Pastaj në dyshe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zbatimin e vetisë distributive në barazimet e dhëna.

Detyrë:

Njehsohet prodhimi i shumës dhe i ndryshimit të pesë detyrave duke e zbatuar vetinë distributive.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 12

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta të bazuara në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave;
Përcakton vlerën numerike të shprehjeve të përbëra.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3,13,14; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.4; 4.5; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi i numrave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson prodhimin e numrave njëshifrorë;
- Zbaton vetitë e shumëzimit në barazimet e dhëna;
- Identifikon vlerën e numrave të panjohur për të fituar barazi të sakta.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative


1 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelën.

Faktori i parë	5	3		7	2		10		7	9
Faktori i dytë	7		9	8		4		8	6	
Prodhimi		27	9		18	28	70	64		81

2 Analizojmë figurën. Pjesën e katrorëve të ngjyrosur me ngjyrë të njëjtë e shprehim me barazi me shumëzim.

3 Pa njehsuar, plotësojmë.
23 • 4 = 4 • ☐ ☐ • 8 = 8 • 9 ☐ • 3 = ☐ • 11

4 Pa njehsuar, plotësojmë.
3 • (2 • 4) = (3 • ☐) • 4
(6 • 2) • 7 = ☐ • (2 • 7)
3 • (☐ • 4) = (4 • 6) • 3
(11 • ☐) • 2 = 3 • (2 • 11)

5 Shenjojmë me √ shprehjen që ka vlerë të barabartë me:
4 • 6
2 • 2 + 3 • 3 ☐
4 • 3 + 4 • 6 ☐
3 • 3 + 3 • 3 ☐
4 • 2 + 4 • 4 ☐
zbatojmë rjetin dhe ndërtojmë modelin
3 • 7
2 • 1 + 3 • 4 ☐
2 • 3 + 2 • 4 ☐
3 • 5 + 3 • 2 ☐
3 • 7 + 3 • 7 ☐
zbatojmë rjetin dhe ndërtojmë modelin
Ushtrojmë
27

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Fillojmë mësimin e sotëm duke i udhëzuar nxënësit që ta rikujtojnë shumëzimin e numrave, duke zgjidhur detyrën 1, në mënyrë individuale në libër.

Duke rikujtuar vetinë e ndërrimit të vendeve - vetinë komutative zgjidhim detyrën 2, ku së pari nga mësimdhënësi/ja realizohet punimi i drejtkëndëshit me fusha të ndara sipas ngjyrave dhe nga 10 nxënës në tabelë, duke parë fushën e ngjyrosur ata duhet ta realizojnë shumëzimin e faktorëve.



Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e orientuar

Duke i respektuar vetitë e shumëzimit, udhëzojmë nxënësit të zgjidhin në dyshe detyrat 3, 4 dhe 6. Detyra 5 në faqe 27 duhet të zgjidhet në shtëpi nga nxënësit.

Detyrën 7 e zgjidhim së bashku me nxënës në tabelë, duke sqaruar se si formohet shuma e prodhimeve për të arritur barazimin 100, pastaj duke analizuar secilën ngjyrë se çfarë prodhimi të faktorëve përfaqëson.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Punë në dyshe

Këtë pjesë e vazhdojmë me zgjidhjen e detyrës 8 në libër nga nxënësit në dyshe, ku secila dyshe, duke respektuar atë që e sqaruam më sipër, së pari i ngjyrosin sipas dëshirës fushat e ndara me rrathë të vegjël sipas 4 ngjyrave, si: të kuqe, të kaltër, të verdhë dhe të gjelbër; pastaj formojnë shumën e prodhimeve për të nxjerrë barazimin 100.

Detyra 9 zgjidhet në tabelë nga mësimdhënësi/ja, duke sqaruar që katrorët me ngjyrë të njëjtë në kolonën e njëjtë duhet të kenë të përshkruar numër të njëjtë.
Pra, kolona e parë: katrori portokalli 25, katrori vjollcë 75 dhe katrori i gjelbër 100.
Kolona e dytë: katrori i kaltër 20, katrori i gjelbër 10 dhe katrori portokalli 30.
Kolona e tretë: katrori i kaltër 10, katrori i gjelbër 60 dhe katrori portokalli 20.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e prodhimit të numrave njëshifrorë, zbatimin e vetive të shumëzimit dhe identifikimin e vlerës së numrave të panjohur për të fituar barazi të sakta.

Detyrë:

Zgjidhet një detyrë sipas modelit të detyrës 8.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 13

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta të bazuara në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave;
Përcakton vlerën numerike të shprehjeve të përbëra.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3,13,14; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.4; 4.5; 7.1.



10 Njehsojmë dhe krahasojmë.

48 = □ • 4 | □ • 8 = 88 | 24 = □ • 2
37 > □ • 4 | □ • 8 ⬡ 60 | 63 > □ • 4
88 = □ • 4 | □ • 8 > 71 | 46 < □ • 8
27 < □ • 4 | 8 • 8 ⬡ 64 | 64 ⬡ 16 • 4

11 Njehsojmë; rezultatin e shenjojmë dhe e shkruajmë si prodhim të dy numrave.

60 – 18 = 6 • 7 | 97 – 89 = _____ | 38 + 32 = _____
27 + 29 = _____ | 43 + 47 = _____ | 73 – 55 = _____
76 – 26 = _____ | 64 – 28 = _____ | 6 + 39 = _____
13 + 59 = _____ | 36 + 27 = _____ | 93 – 45 = _____

48 90 45 36 70 42 18 8 56 72 63 50

12 Kuzhinierja e shkollës kishte përgatitur për drekë 9 pula. Ajo preu secilën pulë në 6 pjesë. Gjatë drekës u hëngrën 37 pjesë pule.
Shkruajmë shprehjen numerike që e tregon këtë: _____
Sa pjesë pule kanë mbetur pa u ngrënë?
Njehsojmë: _____
Përgjigjja: _____

13 Nxënësit e klasës së tretë i mbollën në oborrin e shkollës 7 rende me nga 9 lule të kaltra dhe 4 rende me nga 6 lule të kuqe. Të nesërmen ata vërejtën se në secilin rend kishte dështuar nga një lule. Sa lule kanë zënë në kopsht?
Njehsojmë: _____
Përgjigjja: _____

Ushtrojmë

29

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi i numrave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen faktorin e panjohur në barazimet dhe jobarazimet e dhëna;
- Krahason numrat dyshifrorë;
- Shkruan numrat dyshifrorë si prodhim të dy numrave;
- Zgjidh problema me fjalë;
- Përcakton vlerën e numrave që mbulohen nga figurat e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Fillojmë mësimin e sotëm duke i udhëzuar nxënësit që në mënyrë individuale, duke e rikujtuar shumëzimin e numrave zgjidhin detyrën 10 në faqe 29; në mënyrë individuale në libër, njehsojnë dhe krahasojnë anët e barazimit apo jobarazimit.
Detyrën 11 në faqe 29 e zgjidhim në tabelë së bashku me nxënës, gjithnjë duke sqaruar që rezultatin



14 Babai i bleu Erindit një bluzë dhe një palë pantallona. Pantallonat kushtuan dy herë me shumë se bluza. Ai pagoi gjithsej 45 euro. Sa kushtuan pantallonat dhe sa bluza?

+ = 45

= 2 •

Njehsojmë: _____ _____

_____ _____

Përgjigjja: _____

15 Figurat mbulojnë njërin nga numrat 1, 2, 3, 4 ose 5 në tabelë. Përcaktojmë numrat që mbulojnë ato, nëse është dhënë shuma e numrave në çdo rresht të tabelës.

11 (4)

13 (5)

14 (1) 4 • ___ + ___ = 14

16 (2)

19 (3)

3 2

16 Figurat mbulojnë njërin nga numrat 1, 2, 3, 4 ose 5 në tabelë. Përcaktojmë numrat që mbulojnë ato, nëse është dhënë shuma e numrave në çdo rresht të tabelës.

Nga rreshti i parë në tabelë vërejmë se mbulon një numër më të vogël se numri 3. Pse?

9 (2) 2• + = 7

12 (3) + = 5

14 (1) 3• + 2• = 14 3 • 4 + 2 • 1 = 14

18 (4)

19 (5)

4 1

Ushtrojmë

30

e fituar e eliminojmë dhe të njëjtin duhet ta shkruajnë si prodhim të të dy numrave, si p.sh.: 27+29=8·7

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Rrugëzgjidhje për të lexuarit matematik

Nxënësit ndahen në tri grupe. Grupi i parë e zgjidh detyrën 12; i dyti detyrën 13 dhe grupi i katërt e zgjidh detyrën 14. Përfaqësuesit e grupeve i paraqesin zgjidhjet përpara klasës.
Detyra 12: 9 *pula nga* 6 *pjesë* = 54 *pjesë pule*
9·6=54 *atëherë* 54-37=17. Kanë mbetur edhe 17 pjesë pule pa ngrënë.

Zgjidhim në tabelë problemat me fjalë:
Detyra 13: 7·9+4·6=63+24=87 *atëherë* 87-11=76.
Kanë zënë 76 lule në kopsht.

Zgjidhim në tabelë problemat me fjalë:
Detyra 14: *pantallonat* + *bluza* = 45 €
pantallona=2·*bluza*
P+B = 45 atëherë 2·B+B = 45 rrjedh 3B = 45 ose B = 15 €

Atëherë P = 2·B = 30 €. Pra gjejmë që pantallonat kushtojnë 30 € dhe bluza 15 €.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari në grupe/Lapsat në mes

Detyra 15: Nxënësit udhëzohen që në grup të përcaktojnë vlerën e numrave që mbulohen nga figurat e dhëna në detyrë. Pastaj, tërhiqet një laps, nxënësi përgjegjës i tij tregon vlerat e numrave që mbulohen nga figurat.
Zgjidhja e detyrës diskutohet edhe me grupet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e faktorit të panjohur në barazimet dhe jobarazimet e dhëna, krahasimin e numrave dyshifrorë, shkrimin e tyre si prodhim të dy numrave, zgjidhjen e problemave me fjalë dhe përcaktimin e vlerës së numrave që mbulohen nga figurat e dhëna.
Vlerat: ylli - 3; deltoidi - 2; trekëndëshi - 1; zemra - 5; gjysmëhëna - 4.

Detyrë:

Të punojnë detyrën 16 (faqe 30).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 14

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3,13; III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4,5; 2.4; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi i numrave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përdor vetinë komutative për gjetjen e shumës, ndryshimit, prodhimit dhe herësit të numrave;
- Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit.


Të kujtojmë:
Pjesëtimi është zbritje e njëpasnjëshme e numrit të njëjtë.
20 : 5 =
20 : 4 =
i pjesëtueshmi pjesëtuesi herësi
20 : 5 = 4
Të mbajmë mend:
Pjesëtuesi asnjëherë nuk mund të jetë 0.
Një interpretim:
Në figurë, 20 katrorë janë ndarë në 5 grupe me nga 4 katrorë.
20 : 5 = 4
numri i tërësishëm numri i grupeve numri në secilin grup
Kur pjesëtojmë, një bashkësi e ndajmë në grupe të barabarta.
20 : 4 = 5
numri i tërësishëm numri në secilin grup numri i grupeve
1 Njehsojmë dhe plotësojmë fjalitë.
14 : 1 = Nëse pjesëtuesi është 1, herësi është _____.
70 : 10 = Nëse shumëfishi i numrit 10 pjesëtohet me 10, të pjesëtueshmit i fshihet një _____ në anën e djathtë.
0 : 12 = Nëse zeron e pjesëtojmë me cilindo numër, herësi është _____.
17 : 0 Zeroja nuk mund të jetë _____.
2 Njehsojmë.
35 :5 72 :8 42 :7 45 :9
56 :8 27 :3 48 :6 60 :10
Mësojmë
31

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Bëhet një rikujtim i njohurive nga ora e kaluar. Pyeten nxënësit:
- *Çfarë është pjesëtimi?*

Shkruhen përgjigjet e tyre në tabelë dhe arrihet në përfundim se:
Pjesëtimi është zbritje e njëpasnjëshme e numrit të njëjtë.
Paraqitet në tabelë boshti numerik (si në detyrën 1 në faqe 31): Për ndryshim nga shumëzimi i cili kishte mbledhje të njëpasnjëshme, këtu llogaritet zbritja e njëpasnjëshme.



Të kujtojmë:
Pjesëtimi është zbritje e njëpasnjëshme e numrit të njëjtë.

20 : 5 =

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15 16 17 18 19 20

20 : 4 =

i pjesëtueshmi | pjesëtuesi | herësi

20 : 5 = 4

Të mbajmë mend:
Pjesëtuesi asnjëherë nuk mund të jetë 0.

Një interpretim:
Në figurë, 20 katrorë janë ndarë në 5 grupe me nga 4 katrorë.

20 : 5 = 4 (numri i tërësishëm | numri i grupeve | numri në secilin grup)

Kur pjesëtojmë, një bashkësi e ndajmë në grupe të barabarta.

20 : 4 = 5 (numri i tërësishëm | numri në secilin grup | numri i grupeve)

1 Njehsojmë dhe plotësojmë fjalitë.

14 : 1 = ☐ Nëse pjesëtuesi është 1, herësi është _____.

70 : 10 = ☐ Nëse shumëfishi i numrit 10 pjesëtohet me 10, të pjesëtueshmit i fshihet një _____ në anën e djathtë.

0 : 12 = ☐ Nëse zeron e pjesëtojmë me cilindo numër, herësi është _____.

~~17 : 0~~ Zeroja nuk mund të jetë _____.

2 Njehsojmë.

35 :5 ☐ 72 :8 ☐ 42 :7 ☐ 45 :9 ☐

56 :8 ☐ 27 :3 ☐ 48 :6 ☐ 60 :10 ☐

Mësojmë

31

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e drejtuar

Shpjegohet pjesëtimi duke paraqitur disa bashkësi:
Kur pjesëtojmë një bashkësi e ndajmë në grupe të barabarta.

20 : 5 = 4

Numri i tërësishëm
Numri i grupeve
Numri në secilin grup

Fillohet me zgjidhjen e disa detyrave duke filluar nga detyra 1 në faqe 31.
Jepen disa sqarime shtesë në lidhje me disa pjesëtime që kanë veti të veçanta:

- Pjesëtimi i parë: herësi është po aq sa është i pjesëtueshmi, pra 14.
- Pjesëtimi i dytë: të pjesëtueshmit i fshihet një zero.
- Pjesëtimi i tretë: herësi është zero.
- Pjesëtimi i katërt: zeroja nuk mund të jetë në vendin e pjesëtuesit.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Gjej zgjidhje/ Argumento

Ndahen nxënësit në 4 grupe ku secilit grup u caktohen nga dy detyra dhe kërkohet nga nxënësit të prezantojnë zgjidhjet duke përdorur boshtin numerik, bashkësitë dhe ndonjë formë tjetër.
Pas zgjidhjes së detyrave përfaqësuesi i grupit prezanton mënyrën e zgjidhjes para klasës.

Grupi i parë: 35 : 5 =__ Grupi dytë: 72:8 =__ Grupi tretë: 42: 7 = __ Grupi katërt: 45: 9 = __
56 : 8 =__ 27:3 =__ 48: 6 = __ 60:10=__

Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë lidhjen e pjesëtimit me zbritjen duke e paraqitur në boshtin numerik dhe me ndarjen e të pjesëtueshmit në pjesë të barabarta për të fituar herësin.
Në varësi të kohës mund të kërkojmë nga grupet të krijojnë një problemë të thjeshtë me pjesëtim. Problemën e krijuar e prezantojnë para klasës dhe e argumentojnë zgjidhjen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e numrave të dhënë dhe argumentimin e lidhjes së pjesëtimit me zbritjen e njëpasnjëshme.

Detyrë:

Të zgjjidhet një detyrë sipas modelit të detyrës 2.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 15

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3,13; III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4; 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lidhja ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Llogarit herësin dhe prodhimin e numrave në detyrat e dhëna;
- Zbaton lidhjen ndëmjet pjesëtimit dhe shumëzimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: karta me numra, letra me ngjyra, puzzle, lego.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Fillohet me një rikujtim nga ora e kaluar lidhur me pjesëtimin e numrave dhe lidhjen e pjesëtimit me mbledhjen, zbritjen dhe shumëzimin.
Jepen tre numra: 5, 15 dhe 3.
Kërkohet nga nxënësit të krijojnë 4 barazi (si në detyrën 1 faqe 32). Diskutohen barazitë e krijuara nga nxënësit dhe plotësohen aty ku ka nevojë.





LIDHJA NDËRMJET SHUMËZIMIT DHE PJESËTIMIT

1 Një fushë drejtkëndëshe me katrorë - 4 barazi:

15 katrorë
3 grupe të barabarta
5 në secilin grup

3 • 5 = 15
5 • 3 = 15
15 : 3 = 5
15 : 5 = 3

Kuptojmë
Nga secila barazi rrjedhin tri barazitë e tjera.

Një model i ndërlidhjes se numrave 3, 5 dhe 15.

2 Për secilën fushë drejtkëndëshe me katrorë, shkruajmë 4 barazi:

3 Plotësojmë modelet me numrin që u mungon dhe shkruajmë barazitë:

4 Njehsojmë dhe plotësojmë.

pjesëtimi
: 5
60
• 5
shumëzimi

60 : 5 = 12
12 • 5 = 60

75 : 5 ; • 5
95 : 5 ; • 5
50 :10 ; •10
80 :10 ; •10

5 Zbatojmë lidhjen ndërmjet pjesëtimit dhe shumëzimit, njehsojmë dhe plotësojmë.

24 : 3 = , sepse • 3 = 24
21 : 7 = , sepse • 7 = 21
63 : 9 = , sepse • 9 = 63

24 : 3 = , sepse • =
21 : 7 = , sepse • =
63 : 9 = , sepse • =

Mësojmë

32

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e drejtuar

Shpjegohet lidhja në mes shumëzimit dhe pjesëtimit me anë të skemës së paraqitur më poshtë:



Pra, 27 : 3 = 9, sepse 3 x 9 = 27. Mund të përdoren edhe çfarëdo figure apo skeme tjetër për të demostruar lidhjen ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit, madje edhe nëpërmjet boshtit numerik me mbledhjet dhe zbritjet e njëpasnjëshme.

Në fund bëhet prova :

60: 5= 12
12 x 5=60

Përveç sqarimit rreth provës, nxënësit duhet ta kenë të qartë se herësi i gjetur (nga i pjesëtueshmi dhe pjesëtuesi), në fakt, gjatë provës, shndërrohet në faktor të prodhimit, i cili shumëzohet pastaj me pjesëtuesin, dhe si rezultat (si provë) duhet të japë vlerën e të pjesëtueshmit.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Lapsat në mes

Detyra 5: Nxënësit në grupe udhëzohen që të njehsojnë dhe plotësojnë detyrën e dhënë duke zbatuar lidhjen në mes shumëzimit dhe pjesëtimit.
Çdo grup tërheq një nga lapsat dhe nxënësi përgjegjës argumenton zgjidhjen e detyrës së dhënë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e herësit dhe prodhimit të numrave dhe zbatimin e lidhjes së tyre në detyrat e dhëna.

Detyrë:

Detyra 5 (faqe 32)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 16

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3,14; III.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4,5; 2.4; 7,1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lidhja ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen numrin që mungon në tabelën e dhënë;
- Llogarit dhe krahason herësin a prodhimin e numrave dyshifrorë me numër njëshifror;
- Zgjidh problema me fjalë, duke përdorur veprimin e shumëzimit, mbledhjes dhe pjesëtimit.


1 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelën.

I pjesëtueshmi	32	54		81	27		63			70
Pjesëtuesi	8		8			8		4	8	
Herësi		6	7	9	3	8	7	9	9	7

2 < = > ?

7 · 6 ◯ 9 · 4 3 · 8 ◯ 9 · 1 8 · 9 ◯ 10 · 7
18 : 9 ◯ 7 · 1 27 : 9 ◯ 24 : 8 81 : 9 ◯ 2 · 9
6 · 0 ◯ 0 : 8 16 : 8 ◯ 28 : 7 9 · 7 ◯ 63 : 7
3 · 9 ◯ 2 · 8 56 : 7 ◯ 54 : 9 9 · 6 ◯ 7 · 6

3 Në galerinë e qytetit gjenden 72 piktura. Pikturat janë shpërndarë në mënyrë të barabartë në 9 hapësirat e galerisë. Nga sa piktura janë në secilën hapësirë?
Njehsojmë:
Përgjigjja:

4 Prodhimin e numrave 8 dhe 9 e rritim për herësin e numrave 63 dhe 7. Cili numër fitohet?
Njehsojmë:
Përgjigjja:

5 Njehsojmë dhe plotësojmë.

7 herë më i vogël		8 herë më i madh		për 9 më i vogël	
28	4	32	23		
42					
63					
70					

Ushtrojmë

33

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Karta me numra, fletë me ngjyra, puzzle.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Tabela e koncepteve

U jepen sqarimet e nevojshme dhe provohet nëse nxënësit mund t'i plotësojnë rubrikat e zbrazëta në mënyrë të pavarur.

I pjesëtueshmi	32	54		81	27		63		70
Pjesëtuesi	8		8			8		4	
Herësi		6	7	9	3	8	7	9	7

Siç shihet nga tabela, në shtyllën e parë kemi të bëjmë me pjesëtimin e numrave 32 dhe 8, pra mungon herësi i cili është numri 4.



1 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelën.

I pjesëtueshmi	32	54		81	27		63			70
Pjesëtuesi	8		8			8		4	8	
Herësi		6	7	9	3	8	7	9	9	7

2 < = > ?

7 · 6 ◯ 9 · 4	3 · 8 ◯ 9 · 1	8 · 9 ◯ 10 · 7
18 : 9 ◯ 7 · 1	27 : 9 ◯ 24 : 8	81 : 9 ◯ 2 · 9
6 · 0 ◯ 0 : 8	16 : 8 ◯ 28 : 7	9 · 7 ◯ 63 : 7
3 · 9 ◯ 2 · 8	56 : 7 ◯ 54 : 9	9 · 6 ◯ 7 · 6

3 Në galerinë e qytetit gjenden 72 piktura. Pikturat janë shpërndarë në mënyrë të barabartë në 9 hapësirat e galerisë. Nga sa piktura janë në secilën hapësirë?

Njehsojmë:

Përgjigjja:

4 Prodhimin e numrave 8 dhe 9 e rritim për herësin e numrave 63 dhe 7. Cili numër fitohet?

Njehsojmë:

Përgjigjja:

5 Njehsojmë dhe plotësojmë.

	7 herë më i vogël		8 herë më i madh		për 9 më i vogël	
28	→	4	→	32	→	23
42	→		→		→	
63	→		→		→	
70	→		→		→	

Ushtrojmë

33

Në shtyllën e dytë mungon pjesëtuesi, kërkohet të pjesëtohet i pjesëtueshmi me herësin që të fitohet pjesëtuesi i cili është 9.

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Fillohet me detyrën 2 në libër, ku së bashku me nxënësit vendosen shenjat : >,<,=.

Gjatë shqyrtimeve dhe zgjidhjeve që gjenden së bashku, ju rikujtohet që në rastin kur zero pjesëtohet me një numër rezultati është zero.

Në vazhdim lexohen detyrat me fjalë dhe kërkohet nga nxënësit të njehsojnë dhe të përshkruajnë mënyrën e gjetjes së zgjidhjes. Krahasohen rezultatet e tyre, përmirësohen sipas nevojës dhe argumentohen ato.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Lapsat në mes

Varësisht prej kohës në dispozicion, detyra 5 mund të zgjidhet nga nxënësit duke i zbatuar njohuritë që i kanë fituar më herët.
Plotësohen rubrikat e zbrazëta në libër, kontrollohen rezultatet nga anëtarët e grupit dhe përmes teknikës "Lapsat në mes", përfaqësuesit e grupeve i paraqesin rezultatet e fituara para klasës.
Diskutohen paqartësitë eventuale, si dhe vështirësitë e hasura gjatë zgjidhjes së detyrave.
Zgjidhet grupi fitues i cili ka arritur me kohë dhe saktë të gjejë rezultatet e kërkuara.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e numrit që mungon në tabelën e dhënë, llogaritjen dhe krahasimin e herësit dhe prodhimit të numrave dyshifrorë me numër njëshifror dhe zgjidhjen e problemave me fjalë duke përdorur veprimin e shumëzimit, pjesëtimit dhe mbledhjes së numrave.

Detyrë:
Të zgjidhet një detyrë sipas modelit të detyrës 5.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 17

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3,13; III.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1,1,4,5; 2.4; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lidhja ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit (ushtrime)


6 Ngjyrosim fushat me numrat që nuk pjesëtohen me numrin:

3 → 25 13 18 35 0 21 26 25 15 96 100 69 75 70 66 65
6 → 10 17 20 36 0 42 26 60 15 90 100 69 80 70 66 72
5 → 25 12 18 35 0 20 26 36 15 95 100 69 74 70 66 75
10 → 10 13 20 35 0 40 26 60 15 90 100 69 80 70 76 85

7 Kuzhinieri ka porositur 3 pako me mollë. Në secilën pako janë nga 4 kilogramë mollë. Ai këto mollë i ka ndarë në mënyrë të barabartë në 6 shporta. Nga sa kilogramë mollë ka në secilën shportë?
Shprehja numerike:
Përgjigjja:

8 Shkruajmë të gjithë numrat që pjesëtohen me numrin 7 dhe që ndodhen ndërmjet numrave 11 dhe 74.
Numrat e kërkuar janë:

9 Nëna është 25 vjeçe, kurse Erinda është 5-fish më e re se nëna. Sa vjeçe është Erinda?
Njehsojmë:
Përgjigjja:
Sa vjet kanë së bashku nëna dhe Erinda?
Njehsojmë:
Përgjigjja:

10 Për një shfaqje në teatrin e qytetit, tre të rritur dhe tre fëmijë kanë paguar 39 euro. Sa ka mundur të kushtojë një biletë për një të rritur dhe sa për një fëmijë?
Nëse dihet se një biletë për një të rritur kushton më shumë se për një fëmijë, përcaktojmë të paktën tri raste të mundshme të çmimeve të biletave.

Për lehtësi, numrin 39 e shkruajmë si shumë të dy numrave që pjesëtohen me 3, p.sh.:
39 = 12 + 27

Ushtrojmë

34

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Identifikon numrat që nuk pjesëtohen me numrat e dhënë në detyrë;
- Zgjidh problema me fjalë, duke përdorur veprimin e shumëzimit, pjesëtimit dhe mbledhjes;
- Plotëson barazitë duke përdorur vetëm një herë secilën nga shifrat e dhëna;
- Gjen vlerën e shifrës që mbulohet nga figura.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: karta me numra, shkumësa me ngjyra, puzzle.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Në pjesën hyrëse të orës bëhet një përsëritje me pjesëtimin e numrave dyshifrorë me numra njëshifrorë që është punuar më herët.
Gjejmë pjesëtuesit e numrave 7, 8 dhe 10.
Ja disa shembuj të mundshëm:
7 ⟶ (14, 21, 28, 35, 42, 49, 56, 63, 70, 77, 84, ...)



Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Në fazën e realizimit fillohet me detyrën 1, faqe 34, ku së bashku me nxënësit duhet të ngjyrosen rubrikat të cilat e plotësojnë kushtin e caktuar në lidhje me pjesëtimin:

3	25, 13, 18, 35, 0, 21, 26, 15, 96, 100, 69, 75, 70
6	
5	

Gjatë shqyrtimit duhet të ceket kërkesa e detyrës që duhet të ngjyrosen numrat që nuk pjesëtohen me numrat e dhënë. Në vazhdim, merret një detyrë logjike për zgjidhjen e së cilës mund të kërkohet edhe ndihma e boshtit numerik.
Detyra 8: Shkruaj të gjithë numrat që pjesëtohen me numrin 7 dhe ndodhen ndërmjet numrave 11 dhe 74. Udhëzohen nxënësit që ta ndërtojnë boshtin numerik, nga 11 deri 74 me njësi-gjatësi 1, e pastaj t'i identifikojnë të gjithë numrat që pjesëtohen me 7. Nëse konsiderohet se ka shumë njësi të tilla të shënohen (boshti numerik na del shumë i gjatë), atëherë, zgjidhjen e detyrës e konsiderojmë si varg numerik. Pra, numri i parë që është më i madh se numri 11 dhe që pjesëtohet me 7, është numri 14. Pastaj, çdo anëtar tjetër i këtij vargu duhet të rritet për 7, sepse edhe ai pjesëtohet me 7, dhe kështu vazhdohet deri te numri 84, i cili gjithashtu pjesëtohet me 7.
Përfundimisht kemi: 7, 14, 21, 28, 35, 42, 49, 56, 63, 70, 77, 84.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Zgjidh një problemë/ Rishikim në dyshe

Nxënësit udhëzohen që në mënyrë të pavarur të gjejnë zgjidhje e problemës së dhënë. Pastaj zgjidhja e bërë, rishikohet në dyshe. Diskutimi bëhet me gjithë klasën.
Detyra 9: Nëna është 25 vjeçe, kurse Erinda është pesëfish më e re se nëna. Sa vjece është Erinda?
Meqë nëna ka 25 vjet ndërsa e bija 5 herë më pak, kjo nënkupton që duhet vepruar me pjesëtimin. Pra, Erinda ka 25 : 5 = 5 vjet. Pyetja e radhës realizohet me mbledhje, pra ato së bashku kanë:
25 + 5 = 30.Vazhdohet me detyrën e 9 në po të njëjtën faqe, duke ua dhënë udhëzimet e nevojshme.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin e numrave që nuk pjesëtohen me numrat e dhënë në detyrë, zgjidhjen e problemave me fjalë duke përdorur veprimin e shumëzimit, pjesëtimit dhe mbledhjes, plotësimin e barazive duke përdorur vetëm një herë secilën nga shifrat e dhëna dhe gjetjen e vlerës së shifrës që mbulohet nga figura.

Detyrë:
Detyrat 11 dhe 12 (faqe 37)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 18

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Modelet

Rezultatet e të nxënit të temës:
Praktikon modelet e dhëna në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1,4,7,8; III.3,4,5; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,5; 2.1,2; 3.6; 6.1; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Modele figurash

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet modele figurash të përsëritura;
- Përcakton pjesën kryesore në një model figurash me përsëritje;
- Dallon modele rritëse figurash nga ato zvogëluese.


MODELE FIGURASH DHE NUMRASH

MODELE FIGURASH

Modele figurash që përsëriten
Figurat me forma të caktuara ose ngjyra që përsëriten sipas një rregulle të caktuar paraqesin një model.
Këtë model e quajmë model me përsëritje.

Një model me figura që përsëriten.

Një model me ngjyra që përsëriten.

1 Ngjyrosim për ta kompletuar modelin.

pjesa kryesore

Për të kompletuar një model figurash që përsëriten, në fillim përcaktojmë pjesën kryesore (njësinë).

2 Plotësojmë modelin e figurave.

pjesa kryesore

3 Plotësojmë tabelën.

Modeli i figurave që përsëriten	Figura që vazhdon	Pjesa kryesore (njësia)
CBACBAC		
1357135713		

Mësojmë

36

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: petëza, shkopinj, fasule.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Puno në dyshe/thuaja grupit

Nxënësve iu shpërndahen mjete të ndryshme konkretizuese, si: petëza, shkopinj, fasule, shkronja. Ata udhëzohen të punojnë në dyshe, me shokun/shoqen e bankës. Udhëzohen që t'i rendisin ato sipas dëshirës. Pasi disa dyshe shpjegojnë renditjen e bërë, pyeten: **A janë të renditura figurat e juaja sipas një rregulle?**; **Çfarë keni formuar?**



MODELE RRITËSE DHE MODELE ZVOGËLUESE

Do të shohim modele të përbëra nga grupe njësish që ndryshojnë (rriten apo zvogëlohen) sipas një rregulle.

Modele rritëse figurash

- njësia

- njësia

Modele zvogëluese figurash

- njësia

3 Plotësojmë tabelën.

Modeli	Lloji	Njësia
	model rritës	
	model rritës	
aA aaAA aaaAAA	model rritës	aA
	model zvogëlues	
ZZZYYY ZZYY ZY	model zvogëlues	ZY

Mësojmë

37

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e orientuar

U sqarohet nxënësve që figurat me forma të caktuara ose ngjyra që përsëriten sipas një rregulle paraqesin një model figurash të përsëritur. Vizatohet një model në tabelë dhe përcaktohet pjesa kryesore (njësia) e saj, e ngjashme me detyrën 1 të tekstit. Nxënësve u kërkohet ta caktojnë secila dyshe pjesën kryesore në modelin e formuar në fillim të orës. Vazhdohet me plotësimin e modelit në detyrën 2, në tekst.

Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë modele figurash të paraqitura në tekst, faqe 37 dhe t'i analizojnë. Pasojnë pyetjet: **Ku dallojnë ato mes vete?**; - **Për sa njësi po rriten apo zvogëlohen?** (*Për një njësi*).

Nxënësve u kërkohet ta komentojnë tabelën me modele rritëse/zvogëluese figurash në detyrën 3, faqe 37.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Vëzhgo/plotëso/thuaja grupit

Nxënësit udhëzohen të plotësojnë tabelën në detyrën 3 të tekstit, faqe 36. Ata për çdo model figurash të përsëritur do t'ju caktojnë njësinë si dhe do të vizatojnë figurën përkatëse (vazhduese).

Librat shkëmbehen me shokun/shoqen e bankës për t'i kontrolluar. Plotësimi i pavarur i detyrës vlerësohet. Në fund, komentohen me tërë klasën.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e modeleve të figurave të përsëritura, përcaktimin e pjesës kryesore në një model figurash me përsëritje dhe dallimin e modeleve rritëse dhe zvogëluese.

Detyrë:

Krijohen dy modele me përsëritje.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 19

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Modelet

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zbaton formula të thjeshta për t'i plotësuar vargjet numerike dhe prezanton hapat deri te arritja e zgjidhjes;
Zbulon rregullën dhe shkruan kufizat e vargut numerik.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.4,7; III.1,3,4,5; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 2.1,4; 3.1,6; 6.1; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vargje numrash



VARGJE NUMRASH

Një model numrash është një bashkësi e numrave të renditur. Kjo renditje na ndihmon t'i gjejmë (parashohim) numrat vijues.
Çdo model numrash shkruhet sipas një rregulle. Këtë rregull e quajmë *rregull të modelit*.

1 Modeli numerik:
4, 7, 10, 13, 16, 19, 22, ___, ___, ___
+3 njësia e ndryshimit
është i shkruar sipas rregullës: plus 3. Kjo d.m.th. se çdo term pasardhës është për 3 më i madh se paraardhësi.
Vargu është rritës.

Një sqarim
Pjesa e modelit, që ne shohim, është e fundme, mirëpo, kur ne flasim për një model numrash nënkupton mund të vazhdon përtej asaj që shohim.
Kështu, në vazhdim, për modelin e numrave, do të përdorim emërtimin varg numrash ose shkurt varg.

2 Vargu numerik:
40, 37, 34, 31, 28, 25, ___, ___, ___
-3 njësia e ndryshimit
është i shkruar sipas rregullës: minus 3.
Vargu është zvogëlues.

Duke analizuar termat në modelin me numra, ne zbulojmë rregullën. Pastaj, sipas rregullës shkruajmë termat të tjerë.

3 Vargu numerik:
2, 3, 5, 8, 13, 21, 34, ___, ___, ___
është i shkruar sipas rregullës: duke filluar nga termi i tretë, çdo term pasardhës është i barabartë me shumën e dy termave paraardhës.

5 = 3 + 2
8 = 5 + 3

4 Plotësojmë vargun:
7, ___, 15, 19, 23, ___, ___, ___
+4
Për të plotësuar vargun me numrat në mes, në fillim duhet të gjejmë rregullën. *Rregulla gjendet duke i krahasuar dy terma të njëpasnjëshëm*. Vërejmë se në këtë rast rregulla është: plus 4, që d.m.th. se çdo term pasardhës është për 4 më i madh se paraardhësi.

5 Zbulojmë rregullën dhe plotësojmë vargun:
2, 3, 5, 9, ___, ___, ___, ___, ___, ___
Rregulla: _____

3 = 2 • 2 – 1
5 = 2 • 3 – 1
9 = 2 • 5 – 1

Mësojmë

38

Njësia mësimore: Vargje numrash

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shpjegon kuptimin e modelit numerik/vargut numerik;
- Zbulon rregullën e vargut duke shpjeguar hapat e tij;
- Plotëson vargun numerik me terma sipas rregullit përkatës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Nxënësve u kërkohet të rikujtojnë se çfarë paraqet një model figurash. Pas përgjigjes parashtrohet pyetja: **Ç'mendoni a mund të zëvendësohen figurat me numra në një model?**

Nxënësit udhëzohen që në fletore të paraqesin një model me numra. Parashtrohet pyetja:
Ç'mendoni çfarë paraqet ky model numrash?

Nxënësit përgjigjen lirshëm.



VARGJE NUMRASH

Një model numrash është një bashkësi e numrave të renditur. Kjo renditje na ndihmon t'i gjejmë (parashohim) numrat vijues.
Çdo model numrash shkruhet sipas një rregulle. Këtë rregull e quajmë *rregull të modelit*.

1 Modeli numerik:

4, 7, 10, 13, 16, 19, 22, ___, ___, ___

+3 njësia e ndryshimit

është i shkruar sipas rregullës: plus 3. Kjo d.m.th. se çdo term pasardhës është për 3 më i madh se paraardhësi.
Vargu është rritës.

Një sqarim
Pjesa e modelit, që ne shohim, është e fundme, mirëpo, kur ne flasim për një model numrash nënkupton mund të vazhdon përtej asaj që shohim.
Kështu, në vazhdim, për modelin e numrave, do të përdorim emërtimin varg numrash ose shkurt varg.

2 Vargu numerik:

40, 37, 34, 31, 28, 25, ___, ___, ___

-3 njësia e ndryshimit

është i shkruar sipas rregullës: minus 3.
Vargu është zvogëlues.

Duke analizuar termat në modelin me numra, ne zbulojmë rregullën. Pastaj, sipas rregullës shkruajmë termat të tjerë.

3 Vargu numerik:

2, 3, 5, 8, 13, 21, 34, ___, ___, ___

5 = 3 + 2
8 = 5 + 3

është i shkruar sipas rregullës: duke filluar nga termi i tretë, çdo term pasardhës është i barabartë me shumën e dy termave paraardhës.

4 Plotësojmë vargun:

7, ___, 15, 19, 23, ___, ___, ___

+4

Për të plotësuar vargun me numrat në mes, në fillim duhet të gjejmë rregullën. *Rregulla gjendet duke i krahasuar dy terma të njëpasnjëshëm.* Vërejmë se në këtë rast rregulla është: plus 4, që d.m.th. se çdo term pasardhës është për 4 më i madh se paraardhësi.

5 Zbulojmë rregullën dhe plotësojmë vargun:

2, 3, 5, 9, ___, ___, ___, ___, ___

3 = 2 • 2 – 1
5 = 2 • 3 – 1
9 = 2 • 5 – 1

Rregulla: _____

Mësojmë

38

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Nga biseda nxiten të arrijnë në përfundim që: *Një model numrash është një bashkësi e numrave të renditur sipas një rregulle të caktuar*. Parashtrohet pyetja: **Si mund të emërtohet ndryshe modeli numerik?** (*Varg numerik ose shkurt varg*). Paraqitet vargu numerik i d.1 të teksit, në tabelë dhe e analizojmë me nxënësit. P.sh., 4, 7, 10, 13, 16, 19, 22, ____, ____.

Numrat në varg a janë duke u rritur dhe për sa? Cila qenka rregulla e vargut? (*+3., d.m.th. çdo term, numër pasardhës është për 3 më i madh se paraardhësi*). Plotësohet vargu dhe nxënësit udhëzohen ta plotësojnë vargun në d.1,2,3 në tekst. Te detyra 4 sqarohet në tabelë hapat se si duhet të gjendet rregulla e vargut me numrat në mes.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Gjeje rregullën

Nxënësit udhëzohen të zbulojnë rregullën dhe të plotësojnë vargun numerik, në detyrën 5. Pasi të plotësohet vargu, librat shkëmbehen me shokun/shoqen e bankës dhe kontrollojnë saktësinë e plotësimit. Plotësimi i vargut vlerësohet. Më pas tregojnë para klasës rregullën:
2, 3, 5, 9, _17_, _33_, __, __, __.
Rregulla: *Çdo term, numër shumëzohet me 2 dhe prodhimit ia zbresim numrin 1.*

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shpjegimin e modelit numerik, zbulimin e rregullës së vargut duke shpjeguar hapat e tij dhe plotësimin e vargut numerik me terma sipas rregullit përkatës.

Detyrë:

Shkruhet një varg numerik, sipas një rregulle të caktuar.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 20

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Modelet

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zbulon rregullën dhe shkruan kufizat e vargut numerik.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4,7; III 3, 4, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5; 2.2,4; 3.7; 6.1; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Modelet (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Plotëson modelin e figurave të përsëritura sipas rregullës;
- Zbulon rregullën për të plotësuar vargun numerik.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: zaret, modele figurash.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Loja me zar

Nxënësit nxiten që të sjellin shembuj nga jeta e përditshme ku mund të hasin në modele figurash, si për shembull: në veshmbathje, në qilima me motive popullore, në ndonjë pikturë, mozaik etj.
Nxënësit ndahen në grupe me nga 4 nxënës. Secili grup pajiset me nga një zar. Nxënësit udhëzohen që brenda grupit ta hedhin zarin një herë dhe numrat që do fitojnë i paraqesin si një model numrash që përsëriten. Shembull:
Nxënësi 1 ka hedhur zarin dhe ka fituar numrin 2; nxënësi 2; numrin 5, nxënësi 3; numrin 5; nxënësi 4; numrin 4. Shkruajmë modelin: 2, 5, 5, 4; përsërisin të njëjtin model 2, 5, 5, 4, 2, 5, 5, 4.


1 Plotësojmë modelin e figurave.

2 I vendosim figurat në katrorët e zbrazët dhe fitojmë një model figurash që përsëriten.

3 Ngjyrosim për ta kompletuar modelin. Cila është forma e 18-të me radhë?

1 2 3
4

Përgjigjja:

4 Zbulojmë rregullën dhe plotësojmë vargun:

6, 7, 9, 10, 12, 13, 15, ___, ___, ___, ___

3, 5, 8, 12, 17, ___, ___, ___, ___

1, 3, 6, 8, 11, 13, 16, ___, ___, ___, ___

16, 22, 19, 25, 22, 28, 25, ___, ___, ___, ___

22, 28, 21, 27, 20, 26, 19, ___, ___, ___, ___

4, 8, 10, 20, 22, 44, ___, ___, ___

8 = 4 • 2
10 = 8 + 2
20 =10 • 2

Ushtrojmë

39

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit punojnë të pavarur në detyrat 1, 2, 3 në tekst. Në detyrën 1 kështillohen të kenë kujdes gjatë plotësimit në drejtimin e pikave.

Në detyrën 2 duhet vendosur (duke vizatuar) figurën përkatëse në model figurash që përsëriten sipas rregullës.

Në detyrën 3 së pari kështillohen të ngjyrosin për ta kompletuar modelin e më pas të gjejnë formën e 18 me radhë. Për t'ua lehtësuar gjetjen, do të numërojnë me radhë deri në 18, figurat e pjesës kryesore të modelit në drejtkëndëshin e dhënë.

Cila është forma e 18 me radhë? (Rrethi i kaltër).

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Mendo/zbulo/plotëso

Nxënësit punojnë të pavarur dhe në mënyrë individuale në zbulimin e rregullës dhe plotësimin e tri vargjeve sipas dëshirës.
Pas përfundimit të detyrës, vlerësohen dhe komentohen rregullat para klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në plotësimin e modelit të figurave të përsëritura sipas rregullës dhe zbulimin e rregullës për të plotësuar vargun numerik.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 39)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 21

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II/1, 4, 8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Modeli kubik dhe plani

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Llogarit numrin e përgjithshëm të kubeve të nevojshme për strukturën e dhënë.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Rikujtojmë mësimin e fundit vargjet e numrave dhe rikujtojmë për nxënësit që çdo varg i numrave kishte një modelim të vetin si p.sh., vargu: 2, 3, 5, 8, 13, 21, 34, … ky modelim vargu quhet vargu i Fibonaqit dhe si rregull ka shumën e dy termave paraardhës dhe japin termin pasardhës.


MODELI KUBIK DHE PLANI

1 Për çdo strukturë kubike përcaktojmë planin.

modeli kubik

plani I strukturës

3 4 2

3

1

2 Nga sa kube janë të nevojshme për secilën strukturë?

3 2
2 2 1
1 1

3 4 3
3 3 3
2

2
2 3 3 2
2

4 3 2 1
4 3 2 1
4 3 2 1

3 Sa kube nevojiten që të plotësohet kutia? Sa kube zë kutia?

16

3 2 2
1 1 1
1 1 1
1 1 1

Për plotësimin e kutisë nevojiten ___ kube.

Kutia zë:

3 · 4 · 3 = ☐ kube

Për plotësimin e kutisë nevojiten ___ kube.

Kutia zë:

☐ · ☐ · ☐ = ☐ kube

Për plotësimin e kutisë nevojiten ___ kube.

Kutia zë:

☐ · ☐ · ☐ = ☐ kube

Mësojmë

40

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Sqarojmë detyrën 1 në faqe 40 së bashku me nxënësit për të kuptuar strukturën se si paraqitet modelimi në kube dhe modelimi në plan. Në bazë të figurës 1 nga detyra 1 kuptojmë qasjen e përshkrimit të planit të strukturës apo modelimit në plan të një trupi.

Te figura 2, duke e shikuar modelin e kubit nxjerrim përshkrimin e planit të strukturës:

3 3 3
1 1 1

Te figura 3, duke e shikuar modelin e kubit nxjerrim përshkrimin e planit të strukturës:

3 3 2
3 2 1
2 1 1

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari individuale e orientuar

Nisur nga zgjidhja e detyrës 1 dhe ndërtimi i planit të strukturës duke e vëzhguar trupin apo modelin e kubik, atëherë nxënësit në klasë të ndarë në 4 grupe zgjidhin detyrën 2 dhe secili grup ka për të përcaktuar modelimin kubik, duke u nisur nga plani i strukturës së dhënë. Modelet e krijuara nga grupet e nxënësve paraqiten në tabelë dhe diskutohen me grupet e tjera se a është ndërtuar saktë dhe drejt modelimi kubik. Figurën e parë te detyra 3 e sqaron mësimdhënësi/ja për të gjithë klasën duke iu përmbajtur kërkesës së detyrës ku në bazë të modelimit kubik dhe planit të strukturës, nxënësit duhet të përcaktojnë sa kube mungojnë dhe sa kube zë kutia. Nxënësve ua sqarojmë që për të kuptuar numrin e kubeve në modelimin kubik, mbledhim të gjithë numrat e fituar nga plani i strukturës 3+2+2+1+1+1+1+1+1+1+1+1=16 dhe për të kuptuar sa kube zë kutia atëherë shumëzojmë tri dimensionet e trupi ndërmjet vete p.sh.: *gjatësia · lartësia · gjerësia* nga kemi 3·4·3=12·3=36 *kube*. Pra, 36-16=20 kube mungojnë për të plotësuar kutinë.

Dy pjesët e tjera të detyrës 3 i zgjidhin nxënësit në dyshe dhe zgjidhjet diskutohen në klasë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e numrit të përgjithshëm të kubeve të nevojshme për strukturën e dhënë.

Detyrë:

Të zgjidhet një detyrë sipas modelit të detyrës 2.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 22

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
Klasifikon objektet sipas veçorive të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3, III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 2.4,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bashkësitë dhe elementet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përshkruan bashkësinë si një grumbull elementesh;
- Identifikon elementet që i takojnë/nuk i takojnë bashkësisë;
- Gjen elementet e përbashkëta të dy bashkësive (prerjen).


BASHKËSITË

BASHKËSITË DHE ELEMENTET

1 Në figurë janë dhënë bashkësitë *A* dhe *B*.

A B

Vija që i rrethon elementet e bashkësisë quhet Diagram i Venit.

2 Në figurë është dhënë bashkësia *A* me Diagramin e Venit.

11 8 12 6 4 9 7 5 1 2 3 10 A

Numri 12 i takon bashkësisë *A*. Shkruajmë: $12 \in A$
Lexojmë: 12 është element i bashkësisë *A*.

Numri 11 nuk i takon bashkësisë *A*. Shkruajmë: $11 \notin A$
Lexojmë: 11 nuk është element i bashkësisë *A*.

Elementet që i takojnë bashkësisë *A* janë: 9, ___, ___, ___, ___ dhe ___.
Shkruajmë: $9 \in A$, _____, _____, _____, _____ dhe _____.

Elementet që nuk i takojnë bashkësisë *A* janë: 3, ___, ___, ___, ___ dhe ___.
Shkruajmë: $3 \notin A$, _____, _____, _____, _____ dhe _____.

3 Bashkësitë *A* dhe *B* janë dhënë me Diagramin e Venit si në figurë. Shenjojmë me ✓ shënimet e sakta.

A B

$\in A$ $\in A$ $\notin A$
$\notin A$ $\notin A$ $\in B$
$\notin A$ $\notin B$ ✓ $\notin B$
$\in B$ $\in A$ $\in B$

Mësojmë

41

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: petëza, shkopinj, spango, shkumësa me ngjyrat.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Paraqiten në ekran dy bashkësi dhe pyeten nxënësit se çfarë dinë për bashkësitë.
Nxënësit japin përgjigje të ndryshme, por gjithashtu është me rëndësi të dinë se çfarë kuptimi ka vija e mbyllur që i rrethon objektet e ndryshme.

Vija që i rrethon elementet e bashkësisë njihet ndryshe si ***Diagrami i Venit***.



BASHKËSITË

BASHKËSITË DHE ELEMENTET

1 Në figurë janë dhënë bashkësitë *A* dhe *B*.

A B

Vija që i rrethon elementet e bashkësisë quhet Diagram i Venit.

2 Në figurë është dhënë bashkësia *A* me Diagramin e Venit.

11 6 8 12 4 9 7 5 1 2 3 10 A

Numri 12 i takon bashkësisë *A*. Shkruajmë: $12 \in A$
Lexojmë: 12 është element i bashkësisë *A*.

Numri 11 nuk i takon bashkësisë *A*. Shkruajmë: $11 \notin A$
Lexojmë: 11 nuk është element i bashkësisë *A*.

Elementet që i takojnë bashkësisë *A* janë: 9, ___, ___, ___, ___ dhe ___.
Shkruajmë: $9 \in A$, _____, _____, _____, _____ dhe _____.

Elementet që nuk i takojnë bashkësisë *A* janë: 3, ___, ___, ___, ___ dhe ___.
Shkruajmë: $3 \notin A$, _____, _____, _____, _____ dhe _____.

3 Bashkësitë *A* dhe *B* janë dhënë me Diagramin e Venit si në figurë. Shenjojmë me ✓ shënimet e sakta.

A B

$\in A$ $\notin A$ $\notin A$ $\in B$ | $\in A$ $\notin A$ $\notin B$ ✓ $\in A$ | $\notin A$ $\in B$ $\notin B$ $\in B$

Mësojmë

41

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Paraqitet në ekran bashkësia në detyrën 2 në faqe 41.

Nga figura shihet se elementet e një bashkësie mund të shënohen edhe si vlera numerike, dhe se disa prej tyre janë brenda bashkësisë A, e disa të tjera jo.

Shpjegohet sintaksa matematikore se si shënohet kur një element nuk i takon një bashkësie.

Fillohet së pari me elementet që gjenden në brendi të bashkësisë A, prandaj e lexojmë si: *12 është element i bashkësisë A*.
Në rastin kur një element *nuk* i takon bashkësisë, lexohet si: 11 nuk është element i bashkësisë A.

Inkurajohen nxënësit që identifikimin (dhe shënimin) e elementeve ta bëjnë duke u bazuar në një renditje të caktuar p.sh., nga më i vogli deri te më i madhi.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e drejtuar

Në detyrën 3 janë dhënë dy bashkësi, elementet e të cilave janë figura gjeometrike, të dalluara dhe me ngjyra:
Përpara se të kërkohet nga nxënësit të plotësojnë rubrikat e zbrazëta, është mirë t'u rikujtohet se një element mund t'i takojë në të njëjtën kohë më shumë se një bashkësie. Rastin e tillë do ta njohin si prerje të dy bashkësive, nocion ky që do të mësohet më vonë. Në figurë janë tri elemente që i takojnë dy bashkësive.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e bashkësisë si një grumbull elementesh, identifikimin e elementeve që i takojnë ose jo bashkësisë dhe gjetjen e elementeve të përbashkëta të dy bashkësive.

Detyrë:

Të vizatohen dy bashkësi dhe të identifikohen elementet e përbashkëta të tyre.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 23

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
Paraqet bashkësinë me kllapa gjarpërore dhe përmes Diagramit të Venit;
Jep shembuj për bashkësitë nga jeta e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2; II.1,4,7,8; III.1,3,4,5; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2; 3.4, 6; 4.2; 6.3; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Paraqitja e bashkësive me kllapa



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përshkruan bashkësinë si një grumbull elementesh;
- Paraqet bashkësinë me kllapa gjarpërore dhe përmes Diagramit të Venit;
- Shkruan bashkësinë e zgjidhjeve të jobarazimeve të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletore, petëza, shkopinj, fasule, etiketa shkronjash e numrash, spango.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Mendo/Puno në dyshe/Thuaja grupit

Nxënësit udhëzohen që do të punojnë në dyshe, me shokun/shoqen e bankës. Çdo dyshe do të ketë mjete të ndryshme për të punuar: shkopinj, petëza, fasule, shkronja, numra. Do të përsëriten njohuritë për bashkësitë përmes një aktiviteti. Udhëzohen të tregojnë se çfarë kanë mbi bankë? (*Një grumbull elementesh*). - *Formoni bashkësi! (Nxënësit do të rrethojnë elementet me një spango duke e shndërruar grumbullin e elementeve në bashkësi).* - **Si vepruat për t'i shndërruar në bashkësi**? - **Ç'paraqet bashkësia**? - **Jepni shembuj të bashkësive nga jeta e përditshme**. - **Ç'mendoni si mund t'i paraqesim elementet e një bashkësie**?



PARAQITJA E BASHKËSIVE ME KLLAPA

1 Është dhënë bashkësia *A* me Diagramin e Venit. Elementet e bashkësisë *A* janë:

Elementet që i takojnë bashkësisë i shkruajmë brenda kllapave gjarpërore. Kështu:

$A = \{$, , , , $\}$

2 Bashkësitë e dhëna me Diagramin e Venit i shkruajmë me anë të kllapave.

$A = \{$, , , , $\}$ $B = \{_, _, _, _, _, _\}$ $C = \{_, _, _, _, _\}$

3 Bashkësitë e dhëna i paraqesim me Diagram të Venit.

$A = \{x, y, z, v, w\}$ $B = \{5, 10, 15, 20, 25\}$ $C = \{$, , , , $\}$

4 Të shkruajmë bashkësitë e zgjidhjeve të jobarazimeve:

1. $3 < X < 7$ → $A = \{_, _, _\}$
2. $X \leq 5$ → $B = \{_, _, _, _, _, _\}$
3. $13 \leq X < 22$ → $C = \{_, _, _, _, _, _, _, _, _\}$

Mësojmë

42

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit udhëzohen të shikojnë detyrën 1, faqe 42. **Çfarë përdorim për të paraqitur elementet e bashkësisë?** (*Kllapat gjarpërore*). Është më rëndësi t'u ceket se elementet brenda kllapës gjarpërore ndahen me presje mes vete. Udhëzohen të shikojnë bashkësitë e dhëna në detyrën 2 me anë të Diagramit të Venit. Ua cekim që brenda Diagramit të Venit para çdo shkronje apo numri e vendosim një pikë. Po ashtu shkrimi i numrave brenda kllapave gjarpërore bëhet nga më i vogli deri te më i madhi. P.sh., *C={2, 5, 6, 7, 9}*. Nxënësit punojnë detyrën 2 të pavarur. Më pas kalohet te detyra 3. Pasi të lexohet nga nxënësit pyeten: **Ku është dallimi me detyrën 2?** (*Nga bashkësia e dhënë me elemente të dhëna në kllapat gjarpërore duhet të vendosin brenda Diagrami të Venit).* **Kujdes**! *Vendosja e pikës në shemb.1,2.*

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Vëzhgo/ Zbato

Nxënësit udhëzohen të vështrojnë me kujdes detyrën 4, të lexohen me kujdes shenjat e sidomos te jobarazimi i dyfishtë ashtu që bashkësitë e shkruara të jenë zgjidhja e jobarazimeve.

1. $3 < X > 7$ *(Ndryshorja X duhet të jetë më e madhe se 3 dhe më e vogël se 7).* A= {4,5,6}
2. $X \leq 5$ *(Ndryshorja X duhet të jetë më e vogël ose barazi me 5).* B= {0,1,2,3,4,5}
3. $13 \leq X < 22$ *(Ndryshorja X duhet të jetë më e madhe ose barazi me 13 dhe më e vogël se 22).*

Zgjidhja: C= {13,14,15,16,17,18,19,20,21}.

Zgjidhja e pavarur e kësaj detyre vlerësohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e bashkësisë si një grumbull elementesh, paraqitjen e bashkësisë me kllapa gjarpërore dhe përmes Diagramit të Venit, si dhe për shkrimin e bashkësisë së zgjidhjeve të jobarazimeve të dhëna.

Detyrë:

Të vizatohen dy bashkësi me elemente të ndryshme, me kllapa gjarpërore dhe me Diagram të Venit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 24

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
Klasifikon objektet sipas vecorive te tyre;
Jep shembuj për bashkësitë nga jeta e përditshme;
Paraqet shembuj praktikë nga jeta lidhur me relacionet.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/2,4; II/3,13,14; III/1,7,8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 2.1; 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Nënbashkësia

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përkufizon nënbashkësinë;
- Shkruan simbolikisht nënbashkësinë;
- Identifikon elementet e nënbashkësisë së bashkësive të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Me qenë se nocioni i nënbashkësisë është përdorur edhe më herët, mësimdhënësi/ja vizaton në tabelë një Diagram të Venit dhe brenda tij mund të vizatojë edhe një diagram tjetër.



Rikujtojmë nocionin e nënbashkësisë ku elementet të cilat gjenden në vijën rrethore të bashkësisë A janë të gjitha elemente të bashkësisë, ndërsa nënbashkësi (brenda bashkësisë A) është bashkësia B.


NËNBASHKËSIA

1 Elementet e bashkësisë *A* janë shkronja të alfabetit të gjuhës shqipe. Nga bashkësia *A* veçojmë zanoret *a, e, i, o,* dhe *u*. Me këto elemente formojmë bashkësinë:

A: a, f, e, g, o, u, m, j, c, l

S = { __, __, __, __, __ }.

Bashkësia S është një nënbashkësi e bashkësisë A.
Shkruajmë $S \subset A$.
Lexojmë: S është nënbashkësi e bashkësisë A.

Nënbashkësia e bashkësisë së dhënë formohet nga një pjesë e elementeve të saj.

2 Analizojmë Diagramet e Venit dhe shkruajmë nënbashkësinë *S* të bashkësisë *A*.

A, S

S = { ___, ___, ___, ___, ___ }

A: 13, 17, 9, 14, 8, 11, 12, 10, 7, 16, 15, 6, 5; S

S = { ___, ___, ___, ___, ___, ___, ___ }

3 Është dhënë bashkësia *H* = {1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13}. Duke identifikuar veti të përbashkëta të disa elementeve, shkruajmë nënbashkësinë e bashkësisë *H*.

1. Vetia: Elementet e bashkësisë *H* që janë numra çift.
   A = {2, 4, 6, ___, ___, ___}, $A \subset H$.
2. Vetia: _____
   B = {1, 3, 5, 7, 9, 11, 13}, $B \subset H$.
3. Vetia: Elementet e bashkësisë *H* që pjesëtohen me numrin 3.
   C = { ___, ___, ___, ___ }, $C \subset H$.
4. Vetia: Elementet e bashkësisë *H* që nuk pjesëtohen me numrin 3.
   D = { ___, ___, ___, ___, ___, ___, ___ , ___, ___ }, $D \subset H$.

Nënbashkësitë e një bashkësie formohen duke veçuar elementet e saj sipas një vetie të përbashkët.

Mësojmë

43



NËNBASHKËSIA

1 Elementet e bashkësisë *A* janë shkronja të alfabetit të gjuhës shqipe. Nga bashkësia *A* veçojmë zanoret *a, e, i, o,* dhe *u*. Me këto elemente formojmë bashkësinë:

A

f, a, e, g, o, u, m, j, c, l

S = { __, __, __, __, __ }.

Bashkësia S është një nënbashkësi e bashkësisë A.
Shkruajmë S ⊂ A.
Lexojmë: S është nënbashkësi e bashkësisë A.

Nënbashkësia e bashkësisë së dhënë formohet nga një pjesë e elementeve të saj.

2 Analizojmë Diagramet e Venit dhe shkruajmë nënbashkësinë *S* të bashkësisë *A*.

A, S

S = { __, __, __, __, __ }

A, S: 13, 17, 9, 14, 8, 11, 12, 10, 7, 16, 15, 6, 5

S = { __, __, __, __, __, __, __ }

3 Është dhënë bashkësia *H* = {1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13}. Duke identifikuar veti të përbashkëta të disa elementeve, shkruajmë nënbashkësinë e bashkësisë *H*.

1. Vetia: Elementet e bashkësisë *H* që janë numra çift.
   A = {2, 4, 6, __, __, __}, *A ⊂ H.*
2. Vetia: _____
   B = {1, 3, 5, 7, 9, 11, 13}, *B ⊂ H.*
3. Vetia: Elementet e bashkësisë *H* që pjesëtohen me numrin 3.
   C = { __, __, __, __ }, *C ⊂ H.*
4. Vetia: Elementet e bashkësisë *H* që nuk pjesëtohen me numrin 3.
   D = { __, __, __, __, __, __, __ , __, __ }, *D ⊂ H.*

Nënbashkësitë e një bashkësie formohen duke veçuar elementet e saj sipas një vetie të përbashkët.

Mësojmë

43

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Detyra 1: Nxënësit udhëzohen që nga bashkësia A të formojnë një bashkësi tjetër, duke veçuar zanoret, me ç'rast formohet bashkësia S, për të cilën themi se është nënbashkësi e bashkësisë A.

Detyra 2: Duke analizuar Diagramet e Venit, shkruajmë nënbashkësinë S të bashkësisë A.

Nxënësit pyeten:
Cilat janë elementet e bashkësisë S te diagrami i dytë? (Elementet 10, 14, 7, 9, 8, 5, 6).

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Shqyrtim i përbashkët

Pjesën e fundit të orës zgjidhim detyrën 3, ku nga bashkësia e dhënë
H={1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13},
brenda kësaj bashkësie nëpërmjet disa vetive duhet të identifikojmë bashkësitë (nënbashkësitë e reja).

a. Elementet e bashkësisë H janë numra çift A={2, 4, 6, 8, 10, 12}
b. B={1, 3, 5, 7, 9, 11, 13} bashkësia e fituar nga elementet e B janë numra tek të bashkësisë H.
c. Elementet e bashkësisë H pjesëtohen me 3: C={3, 6, 9, 12}
d. Elementet e bashkësisë H nuk pjesëtohen me 3: D={1, 2, 4, 5, 7, 8, 10, 11, 13}

Vlerësimi i nxënësve:

Mësimdhënësi/ja vlerëson nxënësit përmes kryerjes së drejt të detyrave duke analizuar njohjen e nënbashkësive dhe elementeve të paraqitura dhe përmes vlerësimit formativ.

Detyrë:

Të shkruhen disa shembuj të nënbashkësive nga jeta e përditshme.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 25

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
Klasifikon objektet sipas veçorive të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3, III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 2.4,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Elementet e përbashkëta të dy bashkësive - prerja

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përshkruan bashkësinë si një grumbull elementesh;
- Identifikon elementet që i takojnë bashkësisë;
- Gjen elementet e përbashkëta të dy bashkësive (prerjen).

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Numra magnetikë, spango.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.


ELEMENTET E PËRBASHKËTA TË DY BASHKËSIVE – PRERJA

1 Janë dhënë bashkësitë A dhe B përmes Diagrameve të Venit:

1. 8. 6. 2. 14. 7. 9. 3. 13. 5. 12. 4. 11. 10. A B C

Nga figura lexojmë se:

A = { __, __, __, __, __, __, __, __, __, __ }
B = { __, __, __, __, __, __, __, __ }
C = { __, __, __, __ }

Vërejmë se elementet e bashkësisë C i takojnë bashkësisë A dhe B.

Elementet e përbashkëta të bashkësive A dhe B formojnë prerjen e bashkësive A dhe B.
Shënojmë: $C = A \cap B$

2 Janë dhënë bashkësitë $A = \{m, a, r, s, i\}$ dhe $B = \{m, a, j, i\}$. Bashkësitë A dhe B i paraqesim me Diagram të Venit. Shkruajmë pastaj elementet e përbashkëta të tyre.

A B C

Elementet e përbashkëta të bashkësive A dhe B janë: ___, ___ dhe ___.

Shkruajmë:
$C = A \cap B = \{ __, __, __ \}$.

3 Në një klasë të tretë nxënësit janë ndarë në dy klube, në klubin e gjuhëve të huaja dhe në klubin e shkencave. Klubi i gjuhëve të huaja numëron 17 nxënës, kurse klubi i shkencave 14 nxënës. 5 nxënës janë pjesë e të dyja klubeve. Sa nxënës ka klasa?

Vetëm në klubin e gjuhëve të huaja janë ___ nxënës. | Në të dyja klubet janë ___ nxënës. | Vetëm në klubin e shkencave janë ___ nxënës.

ose

17 14 5

Përgjigjja: _____

Mësojmë

44

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Bëhet një rikujtim rreth njësive të kaluara rreth bashkësive në përgjithësi.
Pyeten nxënësit:
- *Ç'është bashkësia?*
- *Cilat kllapa përdoren për paraqitjen e elementeve të bashkësisë?*
- *Si formohet nënbashkësia e një bashkësie?*
- *Si veprohet nëse në dy bashkësi kemi elemente të njëjta?*



ELEMENTET E PËRBASHKËTA TË DY BASHKËSIVE – PRERJA

1 Janë dhënë bashkësitë *A* dhe *B* përmes Diagrameve të Venit:

Nga figura lexojmë se:

$A = \{__, __, __, __, __, __, __, __, __, __\}$

$B = \{__, __, __, __, __, __, __, __\}$

$C = \{__, __, __, __\}$

Vërejmë se elementet e bashkësisë *C* i takojnë bashkësisë *A* dhe *B*.

Elementet e përbashkëta të bashkësive A dhe B formojnë prerjen e bashkësive A dhe B.
Shënojmë: $C = A \cap B$

2 Janë dhënë bashkësitë $A = \{m, a, r, s, i\}$ dhe $B = \{m, a, j, i\}$. Bashkësitë *A* dhe *B* i paraqesim me Diagram të Venit. Shkruajmë pastaj elementet e përbashkëta të tyre.

Elementet e përbashkëta të bashkësive *A* dhe *B* janë: ___, ___ dhe ____.

Shkruajmë:

$C = A \cap B = \{__, __, __\}$.

3 Në një klasë të tretë nxënësit janë ndarë në dy klube, në klubin e gjuhëve të huaja dhe në klubin e shkencave. Klubi i gjuhëve të huaja numëron 17 nxënës, kurse klubi i shkencave 14 nxënës. 5 nxënës janë pjesë e të dyja klubeve. Sa nxënës ka klasa?

ose

Përgjigjja:_____

Mësojmë

44

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Shqyrtim i përbashkët

Paraqitet në ekran detyra 1, në faqe 44, ku jepen bashkësitë A dhe B sipas Diagramit të Venit. Kërkohet të shënohen elementet e secilës bashkësi të dhënë në figurë. Elementet e përbashkëta të dy bashkësive vendosen në bashkësinë C.

A = {1, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 11, 12, 14}
B = { 2, 3, 5, 6, 9, 10, 12, 13}
C = { 3, 6, 9, 12}

Theksohet se elementet e përbashkëta të bashkësive A dhe B, formojnë prerjen e bashkësive A dhe B.
Kalohet te detyra 2, e cila është një detyrë logjike sa i përket shpërndarjes së elementeve në bashkësi përkatëse. Për këtë qëllim, nxënësit mund të ndahen në grupe, dhe secili grup të provojë ta zgjidhë detyrën, ku më pas përfaqësuesit e grupeve i prezantojnë zgjidhjet e mundshme.
Meqë detyra kërkon të identifikohen elementet e përbashkëta, atëherë elementet e bashkësisë A duhet të vendosen në bashkësinë me ngjyrë të gjelbër (në anën e majtë), ndërsa në anën e djathtë shkruhen elementet e bashkësisë B.

Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Veprimtari e drejtuar

Në këtë pjesë të orës shtjellohet detyra 3, e cila është detyrë logjike që mund të trajtohet nëpërmjet nocionit të bashkësisë.
Në bazë të Diagramit të Venit të dhënë në detyrë dhe skemës së paraqitur shohim se 5 nxënësit që janë pjesë e të dyja klubeve janë numëruar dy herë (në të dy bashkësitë), pra edhe në kuadër të 17, edhe në kuadër të 14, pra numri i nxënësve është: 17 + 14 - 5 = 26 nxënës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e bashkësisë si një grumbull elementesh, identifikimin e elementeve që i takojnë bashkësisë dhe gjetjen e elementeve të përbashkëta të bashkësive.

Detyrë:

Të shkruhen shembuj të elementeve të përbashkëta të bashkësive.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 26

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
Krijon relacione ndërmjet dy bashkësive të dhëna.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1,4,7; III.1,4,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 2.1,2; 3.2,4,6; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Relacionet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shpjegon fjalë relacion si lidhje, shoqërim;
- Krijon relacione ndërmjet dy bashkësive të dhëna.


RELACIONET

1 Elementet e bashkësisë *A* janë fruta, kurse elementet e bashkësisë *B* shkronja. Ndërmjet elementeve të bashkësisë *A* dhe elementeve të bashkësisë *B* përcaktojmë relacionin në këtë mënyrë: Një frutë nga bashkësia *A* është në relacion me një shkronjë nga bashkësia *B*, nëse emri i frutës fillon me atë shkronjë.

Duke i lidhur me shigjetë, si në figurë, përcaktojmë elementet e bashkësisë *A* që janë në relacion me elementet e bashkësisë *B*.

2 Elementet e bashkësive *A* dhe *B* janë shprehje numerike. Ndërmjet elementeve të bashkësisë *A* dhe atyre të bashkësisë *B* përcaktojmë relacionin (lidhjen) në këtë mënyrë: Një shprehje nga bashkësia *A* është në relacion me një shprehje nga bashkësia *B*, nëse ato kanë vlera të barabarta.

Kështu, p.sh., shprehja 35 + 25 nga bashkësia *A* është në relacion me shprehjen 97 − 37 nga bashkësia *B*, sepse 35 + 25 = 60 dhe 97 − 37 = 60.

Të përcaktojmë elementet e tjera të bashkësive të dhëna, të cilat janë në relacion ndërmjet vete.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Mendo/ Zbato

Nxënësve u kërkohet që të vendosin mbi bankë dy fletore (një me katrorë, tjetrën me vija) dhe dy libra (Matematikën dhe Gjuhën shqipe). Udhëzohen të shoqërojnë një libër me një fletore dhe të tregojnë arsyen e shoqërimit të bërë.
Paraqiten në tabelë dy bashkësi si në detyrën 1: bashkësia A, e frutave dhe bashkësia B, e shkronjave. Marrëdhëniet mes elementeve të dy bashkësive analizohen përmes bashkëbisedimit. - **Ç'mendoni a ekziston lidhja mes këtyre dy bashkësive? - Nëse po, cila është ajo?**
U sqarohet që kjo lidhje mes elementeve të dy bashkësive, në matematikë quhet *Relacion*.
Relacioni mes këtyre dy bashkësive përcaktohet kështu: *Një frutë nga bashkësia A është në relacion me një shkronjë nga bashkësia B, nëse emri i frutit fillon me atë shkronjë.*



3 Bashkësitë *A* dhe *B* janë dhënë me Diagramet e Venit si në figurë. Ndërmjet elementeve të bashkësisë *A* dhe elementeve të bashkësisë *B* përcaktojmë relacionin në këtë mënyrë: Një element i bashkësisë *A* është në relacion me një element të bashkësisë *B*, nëse shuma e tyre është 9.

Kështu, $6 \in A$ është në relacion me $3 \in B$, sepse $6 + 3 = 9$.

Duke i lidhur me shigjetë (si në figurë), përcaktojmë elementet e bashkësisë *A* që janë në relacion me elementet e bashkësisë *B*.

4 Bashkësia *A* është dhënë me Diagramin e Venit. Të shkruajmë elementet e bashkësisë *B*, nëse çdo element i bashkësisë *B* është për 2 më i madh se një element i bashkësisë A.

Shkruajmë elementet e bashkësisë *B*, që janë në relacion me elementet e bashkësisë *A*.

5 Bashkësia *B* është dhënë me Diagramin e Venit. Çdo element i bashkësisë *B* është marrë nga numrat e bashkësisë *A* që janë pjesëtuar me 3. Le të gjejmë se cilët kanë qenë numrat e bashkësisë *A*.

Mësojmë

Shkruhet relacioni … *fillon me shkronjën* mbi shigjetë mes dy bashkësive. Nxënësit ftohen që t'i lidhin me anë të shigjetave frutin me shkronjën e caktuar.

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e drejtuar

Detyra 2 është një shembull i relacionit mes shprehjeve numerike të dy bashkësive, nëse ato kanë vlera të barabarta. Nxënësit llogarisin shprehjet numerike dhe krijojnë relacione mes elementeve të dy bashkësive.

Detyra 4 tregon shembullin kur janë dhënë elementet e bashkësisë A dhe relacioni por, elementet e bashkësisë B duhet të llogariten. Nxënësit ftohen të lexojnë detyrën, të llogarisin,t'i shkruajnë elementet e bashkësisë B, që janë në relacion me elementet e bashkësisë A.

Librat shkëmbehen me shokun/shoqen e bankës për t'u kontrolluar nga njëri-tjetri.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Rishikim në dyshe

Detyra 5: Nxënësit udhëzohen që të gjejnë elementet që mungojnë në bashkësinë A; duke ditur se secili element i bashkësisë B është marrë nga numrat e bashkësisë A që janë pjesëtuar me 3.
Nga kjo, gjejmë se elementet e A-së janë:
27, 6, 33, 51, 0. Meqë 27:3=9; 0:3=0; 6:3=2; 33:3=11; 51:3=17.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shpjegimin e fjalës relacion dhe krijimin e relacioneve ndërmjet bashkësive të dhëna.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 46).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 27

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen elementet e përbashkëta të dy bashkësive (prerjen);
Krijon relacione ndërmjet dy bashkësive të dhëna;
Paraqet shembuj praktikë nga jeta lidhur me relacionet.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1,4,7; III.1,4,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5; 2.2; 3.2.6,7; 4.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Prerja, relacionet (ushtrime)


1 Janë dhënë bashkësitë $A = \{1, 2, 3, 4, 5, 6, 7\}$ dhe $B = \{2, 3, 5, 7, 8, 9\}$. Bashkësitë A dhe B i paraqesim me Diagram të Venit.

A B $A \cap B$

Elementet e përbashkëta të bashkësive A dhe B janë: ___, ___, ___ dhe ___.

Prerja e bashkësive A dhe B është:

$A \cap B = \{__, __, __, __\}$.

2 Shënojmë me A bashkësinë e zgjidhjeve të jobarazimit $1 < X \leq 6$, kurse me B bashkësinë e zgjidhjeve të jobarazimit $4 \leq X < 10$.

Bashkësia e zgjidhjeve të jobarazimit $1 < X \leq 6$ është:

$A = \{__, __, __, __, __\}$.

Bashkësia e zgjidhjeve të jobarazimit $4 \leq X < 10$ është:

$B = \{__, __, __, __, __, __\}$.

A B $A \cap B$

Elementet e përbashkëta të bashkësive A dhe B janë: ___, ___ dhe ___.

Prerja e bashkësive A dhe B është:

$A \cap B = \{__, __, __\}$.

3 Bashkësitë A, B dhe C janë dhënë me Diagramin e Venit si në figurë. Analizojmë figurën dhe shkruajmë bashkësitë A, B, C, $A \cap B$ dhe $B \cap C$.

A B C 0 1 2 3 4 5 a b e $A \cap B$ $B \cap C$

$A = \{__, __, __, __\}$.
$B = \{__, __, __, __, __, __, __\}$.
$C = \{__, __, __, __, __, __\}$.
$A \cap B = \{__, __\}$.
$B \cap C = \{__, __, __\}$.

Ushtrojmë

47

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen prerjen e bashkësive;
- Shkruan bashkësinë e zgjidhjeve të jobarazimeve të dhëna;
- Krijon relacion ndërmjet bashkësive të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diagrami i Venit

Nxënësit përsërisin paraprakisht se çfarë ishte prerja e dy bashkësive.
Udhëzohen të kalojnë në libër, për të përfunduar detyrën 1. Elementet e dhëna të bashkësive A dhe B me anë të kllapave gjarpërore i paraqesin së pari me Diagram të Venit e më pas gjejnë prerjen e tyre. Zgjidhja është kjo: $A \cap B = \{2, 3, 5, 7\}$.
Detyra 2 është e shkallës pak më të lartë se detyra 1. Kjo detyrë bart tri kërkesa në vete: të caktojnë elementet e dy bashkësive të dhëna me anë të jobarazimeve; t'i paraqesin në Diagram të Venit dhe të gjejnë prerjen e tyre. Nxënësit udhëzohen të punojnë individualisht.



4 Ndërmjet elementeve të bashkësive *A* dhe *B* është dhënë relacioni që shprehet me thënien *"është nëna e"*. I lidhim me shigjetë elementet e bashkësisë *A* me elementet nga bashkësia *B* me të cilat janë në relacion.

A ...është nëna e... B

5 Bashkësia *A* është dhënë me Diagramin e Venit. T'i shkruajmë elementet e bashkësisë *B*, nëse çdo element i bashkësisë *B* është për 3 më i vogël se një element i bashkësisë *A*.

Shkruajmë elementet e bashkësisë *B* që janë në relacion me elementet e bashkësisë *A*.

A: 11, 10, 17, 13, 14, 25 — B: 7

A B
– 3 =
10 – 3 = 7
– 3 =
– 3 =
– 3 =
– 3 =

6 Bashkësia *B* është dhënë me Diagramin e Venit. T'i shkruajmë elementet e bashkësisë *A*, nëse çdo element i bashkësisë *B* është trefishi i një elementi të bashkësisë A.

A: 17 — B: 9, 12, 45, 15, 27, 33, 51

A B
• 3 = 9
• 3 = 12
• 3 = 45
• 3 = 15
• 3 = 27
• 3 = 33
17 • 3 = 51

Ushtrojmë

48

Nga jobarazimi $1<X\leq 6$ fitohet bashkësia e zgjidhjeve $A=\{2,3,4,5,6\}$, ndërsa nga jobarazimi $4\leq X<10$ fitohet bashkësia e zgjidhjeve $B=\{4,5,6,7,8,9\}$. Rrjedhimisht, $A\cap B=\{4,5,6\}$.

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Nxënësve u kërkohet të tregojnë kuptimin e relacionit dhe të sjellin ndonjë shembull të relacionit nga jeta. Kalohet në detyrën 4. Pasi të lexohet dhe tregojnë relacionin e dhënë, vendosin me anë të shigjetës relacionin mes kafshëve të të dyja bashkësive (nënës dhe të voglit të tij).

Kalohet në detyrën 6, që ka të bëjë me relacionin mes dy bashkësive, ashtu që elementet e bashkësisë A i gjejnë duke i pjesëtuar me 3 elementet e bashkësisë B. Shkruhen elementet e bashkësisë A dhe vendoset relacioni mes elementeve përkatëse të të dyja bashkësive duke i lidhur me shigjetë.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Shkëmbe një detyrë

Nxënësit hartojnë një detyrë, sipas modelit të detyrave të dhëna në tekst.
Nxënësit në dyshe i këmbejnë detyrat me njëri-tjetrin dhe i zgjidhin, rikthehen për të kontrolluar mënyrën e zgjidhjes.
Diskutimi i zgjidhjes së detyrave bëhet me gjithë klasën.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e prerjes së bashkësive, shkrimin e bashkësisë të zgjidhjes së jobarazimit dhe krijimin e relacionit ndërmjet bashkësive të dhëna.

Detyrë:

Detyra 5 (faqe 48)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 28

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Dallon drejtëzën, gjysmëdrejtëzën dhe segmentin dhe i përkufizon ato;
Dallon këndet dhe llojet e këndeve;
Jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin figurave gjeometrike në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/2.,4; II/3,13,14; III/1,5,7,8; IV/5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.2; 1.4.1.


GJEOMETRI

DREJTËZA, GJYSMËDREJTËZA DHE SEGMENTI

1 Të kujtojmë emërtimet.

Vijat

vijë e drejtë — vijë e thyer e hapur — vijë e lakuar — vijë e thyer e mbyllur

Segmenti

Një vijë e drejtë e kufizuar me dy pika A dhe B quhet segment dhe shënohet me simbolin AB.
Pikat A dhe B quhen skaje të segmentit AB.

Drejtëza

E mendojmë një vijë të drejtë, e cila mund të zgjatet pafundësisht në të dyja anët e saj.

! *Drejtëza është një vijë e drejtë e pakufizuar.*

Pyetje: Nëse drejtëza është një vijë e drejtë e pakufizuar, atëherë si mund ta vizatojmë atë?

Përgjigja: Drejtëzën nuk mund ta vizatojmë të tërën. Mund ta vizatojmë vetëm një pjesë të saj. Pjesën tjetër vetëm e imagjinojmë.

E mendojmë një vijë të drejtë e cila kalon nëpër dy pika *A* dhe *B* dhe është e pakufizuar në të dyja anët. Në këtë rast fitohet një drejtëz, të cilën e shënojmë me *AB*.
Nuk duhet të mendojmë se *A* dhe *B* janë pika të skajshme të drejtëzës, sepse drejtëza nuk ka as pikë të fillimit e as pikë të fundit.

Nëpër dy pika të ndryshme mund të vizatojmë vetëm një drejtëz.

2 Është vizatuar drejtëza *d* dhe është veçuar një pikë e saj *R*. Themi se pika *R* i takon drejtëzës *d* ose se drejtëza *d* kalon nëpër pikën *R*.

Një drejtëz ka shumë pika.

Mësojmë

49

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Drejtëza, gjysmëdrejtëza dhe segmenti

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon vijat e ndryshme;
- Identifikon drejtëzat, gjysmëdrejtëzat dhe segmentet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Mësimdhënësi/ja në pjesën hyrëse të orës mësimore rikujton emërtimet e vijave të ndryshme.



vijë e drejtë — vijë e thyer e hapur — vijë e lakuar — vijë e thyer e mbyllur

Segment quajmë një vijë të drejtë e kufizuar në të dy anët me pikat A dhe B, dhe shënohet me simbolin $\overline{AB}$.



GJEOMETRI

DREJTËZA, GJYSMËDREJTËZA DHE SEGMENTI

1 Të kujtojmë emërtimet.

Vijat

vijë e drejtë | vijë e thyer e hapur | vijë e lakuar | vijë e thyer e mbyllur

Segmenti

Një vijë e drejtë e kufizuar me dy pika A dhe B quhet segment dhe shënohet me simbolin AB. Pikat A dhe B quhen skaje të segmentit AB.

Drejtëza

E mendojmë një vijë të drejtë, e cila mund të zgjatet pafundësisht në të dyja anët e saj.

! *Drejtëza është një vijë e drejtë e pakufizuar.*

Pyetje: Nëse drejtëza është një vijë e drejtë e pakufizuar, atëherë si mund ta vizatojmë atë?

Përgjigjja: Drejtëzën nuk mund ta vizatojmë të tërën. Mund ta vizatojmë vetëm një pjesë të saj. Pjesën tjetër vetëm e imagjinojmë.

E mendojmë një vijë të drejtë e cila kalon nëpër dy pika *A* dhe *B* dhe është e pakufizuar në të dyja anët. Në këtë rast fitohet një drejtëz, të cilën e shënojmë me *AB*.

Nuk duhet të mendojmë se *A* dhe *B* janë pika të skajshme të drejtëzës, sepse drejtëza nuk ka as pikë të fillimit e as pikë të fundit.

Nëpër dy pika të ndryshme mund të vizatojmë vetëm një drejtëz.

2 Është vizatuar drejtëza *d* dhe është veçuar një pikë e saj *R*. Themi se pika *R* i takon drejtëzës *d* ose se drejtëza *d* kalon nëpër pikën *R*.

Një drejtëz ka shumë pika.

Mësojmë

49

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes:
Shqyrtim i përbashkët

Gjatë interpretimit të llojeve të vijave, ne rikujtojmë me nxënës edhe njëherë vijën e drejtë e cila nuk është e kufizuar me asnjërën anë dhe mund të zgjatet pafundësisht në të dy anët e saj. Pra, vija e tillë quhet drejtëz (është një vijë e drejtë e pakufizuar).

Një pyetje që duhet të ua parashtrojmë nxënësve është se si vizatohet një drejtëz.

Detyra 2. Kërkojmë nga nxënësit ta vizatojnë një drejtëz e cila kalon nëper një pikë R.

Një drejtëz ka më shumë se një pikë.
Të sqarohet nga mësimdhënësi/ja se gjysmëdrejtëza është një drejtëz e kufizuar në njërën anë.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e orientuar

Së bashku me nxënësit duhet të zgjidhet detyra 3 në libër ku nxënësve duhet t'u sqarohet kërkesa e detyrës.

Në figurat e mëposhtme nxënësit duhet ta përshkruajnë segmentin, drejtëzën dhe gjysmëdrejtëzën.



Detyra 4: Nxënësit në grupe me nga katër persona, udhëzohen ta zgjidhin detyrën në libër ku gjatë analizimit të figurës duhet të nxjerrin drejtëzat, gjysmëdrejtëzat dhe segmentet që i vërejnë dhe t'i emërtojnë ato.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin e vijave të ndryshme dhe identifikimin e drejtëzës, gjysmëdrejtëzës dhe segmentit.

Detyrë:

Të vizatohen dy drejtëza të ndryshme, dy segmente dhe dy gjysmëdrejtëza.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 29

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pozitën e dy drejtëzave: drejtëzën paralele dhe normale si dhe prerjen e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4,7; III.4,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1,2; 3.4; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Drejtëzat prerëse

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përkufizon drejtëzat prerëse dhe ato normale;
- Përcakton pozitën e dy drejtëzave;
- Vizaton drejtëza prerëse dhe normale me vizore.


DREJTËZAT PRERËSE

1 Sa drejtëza kalojnë nëpër një pikë?

Nëpër një pikë kalojnë aq shumë drejtëza, sa nuk mund as t'i numërojmë e as t'i vizatojmë.

Pika *P* i takon drejtëzës *a* dhe drejtëzës *b*. Themi se pika *P* është pikë e përbashkët e tyre.

Drejtëzat që kanë vetëm një pikë të përbashkët quhen drejtëza prerëse. Pika e përbashkët e tyre quhet pikëprerje e tyre.

2 Me laps me ngjyrë i zgjatim drejtëzat, derisa ato të priten. Shënojmë pastaj pikëprerjet e tyre.

Drejtëzat normale

Drejtëzat *a* dhe *b* janë normale.
Shënojmë: $a \perp b$.
Lexojmë: Drejtëza *a* është normale në drejtëzën *b*.

3 Analizojmë figurat. Shënojmë me ✓ pohimin e saktë.

$a \perp b$ ☐ $p \perp q$ ☐ $r \perp s$ ☐

Hësojmë

51

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: spango, kapëse letrash.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Vizato/analizo/thuaja grupit

Nxënësit udhëzohen të punojnë në fletore pa vija. Ata do të punojnë sipas udhëzimeve të dhëna:
- *Vizatoni një pikë në mes të fletores! Pastaj, me anë të vizores, vizatoni sa më shumë drejtëza, të cilat duhet të kalojnë nëpër atë pikë*!
Njëkohësisht këto drejtëza paraqiten me ngjyra të ndryshme në tabelë. Analizohet vizatimi me nxënës përmes pyetjes: - **Sa drejtëza kalojnë nëpër një pikë?** (*Nëpër një pikë kalojnë një numër i madh, i pafund i drejtëzave*).
Këtë e paraqesin me anë të spangos. Dyshet e nxënësve pajisen me spango dhe thirren në mes të klasës. Ata do të qëndrojnë përballë njëri-tjetrit duke e ngritur, tendosur spangon, e cila paraqet drejtëza.
– **Çfarë kanë të përbashkët këto drejtëza?** (*Një pikë të përbashkët*). Në pikën ku ato takohen vendosim një kapëse letrash.



DREJTËZAT PRERËSE

1 Sa drejtëza kalojnë nëpër një pikë?

Nëpër një pikë kalojnë aq shumë drejtëza, sa nuk mund as t'i numërojmë e as t'i vizatojmë.

Pika *P* i takon drejtëzës *a* dhe drejtëzës *b*. Themi se pika *P* është pikë e përbashkët e tyre.

Drejtëzat që kanë vetëm një pikë të përbashkët quhen drejtëza prerëse. Pika e përbashkët e tyre quhet pikëprerje e tyre.

2 Me laps me ngjyrë i zgjatim drejtëzat, derisa ato të priten. Shënojmë pastaj pikëprerjet e tyre.

Drejtëzat normale

Drejtëzat *a* dhe *b* janë normale.
Shënojmë: $a \perp b$.
Lexojmë: Drejtëza *a* është normale në drejtëzën *b*.

3 Analizojmë figurat. Shënojmë me ✓ pohimin e saktë.

$a \perp b$ ☐ $p \perp q$ ☐ $r \perp s$ ☐

Mësojmë

51

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Vizatim i drejtuar

Paraqiten në tabelë dy drejtëza a dhe b, të cilat kalojnë nëpër një pikë. Njëkohësisht edhe nxënësit vizatojnë në fletore. Pikën e përbashkët e shënojmë me P.

U sqarohet që drejtëzat që kanë një P, pikë të përbashkët quhen drejtëza prerëse kurse pika e përbashkët e tyre quhet pikëprerje e tyre.
Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 2 në tekst. Vizatohen në tabelë 2 drejtëza prerëse a dhe b por, që formojnë mes vete 4 kënde të drejta (përdoret trekëndëshi kënddrejtë për t'i treguar këndet e drejta). Nxënësit i vizatojnë në fletore. Emërtohen *si drejtëza normale* dhe shënohen me simbolet *a* dhe *b*.
Lexohet: *Drejtëza a është normale me drejtëzën b.* Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 3 në tekst.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Pesëvargësh

Nxënësit në dyshe do të krijojnë një pesëvargësh prej 5 vargjeve rreth drejtëzave të mësuara. Pasi i përfundojnë, përfaqësuesi i çdo grupi e lexon para klasës. Krijimet e tyre vlerësohen nga të tjerët. P.sh.,

Drejtëza
Prerëse Normale
Priten Formojnë kënde Vizatohen
Drejtëzat normale formojnë kënde të drejta
Vija të drejta

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përkufizimin dhe vizatimin e drejtëzave prerëse dhe ato normale dhe përcaktimin e pozitës së dy drejtëzave.

Detyrë:

Shkruhen shembuj nga jeta e përditshme ku hasen drejtëzat prerëse dhe normale.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 30

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Klasifikon objektet sipas veçorive të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3; 13, 14.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 2.4,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Drejtëzat normale

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përkufizon drejtëzat normale;
- Vizaton drejtëzat normale;
- Paraqet simbolikisht drejtëzat normale.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shkopinj, spango.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Vizatohen disa raste të drejtëzave prerëse në tabelë, e pastaj mund të nxisim një diskutim në lidhje me atë se çfarë lloje të drejtëzave kemi. Ja disa shembuj të mundshëm:


DREJTËZAT NORMALE

1 Është dhënë një drejtëz a dhe një pikë A që nuk i takon drejtëzës a. Vizatojmë drejtëzën b që kalon nëpër pikën A dhe është normale me drejtëzën a.

E vendosim vizoren përgjatë drejtëzës a, kurse trekëndëshin ashtu që njëra brinjë e tij të puthitet me vizoren.

Vizoren e shtypim mbi fletore, kurse trekëndëshin e rrëshqasim mbi vizore, derisa brinja e tij të takojë pikën A.

Trekëndëshin e shtypim mbi fletore, kurse vizoren e rrotullojmë të puthitet me brinjën e trekëndëshit në pikën A.

E largojmë trekëndëshin dhe vizatojmë drejtëzën b që kalon nëpër pikën A.

Drejtëza b kalon nëpër pikën A dhe është normale me drejtëzën a.

$a \perp b$

Ekziston vetëm një drejtëz normale në drejtëzën e dhënë, që kalon nëpër pikën e dhënë.

2 Mund të vizatojmë shumë drejtëza normale në drejtëzën e dhënë p.

3 Me përdorimin e simbolit $\perp$, përshkruajmë pozitat reciproke (të ndërsjella) të drejtëzave.

$p \perp q$ $q \perp p$

Mësojmë

52

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Udhëzohen nxënësit të përdorin dy vizore, siç është rasti me detyrën 1 në faqe 52. Kjo mund të jetë sfidë e vërtetë, sidomos nëse kërkohet edhe saktësi në vizatimin e atyre drejtëzave. Saktësia e vizatimit të atyre drejtëzave nuk është aq me rëndësi sa është krijimi i shprehisë për të vizatuar (konstruktuar) në këtë mënyrë.
Vazhdohet me detyrën 2, në të njëjtën faqe:



Shpjegohet se në një drejtëz mund të ndërtojmë shumë drejtëza të tjera që mund të jenë normale me të, po ashtu, edhe këtu si në shembullin e mëhershëm, nuk duhet të përdoren dy vizore në të njëjtën kohë. U rikujtohet që simboli që tregon se dy drejtëza janë normale është: $\perp$.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Kërkohet nga nxënësit që të shënojnë simbolikisht drejtëzat normale.



Në rastin e parë kemi: p $\perp$ q, q $\perp$ p (renditja nuk ka rëndësi).
Në rastin e dytë kemi: a $\perp$ b, b $\perp$ a.
Në rastin e tretë kemi: u $\perp$ x, x $\perp$ u, v $\perp$ x, x $\perp$ v.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përkufizimin dhe vizatimin e drejtëzave normale, paraqitjen simbolike të tyre.

Detyrë:

Vizatohen drejtëza normale duke përdorur dy vizore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 31

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pozitën e dy drejtëzave: drejtëzën paralele dhe normale si dhe prerjen e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4,7; III.1,3,4,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5; 2.1,2; 3.6; 4.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Drejtëzat paralele

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përkufizon drejtëzat paralele me fjalë dhe simbol;
- Përcakton llojet e drejtëzave të dhëna në detyrë;
- Vizaton drejtëza paralele me drejtëzën e dhënë në figurë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.


DREJTËZAT PARALELE

1 Dalloni elementet në figura, të cilat, edhe nëse i zgjatim sa të duam, ato nuk priten.

2 Analizojmë drejtëzat e dhëna në figurat e mëposhtme. Çka vërejmë?

Drejtëzat *p* dhe *q* janë drejtëza prerëse. Pikëprerja e tyre është pika *S*.

Drejtëzat *c* dhe *d* në dukje nuk janë drejtëza prerëse. Nëse e zgjatim secilën nga to, do të vërtetojmë se ato janë gjithashtu prerëse.

Drejtëzat *a* dhe *b* mund t'i zgjatim sa të duam në të dyja drejtimet, por ato nuk priten.

Drejtëzat a dhe b, që nuk kanë pikë të përbashkët (nuk priten askund), quhen drejtëza paralele.
Shënojmë: a || b
Lexojmë: Drejtëza a është paralele me drejtëzën b.

3 Analizojmë figurën dhe e plotësojmë tabelën.

	a	b	c	d
a		a ∥ b		
b			b ⊥ c	
c				
d				

Mësojmë

53

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Vështro/ Analizo/ Diskuto

Nxënësit udhëzohen që t'i vështrojnë dhe t'i analizojnë figurat e dhëna në detyrë. Pyeten: A priten figurat e dhëna? Nëse jo, pse? (Janë drejtëza paralele dhe janë gjithmonë të baraslarguara nga njëra-tjetra, andaj nuk priten asnjëherë).





Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Vizatohen në tabelë drejtëzat e detyrës 2 nga teksti dhe analizohen me nxënës. Pyeten:
- Si quhen drejtëzat p dhe q? Po nëse zgjaten drejtëzat c dhe d, çfarë drejtëza janë? - A priten drejtëzat a dhe b nëse zgjaten?



Përkufizohen drejtëzat a dhe b: *drejtëzat a dhe b, që nuk priten askund, quhen drejtëza paralele.* Shkruajmë: a b dhe si lexohen. Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 3 në libër. Pasi të plotësohet tabela shkëmbehen librat me shokun/shoqen e bankës për t'u kontrolluar. Plotësimi i saj vlerësohet. Lexohet tabela para klasës. Më pas udhëzohen që me anë te dy vizoreve, sipas udhëzimeve në detyrat 4 dhe 5 të vizatojnë drejtëzat paralele në fletore.
Puna e tyre vlerësohet.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Analizo - Vizato - Përgjigju

Nxënësit punojnë individualisht, të pavarur, në detyrën 6 në libër. Pasi t'i dallojnë llojet e drejtëzave me anë të ngjyrave të caktuara bëhet vlerësimi.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përkufizimin dhe vizatimin e drejtëzave normale, paraqitjen simbolike të tyre.

Detyrë:

Vizatohet një shtëpi, pastaj identifikojnë drejtëza paralele në të.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 32

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pozitën e dy drejtëzave: drejtëzën paralele dhe normale si dhe prerjen e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4,7; III.1,3,4,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.2,4; 3.6,7; 7.1.


1 Katrorin pranë drejtëzave prerëse (jonormale) e ngjyrosim me të kuqe, atë pranë drejtëzave paralele me të gjelbër dhe atë pranë drejtëzave normale me të kaltër.

2 Sa gjysmëdrejtëza, sa segmente dhe sa pikëprerje ka në vizatim?

Përgjigjja: Në figurë ka:
– gjysmëdrejtëza
– segmente
– pikëprerje

3 Në figurë janë vizatuar dy drejtëza prerëse. Në tabelën e mëposhtme, shkruaj po, nëse segmenti është pjesë e drejtëzës dhe jo, nëse segmenti nuk është pjesë e drejtëzës.

Drejtëza	Segmenti	$\overline{AB}$	$\overline{BC}$	$\overline{DE}$	$\overline{CE}$	$\overline{CH}$	$\overline{HJ}$	$\overline{FG}$	$\overline{FC}$	$\overline{FE}$
	a	po								
	b	jo								

Ushtrojmë
55

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përcakton llojin e drejtëzave në detyrën e dhënë;
- Identifikon segmentin, drejtëzën dhe gjysmëdrejtëzën;
- Vizaton drejtëzat paralele dhe normale.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Harta semantike

Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe. Ata do të shkruajnë të gjitha njohuritë që i kanë marrë rreth vijave. Pas përfundimit, çdo përfaqësues i grupit i prezanton para klasës. P.sh.:





4 Le të jenë a, b dy drejtëza normale dhe S një pikë që nuk i takon asnjërës. Nëpër pikën S vizatojmë drejtëzën c paralele me drejtëzën a dhe drejtëzën d paralele me drejtëzën b. Në çfarë pozite janë drejtëzat c dhe d?

Përgjigjja: _____

5 Nëpër pikat e dhëna vizatojmë drejtëza paralele me drejtëzën e dhënë.

6 Është vizatuar drejtëza a dhe dy pika B dhe C, që nuk i takojnë drejtëzës a. Vizatojmë drejtëzën b, që kalon nëpër pikën B dhe është normale me drejtëzën a, dhe një drejtëz c, që kalon nëpër pikën C dhe është normale me drejtëzën b. Në çfarë pozite janë drejtëzat a dhe c?

Përgjigjja: _____

Ushtrojmë

56

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e pavarur

Nxënësit udhëzohen të punojnë të pavarur në detyrat 1 - 5 në tekst.

Në detyrën 1 duhet t'i dallojnë llojet e drejtëzave me ngjyra përkatëse.

Në detyrën 2 duke analizuar figurën e dhënë përcaktohet numri i gjysmëdrejtëzave (9), segmenteve (12) dhe pikëprerjeve (6).

Për detyrën 3, këshillohen nxënësit që duke analizuar segmentet e dhëna në dy drejtëza prerëse, të plotësojnë tabelën duke treguar se pjesë e cilës drejtëz është segmenti përkatës.

Pas përfundimit të çdo detyre vijon komentimi i saj para klasës nga nxënësit.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Vizato/ Përgjigju

Nxënësit udhëzohen që në mënyrë të pavarur të punojnë detyrën 4 dhe 5. Detyrat lexohen me vëmendje, vizatojnë drejtëza sipas kërkesave të detyrave dhe përgjigjen në pyetjen e detyrës 4. Përgjigjja e detyrës 4 është: *Drejtëza c dh d janë drejtëza normale, $c \perp d$.*
Vizatimi i drejtëzave në detyrat 4 dhe 5 vlerësohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përcaktimin e llojit të drejtëzave, identifikimin e segmentit, drejtëzës dhe gjysmëdrejtëzës në figurë, vizatimin e drejtëzave paralele dhe normale.

Detyrë:

Detyra 6 (faqe 56)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 33

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Dallon këndet dhe llojet e këndeve

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3; 13, 14. III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 2.1,2,4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Këndi dhe llojet e këndeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përkufizon këndin;
- Përcakton brinjët dhe krahët e këndit;
- Vizaton llojet e këndeve.


KËNDET DHE LLOJET E KËNDEVE

Këndi

Në figurë janë dhënë dy gjysmëdrejtëza që e kanë pikën e fillimit të përbashkët.

Figura e cila përbëhet prej dy gjysmëdrejtëzave me pikë fillimi të përbashkët quhet vijë këndore.
Pjesa e rrafshit, e kufizuar me vijën këndore, së bashku me vijën këndore, quhet kënd.

Në figurën e mësipërme është vizatuar këndi *AOB*. Për të shënuar një kënd përdorim shenjën ∠. Shënojmë ∠*AOB* dhe lexojmë: këndi *AOB*.
Pikën e përbashkët të gjysmëdrejtëzave (pikën *O*) e quajmë kulm të këndit.
Gjysmëdrejtëzat *OA* dhe *OB* quhen krahë të këndit.
Krahët e një këndi dhe kulmi i tij janë elemente të këndit.

Këndi i drejtë

Në figurë janë vizatuar dy gjysmëdrejtëza me fillim të përbashkët, normale në njëra-tjetrën.

Këndi i formuar nga gjysmëdrejtëzat normale quhet kënd i drejtë.

Llojet e këndeve

Çdo kënd që është më i vogël se këndi i drejtë quhet kënd i ngushtë.

këndi i drejtë

Çdo kënd që është më i madh se këndi i drejtë quhet kënd i gjerë.

Mësojmë

57

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: shkronja magnetike, shkopinj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Udhëzohen nxënësit që në fletoret e tyre të vizatojnë disa drejtëza prerëse dhe dy drejtëza pingule.
I emërtojnë ato dhe dallojnë këndet që formohen nga prerja e tyre.
Drejtohen pyetjet:
- *Ç'është këndi?*
- *Si formohet ai?*
- *A mund të formoni kënde me gjymtyrët tuaja?*



KËNDET DHE LLOJET E KËNDEVE

Këndi

Në figurë janë dhënë dy gjysmëdrejtëza që e kanë pikën e fillimit të përbashkët.

B, krahu, kulmi, O, krahu, A

Figura e cila përbëhet prej dy gjysmëdrejtëzave me pikë fillimi të përbashkët quhet vijë këndore.

Pjesa e rrafshit, e kufizuar me vijën këndore, së bashku me vijën këndore, quhet kënd.

Në figurën e mësipërme është vizatuar këndi *AOB*. Për të shënuar një kënd përdorim shenjën ∠. Shënojmë ∠*AOB* dhe lexojmë: këndi *AOB*.

Pikën e përbashkët të gjysmëdrejtëzave (pikën *O*) e quajmë kulm të këndit.

Gjysmëdrejtëzat *OA* dhe *OB* quhen krahë të këndit.

Krahët e një këndi dhe kulmi i tij janë elemente të këndit.

Këndi i drejtë

Në figurë janë vizatuar dy gjysmëdrejtëza me fillim të përbashkët, normale në njëra-tjetrën.

B, O, A

Këndi i formuar nga gjysmëdrejtëzat normale quhet kënd i drejtë.

Llojet e këndeve

B, O, A, <, R, O, N, <, M, O, K

Çdo kënd që është më i vogël se këndi i drejtë quhet kënd i ngushtë.

këndi i drejtë

Çdo kënd që është më i madh se këndi i drejtë quhet kënd i gjerë.

Mësojmë

57

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e drejtuar

Vizatohen në tabelë dy gjysmëdrejtëza me fillim të përbashkët, dhe pyeten nxënësit se çfarë nënkuptojnë me këtë.



Në figurën e mësipërme është vizatuar këndi AOB. Për të shënuar një kënd përdorim shenjën <. Shënojmë < AOB dhe lexojmë: këndi AOB.

Pikën e përbashkët të gjysmëdrejtëzave e quajmë kulmi i këndit. Gjysmëdrejtëzat OA dhe OB quhen krahë të këndit. Kulmi dhe krahët e një këndi janë elemente të tij.

Pika 2 dhe 3 (në faqen 57) tregojnë rastet kur këndet quhen kënd i drejtë, kënd i ngushtë dhe kënd i gjerë, si dhe raporti në mes tyre (cili më i madh, e cili më i vogël).

Merren edhe shembuj të tjerë nga jeta e përditshme në lidhje me këndet e caktuara, duke filluar p.sh, me qoshet e tavolinave të nxënësve, apo dritaret e klasës (për këndin e drejtë), e kështu me radhë.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Në pjesën përfundimtare të orës kërkohet nga nxënësit që të vizatojnë gjysmëdrejtëzën me fillim në pikën O dhe që duhet të kalojë pastaj nëpër pikën B. Pas vizatimit të tillë, duhet të tregojnë se çfarë këndi është fituar në rastet e lartcekura.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përkufizimin e këndit, përcaktimin e brinjëve dhe krahëve të këndit dhe vizatimin e llojeve të këndeve.

Detyrë:

Të vizatohen llojet e këndeve.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 34

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Dallon këndet dhe llojet e këndeve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3; 13, 14. III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 2.1,2,4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Këndi dhe llojet e këndeve (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përcakton llojin e këndit të fituar në figurë;
- Identifikon drejtëzat prerëse dhe normale.


1 Vizatojmë gjysmëdrejtëzën me fillim në pikën *O*, që kalon nëpër pikën *B*. Çfarë këndi është fituar?

Këndi i _____ Këndi i _____ Këndi i _____

2 Vizatojmë akrepin që mungon në mënyrë që të fitohet:

kënd i gjerë kënd i ngushtë kënd i drejtë

3 Analizojmë figurat dhe plotësojmë fjalitë.

Janë vizatuar dy drejtëza _____.
Dy drejtëza _____ përcaktojnë ___ kënde.

Janë vizatuar dy drejtëza _____.
Dy drejtëza _____ përcaktojnë ___ kënde të _____.

Ushtrojmë

58

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Veprimtari e drejtuar



Udhëzohen nxënësit të punojnë sipas hapave të mëposhtëm:
1. Marrin një karton dhe e presin në formë rrethore.
2. E palosin përgjysmë.
3. E palosin dhe njëherë përgjysmë.
4. Pastaj e marrin dhe brinjët e figurës i puthitin me brinjët e skuadrës (vizore trekëndore).



1 Vizatojmë gjysmëdrejtëzën me fillim në pikën *O*, që kalon nëpër pikën *B*. Çfarë këndi është fituar?

Kënd i _____ Kënd i _____ Kënd i _____

2 Vizatojmë akrepin që mungon në mënyrë që të fitohet:

kënd i gjerë kënd i ngushtë kënd i drejtë

3 Analizojmë figurat dhe plotësojmë fjalitë.

Janë vizatuar dy drejtëza _____.
Dy drejtëza _____ përcaktojnë ___ kënde.

Janë vizatuar dy drejtëza _____.
Dy drejtëza _____ përcaktojnë ___ kënde të _____.

Ushtrojmë

58

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Hulumtim/shqyrtim i përbashkët

Së bashku me nxënësit arrihet te këto përfundime:

- Këndi që puthitet me brinjët e skuadrës quhet kënd i drejtë.
- Këndet që janë më të vegjël se këndi i drejtë quhen kënde të ngushta.
- Këndet që janë më të mëdhenj se këndi i drejtë quhen kënde të gjera.

Hapen librat dhe punohet detyra 1 në faqe 58, ku nga nxënësit kërkohet që të vizatojnë gjysmëdrejtëzën me fillim në pikën O dhe që duhet të kalojë pastaj nëpër pikën B. Pas vizatimit të tillë, duhet të tregojnë se çfarë këndi është fituar në rastet e lartcekura.
Në detyrën 2, në të njëjtën faqe paraqitet ora me një akrep, ndërsa akrepi tjetër vizatohet nga nxënësit varësisht se për çfarë këndi bëhet fjalë.
Analizohen mirë këto tri raste, për të fituar këndin e gjerë në orën e parë, nxënësit mund të vendosin akrepin e dytë prej orës 4 deri në orën 8 (cilindo prej tyre).
Rasti i dytë për këndin e ngushtë, akrepi i orës mund të vendoset prej orës 7 deri në orën 11.
Rasti i tretë për këndin e drejtë, akrepi i dytë mund të vendoset në orën 12 ose në orën 6.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Kalohet te detyra e radhës, ku kërkohet që të tregohet se çfarë drejtëza janë dhe nga sa kënde po formohen. Këtë detyrë meqë është e ngjashme me detyrat e kaluara kërkohet nga nxënësit ta zgjidhin individualisht. Pas zgjidhjes prezantohen dhe jepen sqarimet e nevojshme.
Në rastin e parë kemi të bëjmë me drejtëzën prerëse, si dhe formohen 4 kënde (dy të ngushta dhe dy të gjera).
Në rastin e dytë kemi të bëjmë me drejtëza normale, si dhe formohen 4 kënde të drejta.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përcaktimin e llojit të këndit të fituar në figurën e dhënë dhe identifikimin e drejtëzave prerëse dhe normale.

Detyrë:

Vizatohen llojet e këndëve.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 35

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000 dhe përcakton vlerën e çdo shifre;
Identifikon qindëshet dhe dhjetëshet e mijëshes së parë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1.3; II.4,7,8; III.1,4,5; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 2.1,2; 3.4,6; 7.1.



NUMRAT DERI NË 1000

QINDËSHET E MIJËSHES SË PARË

Të kujtojmë: Shumëfish i një numri është numri një herë ose shumë herë më i madh se ai numër.

Shumëfishat e numri 1 Njëshet	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Shumëfishat e numrit 10 Dhjetëshet	10	20	30	40	50	60	70	80	90
Shumëfishat e numrit 100 Qindëshet	100	200	300	400	500	600	700	800	900

1000

1 Paraqitja e njësheve, dhjetësheve, qindësheve dhe mijëshes.

10 njëshe — 10 Nj = 1 Dh — 1 dhjetëshe

1+1+1+1+1+1+1+1+1+1= ___

10 dhjetëshe — 10 Dh = 1 Q — 1 qindëshe

10+10+10+10+10+10+10+10+10+10=____ 10 • 10 = ____

10 qindëshe — 1 mijëshe

100+100+100+100+100+100+100+100+100+100 = _____ 10 • 100 = ____

10 Q = 1 M

Mësojmë

59

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Qindëshet e mijëshes së parë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Lexon qindëshet e mijëshes së parë;
- Shkruan qindëshet e mijëshes së parë;
- Arsyeton emërtimin e qindësheve të plota.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketa me qindëshe të mijëshes së parë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskuto tabelën

Nxënësit përkujtojnë se çfarë paraqet shumëfishi i një numri: *Shumëfishi i një numri është numri njëherë ose shumë herë më i madh se ai numër*. Paraqitet tabela e njësheve, dhjetësheve, qindësheve dhe diskutohen raportet mes tyre së bashku me nxënësit.

Shumëfishat e numrit 1 - Njëshet	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Shumëfishat e numrit 10 - Dhjetëshet	10	20	30	40	50	60	70	80	90
Shumëfishat e numrit 100 - Qindëshet	100	200	300	400	500	600	700	800	900



Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Shqyrtohen rastet e formimit të dhjetësheve, qindësheve dhe mijësheve. Nxënësit njëkohësisht punojnë me kube, shufra, pllaka dhe kube të mëdha.
Në rastin e parë kemi 10 kube, që paraqesin njëshet, formojnë 1 shtyllë (një dhjetëshe) dhe shënohet: 10 Nj = 1 Dh. **Shufrat ç'paraqesin?** (Dhjetëshet). Shkruhet 10 DH = 1 Q(pllakë). Po 10 pllaka kur të bashkohen e formojnë 1 kub të madh apo 1 mijëshe: 10 Q = 1 M

Nxënësit udhëzohen që në detyrën 2 të analizojnë se si shkruhen dhe lexohen qindëshet e mijëshes së parë. Ata do të arsyetojnë emërtimet e qindësheve të mijëshes së parë. Shkruhet në tabelë barazimi:

1 M = 10 Q = 100 Dh = 1000 Nj.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Gjej qindëshet që mungojnë

Komentohet fotografia e dhënë në detyrën 3, ku nxënësit kanë vendosur një tel dhe në të kemi të vendosur etiketat me disa qindëshe të mijëshes së parë. Nxënësit udhëzohen që të shkruajnë qindëshet e mijëshes së parë, duke filluar nga numri 100.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në leximin, shkrimin dhe arsyetimin e emërimit të qindësheve të mijëshes së parë.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 60).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 36

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Demostron shkathtësi dhe shprehi në zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3; III,1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1,1,4,5; 2.2; 7.1

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krahasimi i qindësheve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000;
- Përcakton vlerën e çdo shifre te numrat katërshifrorë;
- Krahason numrat natyrorë deri në 1000.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Pllaka, shufra, kube, spango, tiketa me numra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Shqyrtim i përbashkët

Shpërndahen në grupe shufra, kube, pllaka dhe shkopinj, ku kërkohet të përcaktojnë vlerën e tyre. Pyeten nxënësit:
- Çfarë përmban një shufër?
- Po pllaka, sa shufra përmban?
- Çka përfaqësojnë kubet?

Pasi bëhet një evokim i shkurtër lidhur me numrat, vazhdohet me krahasimin e tyre.



KRAHASIMI I QINDËSHEVE

Të kujtojmë:

3 është më i vogël se 5

30 është më i vogël se 50

300 është më i vogël se 500

3 ◯ 5 30 ◯ 50 300 ◯ 500

1 < > ?

8 ◯ 5	3 ◯ 6	4 ◯ 9	1 ◯ 3
80 ◯ 50	30 ◯ 60	40 ◯ 90	10 ◯ 30
800 ◯ 500	300 ◯ 600	400 ◯ 900	100 ◯ 300

2 Shkruajmë me radhë qindëshet.

200 900 1000 300

3 Shenjojmë me ✓ jobarazinë e saktë dhe me X jobarazinë e pasaktë.

500 < 600 ☐	900 > 900 ☐	400 > 800 ☐	400 < 300 ☐
Njësia mësimore: Pandryshueshmëria e shumës dhe e ndryshimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shpjegon përkufizimin e pandryshueshmërisë së shumës dhe ndryshimit;
- Përdor vetinë e pandryshueshmërisë për njehsimin e shumës dhe zbritjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit i përsërisin njohuritë rreth varshmërisë së shumës nga mbledhorët dhe varshmërisë së ndryshimit nga i zbritshmi dhe zbritësi.



1 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelat.

a	b	a + b
350	130	480
350 + 150	130	
350 + 250	130	
350 + 350	130	

a	b	a + b
500	80	580
500 – 170	80	
500 – 130	80	
500 – 210	80	

2 Njehsojmë.

395 + 478 = (395 +) + (478 –) = 400 + =

608 + 315 = (608 –) + (+) = + =

3 Njehsojmë.

92 – 37 = (92 +) – (37 +) = – =

340 – 180 = (340 +) – (180 +) = – =

447 – 205 =

773 – 420 =

4 Nëse $a + b = 500$, njehsojmë:

(a + b) + 156 = + =

(a + 156) + b = + =

(a – 156) + b = – =

(a + 156) + (b + 124) = + (+) = + =

5 Nëse $a - b = 400$, njehsojmë.

(a + 167) – b = + =

(a – 167) – b = – =

(a + 167) – (b + 167) =

ndryshimi rritet për aq sa rritet i zbritshmi

ndryshimi zvogëlohet për aq sa zvogëlohet i zbritshmi

ndryshimi nuk e ndryshon vlerën, nëse i zbritshmi dhe zbritësi rriten ose zvogëlohen për të njëjtin numër

Ushtrojmë

96

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Punë e drejtuar

Nxënësit udhëzohen të lexojnë rregullën e pandryshueshmërisë së shumës dhe ndryshimit në libër, e cila komentohet.
Detyra 1 - Nxënësit duke përdorur vetinë e pandryshueshmërisë së shumës njehsojnë shumën e numrave, në dy shembuj. Ata punojnë të pavarur. Në fund komentohen nga disa nxënës. Në detyrën 2 përdoret vetia e pandryshueshmërisë së ndryshimit për të njehsuar ndryshimin e dy numrave treshifrorë në dy shembuj. Nxënësit punojnë të pavarur dhe në fund komentohet nga disa nxënës.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Nxënësit udhëzohen të punojnë të pavarur në detyrën 3. Ata duke e zbatuar vetinë e pandryshueshmërisë së shumës njehsojnë shumën. Dallojnë rritjen e mbledhorëve nëse është për të njëjtin numër, atëherë shuma nuk ndryshon. Vlerësohet puna e tyre.
Komentohet pas njehsimit me tërë klasën.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shpjegimin e përkufizimit të pandryshueshmerisë së shumës dhe ndryshimit dhe përdorimin e tyre në njehsimin e shumës dhe ndryshimit.

Detyrë:
Detyra 1 dhe 2 (faqe 95).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 61

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zbaton varshmërinë e shumës nga mbledhorët dhe pandryshueshmërinë e shumës;
Zbaton varshmërinë e ndryshimit nga i zbritshmi, zbritësi dhe pandryshueshmëria e ndryshimit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1.3; II.4,7; III.3,4,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,.5; 2.2; 3.1 7.1.



MBLEDHJA E NUMRAVE TRESHIFRORË ME NJË NUMËR DYSHIFROR

1 Njehsojmë hap pas hapi.

436 + 53 =

436 + 50 = 486
486 + 3 =
436 + 53 =

Për të lehtësuar zgjidhjen, njehsojmë hap pas hapi.
Shkruajmë rezultatet e ndërmjetme dhe pastaj i mbledhim ato.
Duhet t'i kushtojmë vëmendje shënimit të rezultateve, sepse mund të vijmë në rezultat të gabuar.

436 + 53 = 436 + (50 + 3)
= (436 + 50) + 3
= 486 + 3
=

2 Njehsojmë dhe shenjojmë rezultatin.

653 + 36 = 689
441 + 52 =
233 + 64 =

347 + 32 =
126 + 43 =
132 + 56 =

545 + 24 =
243 + 23 =
333 + 62 =

997 689 458 493 199 297 395 379 266 169 569 188

3 Njehsojmë hap pas hapi:

638 + 78 =

638 + 78
+70 +

689 + 46 =
468 + 78 =

787 + 64 =
375 + 68 =

4 Njehsojmë dhe plotësojmë.

374 + = 426

374 + 50 = 424
424 + 2 =
374 + 52 = 426

358 + = 424
256 + = 323

439 + = 506
783 + = 828

5 Në një fshat jetojnë 858 banorë, kurse në një fshat tjetër 99 banorë më shumë. Sa banorë jetojnë në fshatin e dytë?

Njehsojmë:

Përgjigjja:

Mësojmë

85

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbledhja e numrave treshifrorë me një numër dyshifror

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën dhe ndryshimin duke zbatuar vetinë e pandryshueshmërisë së shumës dhe ndryshimit;
- Zbaton vetinë e varshmërisë së shumës nga mbledhorët dhe të ndryshimit nga i zbritshmi dhe zbritësi në njehsime.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Mendo - Njehso -Thuaja grupit

Nxënësit në fillim të orës përsërisin rregullat e varshmërisë së shumës nga mbledhorët dhe pandryshueshmërisë së shumës si dhe rregullat e varshmërisë së ndryshimit nga zbritësi, i zbritshmi dhe pandryshueshmëria e ndryshimit.
Ata udhëzohen të plotësojnë tabelat në detyrën 1 në libër. Pas plotësimit pyeten: Cilën veti zbatuat?



MBLEDHJA E NUMRAVE TRESHIFRORË ME NJË NUMËR DYSHIFROR

1 Njehsojmë hap pas hapi.

436 + 53 = ☐

436 + 50 = 486
486 + 3 = ☐
436 + 53 = ☐

Për të lehtësuar zgjidhjen, njehsojmë hap pas hapi. Shkruajmë rezultatet e ndërmjetme dhe pastaj i mbledhim ato. Duhet t'i kushtojmë vëmendje shënimit të rezultateve, sepse mund të vijmë në rezultat të gabuar.

436 + 53 = 436 + (50 + 3)
= (436 + 50) + 3
= 486 + 3
= ☐

2 Njehsojmë dhe shenjojmë rezultatin.

653 + 36 = 689
441 + 52 = ☐
233 + 64 = ☐

347 + 32 = ☐
126 + 43 = ☐
132 + 56 = ☐

545 + 24 = ☐
243 + 23 = ☐
333 + 62 = ☐

997 689 458 493 199 297 395 379 266 169 569 188

3 Njehsojmë hap pas hapi:

638 + 78 = ☐

638 + 78 = ☐
638 +70 = ☐
☐ + ☐ = ☐

689 + 46 = ☐
468 + 78 = ☐

787 + 64 = ☐
375 + 68 = ☐

4 Njehsojmë dhe plotësojmë.

374 + ☐ = 426

374 + 50 = 424
424 + 2 = ☐
374 + 52 = 426

358 + ☐ = 424
256 + ☐ = 323

439 + ☐ = 506
783 + ☐ = 828

5 Në një fshat jetojnë 858 banorë, kurse në një fshat tjetër 99 banorë më shumë. Sa banorë jetojnë në fshatin e dytë?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

Mësojmë

85

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Punë e drejtuar

Detyra 3 - Nxënësit zbatojnë pandryshueshmërinë e ndryshimit në njehsimin e ndryshimit. Punohen dy shembuj.
Detyra 4 - Nxënësit njehsojnë shumën dhe ndryshimin në bazë të barazimit të dhënë. Punohet në dyshe. Më pas komentohen para klasës.
Detyra 5 lexohet e komentohet.
Detyra 8 - Nxënësit udhëzohen të plotësojnë tabelën, ku kanë për të njehsuar së pari ndryshimin, e më pas varshmërinë e ndryshimit nga zbritësi. Pas plotësimit komentohet para klasës.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Mendo - Zbulo - Njehso

Nxënësit udhëzohen të zbulojnë rregullën përmes njehsimit të barazimeve në detyrën 9.
Rregulla e tabelës së parë është: Nëse i zbritshmi rritet për 1 kurse zbritësi zvogëlohet po për atë numër, ndyshimi rritet për 2.
Plotësohet edhe tabela e dytë duke njehsuar. Rregulla është e dhënë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësi vlerësohet për saktësinë në zbatimin e vetive të varshmërisë së shumës nga mbledhorët e pandryshueshmërisë së saj si dhe të varshmërisë së ndryshimit nga i zbritshmi, zbritësi dhe pandryshueshmëria e tij.

Detyrë:
Detyra 6 dhe 7 (faqe 86).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 62

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhjen të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3; III/1,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pozita e objekteve në rrjetin koordinativ


RRJETI KOORDINATIV

POZITA E OBJEKTEVE NË RRJETIN KOORDINATIV

1 Si përcaktohet pozita e katrorit të ngjyrosur në rrjetin koordinativ?

Katrori i ngjyrosur ndodhet në prerje të drejtimit vertikal, të përcaktuar me numrin 4 dhe të drejtimit horizontal, të përcaktuar me shkronjën d.

Themi se pozita e katrorit (të ngjyrosur me të kuqe) në rrjetin koordinativ është dhënë me çiftin (4, d).

2 Në rrjetin koordinativ:

1. ngjyrosim me të kuqe katrorët e përcaktuar me çiftet (2, b), (4, d), (5, e) dhe (8, a),
2. ngjyrosim me të gjelbër katrorët e përcaktuar me çiftet (4, b), (3, d), (1, e) dhe (7, c),
3. ngjyrosim me të kaltër katrorët e përcaktuar me çiftet (4, a), (8, c), (1, d) dhe (6, c).

3 Analizojmë rrjetin koordinativ dhe caktojmë pozitat e figurave në të.

(5, e)

Mësojmë

98

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Identifikon rreshtat dhe shtyllat e rrjetit koordinativ;
- Shënon koordinatat e rubrikave të dhëna në rrjetin koordinativ dhe anasjelltas.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Mësimdhënësi/ja u parashtron pyetje nxënësve:
Si përcaktohet pozita e katrorit në rrjetin koordinativ?
Pas përgjigjeve të tyre mësimdhënësi/ja sqaron se nga rrjeti koordinativ për të gjetur koordinatën e katrorit veprojmë si në vijim: së pari përcaktojmë drejtimin vertikal dhe pastaj drejtimin horizontal të saj. Pra, saktësojmë se koordinata e katrorit është 4, d.





RRJETI KOORDINATIV

POZITA E OBJEKTEVE NË RRJETIN KOORDINATIV

1 Si përcaktohet pozita e katrorit të ngjyrosur në rrjetin koordinativ?

Katrori i ngjyrosur ndodhet në prerje të drejtimit vertikal, të përcaktuar me numrin 4 dhe të drejtimit horizontal, të përcaktuar me shkronjën d.

Themi se pozita e katrorit (të ngjyrosur me të kuqe) në rrjetin koordinativ është dhënë me çiftin (4, d).

2 Në rrjetin koordinativ:

1. ngjyrosim me të kuqe katrorët e përcaktuar me çiftet (2, b), (4, d), (5, e) dhe (8, a),
2. ngjyrosim me të gjelbër katrorët e përcaktuar me çiftet (4, b), (3, d), (1, e) dhe (7, c),
3. ngjyrosim me të kaltër katrorët e përcaktuar me çiftet (4, a), (8, c), (1, d) dhe (6, c).

3 Analizojmë rrjetin koordinativ dhe caktojmë pozitat e figurave në të.

(5, e)

Mësojmë

98

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Veprimtari e drejtuar

Në detyrën e dytë është vendosur një rrjet koordinativ i zbrazët dhe nga nxënësit kërkohet që të ngjyrosin katrorët përkatës me disa ngjyra sipas koordinatave të pikave të dhëna nën detyrën 1, 2 dhe 3.

1. ngjyrosim me të kuqe katrorët e përcaktuar me çiftet (2, b), (4, d), (5, e) dhe (8, a),
2. ngjyrosim me të gjelbër katrorët e përcaktuar me çiftet (4, b), (3, d), (1, e) dhe (7, c),
3. ngjyrosim me të kaltër katrorët e përcaktuar me çiftet (4, a), (8, c), (1, d) dhe (6, c).

Dhe do ta fitojme zgjidhjen si më poshtë:

Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Mendo - Zbulo - Njehso

Bazuar në zgjidhjen e detyrës së dytë, nxënësit në librat e tyre do të caktojnë pozitat e figurave dhe do të analizojnë rrjetin koordinativ.

(5, e)

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin e drejtë të rreshtave dhe shtyllave të rrjetit koordinativ dhe për saktësinë e shënimit të koordinatave të rubrikave të dhëna në rrjetin koordinativ dhe anasjelltas.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 63

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3; III,1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1,1,4,5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Koordinatat e pikave


KOORDINATAT E PIKAVE

1 Kopjojmë figurën e dhënë.

2 Për të treguar pozitën e pikës A në rrjetin koordinativ përdorim çiftin e numrave (3, 4).

Numrat 3 dhe 4 quhen koordinatat e pikës A.
Shënojmë: A (3, 4)
3 – quhet koordinata e parë e pikës A.
4 – quhet koordinata e dytë e pikës A.
Kujdes!
Çiftet (3, 4) dhe (4, 3) nuk e përcaktojnë të njëjtën pikë në rrjetin koordinativ.

Analizojmë rrjetin koordinativ dhe shkruajmë koordinatat e pikave:
B(__, __), C(__, __), D(__, __).

3 Përcaktojmë koordinatat e kulmeve të figurave të dhëna në rrjetin koordinativ.

A(__, __), B(__, __), C(__, __).
D(__, __), E(__, __), F(__, __), G(__, __).
H(__, __), I(__, __), J(__, __), K(__, __), L(__, __).

Mësojmë

99

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet pikat në rrjetin koordinativ;
- Identifikon rreshtat dhe shtyllat e rrjetit koordinativ;
- Përcaktojnë koordinatat e kulmeve në figurat e dhëna në rrjetin koordinativ.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: litar, shkronja magnetike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Lojë me numra

Para së të fillohet me detyrat në libër bashkë me nxënësit ndërtohet në dysheme një rrjet koordiantiv. Rrjeti koordiantiv mund të formohet me ngjitës ose edhe me shkumësa me ngjyra.
Kërkohet nga nxënësit e caktuar të pozicionohen në pika të ndryshme.
Një nxënës tjetër gjen koordinatat e pikave. Përsëritet kjo veprimtari me dy ose tre nxënës deri sa të kuptohen nga nxënësit koordinatat e pikave në rrjetin koordinativ. Më pas mund të kërkohet nga nxënësit të kapen për dore dhe të formojnë figura gjeometrike të ndryshme.



4 T'i paraqesim në rrjetin koordinativ këto pika:

$A(1, 1)$ $F(8, 9)$
$B(9, 1)$ $G(2, 9)$
$C(7, 3)$ $H(3, 7)$
$D(8, 6)$ $I(2, 6)$
$E(6, 7)$ $J(3, 3)$

5 Në rrjetin kordinativ përcaktojmë të gjitha pikat, shuma e koordinatave të të cilave është 8.

$A(3, 5)$ $F(__, __)$
$B(__, __)$ $G(__, __)$
$C(__, __)$ $H(__, __)$
$D(__, __)$ $I(__, __)$
$E(__, __)$

6 Shkruajmë koordinatat e pikave të dhëna. Shkruajmë, pastaj, pikat që merren nga pikat e dhëna, kur koordinatës së parë të tyre ia shtojmë numrin 1.

$A(2, 3) \rightarrow A'(3, 3)$
$B(__, __) \rightarrow B'(__, __)$
$C(__, __) \rightarrow C'(__, __)$
$D(__, __) \rightarrow D'(__, __)$
$E(__, __) \rightarrow E'(__, __)$
$F(__, __) \rightarrow F'(__, __)$
$G(__, __) \rightarrow G'(__, __)$

Mësojmë

100

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Paraqitet në ekran detyra 1 në faqe 99 dhe kërkohet nga nxënësit të analizojnë dhe të kopjojnë pikat në figurën tjetër.
Detyra e radhës prezanton një rrjet koordinativ ku janë të vendosura katër pika, ku për të treguar pozitën e tyre në rrjetin koordinativ përdorim çiftin e numrave (3, 4).
Secila prej pikave shoqërohet me shkronja. Sqarohen koordinatat duke u bazuar në udhëzimet që gjenden në libër. Theksohet se: numrat 3 dhe 4 quhen koordinatat e pikës A.
Shënojmë: A(3, 4)
3 - quhet koordinata e parë e pikës A.
4 - quhet koordinata e dytë e pikës A. Duhet pasur kujdes se çiftet (3,4) dhe (4,3) nuk e përcaktojnë të njëjtën pikë në rrjetin koordinativ.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Vëzhgo - analizo - zbato

Kalohet te detyra 3, në të njëjtën faqe, ku kërkohet nga nxënësit të identifikojnë koordinatat e secilës pikë të secilës figurë dhe ta shqyrtojnë atë.
P.sh., te trekëndëshi kemi kulmet A, B, C, me koordinatat A (1, 9); B (1, 6); C (3, 6).
Në mënyrë të ngjashme paraqesin pikat në rrjetin koordinativ në detyrën 4, faqe 100.

Kalohet te detyra 5, ku nxënësit duhet së pari të gjejnë dy mbledhorë që japin numrin 8. Organizohen në dyshe dhe nëpërmjet lojës me zar gjejnë dy mbledhorët që formojnë numrin 8.
Njëri gjuan zarin p.sh., numri (4), dhe nxënësi tjetër duhet të thotë mbledhorin e dytë, pastaj ndërrohen rolet. Më pas ata mbledhorë i vendosin në rrjetin koordinativ dhe i përcaktojnë pikat.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e pikave në rrjetin koordinativ, identifikimin e rreshtave dhe shtyllave dhe përcaktimin e koordinatave të kulmeve të figurave.

Detyrë:
Detyra 6 (faqe 100).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 64

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1.3; II.4,7; III.3,4,5;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,.5; 2.2; 3.1; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Figurat simetrike ndaj një drejtëze të dhënë



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Vizaton figurën simetrike ndaj drejtëzës së simetrisë;
- Vizaton pikat simetrike me pikat e dhëna në lidhje me drejtëzën simetrike duke ua caktuar koordinatat e pikave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Nxënësve u kërkohet të tregojnë se çfarë paraqet simetria.

Japin shembuj nga jeta.



Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Vizatim

Detyra 1 - Nxënësit udhëzohen të plotësojnë vizatimin në mënyrë që figura e fituar të jetë simetrike ndaj drejtëzës së dhënë. Udhëzohen të fillojnë nga drejtëza e simetrisë të plotësojnë vizatimin. Përdoret vizorja. Kujdes të veçantë duhet te shembulli i dytë për shkak të pozitës së pjerrët të figurës.
Detyra 2 është e natyrës së njëjtë me detyrën e mësipërme, vetëm që kanë në fund për ta ngjyrosur figurën. Punohet vetëm një shembull.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Vizato - Formo

Nxënësit vizatojnë pikat simetrike me pikat e dhëna në lidhje me drejtëzën e dhënë. Pastaj do të shkruajnë koordinatat e pikave të caktuara. Punohet shembulli 1.
Koordinatat e pikave janë këto: A (3, 1) A' (7, 1)
B (1, 3) B' (9, 3)
C (1, 7) C' (9. 7)
D (3, 7) D' (7, 7)
E (3, 9) E' (8, 9)

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në vizatimin e figurës dhe pikave në lidhje me drejtëzën e simetrisë dhe pikave të dhëna simetrike duke ua caktuar koordinatat e tyre.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 101).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 65

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhjen e problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3; III/1,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zhvendosja e figurave


ZHVENDOSJA E FIGURAVE

1 Në rrjetin koordinativ janë dhënë trekëndëshat ABC dhe $A`B`C`$. Trekëndëshi $A`B`C`$ është marrë nga trekëndëshi ABC, kur atë e zhvendosim djathtas, paralel me shigjetën e dhënë dhe në largësi sa është gjatësia e shigjetës.

Koordinatat e kulmeve të trekëndëshit ABC janë:
$A(__,__)$, $B(__,__)$, $C(__,__)$.

Koordinatat e kulmeve të trekëndëshit $A`B`C`$ janë:
$A`(__,__)$, $B`(__,__)$, $C`(__,__)$.

Thuhet se:
Trekëndëshi ABC është zhvendosur paralelisht në trekëndëshin $A`B`C`$.

2 Ta zhvendosim figurën e dhënë sipas drejtimit të dhënë me shigjetë.
Vërejmë se shigjeta është e orientuar djathtas, prandaj edhe zhvendosja e figurës bëhet djathtas. Gjithashtu, gjatësia e shigjetës është sa gjatësia 15 njësi, prandaj largësia e zhvendosjes së figurës është 15 njësi.

3 Të zhvendosim figurën sipas drejtimit të përcaktuar me shigjetën e dhënë.

Mësojmë

102

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shënon koordinatat e rubrikave të dhëna në rrjetin koordinativ dhe anasjelltas;
- Paraqet pikat në rrjetin koordinativ;
- Zhvendos figurat brenda rrjetit koordinativ.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Pjesa e parë e orës mund të shfrytëzohet për kontrollim të detyrave të shtëpisë nga figurat simetrike dhe të jepet ndonjë sqarim shtesë.



ZHVENDOSJA E FIGURAVE

1 Në rrjetin koordinativ janë dhënë trekëndëshat ABC dhe $A`B`C`$. Trekëndëshi $A`B`C`$ është marrë nga trekëndëshi ABC, kur atë e zhvendosim djathtas, paralel me shigjetën e dhënë dhe në largësi sa është gjatësia e shigjetës.

Koordinatat e kulmeve të trekëndëshit ABC janë:

$A(__,__)$, $B(__,__)$, $C(__,__)$.

Koordinatat e kulmeve të trekëndëshit $A`B`C`$ janë:

$A`(__,__)$, $B`(__,__)$, $C`(__,__)$.

Thuhet se:
Trekëndëshi ABC është zhvendosur paralelisht në trekëndëshin $A`B`C`$.

2 Ta zhvendosim figurën e dhënë sipas drejtimit të dhënë me shigjetë.
Vërejmë se shigjeta është e orientuar djathtas, prandaj edhe zhvendosja e figurës bëhet djathtas. Gjithashtu, gjatësia e shigjetës është sa gjatësia 15 njësi, prandaj largësia e zhvendosjes së figurës është 15 njësi.

3 Të zhvendosim figurën sipas drejtimit të përcaktuar me shigjetën e dhënë.

Mësojmë

102

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Në këtë fazë të orës paraqesim një skemë të rrjetit koordinativ ku një trekëndësh zhvendoset në anën e djathtë të tij duke mos ndryshuar dimensionin por vetëm duke ndryshuar koordinatat në atë rrjet koordinativ.



Nga nxënësit kërkojmë që paraprakisht të identifikojnë koordinatat e trekëndëshit të parë dhe pastaj të identifikojnë koordinatat e trekëndëshit të zhvendosur në mënyrë paralele. Në detyrën 2 kërkohet nga nxënësit që në libër t'i zhvendosin figurat e dhëna për 15 njësi nga ana e djathtë.



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Në pjesën e mbetur të orës zgjidhet detyra 3 ku kërkohet zhvendosja e figurës së dhënë sipas drejtimit të përcaktuar të shigjetës.
Nxënësit duhet të numërojnë se sa katrorë është e gjatë shigjeta dhe pastaj çdo pikë të figurës duhet ta zhvendosin për gjatësinë e njëjtë nga origjina.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shënimin e drejtë të koordinatave në rrjetin koordinativ si dhe për paraqitjen e pikave në rrjetin koordinativ duke vlerësuar dhe zhvendosur saktë figurat brenda rrjetit.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 66

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhjen e problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3; III/1,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5; 2.2; 7.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zhvendosja e figurave (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shënon koordinatat e rubrikave të dhëna në rrjetin koordinativ dhe anasjelltas;
- Paraqet pikat në rrjetin koordinativ;
- Bën zhvendosjen e figurave brenda rrjetit koordinativ.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Pjesa hyrëse e njësisë mësimore përdoret për të përcaktuar në përgjithësi lidhjet në rrjetin koordinativ, pikat dhe figurat gjeometrike brenda tyre dhe koordinatat e pikave.
Në detyrën 1 është dhënë një rrjet koodinativ dhe kërkohet të përcaktohet pozita e secilës figurë brenda rrjetit koordinativ.





4 Shkruajmë të gjitha pikat, prodhimi i koordinatave të të cilave është 6. I paraqesim pastaj ato në rrjetin koordinativ.

$A(__,__)$
$B(__,__)$
$C(__,__)$
$D(__,__)$

5 Figurën e dhënë e zhvendosim paralelisht në drejtimin e përcaktuar me shigjetë, si në figurë.

6 Shkruajmë koordinatat e kulmeve të figurës së dhënë. E zhvendosim atë paralelisht në drejtim vertikal dhe poshtë për 5 katrorë dhe pastaj shkruajmë koordinatat e kulmeve të figurës së fituar.

$A(2,6) \rightarrow A'(2,1)$
$B(__,__) \rightarrow B'(__,__)$
$C(__,__) \rightarrow C'(__,__)$
$D(__,__) \rightarrow D'(__,__)$
$E(__,__) \rightarrow E'(__,__)$
$F(__,__) \rightarrow F'(__,__)$
$G(__,__) \rightarrow G'(__,__)$
$H(__,__) \rightarrow H'(__,__)$

Ushtrojmë

104

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e orientuar

Detyra 2 paraqet një rrjet koordinativ dhe pikat brenda tij. Nga nxënësit kërkohet që në grupe të vogla t'i identifikojnë koordinatat e këtyre pikave.



$A(__,__)$ $F(__,__)$
$B(__,__)$ $G(__,__)$
$C(__,__)$ $H(__,__)$
$D(3,4)$ $J(__,__)$
$E(__,__)$

Fitohet:



$A(0.1)$ $F(6.3)$
$B(1.6)$ $G(4.1)$
$C(2.2)$ $H(8.2)$
$D(3.4)$ $J(7.0)$
$E(7.5)$

Detyra 3 është rast i anasjellë i detyrës numër 2 sepse këtu janë dhënë koordinatat dhe kërkohet nga nxënësit t'i paraqesin ato në rrjetin koordinativ.

$P(1, 3)$, $Q(2, 1)$, $R(8, 4)$, $N(5, 0)$, $T(6, 3)$, $S(7, 1)$.



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Nxënësit udhëzohen të zgjidhin detyrën 4 dhe 5 në mënyrë individuale.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shënimin e koordinatave në rrjetin koordinativ si dhe për paraqitjen e pikave në rrjetin koordinativ duke vlerësuar dhe zhvendosur saktë figurat brenda rrjetit.

Detyrë:
Detyra 6 (faqe 104).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 67

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen matjet e ndryshme duke përdorur njësitë standarde.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3; III,1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1,1,4,5; 2.4; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Metri dhe centimetri

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton nënfishat dhe shumëfishat e metrit;
- Përdor metrin dhe centimetrin si njësi matëse të gjatësisë;
- Tregon ose përshkruan se si bëhen shndërrimet e nevojshme në detyrat e dhëna.


MATJA E GJATËSISË

METRI DHE CENTIMETRI

Të kujtojmë:

1 cm

Metri

0 10 20 30 40 50 60 70 80 90 100

1 cm → 1 centimetër
1 centimetër = 1 cm

1 m = 100 cm

1 Shndërrojmë metrat në centimetra dhe anasjellas.

1 m = 100 cm				100 cm = 1 m			
3 m = ☐ cm	6 m = ☐ cm	200 cm = ☐ m	300 cm = ☐ m
4 m = ☐ cm	7 m = ☐ cm	800 cm = ☐ m	700 cm = ☐ m
2 m = ☐ cm	9 m = ☐ cm	400 cm = ☐ m	500 cm = ☐ m
8 m = ☐ cm	5 m = ☐ cm	900 cm = ☐ m	600 cm = ☐ m

2 Besa është e gjatë 1 m e 60 cm. Vala është 13 cm më e shkurtër. Sa është e gjatë Vala?
Njehsojmë:
Përgjigjja:

3 Një dërrasë është prerë në dy pjesë si në figurë. Sa ishte e gjatë dërrasa para prerjes?
2 m 35 cm 2 m 90 cm
Njehsojmë:
Përgjigjja:

4 Në një shitore kishte 9 m 50 cm stof pambuku. Sara bleu nga ky lloj 80 cm. Sa metra mbetën nga ky lloj stofi?
9 m 50 cm
80 cm
9 m 50 cm – 80 cm
Njehsojmë:
Përgjigjja:

Mësojmë

105

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Metër druri.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Kërkohet nga nxënësit të përmendin disa njësi të gjatësisë, duke u nxitur nga pyetjet:
- Si mendoni, cila njësi përdoret për:
1) gjatësinë e klasës;
2) gjatësinë e tavolinës suaj;
3) gjatësinë e librit.
Mund të shfrytëzohet dhe një dërrasë e hollë me gjatësi prej një metër, të vizatuar në të centimetrat dhe decimetrat e nevojshëm, dhe të shpjegojë lidhjen e metrit dhe centimetrit.



MATJA E GJATËSISË

METRI DHE CENTIMETRI

Të kujtojmë:

1 cm

Metri

0 10 20 30 40 50 60 70 80 90 100

1 cm → 1 centimetër
1 centimetër = 1 cm

1 m = 100 cm

1 Shndërrojmë metrat në centimetra dhe anasjellas.

1 m = 100 cm

3 m = ☐ cm	6 m = ☐ cm	200 cm = ☐ m	300 cm = ☐ m
4 m = ☐ cm	7 m = ☐ cm	800 cm = ☐ m	700 cm = ☐ m
2 m = ☐ cm	9 m = ☐ cm	400 cm = ☐ m	500 cm = ☐ m
8 m = ☐ cm	5 m = ☐ cm	900 cm = ☐ m	600 cm = ☐ m

100 cm = 1 m

2 Besa është e gjatë 1 m e 60 cm. Vala është 13 cm më e shkurtër. Sa është e gjatë Vala?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

3 Një dërrasë është prerë në dy pjesë si në figurë. Sa ishte e gjatë dërrasa para prerjes?

2 m 35 cm 2 m 90 cm

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

4 Në një shitore kishte 9 m 50 cm stof pambuku. Sara bleu nga ky lloj 80 cm. Sa metra mbetën nga ky lloj stofi?

9 m 50 cm

80 cm

9 m 50 cm – 80 cm

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

Mësojmë

105

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e drejtuar

Fillohet me sqarime elementare duke u nisur nga gjerësia e një gishti, e duke vazhduar me vizoret e tyre.

Detyra e parë në faqe 105 përmban disa shembuj ku kërkohet të bëhet shndërrimi nga metri në centimetër dhe anasjelltas, duke e ditur raportin në mes tyre.

Detyra 3 thotë: Besa është e gjatë 1 m e 60 cm. Vala është 13 cm më e shkurtër. Sa është e gjatë Vala?

Mënyra e të shkruarit mund të bëhet në shumë forma, por për momentin është e rëndësishme që nxënësit të kuptojnë se si bëhet llogaritja. Pra, meqë Vala është për 13 cm më e shkurtër, atëherë, duhet marrë për bazë gjatësinë e Besës, që është 1 m e 60 cm dhe t'i zbresim 13 cm. Prandaj, gjatësia e Valës është 1 m e 47 cm.

Detyra e radhës ilustrohet me një figurë, nga e cila edhe duhet të gjendet zgjidhja -

Një dërrasë është prerë në dy pjesë si në figurë:

2m 35 cm 2m 90 cm

- Sa ishte e gjatë dërrasa para prerjes?

Pra, meqë madhësitë e dy copave të dërrasës janë të dhëna, atëherë, gjatësia e dërrasës para prerjes ka qenë kur i mbledhim gjatësitë e këtyre dy copave:

2 m 35 cm + 2 m 90 cm = 5 m 25 cm.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Vëzhgo - analizo - zbato

Kërkohet nga nxënësit që detyrën e fundit të përpiqen ta zgjidhin individualisht duke e nxjerrë rezultatin e kërkuar. Bëhet prezantimi i tyre para klasës duke e përshkruar mënyrën e zgjidhjes së detyrës me fjalë. P.sh.: 9 m 50 cm – 80 cm = 950 cm – 80 cm = 870 cm ose 8 m e 70 cm.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për emërtimin e nënfishave dhe shumëfishave të metrit, përdorimin e tyre për matjen e gjatësisë dhe zgjidhjen e detyrave duke i kryer shndërrimet e nevojshme.

Detyrë:
Jepen 2 detyra me fjalë lidhur me njësitë matëse.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

_____

_____

Mësimi 68

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema me fjalë në lidhje me gjatësitë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3; III,1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1,1,4,5; 2.4; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Decimetri

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përdor decimetrin si njësi matëse për të kryer veprime;
- Krahason njësitë matëse të gjatësisë;
- Përshkruan kryerjen e shndërrimeve të bëra në detyrat e dhëna.


DECIMETRI

1 dm

Decimetri

10 cm = 1 decimetër
10 cm = 1 dm

1 dm = 10 cm

1 m = 10 dm = 100 cm

1 1 m = 10 dm = 100 cm

3 m = dm = cm
7 m = dm = cm

6 m = dm = cm
4 m = dm = cm

2 10 cm = 1 dm 10 dm = 1 m

800 cm = dm = m
900 cm = dm = m

100 cm = dm = m
500 cm = dm = m

3 100 cm = 1 m

410 cm = m cm
280 cm = m cm

269 cm = m cm
357 cm = m cm

4 1 m = 100 cm 1 dm = 10 cm

475 cm = m dm cm
507 cm = m dm cm

6 m 5 dm 7 cm = cm
3 m 6 dm 8 cm = cm

5 1m = 10 dm 10 dm = 1 m 1 dm = 10 cm

7 m 3 dm = dm
10 m 2 dm = dm

60 dm = m
120 dm = m

70 dm = cm
90 dm = cm

Mësojmë

106

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Metër druri.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Pyeten nxënësit:
- *Cila është njësia bazë e gjatësisë?*
- *Cilët janë nënfishat e metrit?*
- *Po shumëfishat, cilët janë?*
- *Sa decimetra ka një metër?*
- *Po decimetri, sa centimetra ka?*

Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë duke dhënë sqarimet e nevojshme, duke theksuar lidhjen që ka metri, decimetri dhe centimetri.



DECIMETRI

1 dm

Decimetri

10 cm = 1 decimetër
10 cm = 1 dm

1 dm = 10 cm

1 m = 10 dm = 100 cm

1 1 m = 10 dm = 100 cm

3 m = ☐ dm = ☐ cm
7 m = ☐ dm = ☐ cm

6 m = ☐ dm = ☐ cm
4 m = ☐ dm = ☐ cm

2 10 cm = 1 dm 10 dm = 1 m

800 cm = ☐ dm = ☐ m
900 cm = ☐ dm = ☐ m

100 cm = ☐ dm = ☐ m
500 cm = ☐ dm = ☐ m

3 100 cm = 1 m

410 cm = ☐ m ☐ cm
280 cm = ☐ m ☐ cm

269 cm = ☐ m ☐ cm
357 cm = ☐ m ☐ cm

4 1 m = 100 cm 1 dm = 10 cm

475 cm = ☐ m ☐ dm ☐ cm
507 cm = ☐ m ☐ dm ☐ cm

6 m 5 dm 7 cm = ☐ cm
3 m 6 dm 8 cm = ☐ cm

5 1m = 10 dm 10 dm = 1 m 1 dm = 10 cm

7 m 3 dm = ☐ dm
10 m 2 dm = ☐ dm

60 dm = ☐ m
120 dm = ☐ m

70 dm = ☐ cm
90 dm = ☐ cm

Hësojmë

106

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Kërkohet nga nxënësit të bëjnë hapjen e gishtave të dorës së tyre, dhe u tregohet se distanca e skajeve të gishtave të tyre është 10 cm. Sqarimet e tilla prezantohen në tabelë.

10 cm = 1 decimetër 1 dm = 10 cm
10 cm = 1dm
1 m = 10 dm = 100 cm

Detyra 1, në faqe 106 fillimisht tregon se 1 m = 10 dm = 100 cm, e pastaj kërkon të zgjidhen disa shembuj:

1 m = 10 dm = 100 cm

3 m = __ dm = __ cm 6 m = __ dm __cm
7 m = __ dm = __ cm 4 m = __ dm __ cm

Ngjashëm me këtë detyrë janë edhe detyrat e tjera në këtë faqe, dhe varësisht prej kohës në dispozicion kërkohen të zgjidhen të gjitha ose pjesërisht.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Mendo - krijo dyshe - diskuto

Nxënësit punojnë me ushtrimet 2, 3 dhe 4 në faqe 106 në libër që kanë të bëjnë me shndërrimet. Më pas diskutohen përgjigjet dhe korrigjohen gabimet e bëra. Më pas vlerësohen nxënësit që e kanë zgjidhur detyrën saktë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e krahasimit të njësive matëse dhe për kryerjen e shndërrimeve në detyrat e dhëna.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 106).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 69

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen matje të ndryshme duke përdorur njësitë standarde;
Krahason objekte të ndryshme bazuar në matjet e bëra;
Zgjidh problema me fjalë në lidhje me gjatësinë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3,13; II/1, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5; 2.4; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Milimetri


MILIMETRI

1 decimetër
1 dm
1 milimetër
1 mm
1 cm
1 centimetër
1 cm = 10 mm

Me diagramin e mëposhtëm po e japim lidhjen ndërmjet milimetrit (mm), centimetrit (cm), decimetrit (dm) dhe metrit (m).

• 1000
• 100
1 mm • 10 1 cm • 10 1 dm • 10 1 m
• 100

1 1 cm = 10 mm

7 cm = ☐ mm
8 cm = ☐ mm
35 cm = ☐ mm
48 cm = ☐ mm

38 mm = ☐ cm ☐ mm
92 mm = ☐ cm ☐ mm
127 mm = ☐ cm ☐ mm
426 mm = ☐ cm ☐ mm

8 cm 3 mm = ☐ mm
9 cm 8 mm = ☐ mm
6 cm 5 mm = ☐ mm
1 cm 4 mm = ☐ mm

2 100 mm = 1 dm 10 mm = 1 cm

486 mm = ☐ dm ☐ cm ☐ mm
379 mm = ☐ dm ☐ cm ☐ mm
827 mm = ☐ dm ☐ cm ☐ mm

3 cm – 5 mm = ☐ cm ☐ mm
6 cm – 4 mm = ☐ cm ☐ mm
2 cm – 8 mm = ☐ cm ☐ mm

Mësojmë

107

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përdor milimetrin si njësi matëse e gjatësisë dhe kryen veprime me këtë njësi;
- Përdor metrin, decimetrin, centimetrin dhe milimetrin si njësi matëse të gjatësisë dhe kryen veprime me këto njësi.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Ngjashëm si në orën e kaluar edhe këtu mund të bëjmë një përsëritje si hyrje në mes të njësive matëse të gjatësisë duke identifikuar nënfishat e saj të mësuar deri më tani, si: metri, centimetri dhe decimetri.



MILIMETRI

1 decimetër
1 dm
1 milimetër
1 mm
1 cm
1 centimetër
1 cm = 10 mm

Me diagramin e mëposhtëm po e japim lidhjen ndërmjet milimetrit (mm), centimetrit (cm), decimetrit (dm) dhe metrit (m).

• 1000
• 100
1 mm • 10 1 cm • 10 1 dm • 10 1 m
• 100

1 1 cm = 10 mm

7 cm = mm
8 cm = mm
35 cm = mm
48 cm = mm

38 mm = cm mm
92 mm = cm mm
127 mm = cm mm
426 mm = cm mm

8 cm 3 mm = mm
9 cm 8 mm = mm
6 cm 5 mm = mm
1 cm 4 mm = mm

2 100 mm = 1 dm 10 mm = 1 cm

486 mm = dm cm mm
379 mm = dm cm mm
827 mm = dm cm mm

3 cm – 5 mm = cm mm
6 cm – 4 mm = cm mm
2 cm – 8 mm = cm mm

Mësojmë

107

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Pjesën kryesore të kësaj ore e fillojmë me përdorimin e vizores në mënyrë të detajuar, ku mësimdhënësi/ja ua tregon nxënësve raportin në mes të milimetrit dhe centimetrit duke vizatuar në tabelë me anë të ilustrimit.



Më pas vazhdojmë me sqarimin e diagramit të mëposhtëm i cili tregon lidhshmërinë ndërmjet nënfishave të cilët i kemi mësuar deri më tani.



Mësimdhënësi/ja sqaron se për të kuptuar më qartë nënfishat mund t'i përdorim edhe shkallët. Shkalla më e lartë e tregon metrin ndërsa shkalla më e ulët milimetrin.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e orientuar dhe e pavarur

Nxënësit zgjidhin detyrat 1 dhe 2 duke u mbështetur në diagramin e mësipërm të sqaruar për nënfishat e metrit dhe milimetrit e kështu me radhë. Nxënësit punojnë nën ndihmën e mësimdhënësit/es dhe në mënyrë individuale.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përdorimin e drejtë të metrit, decimetrit, centimetrit, milimetrit si dhe për veprimet me këto njësi matëse.

Detyrë:
Detyra 2 (faqe 107).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 70

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen matje të ndryshme duke përdorur njësitë standarde;
Krahason objekte të ndryshme bazuar në matjet e bëra;
Zgjidh problema me fjalë në lidhje me gjatësinë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2, I.7, II.3, III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5; 2.4; 7.1.


1 Plotësojmë tabelat.

m	dm
8	80
	20
	100
9	

dm	cm
4	
	30
2	
	500

cm	dm
	1
70	
	6
100	

m	cm
7	
	800
4	
	100

2 Këmbejmë njësitë matëse.
420 cm = ☐ m ☐ cm
546 cm = ☐ m ☐ cm
837 cm = ☐ m ☐ cm
11 dm 6 cm = ☐ cm
18 dm 7 cm = ☐ cm
37 dm 42 cm = ☐ cm

3 Njehsojmë dhe plotësojmë.
6 m 40 cm + ☐ cm = 7 m
3 m 72 cm + ☐ cm = 4 m
9 m 67 cm + ☐ cm = 10 m
640 cm = ☐ m ☐ cm
720 cm = ☐ m ☐ cm
280 cm = ☐ m ☐ cm

4 Njehsojmë dhe plotësojmë.
6 dm + ☐ dm = 1 m
27 cm + ☐ cm = 1 m
65 cm + ☐ cm = 1 m
1 m – 3 dm = ☐ dm
1 m – 28 cm = ☐ cm
1 m – 49mm = ☐ cm

5 Njehsojmë dhe plotësojmë.
615 mm + ☐ mm = 1 m
328 mm + ☐ mm = 40 dm
73 cm + ☐ mm = 8 dm
60 mm + ☐ cm = 1 m

6 Analizojmë, njehsojmë dhe plotësojmë.
20 mm ☐ mm 38 mm
90 mm

Ushtrojmë

108

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Milimetri (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përdor milimetrin si njësi matëse e gjatësisë dhe kryen veprime me këtë njësi;
- Përdor metrin, decimetrin, centimetrin dhe milimetrin si njësi matëse të gjatësisë dhe kryen veprime me këto njësi.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Në pjesën e parë të orës mësimore, së bashku me nxënësit i përsërisim njësitë e gjatësisë që janë mësuar deri më tani, si: metrin, centimetrin e decimetrin, dhe në bazë të skemës së nënfishave plotësojnë tabelën.

m	dm
8	80
	20
	100
9	

dm	cm
4	
	30
2	
	500

cm	dm
	1
70	
	6
100	

m	cm
7	
	800
4	
	100



1 Plotësojmë tabelat.

m	dm
8	80
	20
	100
9	

dm	cm
4	
	30
2	
	500

cm	dm
	1
70	
	6
100	

m	cm
7	
	800
4	
	100

2 Këmbejmë njësitë matëse.

420 cm = ☐ m ☐ cm
546 cm = ☐ m ☐ cm
837 cm = ☐ m ☐ cm

11 dm 6 cm = ☐ cm
18 dm 7 cm = ☐ cm
37 dm 42 cm = ☐ cm

3 Njehsojmë dhe plotësojmë.

6 m 40 cm + ☐ cm = 7 m
3 m 72 cm + ☐ cm = 4 m
9 m 67 cm + ☐ cm = 10 m

640 cm = ☐ m ☐ cm
720 cm = ☐ m ☐ cm
280 cm = ☐ m ☐ cm

4 Njehsojmë dhe plotësojmë.

6 dm + ☐ dm = 1 m
27 cm + ☐ cm = 1 m
65 cm + ☐ cm = 1 m

1 m – 3 dm = ☐ dm
1 m – 28 cm = ☐ cm
1 m – 49mm = ☐ cm

5 Njehsojmë dhe plotësojmë.

615 mm + ☐ mm = 1 m
328 mm + ☐ mm = 40 dm

73 cm + ☐ mm = 8 dm
60 mm + ☐ cm = 1 m

6 Analizojmë, njehsojmë dhe plotësojmë.

20 mm ☐ mm 38 mm
90 mm

Ushtrojmë

108

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Veprimtari e pavarur/ Përmbledhje në dyshe

Nxënësit në mënyrë individuale zgjidhin detyrën 2, 3 dhe 4 dhe pas 10 minutave të zgjidhjes në libër, ata do t'i ndërrojnë librat me shokun/shoqen e bankës për të kuptuar se a janë zgjidhur saktë detyrat e mëposhtme.

2 Këmbejmë njësitë matëse.

420 cm = ☐ m ☐ cm
546 cm = ☐ m ☐ cm
837 cm = ☐ m ☐ cm

11 dm 6 cm = ☐ cm
18 dm 7 cm = ☐ cm
37 dm 42 cm = ☐ cm

3 Njehsojmë dhe plotësojmë.

6 m 40 cm + ☐ cm = 7 m
3 m 72 cm + ☐ cm = 4 m
9 m 67 cm + ☐ cm = 10 m

640 cm = ☐ m ☐ cm
720 cm = ☐ m ☐ cm
280 cm = ☐ m ☐ cm

4 Njehsojmë dhe plotësojmë.

6 dm + ☐ dm = 1 m
27 cm + ☐ cm = 1 m
65 cm + ☐ cm = 1 m

1 m – 3 dm = ☐ dm
1 m – 28 cm = ☐ cm
1 m – 49mm = ☐ cm

Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Veprimtari e pavarur

Nxënësit udhëzohen që të zgjidhin detyrën 6 në mënyrë të pavarur.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përdorimin e drejtë të metrit, decimetrit, centimetrit, milimetrit si dhe për veprimet me këto njësi matëse.

Detyrë:
Punohet një detyrë sipas modelit të detyrës 5.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 71

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
Krahason objekte të ndryshme bazuar në mjetet e bëra.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3; III,1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1,1,4,5; 2.4; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kilometri

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon nënfishat dhe shumëfishat e metrit;
- Krahason njësitë matëse të gjatësisë;
- Kryen shndërrimet e nevojshme në detyrat e dhëna.


KILOMETRI

START! 100 m 200 m 300 m 400 m 500 m 600 m 700 m 800 m 900 m 1000 m 1 km

1000 m = 1 kilometër
1000 m = 1 km

1 Njehsojmë dhe plotësojmë.

650 m + ☐ m = 1 km
480 m + ☐ m = 1 km
945 m + ☐ m = 1 km
755 m + ☐ m = 1 km

1000 m = 1 km

1 km – ☐ m = 300 m
1 km – ☐ m = 475 m
1 km – ☐ m = 225 m
1 km – ☐ m = 870 m

2 > = < ?

750 m + 240 m ☐ 1000 m
800 m + 150 m ☐ 1000 m
1 km – 520 m ☐ 490 m
1 km – 490 m ☐ 610 m

3 Njehsojmë dhe plotësojmë.

220 km 180 km 350 km ☐ km
125 km 350 km ☐ km 850 km

Njësimë

109

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Shirit gome me njësi matëse.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Përkujtohen shkurtimisht metri si njësi bazë për matjen e gjatësisë dhe nënfishat e tij. Pyeten nxënësit:
- *Me cilën njësi matëse mund ta masim gjatësinë e korridorit të shkollës?*
- *Po rrugën nga Prishtina në Gjakovë, me cilën njësi matëse e masim?*
- *Po librin, lapsin, dollapin me cilat njësi matëse i masim?*

Përsëriten njohuritë e tyre lidhur me njësitë matëse të cilat i kanë mësuar në orët paraprake.



KILOMETRI

STARTI 100 m 200 m 300 m 400 m 500 m 600 m 700 m 800 m 900 m 1000 m 1 km

1000 m = 1 kilometër

1000 m = 1 km

1 Njehsojmë dhe plotësojmë.

650 m + ☐ m = 1 km
480 m + ☐ m = 1 km
945 m + ☐ m = 1 km
755 m + ☐ m = 1 km

1000 m = 1 km

1 km – ☐ m = 300 m
1 km – ☐ m = 475 m
1 km – ☐ m = 225 m
1 km – ☐ m = 870 m

2 > = < ?

750 m + 240 m ☐ 1000 m
800 m + 150 m ☐ 1000 m
1 km – 520 m ☐ 490 m
1 km – 490 m ☐ 610 m

3 Njehsojmë dhe plotësojmë.

220 km 180 km 350 km ☐ km
125 km 350 km ☐ km 850 km

Mësojmë

109

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Udhëzohen nxënësit të shikojnë ilustrimin e paraqitur në faqe 109. Pra, këtu shihet qartë që nëse dëshirojmë të masim gjatësi të mëdha nuk na mjafton metri si njësi matëse.

Duke pasur parasysh raportin në mes të kilometrit dhe metrit, detyra 2 kërkon zgjidhjen e shembujve kur një kilometrit i duhet zbritur një gjatësi e caktuar e shprehur me metër, si më poshtë:

650 m + ___ m = 1 km 1 km - __ = 300 m
480 m + ___ m = 1 km 1 km - __ = 475 m

1000 m = 1 km

Në detyrën e dytë kërkohet të vendosin shenjat: >, <, =, e cila lidhet me jobarazimet, ku fillimisht duhet të bëhen llogaritje të veçanta e pastaj të vendosen shenjat.
Rezultatet paraqiten para klasës, ku diskutohen mënyrat e gjetjes së rezultateve të kërkuara.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Vëzhgo - analizo - zbato

Në detyrën 3, në po të njëjtën faqe, nxënësit vëzhgojnë skemat dhe përpiqen të gjejnë zgjidhjen sipas njohurive të fituara deri tani.

Në rastin e parë duhet të mblidhen gjatësitë e dhëna, ndërsa në rastin e dytë, nga totali prej 850 km duhet të zbritet shuma e 125 km dhe 350 km. Për saktësinë në zgjidhjen e detyrës, nxënësit vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e njësive matëse, krahasimin e tyre dhe saktësinë në kryerjen e shndërrimeve të duhura.

Detyrë:
Matet gjatësia e ndonjë objekti që i rrethon.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 72

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
Krahason objekte të ndryshme bazuar në mjetet e bëra.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3; III,1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1,1,4,5; 2.4; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kilometri

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përdor kilometrin si njësi matëse e gjatësisë dhe kryen veprime me këtë njësi;
- Krahason njësitë matëse të gjatësisë;
- Tregon ose përshkruan se si bëhen shndërrimet e nevojshme në detyrat e dhëna nga mësimdhënësi/ja.


1 Njehsojmë dhe plotësojmë.

610 m + ☐ m = 1 km
360 m + ☐ m = 1 km
1 km – ☐ m = 750 m

☐ m + 640 m = 1 km
1 km – ☐ m = 660 m
☐ m + 50 m = 1 km

2 Bashkoji nga dy numra që të fitosh 1 km.

160 m + 840 m = 1 km

160 m 910 m 760 m 420 m
- Cilat janë hapat që duhet të ndiqen në zbritjen në shtyllë?
- Pse e bëjmë provën?

Diskutohen përgjigjet e nxënësve, plotësohen sipas nevojës dhe në fund u kërkohet ta lexojnë numrin 1234 dhe t'i përcaktojnë vendvlerat sipas çdo shifre.



1 Njehsojmë ndryshimin në tabelën e vendvlerave dhe jashtë saj.

	Q	Dh	Nj
	2	8	6
-	2	2	8

	2	8	6
-	2	2	8

	Q	Dh	Nj
	3	2	1
-	1	1	9

	3	2	1
-	1	1	9

	Q	Dh	Nj
	7	9	2
-	2	6	7

	7	9	2
-	2	6	7

	Q	Dh	Nj
	5	2	1
-	3	0	7

	5	2	1
-	3	0	7

2 Shkruajmë shprehjen numerike dhe njehsojmë vlerën e saj.

Shumën e numrave 338 dhe 455 e zvogëlojmë për numrin 557.

Shprehja numerike:

(338 + 455) – 557 = ☐ – ☐ = ☐

Njehsojmë:

+			

-			

Nga ndryshimi i numrave 841 dhe 526 e zbresim numrin 109.

Shprehja numerike:

Njehsojmë:

-			

-			

3 Në krosin pranveror të shkollës morën pjesë 527 garues. 119 garues nuk arritën ta përfundonin shtegun e përcaktuar. Sa nxënës arritën ta përfundonin shtegun?

Njehsojmë:

-			

Përgjigja:_____

Ushtrojmë

20

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Analizo - zbato

Udhëzohen nxënësit të analizojnë dhe pastaj t'i zbatojnë njohuritë e fituara më herët për detyrat në faqe 20.
Detyra e parë është shprehur me anë të dy tabelave dhe nxënësit duhet të provojnë individualisht të zgjidhin secilin prej shembujve në këtë detyrë.

	Q	Dh	Nj
	2	8	6
-	2	2	8

Vazhdimisht përcillet puna e nxënësve dhe ofrohen sqarimet e nevojshme. Detyra 2 është e ngjashme me detyrat e kaluara, si dhe nxënësit mund të gjejnë zgjidhjen në dyshe, e pastaj t'i shkëmbejnë me njëri-tjetrin. Duhet pasur kujdes që mbledhorët dhe zbritësin e të zbritshmin t'i vendosin në vendet e caktuara.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Shqyrtim i përbashkët

Lexohet detyra 3: Në krosin pranveror të shkollës morën pjesë 527 garues. 119 garues nuk arritën ta përfundonin shtegun e përcaktuar. Sa nxënës arritën ta përfundonin shtegun?
Kërkohet nga nxënësit të mbledhin të dhënat dhe të paraqesin mënyra të ndryshme të gjetjes së zgjidhjes, p.sh.:

527
- 119
408

Përgjigja:_____.

Vlerësohen nxënësit për gjetjen e ndryshimit të numrave në situata të ndryshme problemore.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zbritjen e numrave në shtylla me kalim të dhjetëshes dhe për argumentimin e lidhjes midis mbledhjes dhe zbritjes.

Detyrë:
Të punohet një detyrë sipas modelit të detyrës 3.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 84

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3; III,1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1,1,4,5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të qindëshes

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Llogarit ndryshimin e numrave treshifrorë në shtyllë;
- Shpjegon lidhjen në mes të mbledhjes dhe zbritjes;
- Njehson ndryshimin e shprehjeve të dhëna numerike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.


ZBRITJA E NUMRAVE TRESHIFRORË ME PRISHJE TË QINDËSHES

1 Alketa kishte në kursime 429 €. Gjatë qëndrimit në një kamp veror për gjuhë të huaja ajo shpenzoi 235 €. Sa euro i mbetën asaj në kursime?

Qindëshet | Dhjetëshet | Njëshet

Nga 2 Dh nuk mund të zbriten 3 Dh. Për këtë, të zbritshmit i shtojmë 10 Dh, kurse zbritësit ia zbresim 1 Q. Kështu, ndryshimi nuk e ndërron vlerën.

Përshkrimi:
4 Q = 3 Q + 10 Dh
9 Nj − 5 Nj = 4 Nj
12 Dh − 3 Dh = 9 Dh
3 Q − 2 Q = 1 Q

Shkruajmë 3 në shtyllën Q dhe 10 në shtyllën Dh.

2 Njehsojmë ndryshimin në tabelën e vendvlerave dhe jashtë saj.

3 Njehsojmë ndryshimin dhe bëjmë provën:

Prova:

Mësojmë

21

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Veprimatri e drejtuar - Lojë

Zhvillohet një lojë me nxënësit në formë tregu. Vendosen disa lodra dhe secilës lodër iu vendoset çmimi. Nxënësit pajisen me monedha dhe udhëzohen të shkojnë në treg e të blejnë gjëra të ndryshme. Njëri nxënës bëhet shitësi, kurse nxënësi tjetër blerësi.
Nxënësit gjatë blerjes diskutojnë çmimet dhe sigurojnë eurot e nevojshme për lodrat që u pëlqejnë. Kështu bëhet një përsëritje e zbritjes dhe një lidhje me jetën e përditshme.



1 Njehsojmë ndryshimin në tabelën e vendvlerave dhe jashtë saj.

	Q	Dh	Nj
	7	3	9
-	3	6	4

	7	3	9
-	3	6	4

	Q	Dh	Nj
	6	4	8
-	2	8	7

	6	4	8
-	2	8	7

	Q	Dh	Nj
	9	2	7
-	5	3	4

	9	2	7
-	5	3	4

	Q	Dh	Nj
	7	4	9
-	5	8	7

	7	4	9
-	5	8	7

2 Njehsojmë.

	6	0	5
-	4	3	2

	7	2	6
-	3	4	6

	8	0	4
-	6	5	1

	7	1	7
-	5	7	7

	5	2	3
-	1	3	2

3 Shumën e pasardhësve të numrave 160, 241 dhe 375 e zvogëlojmë për numrin 398.

Shprehja numerike: (+ +) - = - =

Njehsojmë:

	1	6	1
+			

-	3	9	8

4 Në një fabrikë punojnë 547 punëtorë. Në turnin e parë punojnë 152 punëtorë, kurse në të dytin 51 punëtorë më tepër se në të parin. Sa punëtorë punojnë në turnin e tretë?

Njehsojmë:

Numri i punëtorëve në turnin e dytë			
+			

Numri i punëtorëve në turnin e parë dhe në atë të dytë			
+			

Numri i punëtorëve në turnin e tretë			
	5	4	7
-			

Përgjigjja:

Ushtrojmë

22

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Fillohet me detyrën e parë në libër, faqe 21 e cila karakterizohet me çështje që ndërlidhet me para (euro), e pastaj veprimi i zbritjes së atyre mjeteve kthehet në vlera numerike.

Jepen sqarimet e nevojshme në lidhje me huazimet që bëhen te qindëshet. Këto sqarime mund të bëhen edhe me euro e pastaj të shoqërohen me vlera përkatëse numerike.

Detyra e dytë i përmban dy shembuj, ku shembulli i parë është me zgjidhje, dhe nxitet një diskutim me nxënësit se si plotësohet shembulli i dytë.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Punë në grupe

Ndahen nxënësit në katër grupe.
Secilit grup i jepet nga një fletë me detyrat përkatëse:

Grupi 1 → 754 - 297

Grupi 2 → 864 - 597

Grupi 3 → 684 - 397

Grupi 4 → 534 - 387

Kërkohet nga grupet të gjejnë ndryshimin e numrave treshifrorë me kalim të qindëshes në shtyllë dhe të bëjnë provën. Fiton grupi i cili me saktësi dhe me kohë arrin të gjejë rezultatin.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e ndryshimit të numrave treshifrorë në shtyllë, shpjegimin e lidhjes në mes të mbledhjes dhe zbritjes dhe njehsimin e ndryshimit të shprehjeve të dhëna numerike.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 21).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 85

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3; III,1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1,1,4,5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të qindëshes (ushtrime)


ZBRITJA E NUMRAVE TRESHIFRORË ME PRISHJE TË QINDËSHES

1 Alketa kishte në kursime 429 €. Gjatë qëndrimit në një kamp veror për gjuhë të huaja ajo shpenzoi 235 €. Sa euro i mbetën asaj në kursime?

Qindëshet Dhjetëshet Njëshet

Nga 2 Dh nuk mund të zbriten 3 Dh. Për këtë, të zbritshmit i shtojmë 10 Dh, kurse zbritësit ia zbresim 1 Q. Kështu, ndryshimi nuk e ndërron vlerën.

Përshkrimi:
4 Q = 3 Q + 10 Dh
9 Nj − 5 Nj = 4 Nj
12 Dh − 3 Dh = 9 Dh
3 Q − 2 Q = 1 Q

Shkruajmë 3 në shtyllën Q dhe 10 në shtyllën Dh.

2 Njehsojmë ndryshimin në tabelën e vendvlerave dhe jashtë saj.

3 Njehsojmë ndryshimin dhe bëjmë provën:

Prova:

Mësojmë

21

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Llogarit shumën dhe ndryshimin e numrave natyrorë deri në 1000;
- Shpjegon lidhjen në mes të mbledhjes dhe zbritjes;
- Argumenton vendosjen e numrave sipas rendeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Numra magnetikë, kartëmonedha, monedha metalike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Fillohet me një përsëritje nga ora e kaluar, dhe nxitet një diskutim i shkurtër në lidhje me huazimet e qindëshes duke përdorur euro.

Pyeten nxënësit:
- Cilat janë mënyrat e zbritjes?
- Si duhet t'i zbresim numrat me kalim të qindëshes?



1 Njehsojmë ndryshimin në tabelën e vendvlerave dhe jashtë saj.

	Q	Dh	Nj
	7	3	9
−	3	6	4

	7	3	9
−	3	6	4

	Q	Dh	Nj
	6	4	8
−	2	8	7

	6	4	8
−	2	8	7

	Q	Dh	Nj
	9	2	7
−	5	3	4

	9	2	7
−	5	3	4

	Q	Dh	Nj
	7	4	9
−	5	8	7

	7	4	9
−	5	8	7

2 Njehsojmë.

	6	0	5
−	4	3	2

	7	2	6
−	3	4	6

	8	0	4
−	6	5	1

	7	1	7
−	5	7	7

	5	2	3
−	1	3	2

3 Shumën e pasardhësve të numrave 160, 241 dhe 375 e zvogëlojmë për numrin 398.

Shprehja numerike: (+ +) − = − =

Njehsojmë:

	1	6	1
+			

−	3	9	8

4 Në një fabrikë punojnë 547 punëtorë. Në turnin e parë punojnë 152 punëtorë, kurse në të dytin 51 punëtorë më tepër se në të parin. Sa punëtorë punojnë në turnin e tretë?

Njehsojmë:

Numri i punëtorëve në turnin e dytë			
+			

Numri i punëtorëve në turnin e parë dhe në atë të dytë			
+			

Numri i punëtorëve në turnin e tretë			
	5	4	7
−			

Përgjigjja: _____

Ushtrojmë

22

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Fillohet me detyrën e parë në faqe 22, e cila përmban katër shembuj, dhe nxënësit provojnë t'i zgjidhin të pavaruar e pastaj të shpjegojnë zgjidhjen para klasës.

Vërtetimi i saktësisë së detyrave bëhet duke bërë provën dhe argumentuar zgjidhjen. Gjatë shpjegimit të detyrave përmirësohen sipas nevojës.

Detyra e dytë në po të njëjtën faqe kërkon të zgjidhen katër shembuj të ndryshëm. Vlen të theksohet se si duhet të veprohet kur në klasën e dhjetësheve kemi zero.
Detyra e tretë është detyrë logjike, e cila në fakt kërkon edhe zbatimin e njohurive të fituara lidhur me paraardhësin dhe pasardhësin e numrave. Shumën e pasardhësve të numrave 160, 241 dhe 375 e zvogëlojmë për numrin 398.
Shprehja numerike është: (161 + 242 + 376) – 398 = 779 – 398 = 381.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e orientuar dhe e pavarur

Kalohet në detyrën e katërt në të njëjtën faqe, e cila është detyrë logjike, ku zgjidhja realizohet pas kryerjes së veprimeve të njëpasnjëshme:

Në një fabrikë punojnë 547 punëtorë. Në turnin e parë punojnë 152 punëtorë, kurse në të dytin 51 punëtorë më tepër se në ndërrimin e parë. Sa punëtorë janë në turnin e tretë?
Pra, së pari kërkohet numri i punëtorëve në turnin e dytë: 152 punëtorë (sa ka turni i parë) + 51 punëtorë më shumë, d.m.th., 152 + 51 = 203.
Pastaj numri i punëtorëve në turnin e parë dhe të dytë: 152 + 203 = 355 punëtorë.
Në turnin e tretë janë 547 (totali i punëtorëve) zbritur me 355 punëtorë (dy turnet e para), pra:
547 – 355 = 192. Nxënësit argumentojnë zgjidhjen e bërë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës dhe ndryshimit të numrave natyrorë deri 1000, shpjegimin e lidhjes në mes mbledhjes dhe zbritjes dhe argumentimin në vendosjen e numrave sipas rendeve.

Detyrë:
Jepen detyra të ngjashme në fletore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

_____

_____

Mësimi 86

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3; III,1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1,1,4,5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të dhjetëshes dhe qindëshes

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Llogarit shumën dhe ndryshimin e numrave natyrorë deri në 1000;
- Shpjegon zbritjen e numrave treshifrorë me prishje të dhjetëshes dhe qindëshes;
- Njehson vlerën e shprehjeve të dhëna numerike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.


ZBRITJA E NUMRAVE TRESHIFRORË ME PRISHJE TË DHJETËSHES DHE TË QINDËSHES

1 Klasat e treta, në fondin e tyre të bamirësisë, kishin grumbulluar 533 €. Nga kjo shumë, 257 € i janë ndarë Qendrës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara. Edhe sa mjete u mbetën atyre për angazhime të tjera bamirësie?

Qindëshet Dhjetëshet Njëshet — 5 3 3 − 2 5 7 = 2 7 6

Nga 3 Nj nuk mund të zbriten 7 Nj. Për këtë, të zbritshmit ia shtojmë 10 Nj, kurse zbritësit ia zbresim 1 Dh. Kështu, ndryshimi nuk e ndërron vlerën.

Nga 2 Dhj nuk mund të zbriten 5 Dh. Për këtë, të zbritshmit ia shtojmë 10 Dh, kurse zbritësit ia zbresim 1 Q. Kështu, ndryshimi nuk e ndërron vlerën.

13 Nj − 7 Nj = 6 Nj
12 Dh − 5 Dh = 7 Dh
4 Q − 2 Q = 2 Q

Çdoherë bëjmë provën: 2 7 6 + 2 5 7

Përgjigjja: _____

2 Njehsojmë ndryshimin në tabelën e vendvlerave dhe jashtë saj.

3 5 2 − 2 7 6 = 8 3 5 − 3 6 8

9 2 2 − 4 8 8 = 7 3 0 − 4 6 1

Mësojmë

23

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Kërkohet nga nxënësit të marrin disa shembuj të zbritjes së numrave treshifrorë të cilët i kanë mësuar në orët e kaluara. Jepen disa detyra ku kërkohet të zbriten numrat me prishje të dhjetëshes dhe qindëshes, ku ndoshta vijnë në një situatë ku nuk dijnë si të veprojnë, pastaj bëhet ndërlidhja me njësinë e re që do të shpjegohet.



1 Njehsojmë ndryshimin dhe bëjmë provën.

843 − 568	726 − 198	833 − 569	625 − 476
Prova: +	Prova: +	Prova: +	Prova: +

2 Anjesa po lexon një libër me tregime që ka 400 faqe. Deri tash ajo ka lexuar 208 faqe të librit. Edhe sa faqe të librit ka për të lexuar Anjesa?

Njehsojmë: −

Përgjigjja: _____

3 Dy grupe nxënësish do të mbjellin 700 fidanë në parkun e qytetit. Deri tash grupi i parë mbolli 257 fidanë, kurse grupi i dytë 348 fidanë. Edhe sa fidanë duhet të mbillen në park?

Njehsojmë: + 700 −

Përgjigjja: _____

4 Njehsojmë vlerën e shprehjes.

627 + (146 − 28) = ☐ + ☐ = ☐ Njehsojmë: − +

362 − (108 + 116) = ☐ − ☐ = ☐ Njehsojmë: + −

Ushtrojmë

24

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Lexohet detyra e parë në faqe 23, ku nxënësit deshifrojnë të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat si më poshtë:

Qindëshet	Dhjetëshet	Njëshet
5	3	3
- 2	5	7

Nga 3 Nj nuk mund të zbriten 7 Nj. Për këtë të zbritshmit ia shtojmë 10 Nj, kurse zbritësit ia zbresim 1 Dh. Kështu, ndryshimi nuk e ndërron vlerën.

Ngjashëm veprohet edhe me kalim të dhjetëshes dhe qindëshes. Mund të merren edhe shembuj të tjerë që u ndihmojnë nxënësve në të kuptuarit e zbritjes.

Sikur në orët e kaluara të gjitha këto mjete monetare kthehen në vlera numerike, e pastaj prezantohet tabela ku bëhet zbritja e lartcekur. Në kuadër të kësaj detyre gjendet edhe shembulli i dhënë me vlera numerike:

Q	Dh	Nj
	10	
4	2	10
5	3	3
2	5	7
2	7	6

13 Nj − 7 Nj = 6 Nj
12 Dh − 5 Dh = 7 Dh
4 Q − 2 Q = 2 Q

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Punë në dyshe

Kalohet te detyra e dytë e cila përmban katër shembuj, shembulli i parë është pjesërisht i zgjidhur. Nxënësit udhëzohen të zgjidhin në dyshe e më pas t'i shkëmbejnë librat e të krahasojnë zgjidhjet me shokun/shoqen. Përcaktohen disa nxënës të shpjegojnë zgjidhjet në tabelë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës dhe ndryshimit të numrave natyrorë deri në 1000, shpjegimin e zbritjes së numrave treshifrorë me prishje të dhjetëshes dhe qindëshes si dhe për njehsimin e vlerës së shprehjeve të dhëna numerike.

Detyrë:
Jepen detyra të ngjashme në fletore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 87

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3; III,1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1,1,4,5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të dhjetëshes dhe qindëshes (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Llogarit shumën dhe ndryshimin e numrave natyrorë deri në 1000;
- Shpjegon zbritjen e numrave treshifrorë me prishje të dhjetëshes dhe qindëshes;
- Njehson vlerën e shprehjeve të dhëna numerike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Fillohet me detyrën 1 në faqe 23, ku kërkohet nga nxënësit të njehsojnë ndryshimin e numrave dhe të bëjnë provën.
Diskutohen rastet ku kanë pasur vështirësi dhe sqarohen ato. Përcaktohen disa nxënës t'i zgjidhin detyrat në tabelë.


ZBRITJA E NUMRAVE TRESHIFRORË ME PRISHJE TË DHJETËSHES DHE TË QINDËSHES

1 Klasat e treta, në fondin e tyre të bamirësisë, kishin grumbulluar 533 €. Nga kjo shumë, 257 € i janë ndarë Qendrës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara. Edhe sa mjete u mbetën atyre për angazhime të tjera bamirësie?

Qindëshet Dhjetëshet Njëshet

Nga 3 Nj nuk mund të zbriten 7 Nj. Për këtë, të zbritshmit ia shtojmë 10 Nj, kurse zbritësit ia zbresim 1 Dh. Kështu, ndryshimi nuk e ndërron vlerën.

Nga 2 Dhj nuk mund të zbriten 5 Dh. Për këtë, të zbritshmit ia shtojmë 10 Dh, kurse zbritësit ia zbresim 1 Q. Kështu, ndryshimi nuk e ndërron vlerën.

13 Nj − 7 Nj = 6 Nj
12 Dh − 5 Dh = 7 Dh
4 Q − 2 Q = 2 Q

Çdoherë bëjmë provën:

Përgjigjja:

2 Njehsojmë ndryshimin në tabelën e vendvlerave dhe jashtë saj.

Mësojmë

23



1 Njehsojmë ndryshimin dhe bëjmë provën.

843 − 568	726 − 198	833 − 569	625 − 476
Prova: +	Prova: +	Prova: +	Prova: +

2 Anjesa po lexon një libër me tregime që ka 400 faqe. Deri tash ajo ka lexuar 208 faqe të librit. Edhe sa faqe të librit ka për të lexuar Anjesa?

Njehsojmë: − Përgjigjja: _____

3 Dy grupe nxënësish do të mbjellin 700 fidanë në parkun e qytetit. Deri tash grupi i parë mbolli 257 fidanë, kurse grupi i dytë 348 fidanë. Edhe sa fidanë duhet të mbillen në park?

Njehsojmë: + 700 − Përgjigjja: _____

4 Njehsojmë vlerën e shprehjes.

627 + (146 − 28) = + = Njehsojmë: − +

362 − (108 + 116) = − = Njehsojmë: + −

Ushtrojmë

24

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Kalohet te detyra 2, në po të njëjtën faqe e cila është detyrë logjike:
Anjesa po lexon një libër me tregime që ka 400 faqe. Deri tash ajo ka lexuar 208 faqe të librit. Edhe sa faqe të librit ka për të lexuar?
Fillohet nga numri 400 të zbritet numri 208 dhe ndryshimi i fituar tregon numrin e faqeve të mbetura pa i lexuar.

Më pas kalohet te detyra 3, e cila po ashtu është detyrë logjike, lexohet nga një nxënës dhe nxiten ata të mendojnë dhe të gjejnë zgjidhjen sipas mënyrës së shpjeguar.
Në fund pas arritjes së rezultatit të kërkuar, bëjnë provën për të vërtetuar saktësinë dhe e shkruajnë përgjigjen e detyrës në libër.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari në grupe

Ndahen nxënësit në katër grupe dhe secilit prej grupeve u shpërndahen fletë punuese me zbritje të numrave treshifrorë me kalim. Nxënësit bashkëpunojnë në grup dhe gjejnë zgjidhet. Theksohet që duhet të vërtetojnë zgjidhjet para se t'i dorëzojnë fletët me anë të provës.

Përmes teknikës "Lapsat në mes", zgjidhet një përfaqësues i grupit t'i prezantojë detyrat e zgjidhura; grupet e tjera vlerësojnë me notë grupin e pëlqyer. Pasi të përfundojnë prezantimin të gjitha grupet, zgjidhet grupi fitues.

Në varësi të kohës në dispozicion, kërkohet nga nxënësit të krijojnë një problemë me zbritje, dhe pastaj ta lexojnë para klasës. Udhëzohen nxënësit e tjerë të përpiqen të ofrojnë zgjidhjet e mundshme.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës dhe ndryshimit të numrave natyrorë deri në 1000, shpjegimin e zbritjes së numrave treshifrorë me prishje të dhjetëshes dhe qindëshes, njehsimin e vlerës së shprehjeve të dhëna numerike.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 24).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 88

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3; III,1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1,1,4,5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të dhjetëshes dhe qindëshes (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave natyrorë deri në 1000;
- Shpjegon zgjidhjen e detyrave me fjalë;
- Argumenton vendosjen e numrave sipas rendeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Veprimtari e drejtuar

Udhëzohen nxënësit të koncentrohen në detyrat e paraqitura në ekran, faqe 25, ku kërkohet që me anë të kombinimit të shifrave 1, 2, 3, 4, 5, 6 të formojnë numra të tillë treshifrorë që korrespondojnë me shumat si në libër.
Rasti parë dhe i fundit janë me zgjidhje nga libri, ndërsa detyrat e tjera duhet të zgjidhen nga nxënësit në tabelë, me sqarimet e nevojshme. Nëse e marrim shumën e parë 876, atëherë, varet se çfarë mbledhori po marrim të parin. P.sh., nëse marrim mbledhorin e parë 351, atëherë mbledhori i dytë duhet të jetë 525, gjë që do të ishte gabim sepse ne po tentojmë të gjejmë mbledhorë ku shifrat e tyre nuk përsëriten.


1 Me shifrat 1 2 3 4 5 6, shkruajmë numra treshifrorë me shifra të ndryshme, ashtu që shuma e tyre të jetë njëri nga numrat:

975 876 678 813 480 390

462 + 513 = 975 ; _ _ _ + _ _ _ = 876 ; _ _ _ + _ _ _ = 678 ; _ _ _ + _ _ _ = 813 ; _ _ _ + _ _ _ = 480 ; 136 + 254 = 390

2 Me shifrat 1 2 4 5 7 8, shkruajmë numra treshifrorë me shifra të ndryshme, ashtu që shuma e tyre të jetë njëri nga numrat:

999 900 855 765 756 423

_ _ _ + _ _ _ = 999 ; _ _ _ + _ _ _ = 900 ; _ _ _ + _ _ _ = 855 ; _ _ _ + _ _ _ = 765 ; _ _ _ + _ _ _ = 756 ; _ _ _ + _ _ _ = 423

3 Zgjedhim dy nga numrat:

148 175 269 317 355 384 429

dhe gjejmë shumën e tyre. Cilët janë ata numra për të cilët:

1. shuma është më e vogël se 500?
2. shuma është më e madhe se 700?
3. shuma është një numër ndërmjet numrave 600 dhe 700?

Përgjigjja:

1. 148 + 175 = ☐ ; 148 + 317 = ☐ ; 175 + 317 = ☐ ; 148 + 269 = ☐ ; 175 + 269 = ☐
2. _____
3. _____

Ushtrojmë

25



4 Zgjedhim dy nga numrat:

184 | 196 | 248 | 257 | 312 | 359 | 384

dhe gjejmë shumën e tyre. Cilët janë ata numra për të cilët:

1. shuma është një numër ndërmjet numrave 400 dhe 500?
2. shuma është një numër ndërmjet numrave 500 dhe 600?
3. shuma është një numër ndërmjet numrave 600 dhe 700?

5 Zgjedhim dy nga numrat:

145 | 236 | 327 | 475 | 568 | 657

dhe gjejmë shumën e tyre. Cilët janë ata numra, shuma e të cilëve është një numër ndërmjet numrave 600 dhe 700?

Përgjigjja:

6 6 fushat e zbrazëta i plotësojmë me 6 shifra të ndryshme:

1 2 3 4 5
6 7 8 9

1 9 5
+ 6 8 4
8 7 9

+ _ _ _
5 8 1

+ _ _ _
6 5 4

+ _ _ _
7 3 3

7 Secila nga letrat mbulon njërën nga shifrat 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 ose 9. Letrat me ngjyrë të njëjtë mbulojnë shifra të njëjta. Zbulojmë shifrat që mbulojnë letrat.

Vërejmë se shuma është një numër treshifror me shifra të njëjta. Meqë shuma e një numri dyshifror dhe e dy numrave njëshifrorë është më e vogël se 200, atëherë c = 1. Rrjedhimisht, shuma është 111. Pra,

a a
+ b b
c c c

a a
+ b b
1 1 1

- Tash *a* nuk mund të jetë 0. Pse?
- Gjithashtu *a* nuk mund të jetë 1 dhe *b* nuk mund të jetë 2. Pse?
- Nëse *a* = 2, nga *a* + *a* + *b* = 11 Nj = 1 Dh + 1 Nj rrjedh se *b* = 7. Mirëpo *b* Dh + 1 Dhj = 8 Dh që nuk bën.
- Provoni se *a* nuk mund të jetë 3 as 4 e as 5.
- Nëse *a* = 6, nga *a* + *a* + b = 21 Nj = 2 Dh + 1 Nj, rrjedh se *b* = 9. Në këtë rast, *b* Dh + 2 Dhj = 11Dh = 1 Q + 1 Dh. Zgjidhja e detyrës është: *a* = 6, *b* = 9 dhe *c* = 1.
- Provoni gjithashtu se *a* nuk mund të jetë 7 as 8 e as 9.

6 6
+ 9 9
1 1 1

Ushtrojmë

26

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Shqyrtim i përbashkët

Kalohet te detyra e dytë e cila është e ngjashme me detyrën paraprake përveç se këtu përfshihen numrat 1, 2, 4, 5, 7, 8.
Kërkohet nga nxënësit të provojnë zgjidhjet dhe t'i paraqesin para klasës.
Kalohet te detyra e tretë në të njëjtën faqe:
Zgjidhim dy nga numrat: 148, 175, 269, 317, 355, 384, 429 dhe formojnë shumën e tyre.
- Cilët janë ata numra për të cilët:
1. shuma është më e vogël se 500;
2. shuma është më e madhe se 700;
3. shuma është një numër ndërmjet numrave 600 dhe 700.

Të pavarur gjejnë zgjidhjet dhe pastaj diskutohen para klasës përgjigjet e mundshme.

Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Veprimtari e orientuar

Detyra 4, në faqe 26, është e ngjashme me detyrën paraprake, vetëm se kërkohet të zgjidhen dy numra nga:
145, 236, 327, 475, 568, 657 dhe të formohet shuma e tyre.
- Cilët janë ata numra, shuma e të cilëve është një numër ndërmjet numrave 600 dhe 700?

Pas të gjitha kombinimeve, vetëm numri 145 mund të mblidhet me numrin 475 ashtu që shuma e tyre të jetë ndërmjet 600 dhe 700. Të gjitha kombinimet e tjera rezultojnë me shuma më të vogla se 600 ose më të mëdha se 700.
Në fund ata argumentojnë zgjidhjet, plotësohen sipas nevojës nga shokët e klasës dhe mësuesja.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për njehsimin e mbledhjes dhe zbritjes së numrave me kalim, shpjegimin e zgjidhjes së detyrave me fjalë dhe argumentimin e vendosjes së numrave sipas rendeve.

Detyrë:
Detyrat 6 dhe 7 (faqe 26).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 89

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen shumëzimin e numrave njëshifrorë me numra njëshifrorë dhe dyshifrorë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,2; III.2.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 4, 5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi i numrave me 10 dhe 100

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton faktorët dhe prodhimin e numrave të dhënë;
- Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe shumëzimit të numrave deri në 1000;
- Analizon varshmërinë e faktorëve nga prodhimi.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabakë letre, etiketa me fjali.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.


SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI

SHUMËZIMI I NUMRAVE ME 10 DHE 100

1 Njehsojmë.

7 • 10 =

10 + 10 + 10 + 10 + 10 + 10 + 10 = 7 • 10

Një numër shumëzohet me numrin 10, duke i ndajshkruar atij një zero.

7 • 10 = 70

4 • 100 =

100 + 100 + 100 +100 = 4 • 100 = 400

Një numër shumëzohet me numrin 100, duke i ndajshkruar atij dy zero.

4 • 100 = 400

2 Njehsojmë dhe plotësojmë.

2 • 10 = 25 • 10 = • 10 = 70 • 10 = 730
3 • 10 = 42 • 10 = • 10 = 10 • 10 = 150
5 • 10 = 71 • 10 = • 10 = 90 • 10 = 410
8 • 10 = 69 • 10 = • 10 = 60 • 10 = 830

3 Njehsojmë dhe plotësojmë.

7 • 100 = 3 • 100 = • 100 = 500 • 100= 0
9 • 100 = 6 • 100 = • 100 = 800 • 100= 100

4 Njehsojmë dhe plotësojmë.

8 • 10 • 10 • 100
6 • 10 • 10 • 100

Mësojmë

27

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Veprimtari e drejtuar

Loja me etiketa.
Nxënësve u shpërndahen etiketat me numra. Çdo grup ka detyra të ndryshme me faktorët nga 1 deri në 10. Tregojnë çfarë dinë për shumëzimin dhe emërtojnë faktorët dhe prodhimin e tyre.

Shembull: 4 x 8 = 32

Faktori i parë — Faktori i dytë — Prodhimi



SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI

SHUMËZIMI I NUMRAVE ME 10 DHE 100

1 Njehsojmë.

7 • 10 = ☐

10 + 10 + 10 + 10 + 10 + 10 + 10 = 7 • 10

Një numër shumëzohet me numrin 10, duke i ndajshkruar atij një zero.

7 • 10 = 70

4 • 100 = ☐

100 + 100 + 100 +100 = 4 • 100 = 400

Një numër shumëzohet me numrin 100, duke i ndajshkruar atij dy zero.

4 • 100 = 400

2 Njehsojmë dhe plotësojmë.

2 • 10 = ☐	25 • 10 = ☐	☐ • 10 = 70	☐ • 10 = 730
3 • 10 = ☐	42 • 10 = ☐	☐ • 10 = 10	☐ • 10 = 150
5 • 10 = ☐	71 • 10 = ☐	☐ • 10 = 90	☐ • 10 = 410
8 • 10 = ☐	69 • 10 = ☐	☐ • 10 = 60	☐ • 10 = 830

3 Njehsojmë dhe plotësojmë.

7 • 100 = ☐	3 • 100 = ☐	☐ • 100 = 500	☐ • 100= 0
9 • 100 = ☐	6 • 100 = ☐	☐ • 100 = 800	☐ • 100= 100

4 Njehsojmë dhe plotësojmë.

8 • 10 • 10 • 100

6 • 10 • 10 • 100

Mësojmë

27

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Nxënësve u shpjegohet rregulla lidhur me shumëzimin e numrave me faktorët 10 dhe 100. Nxënësve u ndahen detyrat lidhur me shumëzimin e numrave me 10 dhe 100.
Analizojnë detyrat e dhëna dhe plotësojnë ato.
Secili grup arsyeton zgjidhjet e tyre para të tjerëve.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Rishikim në dyshe

Udhëzohen të analizojnë diagramet e dhëna dhe të plotësojnë ata duke zbatuar rregullën e mësuar për shumëzimin e numrave me 10 dhe 100. Kryejnë vlerësim të ndërsjellë duke analizuar zgjidhjet në dyshe.





Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e emërtimit të faktorëve dhe prodhimit, mënyrën e argumentimit të lidhjes së mbledhjes dhe shumëzimit dhe analizës së varshmërisë së faktorëve nga prodhimi.

Detyrë:
Zgjidhen pesë detyra sipas modelit të detyrës 3.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 90

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njehson herësin ndërmjet numrave dyshifrorë dhe treshifrorë me numra njëshifrorë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,2; III.1, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi i shumëfishave të numrit 10 me numrin 10

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen herësin e numrave të dhënë;
- Njehson pjesëtimin e shumëfishave të numrit 10 me numrin 10;
- Argumenton zgjidhjen e problemës së dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.



PJESËTIMI I SHUMËFISHAVE TË NUMRIT 10 ME NUMRIN 10

1 Njehsojmë.

70 : 10 =

7 • 10 = 70
10 • 7 = 70
70 : 7 = 10
70 : 10 = 7

Një shumëfish i numrit 10 pjesëtohet me numrin 10, duke i hequr atij zeron e fundit.
70 : 10 = 7

800 : 100 =

8 • 100 = 800
100 • 8 = 800
800 : 8 = 100
800 : 100 = 8

Një shumëfish i numrit 100 pjesëtohet me numrin 100, duke i hequr atij dy zerot e fundit.
800 : 100 = 8

2 Njehsojmë dhe plotësojmë.

170 : 10 =
17 Dh : 1 Dh = 17

490 : 10 =

580 : 10 =

900 : 100 =
9 Q : 1 Q = 9

600 : 100 =

100 : 100 =

3 Njehsojmë dhe plotësojmë.

750 : 10 =
930 : 10 =
900 : 10 =

1000 : 100 =
900 : 100 =
700 : 100 =

: 10 = 45
650 : = 65
100 : = 1

4 Punëtori në shtypshkronjë duhet të paketojë 380 libra. Nëse në një pako mund të paketohen 10 libra, sa pako janë të nevojshme për paketimin e 380 librave?

Njehsojmë:

Përgjigjja:

Mësojmë

28

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësve u drejtohen pyetjet:
- Çfarë dini për pjesëtimin e numrave?
- Çfarë fitojmë kur pjesëtojmë dy numra?

U paraqiten detyra me pjesëtim të numrave dyshifrorë me njëshifrorë dhe gjejnë herësin e fshehur.

Shembull: 32 x 8 = 4

Herësi



1 Njehsojmë.

35 • 10 = ☐ 56 • 10 = ☐ 72 • 10 = ☐ 81 • 10 = ☐
8 • 100 = ☐ 5 • 100 = ☐ 9 • 100 = ☐ 3 • 100 = ☐

2 Njehsojmë.

430 : 10 = ☐ 560 : 10 = ☐ 900 : 100 = ☐
780 : 10 = ☐ 320 : 10 = ☐ 500 : 100 = ☐
890 : 10 = ☐ 190 : 10 = ☐ 1000 : 100 = ☐

3 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelat.

10 •	8	9	25	42	71
↓	80				

100	80	70	250	420	: 10
	8				↓

4 Duke njehsuar, plotësojmë.

5 Shkruajmë shprehjen numerike dhe, duke përdorur kllapat, njehsojmë vlerën e saj: Prodhimin e numrave 6 dhe 7 e shumëzojmë me prodhimin e numrave 5 dhe 2.

Njehsojmë: _____

6 Njehsojmë herësin e shumës së numrave 577 dhe 283 dhe ndryshimit të numrave 342 dhe 332.

Njehsojmë: _____

Ushtrojmë

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Zbato rregullin/ Gjej rezultatin

Nxënësve u shpjegohet rregulla lidhur me pjesëtimin e numrave me 10 dhe 100.

Nxënësve u ndahen detyrat lidhur me pjesëtimin e numrave me 10 dhe 100 nga detyra 2 dhe 3.

Nxënësit diskutojnë në dyshe dhe zbatojnë rregullën për pjesëtimin e numrave me 10 dhe 100.
Secili grup arsyeton zgjidhjet e tyre para të tjerëve.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Rishikim në dyshe

Nxënësit udhëzohen të analizojnë detyrën 4.
Njehsojnë herësin dhe shkruajnë përgjigjen e duhur.
Kryejnë vlerësim të ndërsjellë dhe përmirësimet e duhura në dyshe.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e gjetjes së herësit, mënyrën e njehsimit dhe argumentimit të zgjidhjes së detyrave.

Detyrë:
Krijohen dy detyra me fjalë duke zbatuar pjesëtimin e numrave me 10 ose 100.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 91

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njehson herësin ndërmjet numrave dyshifrorë dhe treshifrorë me numra njëshifrorë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3,1; III.1, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi i shumëfishave të numrit 10 me numrin 10 (ushtrime)


PJESËTIMI I SHUMËFISHAVE TË NUMRIT 10 ME NUMRIN 10

1 Njehsojmë.

70 : 10 =

70 : 7 = 10 ; 70 : 10 = 7

7 • 10 = 70
10 • 7 = 70
70 : 7 = 10
70 : 10 = 7

Një shumëfish i numrit 10 pjesëtohet me numrin 10, duke i hequr atij zeron e fundit.
70 : 10 = 7

800 : 100 =

800 : 8 = 100 ; 800 : 100 = 8

8 • 100 = 800
100 • 8 = 800
800 : 8 = 100
800 : 100 = 8

Një shumëfish i numrit 100 pjesëtohet me numrin 100, duke i hequr atij dy zerot e fundit.
800 : 100 = 8

2 Njehsojmë dhe plotësojmë.

170 : 10 =
17 Dh : 1 Dh = 17

490 : 10 =

580 : 10 =

900 : 100 =
9 Q : 1 Q = 9

600 : 100 =

100 : 100 =

3 Njehsojmë dhe plotësojmë.

750 : 10 =
930 : 10 =
900 : 10 =

1000 : 100 =
900 : 100 =
700 : 100 =

: 10 = 45
650 : = 65
100 : = 1

4 Punëtori në shtypshkronjë duhet të paketojë 380 libra. Nëse në një pako mund të paketohen 10 libra, sa pako janë të nevojshme për paketimin e 380 librave?

Njehsojmë:

Përgjigjja:

Mësojmë

28

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen prodhimin dhe herësin e numrave të dhënë;
- Njehson pjesëtimin e shumëfishave të numrit 10 me numrin 10;
- Argumenton zgjidhjen e problemës së dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Rrjeti i merimangës

Nxënësit formojnë një rreth brenda klasës.
U jepen sqarimet për lojën me shumëzim dhe pjesëtim të numrave. Çdo nxënësi brenda rrethit i hidhet peri apo lëmshi dhe për çdo hedhje një nxënësi i caktohet një detyrë me shumëzim e tjetrit me pjesëtim.

Nxënësit ia caktojnë njëri-tjetrit detyrat dhe bëjnë përmirësimet e duhura.



1 Njehsojmë.

35 • 10 = 56 • 10 = 72 • 10 = 81 • 10 =
8 • 100 = 5 • 100 = 9 • 100 = 3 • 100 =

2 Njehsojmë.

430 : 10 = 560 : 10 = 900 : 100 =
780 : 10 = 320 : 10 = 500 : 100 =
890 : 10 = 190 : 10 = 1000 : 100 =

3 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelat.

10 •	8	9	25	42	71
↓	80				

100	80	70	250	420	: 10
	8				↓

4 Duke njehsuar, plotësojmë.

5 Shkruajmë shprehjen numerike dhe, duke përdorur kllapat, njehsojmë vlerën e saj: Prodhimin e numrave 6 dhe 7 e shumëzojmë me prodhimin e numrave 5 dhe 2.

Njehsojmë: _____

6 Njehsojmë herësin e shumës së numrave 577 dhe 283 dhe ndryshimit të numrave 342 dhe 332.

Njehsojmë: _____

Ushtrojmë

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
R. A. F. T.

Nxënësve u ndahen detyrat lidhur me shumëzimin dhe pjesëtimin e numrave nga detyra 1 dhe 2.
Çdo grup ka nga dy detyra me shumëzim dhe tri detyra me pjesëtim.
Nxënësit mendojnë, diskutojnë në dyshe e pastaj analizojnë dhe plotësojnë bashkë me grupin.
Secili grup arsyeton zgjidhjet e tyre para të tjerëve.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Analizo - Plotëso

Nxënësit udhëzohen të analizojnë detyrën 3, 4 dhe 5.
Njehsojnë prodhimin dhe herësin dhe shkruajnë përgjigjen e duhur.
Kryejnë vlerësim të ndërsjellë duke bërë përmirësimet e duhura.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e gjetjes së prodhimit dhe herësit, mënyrën e njehsimit dhe argumentimit të zgjidhjes së detyrave.

Detyrë:
Detyra 6 (faqe 29).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 92

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen shumëzimin e numrave njëshifrorë me numra njëshifrorë dhe dyshifrorë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.1.2; III.1, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi i numrave me dhjetëshe dhe qindëshe të plota

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen faktorin e fshehur në detyrat e dhëna;
- Shoqëron faktorët e dhënë për të gjetur prodhimin;
- Argumenton zgjidhjen e detyrave të dhëna.


SHUMËZIMI I NUMRAVE ME DHJETËSHE DHE QINDËSHE TË PLOTA

1 Shumëzojmë me dhjetëshe të plota.

5 • 70 = ☐ (shoqërojmë faktorët)

5 • 70 = 5 • 7 • 10
= (5 • 7) • 10
= ☐ • 10
= ☐

5 • 7 0 = 3 5 0

7 • 40 = ☐
6 • 90 = ☐
80 • 3 = ☐
3 • 70 = ☐

2 Njehsojmë dhe plotësojmë.

120 = ☐ • 40
240 = ☐ • 80

360 = ☐ • 60
480 = ☐ • 80

720 = ☐ • 90
560 = ☐ • 80

3 Njehsojmë dhe plotësojmë.

8 • 90 = ☐ • 80
8 • 20 = ☐ • 80

7 • 30 = ☐ • 70
2 • 50 = ☐ • 20

6 • 40 = ☐ • 60
3 • 60 = ☐ • 30

4 Shumëzimi me qindëshe të plota.

4 • 200 = ☐ (shoqërojmë faktorët)

4 • 200 = 4 • 2 • 100
= (4 • 2) • 100
= ☐ • 100
= ☐

4 • 2 0 0 = 8 0 0

3 • 300 = ☐
8 • 100 = ☐
5 • 200 = ☐
2 • 300 = ☐

4 Njehsojmë dhe plotësojmë.

☐ • 300 = 600
☐ • 100 = 700

4 • ☐ = 800
2 • ☐ = 1000

☐ • 90 = 900
☐ • 50 = 1000

Mësojmë

30

Njësia mësimore: Shumëzimi i numrave me dhjetëshe dhe qindëshe të plota

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen faktorin e fshehur në detyrat e dhëna;
- Shoqëron faktorët e dhënë për të gjetur prodhimin;
- Argumenton zgjidhjen e detyrave të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabakë letre, etiketa me fjali.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Gjej numrin e fshehur

Nxënësve në grupe u ndahen fletët me detyra me shumëzim të numrave ku mungon njëri faktor, të cilin ata duhet ta gjejnë.
Shembull:
7 x ☐ = 560. Numri i fshehur është 80 sepse 7 x 80 = 560.



SHUMËZIMI I NUMRAVE ME DHJETËSHE DHE QINDËSHE TË PLOTA

1 Shumëzojmë me dhjetëshe të plota.

5 · 70 = □ (shoqërojmë faktorët)

5 · 70 = 5 · 7 · 10
= (5 · 7) · 10
= □ · 10
= □

5 · 7 0 = 3 5 0

7 · 40 = □
6 · 90 = □
80 · 3 = □
3 · 70 = □

2 Njehsojmë dhe plotësojmë.

120 = □ · 40
240 = □ · 80

360 = □ · 60
480 = □ · 80

720 = □ · 90
560 = □ · 80

3 Njehsojmë dhe plotësojmë.

8 · 90 = □ · 80
8 · 20 = □ · 80

7 · 30 = □ · 70
2 · 50 = □ · 20

6 · 40 = □ · 60
3 · 60 = □ · 30

4 Shumëzimi me qindëshe të plota.

4 · 200 = □ (shoqërojmë faktorët)

4 · 200 = 4 · 2 · 100
= (4 · 2) · 100
= □ · 100
= □

4 · 2 0 0 = 8 0 0

3 · 300 = □
8 · 100 = □
5 · 200 = □
2 · 300 = □

4 Njehsojmë dhe plotësojmë.

□ · 300 = 600
□ · 100 = 700

4 · □ = 800
2 · □ = 1000

□ · 90 = 900
□ · 50 = 1000

Mësojmë

30

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Mendo/Puno në dyshe/Ndaje me grupin

Nxënësve u jepen sqarime për shoqërimin e faktorëve dhe udhëzohen të plotësojnë detyrën 1. Nxënësit mendojnë, diskutojnë në dyshe e pastaj analizojnë dhe plotësojnë bashkë me grupin. Secili grup arsyeton zgjidhjet e tyre para të tjerëve. U paraqitet detyra si vijon:

$$120 = \square \cdot 40$$

Dhe zgjidhjet me tri opcione, si:
A. 3
B. 30
C. 60
Në sajë të përgjigjeve të sakta të tyre, nxënësit vazhdojnë me plotësimin e detyrave 2 dhe 3 dhe paraqesin zgjidhjet.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Aktiviteti: Unë jam Tutori

Aktiviteti: Unë jam Tutori
Nxënësit udhëzohen të analizojnë detyrën 4. Njehsojnë prodhimin duke shoqëruar faktorët sipas shembullit të dhënë. Nxënësi që gjen zgjidhjet i pari i paraqet ato para të tjerëve duke u dhënë sqarimet e nevojshme nxënësve të tjerë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e gjetjes së prodhimit, mënyrën e shoqërimit dhe argumentimit të zgjidhjes së detyrave.

Detyrë:
Detyra 6 (faqe 30).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 93

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njehson herësin ndërmjet numrave dyshifrorë dhe treshifrorë me numra njëshifrorë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.1.2; III.2,3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi i shumëfishave të numrit 10 me dhjetëshe të plota

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Identifikon herësin e fshehur në detyrat e dhëna;
- Zbaton lidhjen e pjesëtimit me shumëzimin;
- Argumenton zgjidhjen e detyrave të dhëna.



PJESËTIMI I SHUMËFISHAVE TË NUMRIT 10 ME DHJETËSHE TË PLOTA

1 Për Ditën e Tokës, 60 nxënës të një shkolle mbollën 420 fidanë. Nga sa fidanë mbolli secili nxënës?
Për të njehsuar se nga sa fidanë mbolli secili nxënës, njehsojmë herësin 420 : 60.
Zbatojmë lidhjen e pjesëtimit me shumëzimin dhe kemi:
420 : 60 = ☐ , sepse 70 • 60 = 420
Përgjigjja: _____
fshihen zerot
4 2 0 : 6 0 = 7

2 Njehsojmë.
200 : 50 = ☐ 400 : 40 = ☐ ☐ : 90 = 6 250 : ☐ = 5
480 : 60 = ☐ 150 : 30 = ☐ ☐ : 40 = 4 490 : ☐ = 7
180 : 90 = ☐ 140 : 70 = ☐ ☐ : 30 = 8 630 : ☐ = 9

3 Njehsojmë dhe plotësojmë.
400 = 5 • 70 + 50 270 = ☐ • 60 + ☐ 590 = ☐ • 90 + ☐
180 = ☐ • 40 + ☐ 550 = ☐ • 80 + ☐ 480 = ☐ • 50 + ☐
290 = ☐ • 30 + ☐ 130 = ☐ • 20 + ☐ 510 = ☐ • 90 + ☐

4 Njehsojmë.
360 : 60 – 2 = ☐ 300 : 5 + 3 = ☐
560 : 7 – 2 = ☐ 200 : 40 – 1 = ☐
630 : 90 – 1 = ☐ 500 : 5 + 5 = ☐
350 : 7 – 5 = ☐ 360 : 40 – 5 = ☐
4 2 0 : 7 = 6 0

5 Në një aktivitet bamirësie, për fëmijët me aftësi të kufizuara, 90 nxënës të një shkolle grumbulluan 450 euro. Nëse secili nxënës dhuroi shumë të njëjtë, nga sa euro dhuroi secili nga ta?
Njehsojmë: _____
Përgjigjja: _____

Mësojmë

31

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketa me detyra

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Fletushkat e përziera

Nxënësve në grupe u shpërndahen copëzat e letrave me detyra në mënyrë që herësi të jetë i saktë. Secili grup bashkon detyrat me herësin e duhur. Paraqesin detyrat para të tjerëve.

Shembull:



1 Njehsojmë dhe plotësojmë.

8 • 50 = □ 9 • 40 = □ 5 • 60 = □
3 • 50 = □ 7 • 40 = □ 7 • 60 = □

200 = □ • 40 320 = □ • 40 400 = □ • 40
320 = □ • 80 400 = □ • 80 560 = □ • 80

2 + – ?

3 • 50 □ 2 • 40 □ 3 • 90 = 500
150 + 80 + 270 = 500

9 • 90 □ 5 • 70 □ 3 • 80 = 220
9 • 80 □ 5 • 50 □ 3 • 30 = 380

6 • 40 □ 2 • 60 □ 3 • 90 = 630
8 • 80 □ 3 • 40 □ 4 • 40 = 600

6 • 80 □ 9 • 20 □ 5 • 30 = 810
5 • 30 □ 7 • 50 □ 1 • 90 = 410

3 > = < ?

5 • 20 + 4 • 30 □ 3 • 60 + 2 • 40
100 + 120 □ 180 + 60
220 □ ___

3 • 30 + 8 • 50 □ 5 • 20 + 7 • 50
9 • 20 – 3 • 30 □ 7 • 30 – 6 • 20
8 • 40 – 4 • 30 □ 7 • 30 + 5 • 40

4 Njehsojmë dhe plotësojmë.

12 : 6 = □
120 : 60 = □ 120 : 6 = □

15 : 5 = □ 72 : 8 = □
150 : 5 = □ 720 : 8 = □
150 : 50 = □ 720 : 80 = □

5 Njehsojmë dhe plotësojmë.

: 60		: 80		: 70		: 90		: 40	
360		240		350			9	160	
240		480			4	270			6
	5		9	420		630		280	
	6		3		5		2		8
480			4	560			4	400	

Ushtrojmë

32

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Mësimdhënia e ndërsjellë

Nxënësve u paraqitet detyra 1 dhe u jepen sqarime për zbatimin e lidhjes së pjesëtimit me shumëzimin. Shkruajnë përgjigjen e duhur. Udhëzohen të plotësojnë detyrën 2.
Nxënësit mendojnë, diskutojnë në dyshe dhe plotësojnë bashkë me grupin. Secili grup arsyeton zgjidhjet e tyre para të tjerëve. U drejtohen pyetje orientuese, si:

$$270 = \square \cdot 60 + \square$$

Dhe zgjidhjet me tri opcione, si:
A. $4 \cdot 60 + 30$
B. $5 \cdot 60 + 20$
C. $6 \cdot 60 + 40$
Varësisht nga përgjigjet e sakta të tyre, u jepen sqarimet e nevojshme dhe nxënësit vazhdojnë me plotësimin e detyrës 3 dhe paraqesin zgjidhjet e tyre.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Mendo/Puno në dyshe

Nxënësit udhëzohen të analizojnë detyrën 4.
Njehsojnë prodhimin duke njehsuar rezultatin e saktë bazuar në shembullin e dhënë. Nxënësit diskutojnë në dyshe dhe kryejnë vlerësim të ndërsjellë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e gjetjes së prodhimit, mënyrën e shoqërimit dhe argumentimit të zgjidhjes së detyrave.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 31).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 94

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri në 1000.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.1.2; III.1, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi i shumëfishave të numrit 10 me dhjetëshe të plota

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen numrin e duhur në detyrat e dhëna;
- Vendos shenjës + apo – për të formuar barazi të sakta;
- Krahason barazimet e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
6 Prindërit e Gentit vendosën që me fëmijët e tyre të kalonin disa ditë në Tiranë. Ata u nisën nga Prishtina në orën 10 e 30 minuta. Rrugëtimi u zgjati 3 orë e 53 minuta. Kur mbërritën ata në Tiranë?

Prishtinë — pas 3 h e 53 min — Tiranë

Ora është ☐ h ☐ min

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

Ushtrojmë

61

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e drejtuar

Nxënësit llogaritin kohën në detyrën 1. U paraqiten informacionet lidhur me njësitë matëse të kohës.



Analizojnë detyrën 2 dhe kryejnë shndërrimet e njësive matëse të kohës në orë.

Diskutojnë në dyshe dhe krahasojnë zgjidhjet me të tjerët.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Rishikim në dyshe

Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrën 3. Pas llogaritjes përgjigjen se kur nisi Guri të bënte detyrat.

Kontrollojnë zgjidhjet e tyre dhe bëjnë përmirësimet e nevojshme.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, pjesëmarrjen aktive në diskutim dhe mënyrën e shndërrimit dhe llogaritjes së kohës.

Detyrë:

Punohet një orë mekanike, me cilindo material.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 121

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7 III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5; 2.4.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Matja e kohës (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Krahason numrat dyshifrorë ndërmjet vete;
- Rendit numrat nga më i vogli deri te më i madhi;
- Identifikon paraardhësin dhe pasardhësin e numrave deri në 100.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Rikujtimi i paranjohurive për temën
Në këtë fazë të orës bëjmë një rikujtim të asaj çka mësuam orën e fundit, dhe menjëherë pas këtij rikujtimi nxënësit zgjidhin detyrën 1 ku kanë për detyrë ta vizatojnë se si duken akrepat në orën e caktuar.

Ora është 1 Ora është 4 Ora është 15 Ora është 22





3 Njehsojmë dhe plotësojmë.

1 h + 8 min = ☐ min
1 h – 10 min = ☐ min
85 min = 1 h + ☐ min

1 h + 50 min = ☐ min
1 h – 20 min = ☐ min
95 min = ☐ h + ☐ min

1 h + 8 min *paraqet të njëjtin shënim sikur edhe* 1h e 8 min

1h e 30 min + 1h e 50 min = ☐ h ☐ min
2h e 10 min – 1h e 30 min = ☐ h ☐ min

4 Kjo orë është 10 minuta mbrapa. Sa është ora e saktë?

Përgjigjja: _____

5 Plotësojmë fjalitë:

1. Ora 17 është ___ orë pas orës 12 të mesditës.
2. Ora 13 e 30 min është ___ orë e ___ min pas orës 12 të mesditës.
3. Ora 10 e 23 min është ___ orë e ___ min pas orës 12 të mesditës.
4. Ora 6 e 34 min është ___ orë e ___ min pas orës 12 të mesnatës.
5. Ora 21 e 10 min është ___ orë e ___ min para orës 12 të mesnatës.

6 Prindërit e Gentit vendosën që me fëmijët e tyre të kalonin disa ditë në Tiranë. Ata u nisën nga Prishtina në orën 10 e 30 minuta. Rrugëtimi u zgjati 3 orë e 53 minuta. Kur mbërritën ata në Tiranë?

Prishtinë — pas 3 h e 53 min — Tiranë

Ora është ☐ h ☐ min

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

Ushtrojmë

61

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Rishikim në dyshe

Vazhdojmë me detyrën 2 ku nxënësit në çifte kanë për të zgjidhur detyrën, ku si udhëzim i detyrës është kuptimi i ndryshimit të orës pas një kohe të caktuar.



Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e zgjidh në tabelë detyrën 3 dhe 4, ku ua shpjegon atyre se si duhet të bëhet mbledhja dhe kthimi i orëve në minuta, minutave në sekonda etj.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Punë e pavarur

Nxënësit në mënyrë individuale vazhdojnë zgjidhjen e detyrës së pestë duke plotësuar fjalitë në detyrë.

Detyra 6 duhet të zgjidhet në tabelë dhe mësimdhënësi/ja këtë detyrë e zgjidh në formë të garës ndërmjet nxënësve të klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në krahasimin e numrave dyshifrorë, renditjen e numrave nga me i vogli deri te më i madhi dhe identifikimin e paraardhësit dhe pasardhësit të numrave deri në 100.

Detyrë:

Detyra 8 dhe 9 (faqe 62).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 122

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5; 2.42.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi i numrave dyshifrorë me numër njëshifror

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Kryen pjesëtimin e numrave dyshifrorë me numër njëshifror duke përshkruar me fjalë.



PJESËTIMI NË TABELËN E VENDVLERAVE

PJESËTIMI I NUMRAVE DYSHIFRORË ME NUMËR NJËSHIFROR

1 Të kujtojmë.

Një mjeshtër i violinave ka në punëtorinë e tij 24 tela të violinës. Sa violina mund t'i punojë mjeshtri, nëse dihet se një violinë ka 4 tela?

24 : 4 = 6, sepse 6 · 4 = 24 (herësi; i pjesëtueshmi; pjesëtuesi)

Përgjigjja: Mjeshtri mund t'i punojë ____ violina.

Herësin 24 : 4 mund ta njehsojmë edhe drejtpërdrejt, kështu:

24 : 4 = (20 + 4) : 4 = 20 : 4 + 4 : 4 = 5 + 1 = 6.

Pra, në fillim i pjesëtueshmi pjesëton dhjetëshet e pastaj njëshet.

2 Në kopshtin e botanikës, nxënësit mbollën 36 zambakë në 3 rende me numër të njëjtë. Sa zambakë janë në secilin rend?

Dh	Nj		Dh	Nj
3	6	: 3 =	1	2
− 3				
0	6			
−	6			
	0			

36 : 3 = 12; − 3; 06; − 6; 0

Përgjigjja: në secilin rend janë ____ zambakë.

Përshkrimi:

I. Pjesëtojmë shifrën e dhjetësheve me pjesëtuesin.

1. Pjesëtojmë: 3 Dh : 3 = 1 Dh. Rezultatin e shkruajmë në vendvlerën e dhjetëshes së herësit.
2. Shumëzojmë: 1 Dh · 3 = 3 Dh. Prodhimin e shkruajmë nën vendvlerën e dhjetëshes së të pjesëtueshmit.
3. Zbresim: 3 Dh - 3 Dh = 0. Diferencën e shkruajmë nën vendvlerën e dhjetëshes.
4. Mbetjes ia ndajshkruajmë njëshen e të pjesëtueshmit.

II. Pjesëtojmë shifrën e njësheve me pjesëtuesin.

1. Pjesëtojmë: 6 Nj : 3 = 2 Nj. Rezultatin e shkruajmë në vendvlerën e njëshes së herësit.
2. Shumëzojmë: 2 Nj · 3 = 6 Nj. Prodhimin e shkruajmë në vendvlerën e njëshes së të pjesëtueshmit.
3. Zbresim: 6 Nj - 6 Nj = 0. Diferencën e shkruajmë në vendvlerën e njëshes.
4. Pjesëtimi është kryer, sepse nuk ka shifra të tjera për ta vazhduar pjesëtimin.

Mësojmë

63

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Meqenëse këtu fillojmë me një kapitull të ri atëherë mësimdhënësi/ja bën një përsëritje të shkurtër lidhur me pjesëtimin e numrave dyshifrorë më saktësisht me dhjetëshe të plota me numër njëshifror.



3 Pemëtari dëshiron të mbjellë 85 fidanë kumbulle në 5 rende me numër të njëjtë. Sa fidanë kumbulle do të ketë në secilin rend?

Dh	Nj		Dh	Nj
8	5	: 5 =	1	7
− 5				
3	5			
− 3	5			
0	0			

85 : 5 = 17
− 5
35
− 35
00

8 : 5 "përafërsisht" 1
1 • 5 = 5 < 8
8 − 5 = 3

Përgjigjja: _____

Përshkrimi:

I. Pjesëtojmë shifrën e dhjetësheve me pjesëtuesin.

1. Pjesëtojmë: 8 Dh : 5 = "përafërsisht" 1 Dh. Rezultatin e shkruajmë në vendvlerën e dhjetëshes së herësit.
2. Shumëzojmë: 1 Dh • 5 = 5 Dh. Prodhimin e shkruajmë nën vendvlerën e dhjetëshes së të pjesëtueshmit.
3. Zbresim: 8 Dh - 5 Dh = 5 Dh. Diferencën e shkruajmë nën vendvlerën e dhjetëshes.
4. Mbetjes i ndajshkruajmë njëshen e të pjesëtueshmit.

II. Pjesëtojmë shifrën e njësheve me pjesëtuesin.

1. Pjesëtojmë: 35 Nj : 5 = 7 Nj. Rezultatin e shkruajmë në vendvlerën e njëshes së herësit.
2. Shumëzojmë: 7 Nj • 5 = 35 Nj = 3 Dh 5 Nj. Prodhimin e shkruajmë në shtyllat Dh dhe Nj.
3. Zbresim: 3 Dh - 3 Dh = 0 Dh, 5 Nj - 5 Nj = 0 Nj. Diferencën e shkruajmë në shtyllat Dh dhe Nj.
4. Pjesëtimi është kryer, sepse nuk ka shifra të tjera për të vazhduar pjesëtimin.

4 Formulojmë pyetjen, njehsojmë dhe gjejmë përgjigjen.
Nga 98 drurë që u mbollën në parkun e qytetit, çdo i shtati ishte gjethembajtës.

Pyetja: _____

Njehsojmë: 98 : 7 = (__+__) : __ =

Përgjigjja: _____

Mësojmë

64

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Në këtë fazë të orës, detyra e parë do të na rikujtojë se si realizohet pjesëtimi i një numri dyshifror me një numër njëshifror. Nga nxënësit kërkohet që të lexohet kjo pjesë dhe ta kuptojnë qartë se si është vepruar në këtë shembull.

Detyra 2 është problem matematikor, ku së pari duhet të realizohet shprehja numerike e pastaj nxënësit në shtyllë duhet ta kuptojnë realizimin e pjesëtimit.

Dh	Nj		Dh	Nj
3	6	: 3 =	1	2
− 3				
0	6			
−	6			
	0			

36 : 3 = 12
− 3
06
− 6
0

Nxënësit duhet ta ndjekin hap pas hapi përshkrimin e dhënë për këtë pjesëtim të numrave në libër, faqe 63.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Shkëmbe një detyrë

Nxënësit udhëzohen që në dyshe të shkëmbejnë një detyrë me pjesëtim dhe ta zgjidhin atë. Zgjidhjet e detyrës diskutohen në dyshe pastaj me të gjithë klasën.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në kryerjen e pjesëtimit të numrave dyshifrorë me numër njëshifror duke përshkruar atë me fjalë.

Detyrë:

Njehsohet herësi i pesë numrave dyshifrorë me numër njëshifror.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 123

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi i numrave dyshifrorë me numër njëshifror (vazhdim)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përshkruan pjesëtimin e numrave dyshifrorë me numër njëshifror;
- Gjen herësin e numrave dyshifrorë me numër njëshifror.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Meqenëse këtu fillojmë me një kapitull të ri, atëherë mësimdhënësi/ja bën një përsëritje të shkurtër lidhur me pjesëtimin e numrave dyshifrorë, më saktësisht me dhjetëshe të plota me numër njëshifror.



PJESËTIMI NË TABELËN E VENDVLERAVE

PJESËTIMI I NUMRAVE DYSHIFRORË ME NUMËR NJËSHIFROR

1 Të kujtojmë.

Një mjeshtër i violinave ka në punëtorinë e tij 24 tela të violinës. Sa violina mund t'i punojë mjeshtri, nëse dihet se një violinë ka 4 tela?

herësi

24 : 4 = 6, sepse 6 · 4 = 24

i pjesëtueshmi — pjesëtuesi

Përgjigjja: Mjeshtri mund t'i punojë ____ violina.

Herësin 24 : 4 mund ta njehsojmë edhe drejtpërdrejt, kështu:

24 : 4 = (20 + 4) : 4 = 20 : 4 + 4 : 4 = 5 + 1 = 6.

Pra, në fillim i pjesëtueshmi pjesëton dhjetëshet e pastaj njëshet.

2 Në kopshtin e botanikës, nxënësit mbollën 36 zambakë në 3 rende me numër të njëjtë. Sa zambakë janë në secilin rend?

Dh	Nj		Dh	Nj
3	6	: 3 =	1	2
− 3				
0	6			
−	6			
	0			

36 : 3 = 12
− 3
06
− 6
0

Përgjigjja: në secilin rend janë ___ zambakë.

Përshkrimi:

I. Pjesëtojmë shifrën e dhjetësheve me pjesëtuesin.

1. Pjesëtojmë: 3 Dh : 3 = 1 Dh. Rezultatin e shkruajmë në vendvlerën e dhjetëshes së herësit.
2. Shumëzojmë: 1 Dh · 3 = 3 Dh. Prodhimin e shkruajmë nën vendvlerën e dhjetëshes së të pjesëtueshmit.
3. Zbresim: 3 Dh - 3 Dh = 0. Diferencën e shkruajmë nën vendvlerën e dhjetëshes.
4. Mbetjes ia ndajshkruajmë njëshen e të pjesëtueshmit.

II. Pjesëtojmë shifrën e njësheve me pjesëtuesin.

1. Pjesëtojmë: 6 Nj : 3 = 2 Nj. Rezultatin e shkruajmë në vendvlerën e njëshes së herësit.
2. Shumëzojmë: 2 Nj · 3 = 6 Nj. Prodhimin e shkruajmë në vendvlerën e njëshes së të pjesëtueshmit.
3. Zbresim: 6 Nj - 6 Nj = 0. Diferencën e shkruajmë në vendvlerën e njëshes.
4. Pjesëtimi është kryer, sepse nuk ka shifra të tjera për ta vazhduar pjesëtimin.

Mësojmë

63



3 Pemëtari dëshiron të mbjellë 85 fidanë kumbulle në 5 rende me numër të njëjtë. Sa fidanë kumbulle do të ketë në secilin rend?

Dh	Nj		Dh	Nj
8	5	: 5 =	1	7
− 5				
3	5			
− 3	5			
0	0			

85 : 5 = 17
− 5
35
− 35
00

8 : 5 "përafërsisht" 1
1 • 5 = 5 < 8
8 − 5 = 3

Përgjigjja: _____

Përshkrimi:

I. Pjesëtojmë shifrën e dhjetësheve me pjesëtuesin.

1. Pjesëtojmë: 8 Dh : 5 = "përafërsisht" 1 Dh. Rezultatin e shkruajmë në vendvlerën e dhjetëshes së herësit.
2. Shumëzojmë: 1 Dh • 5 = 5 Dh. Prodhimin e shkruajmë nën vendvlerën e dhjetëshes së të pjesëtueshmit.
3. Zbresim: 8 Dh - 5 Dh = 5 Dh. Diferencën e shkruajmë nën vendvlerën e dhjetëshes.
4. Mbetjes i ndajshkruajmë njëshen e të pjesëtueshmit.

II. Pjesëtojmë shifrën e njësheve me pjesëtuesin.

1. Pjesëtojmë: 35 Nj : 5 = 7 Nj. Rezultatin e shkruajmë në vendvlerën e njëshes së herësit.
2. Shumëzojmë: 7 Nj • 5 = 35 Nj = 3 Dh 5 Nj. Prodhimin e shkruajmë në shtyllat Dh dhe Nj.
3. Zbresim: 3 Dh - 3 Dh = 0 Dh, 5 Nj - 5 Nj = 0 Nj. Diferencën e shkruajmë në shtyllat Dh dhe Nj.
4. Pjesëtimi është kryer, sepse nuk ka shifra të tjera për të vazhduar pjesëtimin.

4 Formulojmë pyetjen, njehsojmë dhe gjejmë përgjigjen.
Nga 98 drurë që u mbollën në parkun e qytetit, çdo i shtati ishte gjethembajtës.

Pyetja: _____

Njehsojmë: 98 : 7 = (__+__) : __ =

Përgjigjja: _____

Mësojmë

64

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e orientuar

Në këtë fazë të orës, detyra e parë do të na rikujtojë se si realizohet pjesëtimi i një numri dyshifror me një numër njëshifror. Nga nxënësit kërkohet që të lexohet kjo pjesë dhe ta kuptojnë qartë se si është vepruar në këtë shembull.

Detyra 3 është problem matematikor, ku së pari duhet të realizohet shprehja numerike e pastaj nxënësit në shtyllë duhet ta kuptojnë realizimin e pjesëtimit.



Nxënësit duhet ta ndjekin hap pas hapi përshkrimin e dhënë për këtë pjesëtim të numrave në libër, faqe 64.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që në mënyrë individuale t'i përgjigjen zgjidhjes së detyrës 4 me fjalë. Ku së pari duhet të krijohet shprehja numerike e pastaj arrijmë deri te përgjigja e detyrës me fjalë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e pjesëtimit të numrave dyshifrorë me numër njëshifror dhe gjetjen e herësit të tyre.

Detyrë:

Të njehsohet herësi i pesë numrave dyshifrorë me numër njëshifror.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 124

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi i numrave dyshifrorë me numër njëshifror (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Kryen pjesëtimin e numrave dyshifrorë me një numër njëshifror;
- Zbaton pjesëtimin në problema me fjalë;
- Njehson vlerën e shprehjeve numerike të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Shkruhet në tabelë shprehja numerike 84:6. Nxënësit udhëzohen ta gjejnë herësin dhe zgjidhja diskutohet me gjithë klasën.


1 Njehsojmë.

39 : 3 = 13 −3 09 −9 0	65 : 5 =	84 : 4 =
84 : 7 = 12 −7 14 −14 00	72 : 3 =	96 : 4 =

2 Në ditën e parë të pranverës, gjatësia e ditës me të natës është e barabartë. Sa është e gjatë dita e parë e pranverës?

Njehsojmë:

Përgjigjja:

3 Formulojmë pyetjen dhe gjejmë përgjigjen.
Në 6 kopshte kanë lulëzuar 84 lulebora dhe numri i luleborave të lulëzuara në çdo kopsht është i njëjtë.

Pyetja:

Njehsojmë:

Përgjigjja:

Ushtrojmë

65



4 Njehsojmë herësin, drejtpërdrejt dhe në shtylla.

48 : 4 = (40 + 8) :4
= 40 : 4 + 8 :4
= ☐ + ☐ = ☐

4	8	:	4	=		

sepse: ☐☐ · 4

51 : 3 = _____
= _____
= _____

5	1	:	3	=		

sepse: ☐☐☐

5 Një shtëpi botuese ka dhuruar 96 libra për 4 shkollat e qytetit. Secila shkollë ka marrë numër të njëjtë të librave. Nga sa libra ka marrë secila shkollë?

Njehsojmë:

96 : 4 = (40 + 40 +16) : 4
= _____
= _____
= _____

sepse: ☐☐ · 4

Përgjigjja: _____

6 Formulojmë pyetjen dhe gjejmë përgjigjen.

Nga 42 anëtarët e klubit të atletikës në shkollë, çdo i treti merret me vrapim.

Pyetja: _____

Njehsojmë:

Përgjigjja: _____

Ushtrojmë

66

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e pavarur

Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë individuale në zgjidhjen e detyrës 1, faqe 65 në libër.



Detyrën 2, 3, 4 dhe 5 i ndajmë në katër grupe të nxënësve dhe secili grup do të zgjidhë njërën nga detyrat e caktuara nga mësimdhënësi/ja në afatin kohor të përcaktuar dhe pastaj e paraqesin në tabelë zgjidhjen e tyre.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Formo pyetje/ Gjej përgjigjen

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi/ja përsëri në formë të garës udhëzon nxënësit të zgjidhin detyrën 6, ku nga formulimi i detyrës nxënësit duhet të krijojnë pyetje, ta zgjidhin detyrën dhe të nxjerrin përgjigje.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për kryerjen e pjesëtimit të numrave dyshifrorë me numër njëshifror, zbatimin e pjesëtimit në problema me fjalë dhe njehsimin e vlerës së shprehjeve të dhëna numerike.

Detyrë:

Të njehsohet herësi i pesë numrave dyshifrorë me numër njëshifror.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 125

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; I.2; I.7; III.1; III.3; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifror

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Kryen pjesëtimin e numrave treshifrorë me një numër njëshifror.


PJESËTIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË ME NUMËR NJËSHIFROR

1 Nga 639 nxënës sa ka një shkollë, një e treta merren me sport. Sa nxënës merren me sport?

639 : 3 = 213 ← herësi
i pjesëtueshmi — pjesëtuesi

Pjesëtojmë në shtylla (duke i vendosur numrat në vendvlerat e tyre).

Q	Dh	Nj		Q	Dh	Nj
6	3	9	: 3 =	2	1	3
− 6						
0	3					
−	3					
	0	9				
−		9				
		0				

639 : 3 = 213
− 6
03
− 3
09
− 9
0

Prova: · 3

Përgjigjja: _____

2 Njehsojmë.

848 : 4 =

Q	Dh	Nj	
8	4	8	: 4 =

Prova: · 3

663 : 3 =

Q	Dh	Nj	
6	6	9	: 3 =

Prova: · 3

3 Njehsojmë.

468 : 2 = 488 : 4 = 699 : 3 = 824 : 2 =
280 : 2 = 555 : 5 = 666 : 6 = 480 : 4 =

Mësojmë

67

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Nxënësve u kërkohet të gjejnë herësin e numrit dyshifror me një numër njëshifror.
Shembull: 84:4
Në mënyrë të rastësishme zgjidhet një nxënës të kryejë këtë llogaritje para klasës.



PJESËTIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË ME NUMËR NJËSHIFROR

1 Nga 639 nxënës sa ka një shkollë, një e treta merren me sport. Sa nxënës merren me sport?

639 : 3 = 213 ← herësi
i pjesëtueshmi — pjesëtuesi

Pjesëtojmë në shtylla (duke i vendosur numrat në vendvlerat e tyre).

Q	Dh	Nj		Q	Dh	Nj
6	3	9	: 3 =	2	1	3
− 6						
0	3					
−	3					
	0	9				
−		9				
		0				

639 : 3 = 213
− 6
03
− 3
09
− 9
0

Prova: · 3

Përgjigjja: _____

2 Njehsojmë.

848 : 4 =

Q	Dh	Nj	
8	4	8	: 4 =

Prova: · 3

663 : 3 =

Q	Dh	Nj	
6	6	9	: 3 =

Prova: · 3

3 Njehsojmë.

468 : 2 = 488 : 4 = 699 : 3 = 824 : 2 =
280 : 2 = 555 : 5 = 666 : 6 = 480 : 4 =

Mësojmë

67

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Shqyrtim i përbashkët

Në detyrën 1, nxënësit do të njoftohen me mënyrën e pjesëtimit të një numri treshifror me një numër njëshifror dhe normalisht do të bëjnë provën se a është realizuar mirë pjesëtimi.



Pas sqarimit të pjesëtimit të një numri treshifror me një numër njëshifror bëjmë zgjidhjen e detyrës 2 në të njëjtën formë si në sqarimin e mësipërm.

Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Lapsat në mes

Nxënësit udhëzohen që në grup të njehsojnë herësin e detyrave të dhëna. Pas njehsimit, nxënësit vendosin lapsin në mes. Brenda grupit, tërhiqet një laps dhe kërkohet nga nxënësi përgjegjës të tregojë ecurinë e gjetjes së herësit te detyra e dhënë.

468 : 2 = 488 : 4 = 699 : 3 = 824 : 2 =
280 : 2 = 555 : 5 = 666 : 6 = 480 : 4 =

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në kryerjen e numrave treshifrorë me numër njëshifror.

Detyrë:

Të njehsohet herësi i pesë numrave treshifrorë me numër njëshifror.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 126

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifror (vazhdim)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Pjesëton numrat treshifrorë me numër njëshifror.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).



PJESËTIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË ME NUMËR NJËSHIFROR

1 Nga 639 nxënës sa ka një shkollë, një e treta merren me sport. Sa nxënës merren me sport?

639 : 3 = 213 ← herësi
↑ i pjesëtueshmi ↑ pjesëtuesi

Pjesëtojmë në shtylla (duke i vendosur numrat në vendvlerat e tyre).

Q	Dh	Nj		Q	Dh	Nj
6	3	9	: 3 =	2	1	3
− 6						
0	3					
−	3					
	0	9				
−		9				
		0				

639 : 3 = 213
− 6
03
− 3
09
− 9
0

Prova: · 3

Përgjigjja: _____

2 Njehsojmë.

848 : 4 =

Q	Dh	Nj	
8	4	8	: 4 =

Prova: · 3

663 : 3 =

Q	Dh	Nj	
6	6	9	: 3 =

Prova: · 3

3 Njehsojmë.

468 : 2 = 488 : 4 = 699 : 3 = 824 : 2 =
280 : 2 = 555 : 5 = 666 : 6 = 480 : 4 =

Mësojmë

67

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Rikujtim i njohurive paraprake

Nxënësve u kërkohet ta gjejnë herësin e numrit 448:4. Pastaj zgjidhja diskutohet me gjithë klasën.



4 Një kultivues i boronicës ka vendosur të mbjellë edhe 968 fidanë boronice. Ato do t'i mbjellë në 8 rende me numër të njëjtë. Nga sa fidanë boronice do të mbjellë në secilin rend?

Njehsojmë:

Q	Dh	Nj		Q	Dh	Nj
9	6	8	: 8 =	1	2	1
− 8						
1	6					
− 1	6					
	0	8				
−		8				
		0				

968 : 8 = 121
− 8
16
− 16
8
− 8
0

Pas pjesëtimit të qindësheve, mbetet një qindëshe, të cilën e zbërthejmë në dhjetëshe dhe vazhdojmë pjesëtimin.

Përgjigjja: _____

5 Njehsojmë.

486 : 3 = 162
− 3
18
− 18
006
− 6
0

789 : 3 = 263
964 : 4 = ____
850 : 5 = ____
786 : 6 = ____
459 : 3 = ____

847 : 7 = ____
917 : 7 = ____
728 : 8 = ____
968 : 8 = ____
966 : 6 = ____

6 Nga 513 banorë sa ka një fshat, një e treta merren me perimtari. Sa banorë të fshatit merren me perimtari?

Njehsojmë: 5 1 3 : 3 =

sepse: ____ · 3

Përgjigjja: _____

Hësojmë

68

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Shqyrtim i përbashkët

Në detyrën 4 nxënësit do të njoftohen me mënyrën e pjesëtimit të një numri treshifror me një numër njëshifror dhe normalisht do të bëjnë provën se a është realizuar mirë pjesëtimi.



Pas sqarimit të pjesëtimit të një numri treshifror me një numër njëshifror bëjmë zgjidhjen e detyrës 5, në të njëjtën formë si në sqarimin e mësipërm.

Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Veprimtari e orientuar

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e zgjidhin detyrën 6 në tabelë, gjithnjë duke kujtuar metodën e realizimit të pjesëtimit të një numri treshifror me një numër njëshifror.

Njehsojmë: 5 1 3 : 3 =

sepse: ____ · 3

Përgjigjja: _____

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në pjesëtimin e numrave treshifrorë me numër njëshifror.

Detyrë:

Të njehsohet herësi i katër numrave treshifrorë me numër njëshifror.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 127

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifror (vazhdim)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Pjesëton numrat treshifrorë me numër njëshifror.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë fazë të orës, te detyra 7 ne rikujtojmë pjesëtimin e numrave treshifrorë me një numër njëshifror.



10 Njehsojmë.

852 : 3 =

Q	Dh	Nj		Q	Dh	Nj
8	5	2	: 3 =	2	8	4
− 6						
2	5					
− 2	4					
	1	2				
−	1	2				
		0				

852 : 3 = 284
− 6
25
− 24
12
− 12
0

Pas pjesëtimit të qindësheve, mbeten 2 qindëshe, të cilat i zbërthejmë në dhjetëshe. Gjatë pjesëtimit të dhjetësheve na mbetet 1 dhjetëshe, të cilën e zbërthejmë në njëshe.

11 Njehsojmë.

924 : 7 = 132
− 7
22
− 21
14
− 14
0

579 : 3 =
498 : 3 =
775 : 5 =
976 : 8 =
875 : 7 =

952 : 8 =
845 : 5 =
992 : 4 =
758 : 2 =
928 : 8 =

12 Prodhimin e numrave 226 dhe 4 e zvogëlojmë për herësin e numrave 357 dhe 3.

Njehsojmë: 2 2 6 · 4 dhe 3 5 7 : 3 =

Gjejmë: 226 · 4 − 357 : 3 = − =

Hësojmë

70

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e orientuar

Pas sqarimit të pjesëtimit të një numri treshifror me një numër njëshifror, së bashku me nxënësit bëjmë zgjidhjen e detyrës 8, në të njejtën formë si në sqarimin e mësipërm në tabelë.

Q	Dh	Nj		Q	Dh	Nj
6	7	2	: 6 =	1	1	2
− 6						
0	7					
−	6					
	1	2				
−	1	2				
		0				

· 3

234 : 2 =
642 : 3 =
472 : 4 =
565 : 5 =
896 : 8 =
651 : 3 =

354 : 3 =
864 : 4 =
951 : 3 =
642 : 6 =
874 : 2 =
945 : 3 =

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Punë në grupe

Nxënësit në grupe udhëzohen që të njehsojnë pjesëtimin përkatësisht shumëzimin e numrit treshifror me numër njëshifror.

Zgjidhja e saktë është në katrorin e parë 125, në të dytin 25, në të tretin 5 dhe në të fundit 1.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në pjesëtimin e numrave treshifrorë me numër njëshifror.

Detyrë:

Të njehsohet herësi i pesë numrave treshifrorë me numër njëshifror.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 128

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifror (vazhdim)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Kryen pjesëtimin e numrave treshifrorë me një numër njëshifror;
- Zbaton pjesëtimin në problema me fjalë;
- Njehson vlerën e shprehjeve numerike të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë fazë të orës, te detyra 10 ne rikujtojmë pjesëtimin e numrave treshifrorë me një numër njëshifror.







1 Njehsojmë.

8 6 1 : 7 =

9 3 6 : 9 =

280 : 2 = 724 : 4 = 918 : 3 =

530 : 5 = 304 : 4 = 654 : 6 =

360 : 8 = 609 : 3 = 728 : 7 =

2 Daja dëshiron që tetë nipërve të tij t'ua ndajë 100 euro, në mënyrë të barabartë. Nga sa euro morën ata dhe sa euro i mbetën dajës?

Njehsojmë:

Përgjigjja:

3 Formulojmë pyetjen, njehsojmë dhe gjejmë përgjigjen.

Prindërit i blenë Erindit një kompjuter për 630 euro. Pagesën do ta bëjnë në 7 këste të barabarta mujore.

Pyetja:

Njehsojmë:

sepse: · 7

Ushtrojmë

72

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e pavarur me mbikëqyrje

Pas sqarimit të pjesëtimit të një numri treshifror me një numër njëshifror, së bashku me nxënësit bëjmë zgjidhjen e detyrës 11, në të njëjtën formë si në sqarimin e mësipërm në tabelë.

924 : 7 = 132
− 7
22
− 21
14
− 14
0

579 : 3 =
498 : 3 =
775 : 5 =
976 : 8 =
875 : 7 =

952 : 8 =
845 : 5 =
992 : 4 =
758 : 2 =
928 : 8 =

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Rishikim në dyshe

Nxënësit udhëzohen që të njehsojnë vlerën e shprehjes së dhënë. Pas njehsimit, nxënësit në dyshe kontrollojnë detyrën. Më pas zgjidhja e detyrës diskutohet me gjithë klasën.

Njehsojmë: 226 · 4 dhe 357 : 3 =

Gjejmë: 226 · 4 − 357 : 3 = − =

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në kryerjen e pjesëtimit të numrit treshifrorë me numër njëshifror, zbatimin e pjesëtimit në zgjidhjen e problemave me fjalë dhe njehsimin e vlerës së shprehjeve të dhëna numerike.

Detyrë:

Njehsohet herësi i pesë numrave treshifrorë me numër njëshifror.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 129

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifror (vazhdim)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Kryen pjesëtimin e numrave treshifrorë me një numër njëshifror;
- Zbaton pjesëtimin në problema me fjalë;
- Njehson vlerën e shprehjeve numerike të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).


13 Babai ka blerë katër goma të automobilit për 376 euro. Sa ka kushtuar një gomë?

Çka nëse te vlera numerike e qindëshes tek i pjesëtueshmi është më e vogël se pjesëtuesi?

Në këtë rast, në vendvlerën e qindëshes të herësit është shkruar një zero.

Përgjigjja: _____

14 Njehsojmë.

216 : 4 = 54
- 20
16
- 16
0

245 : 7 = 35
348 : 6 = ____
567 : 9 = ____
294 : 7 = ____
846 : 9 = ____
423 : 9 = ____
384 : 6 = ____
225 : 5 = ____

864 : 8 = 108
- 8
06
- 00
64
- 64
0

Çka nëse vlera numerike e dhjetëshes tek i pjesëtueshmi është më e vogël se pjesëtuesi? Në këtë rast, në vendvlerën e dhjetëshes së herësit shkruajmë zero.

621 : 3 = ____
921 : 3 = ____
804 : 4 = ____
515 : 5 = ____

15 Duke zbatuar vetinë e shpërndarjes, njehsojmë.

350 : 5 + 150 : 5 = (350 + 150) : ____ = ____ : ____ = ____.
180 : 6 + 120 : 6 = _____
360 : 9 + 90 : 9 = _____

Mësojmë

71

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë fazë të orës, te detyra 13 ne sqarojmë formën e pjesëtimit dhe nga nxënësit kërkojmë nga një përgjigje rreth detyrës së dhënë.



1 Njehsojmë.

8 6 1 : 7 =

9 3 6 : 9 =

280 : 2 = 724 : 4 = 918 : 3 =

530 : 5 = 304 : 4 = 654 : 6 =

360 : 8 = 609 : 3 = 728 : 7 =

2 Daja dëshiron që tetë nipërve të tij t'ua ndajë 100 euro, në mënyrë të barabartë. Nga sa euro morën ata dhe sa euro i mbetën dajës?

Njehsojmë:

Përgjigjja:

3 Formulojmë pyetjen, njehsojmë dhe gjejmë përgjigjen.

Prindërit i blenë Erindit një kompjuter për 630 euro. Pagesën do ta bëjnë në 7 këste të barabarta mujore.

Pyetja:

Njehsojmë:

sepse: · 7

Ushtrojmë

72

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Shqyrtim i përbashkët

Pas sqarimit dhe marrjes së përgjigjes nga nxënësit, në këtë fazë të orës vazhdojmë me zgjidhjen e detyrës 14.

216 : 4 = 54

245 : 7 = 35 846 : 9 =

348 : 6 = 423 : 9 =

567 : 9 = 384 : 6 =

294 : 7 = 225 : 5 =

864 : 8 = 108

Çka nëse vlera numerike e dhjetëshes tek i pjesëtueshmi është më e vogël se pjesëtuesi? Në këtë rast, në vendvlerën e dhjetëshes së herësit shkruajmë zero.

621 : 3 = 804 : 4 =

921 : 3 = 515 : 5 =

Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Veprimtari e pavarur

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që duke zbatuar vetinë e shpërndarjes të bëjnë zgjidhjen e detyrës 15.

350 : 5 + 150 : 5 = (350 + 150) : ___ = ___ : ___ = ___.

180 : 6 + 120 : 6 = _____

360 : 9 + 90 : 9 = _____

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në krahasimin e numrave dyshifrorë në mes vete, renditjen e numrave në formë të drejtë nga më i vogli te më i madhi si dhe për paraqitjen e paraardhësit dhe pasardhësit të numrave deri në 100.

Detyrë:

Detyrat 2 dhe 3 (faqe 72).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 130

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi me mbetje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Kryen pjesëtimin e numrave me mbetje;
- Zbaton rregullën që mbetja çdo herë është më e vogël se pjesëtuesi;
- Njehson vlerën e shprehjeve numerike të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Nxënësit pyeten:
Si quhen numrat që marrin pjesë në pjesëtim? (I pjesëtueshmi, pjesëtuesi dhe herësi).
Te shprehja 32:8=4, cili është herësi? (Numri 4).
Po pjesëtuesi? (Numri 8).
Po i pjesëtueshmi? (Numri 32).



PJESËTIMI ME MBETJE

1 Të kujtojmë. Plotësojmë tabelën.

I pjesëtueshmi		14	72	48	12
Pjesëtuesi	3	3	8		
Herësi	7	?		6	4

Numri 14 nuk është i pjesëtueshëm me numrin 3.
Numri i parë më i vogël se numri 14 që pjesëtohet me numrin 3 është numri 12.

Nëse i pjesëtueshmi nuk pjesëtohet me pjesëtuesin, gjatë pjesëtimit fitohet mbetje. Për këtë, pjesëtimin në këtë rast e quajmë pjesëtim me mbetje.

2 Gjyshja kishte 9 arra. Ajo dëshiron që ato t'ua ndajë Erindës dhe Erindit.

Erinda Erindi mbetja

mbetja -2 -2 -2 -2
0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

9 -2→ 7 -2→ 5 -2→ 3 -2→ 1 mbetja

9 : 2 = 4 dhe mbetja 1, sepse 4 · 2 +1 = 8 + 1 =

Numri 9 nuk është i pjesëtueshëm me numrin 2. Numri i parë më i vogël se numri 9 që është i pjesëtueshëm me numrin 2 është numri 8. Numri 1 = 9 – 8 nuk mund të pjesëtohet me numrin 2. Ky numër është mbetja gjatë pjesëtimit të numrit 9 me numrin 2.

8 : 2 =

-2 -2 -2 -2 mbetja
0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10
+2 +2 +2 +2

4 · 2 =

Nëse numri a nuk është i pjesëtueshëm me numrin b, përcaktojmë numrin e parë më të vogël se numri a që është i pjesëtueshëm me numrin b.

Mbetja është çdoherë më e vogël se pjesëtuesi.

Mësojmë

73



3 Një vreshtare ka blerë 859 hardhi rrushi. Ajo dëshiron që ato t'i mbjellë në 8 rende. Sa hardhi do të ketë në secilin rend dhe sa do t'i mbesin asaj për t'i mbjellë para shtëpisë?

Q Dh Nj : 8 = Q Dh Nj
8 5 9 : 8 = 1 0 7
− 8
0 5
− 0
5 9
− 5 6
3 → mbetja

Mbetja është çdo herë më e vogël se pjesëtuesi.

859 : 8 = 107
− 8
05
− 0
59
− 56
3 → mbetja

0 ≤ 3 < 8

1 0 7 • 8
+ =

Përgjigjja:

4 Njehsojmë.

547 : 3 = 182
− 3
24
− 24
07
− 6
1 → mbetja

Pjesëtimi i numrit 547 me 3 jep herësin 182 dhe mbetjen 1.
Shkruajmë: 547 : 3 = 182 plus mbetja 1.
547 = 182 • 3 + 1

817 : 2 275 : 7 367 : 5
557 : 9 174 : 3 582 : 9

5 Njehsojmë herësin dhe bëjmë provën.

Q Dh Nj : 3 = Q Dh Nj
6 2 3 : 3 = 2 0 7
− 6
0 2
− 0
2 3
− 2 1
2 → Mbetja

231 : 2 482 : 9 195 : 4
217 : 5 131 : 5 480 : 9
365 : 7 367 : 5 409 : 2
713 : 5 380 : 8 295 : 3

Sepse: 207 • 3 + 2

Hësojmë

74

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e orientuar

Vazhdojmë mësimin me detyrën 1 ku kërkohet nga nxënësit që duke kujtuar pjesëtimin dhe shumëzimin të plotësojnë tabelën.

I pjesëtueshmi		14	72	48	12
Pjesëtuesi	3	3	8		
Herësi	7	?		6	4

Pas plotësimit të tabelës nxënësve u kërkohet të sqarojnë përse në rastin e pjesëtimit 14 : 3 nuk kemi numër të plotë si në rastet e tjera.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Shqyrtim i përbashkët

Mësimdhënësi/ja vazhdon me zgjidhjen e detyrës 2 së bashku me nxënësit duke kujtuar se nuk kemi vetëm pjesëtim me herës të plotë por kemi edhe pjesëtim me mbetje.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në krahasimin e numrave dyshifrorë në mes vete, renditjen e numrave në formë të drejtë nga më i vogli te më i madhi si dhe për paraqitjen e paraardhësit dhe pasardhësit të numrave deri në 100.

Detyrë:

Të punohet një detyrë sipas modelit të detyrës 2.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 131

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi me mbetje (vazhdim)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Kryen pjesëtimin e numrave me mbetje;
- Zbaton rregullën që mbetja çdo herë është më e vogël se pjesëtuesi;
- Njehson vlerën e shprehjeve numerike të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Veprimtari e orientuar

Në këtë fazë të orës, para nxënësve sqarojmë detyrën 3 të nxjerrë nga problema me fjalë.



Në fund të detyrës nxënësit duhet të japin përgjigje për pyetjen e dhënë.


PJESËTIMI ME MBETJE

1 Të kujtojmë. Plotësojmë tabelën.

I pjesëtueshmi		14	72	48	12
Pjesëtuesi	3	3	8		
Herësi	7	?		6	4

Numri 14 nuk është i pjesëtueshëm me numrin 3.
Numri i parë më i vogël se numri 14 që pjesëtohet me numrin 3 është numri 12.

Nëse i pjesëtueshmi nuk pjesëtohet me pjesëtuesin, gjatë pjesëtimit fitohet mbetje. Për këtë, pjesëtimin në këtë rast e quajmë pjesëtim me mbetje.

2 Gjyshja kishte 9 arra. Ajo dëshiron që ato t'ua ndajë Erindës dhe Erindit.

Erinda Erindi mbetja

mbetja -2 -2 -2 -2
0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

9 -2→ 7 -2→ 5 -2→ 3 -2→ 1 mbetja

9 : 2 = 4 dhe mbetja 1, sepse 4 · 2 +1 = 8 + 1 =

Numri 9 nuk është i pjesëtueshëm me numrin 2. Numri i parë më i vogël se numri 9 që është i pjesëtueshëm me numrin 2 është numri 8. Numri 1 = 9 – 8 nuk mund të pjesëtohet me numrin 2. Ky numër është mbetja gjatë pjesëtimit të numrit 9 me numrin 2.

8 : 2 =

-2 -2 -2 -2 mbetja
0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10
+2 +2 +2 +2

4 · 2 =

Nëse numri a nuk është i pjesëtueshëm me numrin b, përcaktojmë numrin e parë më të vogël se numri a që është i pjesëtueshëm me numrin b.

Mbetja është çdoherë më e vogël se pjesëtuesi.

Mësojmë

73



3 Një vreshtare ka blerë 859 hardhi rrushi. Ajo dëshiron që ato t'i mbjellë në 8 rende. Sa hardhi do të ketë në secilin rend dhe sa do t'i mbesin asaj për t'i mbjellë para shtëpisë?

Q	Dh	Nj		Q	Dh	Nj
8	5	9	: 8 =	1	0	7
− 8						
0	5					
−	0					
	5	9				
−	5	6				
		3	→ mbetja			

Mbetja është çdo herë më e vogël se pjesëtuesi.

859 : 8 = 107
− 8
05
− 0
59
− 56
3 → mbetja

0 ≤ 3 < 8

1	0	7	•	8

□ + □ = □

Përgjigjja: _____

4 Njehsojmë.

547 : 3 = 182
− 3
24
− 24
07
− 6
1 → mbetja

Pjesëtimi i numrit 547 me 3 jep herësin 182 dhe mbetjen 1.
Shkruajmë: 547 : 3 = 182 plus mbetja 1.
547 = 182 • 3 + 1

817 : 2	275 : 7	367 : 5
557 : 9	174 : 3	582 : 9

5 Njehsojmë herësin dhe bëjmë provën.

Q	Dh	Nj		Q	Dh	Nj
6	2	3	: 3 =	2	0	7
− 6						
0	2					
−	0					
	2	3				
−	2	1				
		2	→ Mbetja			

231 : 2	482 : 9	195 : 4
217 : 5	131 : 5	480 : 9
365 : 7	367 : 5	409 : 2
713 : 5	380 : 8	295 : 3

Sepse: 207 • 3 □ + 2 □

Hësojmë

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Veprimtari e orientuar dhe e pavarur

Pas sqarimit të pjesëtimit me mbetje, mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit të zgjidhin detyrën 4 në mënyrë individuale duke u bazuar te shembulli i mësipërm.



Pjesëtimi i numrit 547 me 3 jep herësin 182 dhe mbetjen 1.
Shkruajmë: 547 : 3 = 182 plus mbetja 1.
547 = 182 • 3 + 1

817 : 2	275 : 7	367 : 5
557 : 9	174 : 3	582 : 9

Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Veprimtari e pavarur

Mësimdhënësi/ja vazhdon me zgjidhjen e detyrës 5 në formë grupore ku secili grup do të zgjidh nga 3 pjesëtime të numrave të caktuara nga mësimdhënësi/ja. Pastaj zgjidhjet do të paraqiten në tabelë.

Q	Dh	Nj		Q	Dh	Nj
6	2	3	: 3 =	2	0	7
− 6						
0	2					
−	0					
	2	3				
−	2	1				
		2	→ Mbetja			

Sepse: 207 • 3 □ + 2 □

231 : 2	482 : 9	195 : 4
217 : 5	131 : 5	480 : 9
365 : 7	367 : 5	409 : 2
713 : 5	380 : 8	295 : 3

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në krahasimin e numrave dyshifrorë në mes vete, renditjen e numrave në formë të drejtë nga më i vogli te më i madhi si dhe për paraqitjen e paraardhësit dhe pasardhësit të numrave deri në 100.

Detyrë:

Të njehsohet herësi i pesë numrave treshifrorë me numër njëshifror.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 132

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5.


1 Njehsojmë.

301 : 2 =

sepse: · 2

+ =

725 : 3 =

sepse: · 3

+ =

679 : 7 =

sepse: · 7

+ =

923 : 4 =

sepse: · 4

+ =

2 Nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës janë nisur aeroplanë për Londër, Berlin dhe Budapest. Në secilin aeroplan kishte numër të njëjtë të udhëtarëve. Në zonën e pritjes për nisje ishin 563 udhëtarë. Në pritje mbetën më pak se tre udhëtarë. Nga sa udhëtarë u nisën me secilin aeroplan dhe sa mbetën për fluturimet e tjera?

Përgjigjja:

PRN

Ushtrojmë

75

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi me mbetje (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Kryen pjesëtimin e numrave me mbetje;
- Zbaton rregullën që mbetja çdo herë është më e vogël se pjesëtuesi;
- Njehson vlerën e shprehjeve numerike të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Veprimtari e orientuar

Në pjesën hyrëse të mësimit, mësimdhënësi/ja përcakton katër nxënës që në katër pjesët e tabelës njëkohësisht t'i zgjidhin detyrat e mëposhtme.



3 Formulojmë pyetjen, njehsojmë dhe gjejmë përgjigjen.
Në oborrin e fabrikës së mobilieve, 836 dërrasa janë paluar në 4 pako.
Pyetja: _____
Njehsojmë: Përgjigjja: _____

4 Në 6 pako ka 408 tasa kosi. Sa tasa kosi ka në 9 pako të njëjta?
Njehsojmë: 4 0 8 : = ·
Përgjigjja:
Në 1 pako ka: _____
Në 9 pako ka: _____

5 Gjejmë vlerën numerike të shprehjes së dhënë me fjalë: nga prodhimi i numrave 258 dhe 3, zbresim herësin e numrave 978 dhe 3.
Njehsojmë: ·
Shprehja numerike: _____
9 7 8 : =

6 Njehsojmë dhe plotësojmë.
852 → : 6 → • 5 → : 10 → • 6 → : 3 → 142

Ushtrojmë
76

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Punë në grupe

Klasa e ndarë në katër grupe fillojnë zgjidhjen e detyrave 2, 3, 4 dhe 5 dhe të njëjtat detyra pas një kohë prej 10 minutash fillojnë zgjidhjen e tyre në tabelë për të parë se a janë zgjidhur në mënyrë të saktë këto detyra.

2 Nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës janë nisur aeroplanë për Londër, Berlin dhe Budapest. Në secilin aeroplan kishte numër të njëjtë të udhëtarëve. Në zonën e pritjes për nisje ishin 563 udhëtarë. Në pritje mbetën më pak se tre udhëtarë. Nga sa udhëtarë u nisën me secilin aeroplan dhe sa mbetën për fluturimet e tjera?

3 Formulojmë pyetjen, njehsojmë dhe gjejmë përgjigjen.
Në oborrin e fabrikës së mobilieve, 836 dërrasa janë paluar në 4 pako.

4 Në 6 pako ka 408 tasa kosi. Sa tasa kosi ka në 9 pako të njëjta?

Gjejmë vlerën numerike të shprehjes së dhënë me fjalë: nga prodhimi i numrave 258 dhe 3, zbresim herësin e numrave 978 dhe 3.

Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Shqyrtim i përbashkët

Mësimdhënësi/ja bashkë me nxënësin e zgjidhin detyrën 6 në tabelë dhe mësimdhënësi/ja sipas nevojës bën sqarimin e detyrës.

852 → : 6 → • 5 → : 10 → • 6 → : 3 → 142

Po e tregojmë si plotësohet modeli 1.

50 / 21 ? 17 → 50 / 21 X 17 → 50 / X+21 X+17 / 21 X 17

Këtu duhet të vendoset një numër, Cili?

Merret barazimi:

X + 21 + X + 17 = 50
2X + 38 = 50
2X = 12
X = ?

Zgjidhja:

50 / 27 23 / 21 6 17

8 Analizojmë figurat dhe gjejmë sa peshon lepuri dhe sa breshka.

Ushtrojmë

88

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit i zgjidhin në tabelë detyrat 3 dhe 4 si problema me fjalë të lidhura me barazime me mbledhje dhe zbritje.



Nga ky shembull mësimdhënësi/ja duhet të sqarojë, hap pas hapi, qartë, se si vijmë deri te gjetja e të panjohurës nga barazimi me shumëzim.



5 T'i zgjidhim barazimet

X • 6 = 432	20 • X = 640	8 • X = 968
X • 5 = 285	10 • X = 600	7 • X = 392
X • 8 = 312	7 • X = 287	X • 5 = 725

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e drejtuar

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që zgjidhjen e barazimeve me pjesëtim ta realizojnë në çifte në fletoret e tyre.

6 T'i zgjidhim barazimet

X : 7 = 124	X : 6 = 124
X : 8 = 368	624 : X = 3
X : 8 = 112	185 : X = 5

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e të panjohurës në detyrat e dhëna dhe zgjidhjen e problemave me fjalë.

Detyrë:

Detyrat 7 dhe 8 (faqe 88).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 143

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave;
Përcakton vlerën e shprehjeve të përbëra numerike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3,14; III/1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5; 2.2; 7.1.



JOBARAZIMET

► Një jobarazi që përmban një apo më shumë shkronja (ndryshore) quhet jobarazim ose inekuacion.

1 T'i gjejmë vlerat e shkronjës X për të cilat jobarazimi 82 + X < 90 shndërrohet në jobarazi të saktë.

82 + X < 90

Për X = 1, 82 + 1 < 90 e saktë
Për X = 2, 82 + 2 < 90 e saktë
Për X = 3, 82 + 3 < 90 e saktë
Për X = 4, 82 + 4 < 90 e saktë
Për X = 5, 82 + 5 < 90 e saktë
Për X = 6, 82 + 6 < 90 e saktë
Për X = 7, 82 + 7 < 90 e saktë
Për X = 8, 82 + 8 < 90 e pasaktë

Vërejmë se, për X = 1, X = 2, X = 3, X = 4, X = 5, X = 6 dhe X = 7, jobarazimi 82 + X < 90 shndërrohet në jobarazi të saktë, d.m.th.

X = 1, X = 2, X = 3, X = 4, X = 5, X = 6 dhe X = 7

janë zgjidhje të jobarazimit 82 + X < 90.

Të mbajmë mend: Zgjidhje e jobarazimit është vlera e ndryshores për të cilën jobarazimi shndërrohet në jobarazi të saktë.

Një jobarazim mund të ketë shumë zgjidhje.

Për X = 8, merret jobarazia 82 + 8 < 90, që është e pasaktë. Pra, X = 8 nuk është zgjidhje e jobarazimit 82 + X < 90.

2 Të provojmë se cilët nga numrat: 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21 janë zgjidhje të jobarazimit X – 12 > 5.

Për X = 16, 16 – 12 > 5 e pasaktë
Për X = 17, 17 – 12 > 5 e pasaktë
Për X = 18, 18 – 12 > 5 e saktë
Për X = 19, 19 – 12 > 5 e saktë
Për X = 20, 20 – 12 > 5 e saktë
Për X = 21, 21 – 12 > 5 e saktë

Pra, numrat 18, 19, 20 dhe 21 janë zgjidhje të jobarazimit X – 12 > 5, kurse numrat 16 dhe 17 nuk janë zgjidhje.

3 Duke plotësuar tabelën, tregojmë se cilët nga numrat e dhënë në tabelë janë zgjidhje të jobarazimit X + 5 > 50.

	Zgjidhjet											
X	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54
X + 5												

Numrat: __, __, __, __, __, __, __, __ dhe 54 janë zgjidhje të jobarazimit X + 5 > 50.

4 Shkruajmë numrat e dhjetëshes së katërt për të cilët jobarazimi është i saktë:

X – 3 < 34 → 31
X – 4 > 29 → 34

Mësojmë

89

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Jobarazimet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përkufizon nocionin jobarazi në shprehje numerike;
- Zgjidh jobarazime me një të panjohur.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Term i ri

Mësimdhënësi/ja ua sqaron nxënësve që një jobarazim që përmban 1 e më shumë shkronja quhet jobarazim ose inekuacion.



JOBARAZIMET

► Një jobarazi që përmban një apo më shumë shkronja (ndryshore) quhet jobarazim ose inekuacion.

1 T'i gjejmë vlerat e shkronjës X për të cilat jobarazimi 82 + X < 90 shndërrohet në jobarazi të saktë.

82 + X < 90

Për X = 1, 82 + 1 < 90 e saktë
Për X = 2, 82 + 2 < 90 e saktë
Për X = 3, 82 + 3 < 90 e saktë
Për X = 4, 82 + 4 < 90 e saktë
Për X = 5, 82 + 5 < 90 e saktë
Për X = 6, 82 + 6 < 90 e saktë
Për X = 7, 82 + 7 < 90 e saktë
Për X = 8, 82 + 8 < 90 e pasaktë

Vërejmë se, për X = 1, X = 2, X = 3, X = 4, X = 5, X = 6 dhe X = 7, jobarazimi 82 + X < 90 shndërrohet në jobarazi të saktë, d.m.th.

X = 1, X = 2, X = 3, X = 4, X = 5, X = 6 dhe X = 7

janë zgjidhje të jobarazimit 82 + X < 90.

Për X = 8, merret jobarazia 82 + 8 < 90, që është e pasaktë. Pra, X = 8 nuk është zgjidhje e jobarazimit 82 + X < 90.

Të mbajmë mend:
Zgjidhje e jobarazimit është vlera e ndryshores për të cilën jobarazimi shndërrohet në jobarazi të saktë.

Një jobarazim mund të ketë shumë zgjidhje.

2 Të provojmë se cilët nga numrat: 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21 janë zgjidhje të jobarazimit X – 12 > 5.

Për X = 16, 16 – 12 > 5 e pasaktë
Për X = 17, 17 – 12 > 5 e pasaktë
Për X = 18, 18 – 12 > 5 e saktë
Për X = 19, 19 – 12 > 5 e saktë
Për X = 20, 20 – 12 > 5 e saktë
Për X = 21, 21 – 12 > 5 e saktë

Pra, numrat 18, 19, 20 dhe 21 janë zgjidhje të jobarazimit X – 12 > 5, kurse numrat 16 dhe 17 nuk janë zgjidhje.

3 Duke plotësuar tabelën, tregojmë se cilët nga numrat e dhënë në tabelë janë zgjidhje të jobarazimit X + 5 > 50.

	Zgjidhjet										
X	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54
X + 5												

Numrat: __, __, __, __, __, __, __, __ dhe 54 janë zgjidhje të jobarazimit X + 5 > 50.

4 Shkruajmë numrat e dhjetëshes së katërt për të cilët jobarazimi është i saktë:

X – 3 < 34 ⟶ 31 ☐ ☐ ☐ ☐ ☐
X – 4 > 29 ⟶ 34 ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

Mësojmë

89

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e orientuar

Për ta kuptuar qartë se si e gjejmë vlerën e të panjohurës X nga jobarazimi, atëherë duhet ta interpretojmë qartë te nxënësit detyrën 1 ku sqaron saktë se si zgjidhet një inekuacion.

Për të kuptuar qartë se nxënësit dijnë ta zgjidhin një inekuacion, atëherë zgjidhim detyrën 3 dhe gjejmë zgjidhjen e jobarazimit.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Shqyrtim i përbashkët

Në fund të mësimit bëjmë një përforcim duke kuptuar nga nxënësit se sa shpejt ata mund ta bëjnë zgjidhjen e një jobarazimi dhe si mund ta kuptojnë zgjidhjen e saktë të tij.
Detyra zgjidhet në tabelë nga dy nxënës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përkufizimin e nocionit jobarazi në shprehje numerike dhe zgjidhjen e jobarazive me një të panjohur.

Detyrë:

Të punohet një detyrë sipas modelit të detyrës 4.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 144

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Grumbullon dhe sistemon të dhënat në tabelën përkatëse;
Lexon dhe analizon të dhënat e grumbulluara.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3,10; III/1,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5; 2.2; 7.1.



PUNA ME TË DHËNAT

GRUMBULLIMI DHE LEXIMI I TË DHËNAVE

1 Të dhënat janë informacione që mblidhen mbi bazën e një ankete apo të një eksperimenti.

Altina ka shënuar çdo ditë të javës sa kompjutera janë servisuar në servisin e babait të saj. Të dhënat e fituara i ka paraqitur në këtë diagram me shtylla.

numri i kompjuterave

shkalla

H M M E P SH D

Duke analizuar diagramin me shtylla, plotësojmë tabelën.

Ditët	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E diel
Nr. i kompjuterave	9						

Plotësojmë fjalitë:

1. Ditën _____ numri i kompjuterave të servisuar ka qenë më i madh.
2. Ditën _____ numri i kompjuterave të servisuar ka qenë më i vogël.
3. Ditën _____ numri i kompjuterave të servisuar ka qenë 8.

Përdorim diagramin (ose tabelën) për t'iu përgjigjur pyetjeve.

1. Sa është numri i përgjithshëm i kompjuterave të servisuar gjatë javës?
   Njehsojmë: _____
   Përgjigjja: _____
2. Sa është numri i kompjuterave të servisuar ditëve të vikendit?
   Njehsojmë: _____
   Përgjigjja: _____
3. Në cilën ditë numri i kompjuterave të servisuar është sa shuma e kompjuterave të servisuar në dy ditë të tjera?
   Njehsojmë: _____
   Përgjigjja: _____

Njehsojmë

90

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Grumbullimi dhe leximi i të dhënave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet të dhënat me tabelë dhe me diagrame;
- Interpreton të dhënat e paraqitura në tabelë dhe diagram.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Meqenëse në këtë orë mësimore do të zhvillohet një temë e re atëherë mësimdhënësi/ja në hyrje duhet të marrë shembuj që lidhen me notat në ditar, p.sh., si mund të organizohen notat 5 që ka klasa, notat 4 e kështu me radhë.



2 Erindi ka ftuar shokët e klasës që së bashku t'i ndihmojnë gjyshit të tij në grumbullimin e mjedrave. Sasinë e mjedrës së grumbulluar, sipas ditëve, ata e paraqitën me tabelën e papërfunduar dhe grafikun e papërfunduar.

Ditët	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
Sasia në kilogramë	290	315		180	

Duke lexuar të dhënat në tabelë, plotësojmë grafikun. Gjithashtu, duke lexuar të dhënat në grafik, plotësojmë tabelën.

Përdorim diagramin (ose tabelën) për t'iu përgjigjur pyetjeve.

3 1. Sa kilogramë mjedra u grumbulluan të mërkurën?
2. Sa kilogramë mjedra u grumbulluan të premten?
3. Për sa është më e madhe sasia e mjedrave të grumbulluara të hënën dhe të mërkurën në krahasim me sasinë e grumbulluar të premten?

Arsimtari ishte i pakënaqur me rezultatin në testin e fundit nga matematika. Me qëllim të përmirësimit të rezultateve, kërkoi nga nxënësit të deklaroheshin nëse ata preferonin të organizonin mësim shtesë. Nxënësit u deklaruan me Po, Jo dhe I papërcaktuar. Rezultatet u shënuan në tabelën e numërimit:

Mësimi shtesë nga matematika	
Po	𝍸 𝍸 I
Jo	III
I papërcaktuar	II

Simbolet e numërimit

I - një
II - dy
III - tre
IIII - katër
𝍸 - pesë

Përdorim tabelën e numërimit për t'iu përgjigjur pyetjeve:

1. Sa nxënës e preferojnë mësimin shtesë nga matematika?
2. Sa nxënës nuk e preferojnë mësimin shtesë nga matematika?
3. Sa është numri i nxënësve që nuk janë deklaruar për mësim shtesë nga matematika?

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e drejtuar

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të hapin librin në faqe 90 dhe te detyra e parë të marrin informacione që mbledhin të dhëna rreth një ankete apo një eksperimenti dhe ta shohin si janë vendosur këto të dhëna.

Nxënësit duke shikuar diagramin e dhënë duhet të përgjigjen në disa nga pyetjet e mëposhtme.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Pyetje/ përgjigje

Mësimdhënësi/ja në kuadër të diagramit të mësipërm krijon edhe disa pyetje shtesë, si:
- Cila ka qenë mesatarja ditore e rregullimit të kompjuterëve brenda javës?
- Sa ka qenë dallimi i servisimit të kompjuterëve ndërmjet ditës së hënë dhe ditës së diel?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e të dhënave në diagram dhe tabelë, si dhe interpretimin e tyre.

Detyrë:

Të punohet një detyrë sipas modelit të detyrës 3.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 145

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Grumbullon dhe sistemon të dhënat në tabelën përkatëse;
Lexon dhe analizon të dhënat e grumbulluara.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3,10; III/1,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5; 2.2; 7.1.



PUNA ME TË DHËNAT

GRUMBULLIMI DHE LEXIMI I TË DHËNAVE

1 Të dhënat janë informacione që mblidhen mbi bazën e një ankete apo të një eksperimenti.
Altina ka shënuar çdo ditë të javës sa kompjutera janë servisuar në servisin e babait të saj. Të dhënat e fituara i ka paraqitur në këtë diagram me shtylla.

Duke analizuar diagramin me shtylla, plotësojmë tabelën.

Ditët	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E diel
Nr. i kompjuterave	9						

Plotësojmë fjalitë:
1. Ditën _____ numri i kompjuterave të servisuar ka qenë më i madh.
2. Ditën _____ numri i kompjuterave të servisuar ka qenë më i vogël.
3. Ditën _____ numri i kompjuterave të servisuar ka qenë 8.

Përdorim diagramin (ose tabelën) për t'iu përgjigjur pyetjeve.
1. Sa është numri i përgjithshëm i kompjuterave të servisuar gjatë javës?
   Njehsojmë: _____
   Përgjigjja: _____
2. Sa është numri i kompjuterave të servisuar ditëve të vikendit?
   Njehsojmë: _____
   Përgjigjja: _____
3. Në cilën ditë numri i kompjuterave të servisuar është sa shuma e kompjuterave të servisuar në dy ditë të tjera?
   Njehsojmë: _____
   Përgjigjja: _____

Mësojmë

90

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Grumbullimi dhe leximi i të dhënave (vazhdim)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet të dhënat me tabelë dhe me diagrame;
- Interpreton të dhënat e paraqitura në tabelë dhe diagram.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Vazhdojmë mësimin e sotëm me zgjidhjen e detyrës 2 dhe në bazë të diagramit dhe tabelës së dhënë i përgjigjemi pyetjeve të paraqitura në librin 3b në faqe 91, detyra 3.



2 Erindi ka ftuar shokët e klasës që së bashku t'i ndihmojnë gjyshit të tij në grumbullimin e mjedrave. Sasinë e mjedrës së grumbulluar, sipas ditëve, ata e paraqitën me tabelën e papërfunduar dhe grafikun e papërfunduar.

Ditët	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
Sasia në kilogramë	290	315		180	

400 350 300 250 200 150 100 50 0

H M M E P

Duke lexuar të dhënat në tabelë, plotësojmë grafikun. Gjithashtu, duke lexuar të dhënat në grafik, plotësojmë tabelën.

Përdorim diagramin (ose tabelën) për t'iu përgjigjur pyetjeve.

1. Sa kilogramë mjedra u grumbulluan të mërkurën?
2. Sa kilogramë mjedra u grumbulluan të premten?
3. Për sa është më e madhe sasia e mjedrave të grumbulluara të hënën dhe të mërkurën në krahasim me sasinë e grumbulluar të premten?

3 Arsimtari ishte i pakënaqur me rezultatin në testin e fundit nga matematika. Me qëllim të përmirësimit të rezultateve, kërkoi nga nxënësit të deklaroheshin nëse ata preferonin të organizonin mësim shtesë. Nxënësit u deklaruan me Po, Jo dhe I papërcaktuar. Rezultatet u shënuan në tabelën e numërimit:

Mësimi shtesë nga matematika	
Po	𝍸 𝍸 |
Jo	|||
I papërcaktuar	||

Simbolet e numërimit: | - një, || - dy, ||| - tre, |||| - katër, 𝍸 - pesë

Përdorim tabelën e numërimit për t'iu përgjigjur pyetjeve:

1. Sa nxënës e preferojnë mësimin shtesë nga matematika?
2. Sa nxënës nuk e preferojnë mësimin shtesë nga matematika?
3. Sa është numri i nxënësve që nuk janë deklaruar për mësim shtesë nga matematika?

Mësojmë

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Veprimtari në dyshe

Për të kuptuar më qartë paraqitjen e të dhënave, mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që në çifte të zgjidhin detyrën 3 dhe në fund t'u përgjigjen pyetjeve rreth këtij diagrami apo tabele.

Arsimtari ishte i pakënaqur me rezultatin në testin e fundit nga matematika. Me qëllim të përmirësimit të rezultateve, kërkoi nga nxënësit të deklaroheshin nëse ata preferonin të organizonin mësim shtesë. Nxënësit u deklaruan me Po, Jo dhe I papërcaktuar. Rezultatet u shënuan në tabelën e numërimit:

Mësimi shtesë nga matematika	
Po	𝍸 𝍸 |
Jo	|||
I papërcaktuar	||

Simbolet e numërimit: | - një, || - dy, ||| - tre, |||| - katër, 𝍸 - pesë

Përdorim tabelën e numërimit për t'iu përgjigjur pyetjeve:

1. Sa nxënës e preferojnë mësimin shtesë nga matematika?
2. Sa nxënës nuk e preferojnë mësimin shtesë nga matematika?
3. Sa është numri i nxënësve që nuk janë deklaruar për mësim shtesë nga matematika?

Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Shqyrtim i përbashkët

Mësimdhënësi/ja krijon një detyrë ku si bazë e të dhënave merren statistikat e notave nga gjysmëvjetori i parë në lëndën e matematikës për të gjithë klasën dhe krijon pyetje, si:

- Sa nota 5 ka klasa?
- Cila notë është më së shumti e përsëritur në klasë në lëndën e matematikës?
- Cila notë është më e ulëta në klasë në lëndën e matematikës?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e të dhënave në tabelë dhe në diagram dhe për interpretimin e tyre.

Detyrë:

Të punohet një detyrë sipas modelit të detyrës 3.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 146

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Grumbullon dhe sistemon të dhënat në tabelën përkatëse;
Lexon dhe analizon të dhënat e grumbulluara.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3,10; III/1,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5; 2.2; 7.1.



PARAQITJA E TË DHËNAVE

1 Në diagramin e papërfunduar janë paraqitur të dhënat që tregojnë numrin e akulloreve me shije të ndryshme të shitura gjatë ditës në një dyqan.

10 9 8 7 6 5 4 3 2 1

legjenda: ☐ paraqet 3 njësi

1. Sa akullore me shije çokollate janë shitur gjatë ditës në dyqan?
2. Sa akullore me shije limoni janë shitur gjatë ditës në dyqan?
3. Në dyqan janë shitur 27 akullore me shije dredhëze. Duke ngjyrosur, e paraqesim këtë në diagram.
4. Sa akullore janë shitur gjatë ditës në dyqan?

Pasi ta përfundojmë diagramin, të dhënat i paraqesim në tabelë.

Lloji i akullores	Me shije limoni	Me shije çokollate	Me shije dredhëze
Sasia e shitur			

2 Ky diagram paraqet numrin e vizitorëve të pavijonit të librave për fëmijë, në panairin e librit, nga e hëna deri të premten.

400 350 300 250 200 150 100 50 0

H M M E P

Përdorim diagramin për t'iu përgjigjur pyetjeve.

1. Sa vizitorë vizituan pavijonin e librave për fëmijë të martën?
2. Sa vizitorë më shumë vizituan pavijonin e librave për fëmijë të premten se të enjten?
3. Në cilën ditë pati më së paku vizitorë?
4. Në cilën ditë numri i vizitorëve ishte po aq sa edhe të hënën?
5. Në cilën ditë numri i vizitorëve ishte sa dyfishi i vizitorëve të ditës së mërkurë?

Mësojmë

92

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Paraqitja e të dhënave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet të dhënat në tabelë dhe me diagrame;
- Analizon të dhënat e grumbulluara;
- Interpreton të dhënat e paraqitura në tabelë dhe diagram.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Në fazën hyrëse të mësimit bëhet një përsëritje nga mësimi i kaluar; më shumë duhet të ndalemi te vendosja e të dhënave në rreshta dhe në shtylla.



3 Në fund të vitit shkollor, suksesi i nxënësve të shkollës fillore **Emrush Gashi** është dhënë me tabelën:

	Shkolla fillore Emrush Gashi				
Suksesi	Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Përsëritës
Nr. i nxënësve	115	102	147	140	13

Të dhënat e paraqitura me tabelën e mësipërme po i paraqesim me anën e diagramit me shtylla horizontale.

titulli i institucionit

Nxënësit e shkollës fillore **Emrush Gashi**

Shkëlqyeshëm
Shumë mirë
Mirë
Mjaftueshëm
Përsëritës

suksesi

0 20 40 60 80 100 120 140 160 180

numri i nxënësve

Vërejmë se:

- Një diagram ka emrin dhe llojin e të dhënave.
- Një diagram ka shkallë, e cila na tregon se çka paraqet largesa mes rreshtave.
- Një diagram mund të jetë horizontal ose vertikal.

Diskutojmë për atë pse të dhënat paraqiten më lehtë me tabelë, kurse krahasohen më lehtë me diagram.

4 Në një shitore frutash gjatë javës janë shitur 330 kilogramë mollë, 280 kilogramë dardha, 80 kilogramë mandarina dhe 40 kilogramë limonë. Formojmë tabelën me të dhënat e shitjes.

Frutat	Mollë	Dardha	Mandarina	Limonë
Nr. në kilogram				

Këto të dhëna i paraqesim me diagram.

Mollë
Dardha
Mandarina
Limonë

0 50 100 150 200 250 300 350 400

Mësojmë

93

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e orientuar

Në këtë fazë të orës udhëzojmë nxënësit që me kujdes ta vështrojnë diagramin në detyrën 1 dhe t'i përgjigjen pyetjeve, e në fund t'i plotësojnë të dhënat në tabelë.

Udhëzohen nxënësit që në mënyrë individuale të zgjidhin detyrën 2 në fletoret e tyre duke iu përgjigjur pyetjeve të ndërlidhura me diagramin e mësipërm.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Punë e pavarur

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që në libër, faqe 93 të zgjidhin detyrën 3 dhe pas disa minutave zgjidhje e diskutojmë atë detyrë për saktësinë e saj.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e të dhënave në tabelë dhe diagrame, analizën e të dhënave dhe përshkrimin, komentimin e të dhënave të paraqitura.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 93).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 147

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Grumbullon dhe sistemon të dhënat në tabelën përkatëse;
Lexon dhe analizon të dhënat e grumbulluara.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3,10; III/1,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5; 2.2; 7.1.



5 Është matur gjatësia e nxënësve të klasave të dyta. Rezultatet janë shkruar në këtë tabelë numërimi.

Gjatësia e nxënësve në centimetra	
deri në 115	𝍸 𝍸 ||
116 – 120	𝍸 𝍸 𝍸
121 – 125	𝍸 𝍸 𝍸 𝍸 ||
126 – 130	𝍸 𝍸 𝍸 ||||
mbi 130	𝍸 |||

Simbolet e numërimit: \| - një; \|\| - dy; \|\|\| - tre; \|\|\|\| - katër; 𝍸 - pesë

Këto të dhëna nga piktografi i paraqesim me tabelë.

Gjatësia (cm)	deri në 115	116 - 120	121 - 125	126 - 130	mbi 130
Nr. i nxënësve					8

Duke analizuar të dhënat nga tabela, vizatojmë grafikun.

6 Në një shitore, shitja e bukës gjatë një jave është paraqitur me tabelë.

Ditët	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E diel
Nr. i bukëve	143	86	104	185	162	201	64

Përdorim tabelën dhe plotësojmë fjalitë.

1. Më shumë bukë janë shiturditën e _____.
2. Të martën dhe të enjten janë shitur ___ + ___ = ____ bukë.
3. Të dielën janë shitur ___ bukë më pak se të mërkurën.
4. Gjatë javës janë shitur ___ + ___ + ___ + ___ + ___ + ___ + ___ = ____ bukë.

Mësojmë

94

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Paraqitja e të dhënave (vazhdim)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet të dhënat në tabelë dhe me diagrame;
- Analizon të dhënat e grumbulluara;
- Interpreton të dhënat e paraqitura në tabelë dhe diagram.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Në pjesën hyrëse të orës, ne së bashku me nxënës i rikujtojmë ato që kemi mësuar nga orët e kaluara dhe japim sqarime shtesë nëse është e nevojshme për nxënësit.



5 Është matur gjatësia e nxënësve të klasave të dyta. Rezultatet janë shkruar në këtë tabelë numërimi.

Gjatësia e nxënësve në centimetra	
deri në 115	𝍸 𝍸 ||
116 – 120	𝍸 𝍸 𝍸
121 – 125	𝍸 𝍸 𝍸 ||
126 – 130	𝍸 𝍸 𝍸 ||||
mbi 130	𝍸 |||

Simbolet e numërimit: | - një; || - dy; ||| - tre; |||| - katër; 𝍸 - pesë

Këto të dhëna nga piktografi i paraqesim me tabelë.

Gjatësia (cm)	deri në 115	116 - 120	121 - 125	126 - 130	mbi 130
Nr. i nxënësve					8

Duke analizuar të dhënat nga tabela, vizatojmë grafikun.

6 Në një shitore, shitja e bukës gjatë një jave është paraqitur me tabelë.

Ditët	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E diel
Nr. i bukëve	143	86	104	185	162	201	64

Përdorim tabelën dhe plotësojmë fjalitë.

1. Më shumë bukë janë shitur ditën e _____.
2. Të martën dhe të enjten janë shitur ___ + ___ = ___ bukë.
3. Të dielën janë shitur ___ bukë më pak se të mërkurën.
4. Gjatë javës janë shitur ___ + ___ + ___ + ___ + ___ + ___ + ___ = ___ bukë.

Mësojmë

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Zgjidhim së bashku me nxënës detyrën 5 për të kuptuar se sa nxënësit mund t'i interpretojnë të dhënat dhe paraqesin ato në diagrame të ndryshme.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Punë e pavarur

Nga detyrat e dhëna mësimdhënësi/ja kërkon që nxënësit në fletoret e tyre, në mënyrë individuale t'i përgjigjen detyrës 6 dhe t'i plotësojnë fjalitë që dalin nga të dhënat në tabelë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e të dhënave në tabelë dhe diagrame, analizën e të dhënave dhe përshkrimin, komentimin e të dhënave të paraqitura.

Detyrë:

Të zgjidhet një detyrë sipas modelit të detyrës 6.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 148

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Grumbullon dhe sistemon të dhënat në tabelën përkatëse;
Lexon dhe analizon të dhënat e grumbulluara.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I/1,2,7; II/3,10; III/1,5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Paraqitja dhe analiza e të dhënave (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet të dhënat në tabelë dhe me diagrame;
- Analizon të dhënat e grumbulluara;
- Përdor piktogramin në zgjidhjen e detyrave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.


1 Nxënësit e klasave të treta, të katërta dhe të pesta kanë vjelë mollë nga një kopsht. Rezultatet e punës së nxënësve janë paraqitur përmes piktografeve.

Sasia e mollëve të vjela

Klasa: e tretë, e katërt, e pestë

Një shportë → 20 kilogramë.

Të dhënat nga piktografi i paraqesim me tabelë.

Klasa	E tretë	E katërt	E pestë
Sasia e mollëve (kg)			

Plotësojmë fjalitë:

1. Klasa e tretë ka vjelë ___ kilogramë mollë.
2. Klasa e tretë dhe klasa e katërt kanë vjelë: ___ + ___ = ___ kilogramë mollë.
3. Klasa e _____ kanë vjelë më së shumti mollë.
4. Klasa e _____ kanë vjelë më së paku mollë.
5. Klasa e pestë ka vjelë ___ kilogramë mollë më shumë se klasa e parë.

2 Në një pemishte, numri i fidanëve sipas llojit është dhënë me diagram.

Lloji i fidanëve: kajsi, pjeshkë, vishnjë, qershi, mollë, kumbull, dardhë

0 10 20 30 40 50 60 70 80 90 100 110 120

Të dhënat nga diagrami i paraqesim në tabelën e mëposhtme:

Lloji i fidanëve	kajsi	pjeshkë	vishnjë	qershi	mollë	kumbull	dardhë
Numri i fidanëve							

Ushtrojmë

95

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Pjesën hyrëse të orës mund ta shfrytëzojmë për një përsëritje të shkurtër të të gjitha detyrave që janë zhvilluar në orët e fundit.



3 Në një garë në lojën me shigjeta, Blerimi, Tesa dhe Arbeni i kanë zënë tri vendet e para. Numri i pikëve të fituara nga ta është dhënë në tabelën e lojës.

Pikët e shënuara		
Blerimi	100 + 200 + 300	
Tesa		
Arbeni		

Të dhënat e fituara paraqitini në diagram:

Lexojmë:

1. Vendin e parë e ka zënë _____ me ___ pikë.
2. Vendin e dytë e ka zënë _____ me ___ pikë.
3. Vendin e tretë e ka zënë _____ me ___ pikë.
4. Tesës i munguan ___ pikë për të ndarë vendin e parë me Arbenin.

4 Nxënësit e klasave të treta kanë mbjellë fidanë në parkun e qytetit. Numrin e fidanëve të mbjellë sipas klasave e kanë paraqitur si më poshtë.

Klasa	Numri i fidanëve të mbjellë
III – 1	
III – 2	
III – 3	
III – 4	
III – 5	

Çelësi: → 10 fidanë

Duke analizuar piktografin, plotësojmë fjalitë:

1. Klasa III–3 ka mbjellë ___ fidanë.
2. Klasa III–1 ka mbjellë ___ fidanë më shumë se klasa III–5.
3. Të gjitha klasat kanë mbjellë ___ fidanë.

Ushtrojmë

96

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Veprimtari e pavarur

Në pjesën kryesore të orës vazhdojmë me detyrën e parë ku nxënësit duhet ta zgjidhin në mënyrë individuale.

3 Nxënësit e klasave të treta, të katërta dhe të pesta kanë vjelë mollë nga një kopsht. Rezultatet e punës së nxënësve janë paraqitur përmes piktografeve.

Të dhënat nga piktografi i paraqesim me tabelë.

Klasa	E tretë	E katërt	E pestë
Sasia e mollëve (kg)			

Plotësojmë fjalitë:

1. Klasa e tretë ka vjelë ___ kilogramë mollë.
2. Klasa e tretë dhe klasa e katërt kanë vjelë: ___ + ___ = ___ kilogramë mollë.
3. Klasa e _____ kanë vjelë më së shumti mollë.
4. Klasa e _____ kanë vjelë më së paku mollë.
5. Klasa e pestë ka vjelë ___ kilogramë mollë më shumë se klasa e parë.

Në detyrën tjetër janë paraqitur disa të dhëna të grumbulluara në një diagram dhe udhëzojmë nxënësit të zgjidhin detyrën 2.



2 Në një pemishte, numri i fidanëve sipas llojit është dhënë me diagram.

Të dhënat nga diagrami i paraqesim në tabelën e mëposhtme:

Lloji i fidanëve	kajsi	pjeshkë	vishnjë	qershi	mollë	kumbull	dardhë
Numri i fidanëve							

Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Veprimtari e pavarur

Në pjesën e fundit të orës, nxënësit në formë individuale në libër, faqe 96 zgjidhin detyrën 3 ku duhet t'i plotësojnë edhe fjalitë e dhëna. Ata marrin përkrahje për zgjidhjen e detyrave gjatë tërë kohës nga mësimdhënësi/ja.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e të dhënave në tabelë dhe diagrame, analizën e të dhënave dhe përshkrimin, komentimin e të dhënave të paraqitura.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 96).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 149

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Probabiliteti

Rezultatet e të nxënit të temës:
Parashikon mundësinë;
Bën provën e mundshme, e pamundshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.1,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Probabiliteti - Njohuri fillestare



PROBABILITETI

NJOHURI FILLESTARE

Qëllimi: do të tregojmë kur një ngjarje është e sigurt, e mundshme, më pak e mundshme ose e pamundshme.

Kuptimet themelore — Probabiliteti

Me fjalë: *Probabiliteti* përshkruan mundësinë (sa është e mundshme) që një ngjarje të ndodhë.

Shembuj:

- është e sigurt që një rruazë të zgjidhet.
- është e mundshme të zgjidhet e kuqe.
- është më pak e mundshme të zgjidhet e kaltër.
- është e pamundshme të zgjidhet e verdhë.

Mundësia që një ngjarje të ndodhë quhet probabilitet i asaj ngjarjeje.

1 Në një qese janë 8 rrathë dore. Njëri nga rrathët është i kaltër, kurse të tjerët të gjelbër. Erina e tërheq rastësisht (pa shikuar) një rreth nga qesja.

- Sa është e mundshme që rrethi i tërhequr të jetë i kaltër?
- Sa është e mundshme që rrethi i tërhequr të jetë i gjelbër?

Përshkruajmë me fjalë:

Në qese ka 1 rreth të kaltër nga 8 rrathë gjithsej. Prandaj, është *më pak e mundshme* që Erinda të tërheqë rrethin e kaltër.

Në qese ka 7 rrathë të kaltër nga 8 rrathë gjithsej. Prandaj, është *e mundshme* që Erinda të tërheqë njërin nga rrathët e gjelbër.

2 Nëse e rrotullojmë spinerin, sa është e mundshme që ai të ndalojë në një shumëfish të numrit 3?

Numrat 3, 6, 9 dhe 12 janë të gjithë shumëfisha të numrit 3. Prandaj, është *e sigurt* që spineri do të ndalojë në një shumëfish të numrit 3.

3 Thana dhe Dioni luajnë një lojë me letra. Dionit i duhet një 4 për ta fituar lojën. Letrat e treguara do të përzihen dhe do të kthehen me fytyrë poshtë në tavolinë. Sa është e mundshme që Dioni të tërheqë një 4?

Meqenëse në stokun e letrave nuk ka letër me numrin 4, është *e pamundshme* që Dioni të tërheqë një 4.

Probabiliteti që Dioni të fitojë lojën është i pamundshëm.

Mësojmë

97

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon ngjarjen e mundshme nga ngjarja e pamundshme;
- Arsyeton rreth ngjarjeve të sigurta, të mundshme, pak të mundshme apo të pamundshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: zari

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Nxënësit nxiten të tregojnë se çfarë ngjarje janë të sigurta të ndodhin në klasë atë ditë, çfarë është e mundshme, më pak e mundshme dhe e pamundshme.
Idetë e tyre shkruhen në tabelë, p.sh.:
E sigurt - mësojmë diçka të re;
E mundshme - marrim notën 5;
Më pak e mundshme - bëjmë 6 orë mësim;
E pamundshme - dalim në klasë të katërt.

PROBABILITETI

NJOHURI FILLESTARE

Qëllimi: do të tregojmë kur një ngjarje është e sigurt, e mundshme, më pak e mundshme ose e pamundshme.

Kuptimet themelore — Probabiliteti

Me fjalë: *Probabiliteti* përshkruan mundësinë (sa është e mundshme) që një ngjarje të ndodhë.

Shembuj:

- është e sigurt që një rruazë të zgjidhet.
- është e mundshme të zgjidhet e kuqe.
- është më pak e mundshme të zgjidhet e kaltër.
- është e pamundshme të zgjidhet e verdhë.



Mundësia që një ngjarje të ndodhë quhet probabilitet i asaj ngjarjeje.

1 Në një qese janë 8 rrathë dore. Njëri nga rrathët është i kaltër, kurse të tjerët të gjelbër. Erina e tërheq rastësisht (pa shikuar) një rreth nga qesja.

- Sa është e mundshme që rrethi i tërhequr të jetë i kaltër?
- Sa është e mundshme që rrethi i tërhequr të jetë i gjelbër?

Përshkruajmë me fjalë:

Në qese ka 1 rreth të kaltër nga 8 rrathë gjithsej. Prandaj, është *më pak e mundshme* që Erinda të tërheqë rrethin e kaltër.

Në qese ka 7 rrathë të kaltër nga 8 rrathë gjithsej. Prandaj, është *e mundshme* që Erinda të tërheqë njërin nga rrathët e gjelbër.

2 Nëse e rrotullojmë spinerin, sa është e mundshme që ai të ndalojë në një shumëfish të numrit 3?

Numrat 3, 6, 9 dhe 12 janë të gjithë shumëfisha të numrit 3. Prandaj, është *e sigurt* që spineri do të ndalojë në një shumëfish të numrit 3.

3 Thana dhe Dioni luajnë një lojë me letra. Dionit i duhet një 4 për ta fituar lojën. Letrat e treguara do të përzihen dhe do të kthehen me fytyrë poshtë në tavolinë. Sa është e mundshme që Dioni të tërheqë një 4?

Meqenëse në stokun e letrave nuk ka letër me numrin 4, është *e pamundshme* që Dioni të tërheqë një 4.

Probabiliteti që Dioni të fitojë lojën është i pamundshëm.

Mësojmë

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Hidhe zarin

Merret një zar dhe paraqitet para nxënësve. Pyeten nxënësit se nga sa pika ka në secilën faqe të tij. Pastaj pyeten se a është e mundshme që kur të hedhim zarin të na bie numri 4. Pse? Pastaj iu bëhet pyetja:

- A është e mundshme të bie numri 10 kur e hedhim zarin? Pse?

Udhëzohen t' hapin librat në njësinë përkatëse dhe të shohin figurën, të lexojnë informacionet dhe të tregojnë se çfarë kuptojnë me fjalën probabilitet.

Detyra 1 - shohin figurën, lexojnë tekstin, përshkruajnë me fjalë mundësinë.

Detyra 2 - arsyetojnë rreth idesë se pse është e sigurt të ndodhë ajo ngjarje.

Detyra 3 - arsyetojnë rreth idesë se pse është e pamundshme të ndodhë ajo ngjarje.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Shkrim i lirë

Në fletore shkruajnë se çfarë është e sigurt, e mundshme, më pak e mundshme apo e pamundshme të kenë në çantat e tyre.

E sigurt

E mundshme

Më pak e mundshme

E pamundshme

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin e ngjarjeve të mundshme nga ato të pamundshme dhe arsyetimin për ngjarjet e sigurta, të mundshme, më pak të mundshme apo të pamundshme.

Detyrë:

Shkruhen nga katër shembuj për mundësinë që të ndodhë ndonjë ngjarje.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 150

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Probabiliteti

Rezultatet e të nxënit të temës:
Parashikon mundësinë;
Bën provën e mundshme, e pamundshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.1,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Eksperimenti dhe rezultatet e pritshme (ngjarjet)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përkufizon termin eksperiment i probabilitetit;
- Analizon rezultatet e eksperimenteve të dhëna;
- Shpjegon mundësinë e ngjarjeve-rezultatave nga eksperimentet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: monedhë, zar

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.



EKSPERIMENTI DHE REZULTATET E PRITSHME (NGJARJET)

Eksperimeti i rastit (eksperimenti i probabilitetit) paraqet eksperiment tek i cili nuk e dimë se çfarë rezultati do të fitohet. P.sh.:

▶ *Hedhja e monedhës*: Kur e hedhim monedhën, nuk e dimë saktësisht se a do të bjerë *numër* apo *fytyrë*.
Rezultatet e pritshme të hedhjes së një monedhe janë: (*F*) - *bie fytyrë* dhe (*N*) - bie numër.
Këto rezultate janë njëlloj të mundshme apo ngjarje me probabilitet të barabartë. Mu për këtë, hedhja e monedhës quhet eksperiment fer.

▶ *Rrokullisja e zarit*: Kur e rrokullisim zarin, nuk e dimë saktësisht se cili numër do të bjerë.
Rezultatet e pritshme të rrokullisjes së një zari janë: bie 1, bie 2, bie 3, bie 4, bie 5 dhe bie 6.
Këto rezultate janë njëlloj të mundshme.
Rënia e një numri çift është gjithashtu një rezultat (ngjarje).

▶ *Rrotullimi i spinerit*: Kur e rrotullojmë spinerin, nuk e dimë saktësisht se në cilën ngjyrë do të ndalojë ai.
Rezultatet e pritshme të rrotullimit të spinerit janë: *spineri ndalon në të kuqe*, *spineri ndalon në të kaltër* dhe *spineri ndalon në të gjelbër*.

1 E hedhim 50 herë një pllakëz me dy faqe. Secilin nga rezultatet e shkruajmë në tabelë.

Eksperimenti me pllakën dyngjyrëshe

Rezultati	Numërimi	Numri
E kuqe		
E verdhë		

Analizojmë rezultatin:
- Sa herë pllakëza ka rënë në të verdhë?
- Sa herë pllakëza ka rënë në të kuqe?
- A janë njëlloj të mundshme rezultatet (ngjarjet) në këtë eksperiment? Sqarojmë.

2 E rrokullisim 50 herë një zar të rregullt. Secilin nga rezultatet e shkruajmë në tabelë.

- Rezultatet nga tabela i paraqesim në një diagram me shtylla.
- A janë njëlloj të mundshme rezultatet (ngjarjet) në këtë eksperiment? Sqarojmë.

Eksperimenti me zar

Rezultati	Numërimi	Numri
1		
2		
3		
4		
5		
6		

Mësojmë

98

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Nxënësit nxiten të tregojnë se për çfarë njerëzit bëjnë eksperimente dhe a dihen gjithmonë rezultatet që do të fitohen. Tregojnë ndonjë shembull të ndonjë eksperimenti.

Ata shembuj shkruhen në tabelë, p.sh.:
- mbajtja e topit me këmbë pa e lëshuar në tokë;
- kapërcimi i litarit pa e prekur me trup;
- leximi i një teksti pa asnjë gabim etj.



EKSPERIMENTI DHE REZULTATET E PRITSHME (NGJARJET)

Eksperimeti i rastit (eksperimenti i probabilitetit) paraqet eksperiment tek i cili nuk e dimë se çfarë rezultati do të fitohet. P.sh.:

▶ *Hedhja e monedhës*: Kur e hedhim monedhën, nuk e dimë saktësisht se a do të bjerë *numër* apo *fytyrë*.
Rezultatet e pritshme të hedhjes së një monedhe janë: (*F*) - *bie fytyrë* dhe (*N*) - bie numër.
Këto rezultate janë njëlloj të mundshme apo ngjarje me probabilitet të barabartë. Mu për këtë, hedhja e monedhës quhet eksperiment fer.

▶ *Rrokullisja e zarit*: Kur e rrokullisim zarin, nuk e dimë saktësisht se cili numër do të bjerë.
Rezultatet e pritshme të rrokullisjes së një zari janë: bie 1, bie 2, bie 3, bie 4, bie 5 dhe bie 6.
Këto rezultate janë njëlloj të mundshme.
Rënia e një numri çift është gjithashtu një rezultat (ngjarje).

▶ *Rrotullimi i spinerit*: Kur e rrotullojmë spinerin, nuk e dimë saktësisht se në cilën ngjyrë do të ndalojë ai.
Rezultatet e pritshme të rrotullimit të spinerit janë: *spineri ndalon në të kuqe*, *spineri ndalon në të kaltër* dhe *spineri ndalon në të gjelbër*.

1 E hedhim 50 herë një pllakëz me dy faqe. Secilin nga rezultatet e shkruajmë në tabelë.

Eksperimenti me pllakën dyngjyrëshe		
Rezultati	Numërimi	Numri
E kuqe		
E verdhë		

Analizojmë rezultatin:
- Sa herë pllakëza ka rënë në të verdhë?
- Sa herë pllakëza ka rënë në të kuqe?
- A janë njëlloj të mundshme rezultatet (ngjarjet) në këtë eksperiment? Sqarojmë.

2 E rrokullisim 50 herë një zar të rregullt. Secilin nga rezultatet e shkruajmë në tabelë.

Eksperimenti me zar		
Rezultati	Numërimi	Numri
1		
2		
3		
4		
5		
6		

- Rezultatet nga tabela i paraqesim në një diagram me shtylla.
- A janë njëlloj të mundshme rezultatet (ngjarjet) në këtë eksperiment? Sqarojmë.

Mësojmë

98

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
D.R.T.A.

Udhëzohen nxënësit t'i hapin librat dhe t'i lexojnë tre shembujt e dhënë nga tre nxënës për eksperimentet e probabilitetit. Bëhen pyetje për të analizuar dhe parashikuar.
Shembulli 1 - Cilat janë rezultatet e pritshme te hedhja e monedhës? Pse quhet ky eksperiment fer?
Shembulli 2 - A e dimë gjithmonë se cili numër do të bjerë kur e rrokullisim zarin? Cilat mund të jenë rezultatet?
Shembulli 3 - Cilat janë rezultatet e pritshme gjatë rrotullimit të spinerit? A mund të ndodhë diçka tjetër?
Bëhen pastaj dy eksperimentet e kërkuara: hedhja e pllakës me dy faqe ose e monedhës dhe hedhja e zarit. Të gjithë nxënësit hedhin monedhën dhe zarin derisa të shkojë hedhja në 50 herë. Mbajnë shënime dhe rezultatet i shkruajnë në tabelat përkatëse.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e orientuar
Në fletore me një diagram shtyllor paraqesin rezultatet nga tabela e hedhjes së zarit. Sqarojnë me shkrim rezultatet e fituara p.sh.:

Rezultati	Numërimi	Numri
1	///////	7
2	/////	5
3	//////////	10
4	////////	8
5	///////////	11
6	/////////	9

Gjatë hedhjes së zarit ka pasur mundësi të barabarta për të rënë secili numër, por më së shumti ka rënë numri 5 e më së paku numri 2.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në pëkufizimin e termit eksperiment i probabilitetit, analizimin dhe shpjegimin e mundësisë së ngjarjeve-rezultateve nga eksperimentet.

Detyrë:

Të paraqiten rezultatet në tabelë të hedhjes së zarit pesë herë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 151

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Probabiliteti

Rezultatet e të nxënit të temës:
Parashikon mundësinë;
Bën provën e mundshme, e pamundshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.1,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Eksperimenti dhe rezultatet e pritshme (ngjarjet) (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përshkruan mundësinë e ndodhjes së ngjarjes;
- Shpjegon kur ngjarja është më pak e mundshme apo e mundshme të ndodhë.


1 Mbi tavolinë janë 7 letra me shkronja si në figurë. Letrat u përzien dhe u kthyen me fytyrë poshtë në tavolinë. Nëse një shkronjë zgjidhet rastësisht:
• përshkruani probabilitetin që ajo të jetë shkronja S.
• përshkruani probabilitetin që ajo të jetë shkronja R.
S S S S S R M
2 Pas rrotullimit të spinerit, përshkruajmë probabilitetin që ai të ndalojë:
• në fushën me numrin 4
• në fushën me numrin 6 e mundshme
• në fushën me numrin 3
• në fushën me shumëfish të numrit 3
6 6 6 6 3
3 Është dhënë një spiner si në figurë. Nëse spinerin e rrotullojmë, tregoni se:
• në cilën ngjyrë është më pak e mundshme të ndalojë.
• në cilën ngjyrë është e mundshme të ndalojë.
• si duhet t'i ndryshojmë ngjyrat e spinerit në mënyrë që të jetë e sigurt se ai do të ndalojë në të kaltrën.
4 Lina ka 7 kube mbi tavolinë. Ajo mbylli sytë dhe tërhoqi një kub. Përshkruajmë probabilitetin që kubi i tërhequr të jetë i gjelbër.
5 Në një qese janë 8 topa. Një top e tërheqim rastësisht. Duke plotësuar fjalitë, përshkruajmë sa është probabiliteti që një ngjarje të ndodhë:
• _____ që një top do të tërhiqet.
• _____ që një top i kuq të tërhiqet.
• _____ që topi i gjelbër të tërhiqet.
• _____ që një top i kaltër të tërhiqet.
Ushtrojmë
99

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Pesëvargësh

Nxënësit nxiten të kujtojnë për ato që kanë mësuar rreth probabilitetit dhe të krijojnë një pesëvargësh individualisht. Pasi të kryejnë detyrën e dhënë disa nxënës lexojnë atë që kanë shkruar. Për të ndihmuar të tjerët që nuk kanë arritur të kryejnë detyrën, mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë një pesëvargësh me idetë që japin nxënësit, p.sh.:

Probabiliteti
I madh I vogël
Parashikohet Arsyetohet Përshkruhet
Probabiliteti paraqitet me anë të eksperimenteve
Mundësia



1 Mbi tavolinë janë 7 letra me shkronja si në figurë. Letrat u përzien dhe u kthyen me fytyrë poshtë në tavolinë. Nëse një shkronjë zgjidhet rastësisht:

S S S S S R M

- përshkruani probabilitetin që ajo të jetë shkronja S.
- përshkruani probabilitetin që ajo të jetë shkronja R.

2 Pas rrotullimit të spinerit, përshkruajmë probabilitetin që ai të ndalojë:

- në fushën me numrin 4
- në fushën me numrin 6 — *e mundshme*
- në fushën me numrin 3
- në fushën me shumëfish të numrit 3

6 6 6 6 3

3 Është dhënë një spiner si në figurë. Nëse spinerin e rrotullojmë, tregoni se:

- në cilën ngjyrë është më pak e mundshme të ndalojë.
- në cilën ngjyrë është e mundshme të ndalojë.
- si duhet t'i ndryshojmë ngjyrat e spinerit në mënyrë që të jetë e sigurt se ai do të ndalojë në të kaltrën.

4 Lina ka 7 kube mbi tavolinë. Ajo mbylli sytë dhe tërhoqi një kub. Përshkruajmë probabilitetin që kubi i tërhequr të jetë i gjelbër.

5 Në një qese janë 8 topa. Një top e tërheqim rastësisht. Duke plotësuar fjalitë, përshkruajmë sa është probabiliteti që një ngjarje të ndodhë:

- _____ që një top do të tërhiqet.
- _____ që një top i kuq të tërhiqet.
- _____ që topi i gjelbër të tërhiqet.
- _____ që një top i kaltër të tërhiqet.

Ushtrojmë

99

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
D.R.T.A.

Udhëzohen t'i hapin librat dhe të lexojnë kërkesën te detyra 1. Bëhen pyetje për të analizuar dhe parashikuar.
Sa letra janë me shkronjën S? Po me shkronjën R? Cila nga shkronjat ka më shumë mundësi të zgjidhet? Pse? Përshkruajnë probabilitetin për të dy rastet.
Lexohet kërkesa te detyra 2. Pyeten nxënësit: A është numri 4 në këtë spiner? A ka mundësi që spineri të ndalojë te ky numër? Cilët janë shumëfishat e numrit 3? Sa është e mundshme që spineri të ndalojë te numri 3? Po te shumëfishat e numrit 3? Pse? Përshkruajnë probabilitetin me fjalë.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Të pavarur dhe individualisht do të punojnë detyrat 4 dhe 5 ku do të përshkruajnë me fjalë sa është probabiliteti të ndodhin ngjarjet përkatëse. Lexojnë përshkrimet para të tjerëve.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e mundësisë së ndodhjes së ngjarjes dhe shpjegimin kur ngjarja është më pak e mundshme apo e mundshme të ndodhë.

Detyrë:

Detyra 3 (faqe 99).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 152

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Thyesat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pjesën e një tërësie;
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi në zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3; III.1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4,5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Thyesat si pjesë të barabarta të një tërësie

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet numrat thyesorë - thyesat;
- Cakton pjesën e një tërësie;
- Paraqet përmes ilustrimit - ngjyrosjes thyesat e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Organizues grafik

Nxënësit nxiten t'i tregojnë të gjitha idetë që i kanë në mend për thyesat të cilat i kanë mësuar në klasën e dytë.
Idetë e tyre shkruhen në tabelë në formë të organizuesit grafik.


THYESAT

THYESAT SI PJESË TË BARABARTA TË NJË TËRËSIE

1 E ndajmë një picë në pjesë të barabarta.

Të mbajmë mend:
Një thyesë paraqet një apo më shumë pjesë të barabarta të një tërësie.

Një nga dy pjesët e barabarta (gjysma).
Shkruajmë: $\frac{1}{2}$
Lexojmë: një e dyta.

Tri nga katër pjesët e barabarta.
Shkruajmë: $\frac{3}{4}$
Lexojmë: tri të katërtat.

Një nga katër pjesët e barabarta (çereku).
Shkruajmë: $\frac{1}{4}$
Lexojmë: një e katërta.

2 Ngjyrosi vetëm rrathët e figurave që tregojnë çerekun (një të katërtën), ndërsa lëri të pangjyrosura rrathët e figurave që tregojnë gjysmën.

3 Ngjyrosim gjysmën (një të dytën) e figurës.

4 Ngjyrosim çerekun (një të katërtën) e figurës:

Mësojmë

100



Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Nxënësve iu shpërndahen fletë A4 me ngjyra të ndryshme. Secila fletë është e ndarë me vizatim në gjashtë pjesë të barabarta. Në anën e pasme të fletës shkruhen udhëzimet p.sh., ngjyros një nga gjashtë pjesët dhe paraqit pjesën e ngjyrosur me thyesë etj. Pasi të kryejnë këtë veprim, nxënësit me ngjyrë të njëjtë të fletës mblidhen dhe diskutojnë. Tregojnë para të tjerëve sa pjesë kanë ngjyrosur dhe cila thyesë tregon atë. Përmenden emërtimet numërues - sa pjesë u ngjyrosën dhe emërues - në sa pjesë ishte ndarë.
Nxënësit udhëzohen te detyra 1 t'i shohin figurat dhe lexojnë sqarimet. Kuptojnë që thyesa mund të paraqesë vetëm pjesë të barabarta të një tërësie. Te detyra 2 udhëzohen t'i ngjyrosin rrathët te figurat ku tregohet çereku. Te detyra 3 dhe 4 udhëzohen t'i ngjyrosin gjysmën dhe çerekun e figurave. Detyra 5 ka karakter informues andaj këtu duhet të jepen sqarime nga mësimdhënësi/ja.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Nxënësit punojnë të pavarur detyrën 7. Tregojnë se në sa pjesë është ndarë figura dhe si quhet ai numër, sa pjesë janë të ngjyrosura me të verdhë e sa me të gjelbër dhe si quhen ata numra. Pastaj ngjyrosin aq pjesë sa tregon thyesa para figurës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e numrave thyesorë, caktimin e pjesës së një tërësie dhe paraqitjen e tyre përmes vizatimit.

Detyrë:

Detyra 6 (faqe 103).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 153

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Thyesat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pjesën e një tërësie;
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi në zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7 ; II.3 ; III.1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4,5; 2.2; 7.1.



THYESAT EKUIVALENTE (TË BARABARTA)

1 Të shkruajmë thyesën që tregon pjesën e ngjyrosur të figurës.

$\frac{1}{2}$ $\frac{1}{2} = \frac{\ }{\ }$ $\frac{1}{2} = \frac{\ }{\ }$ $\frac{1}{2} = \frac{\ }{\ }$ $\frac{1}{2} = \frac{\ }{\ }$

Pra, thyesat: $\frac{1}{2}$, $\frac{2}{4}$, $\frac{4}{8}$, $\frac{3}{6}$, $\frac{5}{10}$ emërtohen dhe shkruhen ndryshe, por tregojnë të njëjtën pjesë të një tërësie.

*Dy apo më shumë thyesa që paraqesin të njëjtën pjesë të një tërësie quhen **thyesa ekuivalente**.*

2 Shkruajmë dy thyesa (ekuivalente) që tregojnë pjesën e ngjyrosur të figurës.

$\frac{4}{8} = \frac{\ }{2}$ $\frac{\ }{8} = \frac{3}{\ }$ $\frac{\ }{6} = \frac{1}{\ }$ $\frac{4}{\ } = \frac{\ }{3}$

3 Ngjyrosim pjesën e figurës që tregon thyesa, pastaj shkruajmë edhe një thyesë tjetër ekuivalente me thyesën e dhënë.

$\frac{2}{4} = \frac{\ }{\ }$ $\frac{3}{6} = \frac{\ }{\ }$ $\frac{4}{8} = \frac{\ }{\ }$ $\frac{5}{10} = \frac{\ }{\ }$

Mësojmë

102

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Thyesat ekuivalente (të barabarta)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet numrat thyesorë - thyesat;
- Cakton pjesën e një tërësie;
- Shkruan thyesë ekuivalente me thyesën e dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Punë praktike

Nxënësit marrin nga një rreth prej letre dhe e palosin në gjysmë me ç'rast krijohen dy pjesë të barabarta. Njërën nga këto dy pjesë e ngjyrosin. Nxiten të tregojnë se çfarë ngjyrosën dhe si paraqitet me thyesë ajo pjesë. Të njëjtën fletë e palosin prapë duke krijuar katër pjesë të barabarta. Tregojnë a ndryshoi madhësia e pjesës së ngjyrosur, a ndryshoi numri i pjesëve dhe a ndryshoi thyesa që paraqet ato pjesë të ngjyrosura. Vazhdojnë me palosje të tjera dhe pyeten nëse mund të japin ndonjë përfundim për ato që bënë, nëse jo atëherë vazhdohet me punën në libër.





THYESAT EKUIVALENTE (TË BARABARTA)

1 Të shkruajmë thyesën që tregon pjesën e ngjyrosur të figurës.

$\frac{1}{2}$ $\frac{1}{2} = \frac{\quad}{\quad}$ $\frac{1}{2} = \frac{\quad}{\quad}$ $\frac{1}{2} = \frac{\quad}{\quad}$ $\frac{1}{2} = \frac{\quad}{\quad}$

Pra, thyesat: $\frac{1}{2}, \frac{2}{4}, \frac{4}{8}, \frac{3}{6}, \frac{5}{10}$ emërtohen dhe shkruhen ndryshe, por tregojnë të njëjtën pjesë të një tërësie.

Dy apo më shumë thyesa që paraqesin të njëjtën pjesë të një tërësie quhen ***thyesa ekuivalente****.*

2 Shkruajmë dy thyesa (ekuivalente) që tregojnë pjesën e ngjyrosur të figurës.

$\frac{4}{8} = \frac{\quad}{2}$ $\frac{\quad}{8} = \frac{3}{\quad}$ $\frac{\quad}{6} = \frac{1}{\quad}$ $\frac{4}{\quad} = \frac{\quad}{3}$

3 Ngjyrosim pjesën e figurës që tregon thyesa, pastaj shkruajmë edhe një thyesë tjetër ekuivalente me thyesën e dhënë.

$\frac{2}{4} = \frac{\quad}{\quad}$ $\frac{3}{6} = \frac{\quad}{\quad}$ $\frac{4}{8} = \frac{\quad}{\quad}$ $\frac{5}{10} = \frac{\quad}{\quad}$

Mësojmë

102

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Të nxënit në bashkëpunim

Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe te detyra 1 t'i shohin figurat dhe të shkruajnë thyesën që tregon pjesën e ngjyrosur. Pyeten:
- Cila pjesë është ngjyrosur te të gjitha figurat?
- A paraqitet gjysma në të gjitha figurat me të njëjtën thyesë? Sqarohet se thyesat që paraqesin pjesë të njëjtë të tërësisë edhe pse shkruhen dhe emërtohen ndryshe, quhen thyesa ekuivalente ose të barabarta.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Të pavarur punojnë detyrën 2. Janë dhënë figurat me pjesët e ngjyrosura. Atë pjesë nxënësit e paraqesin me thyesë e pastaj gjejnë dhe shkruajnë edhe një thyesë tjetër që është ekuivalente me të. Për këtë ndihmohen nga prezenca e numëruesit apo emëruesit të cilët janë dhënë. Tregojnë para klasës se cilat thyesa i kanë gjetur.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e thyesave, caktimin e pjesës së një tërësie dhe shkrimin e thyesave ekuivalente me thyesën e dhënë.

Detyrë:

Detyra 3 (faqe 102).

Reflektim për vrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 154

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Thyesat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pjesën e një tërësie;
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi në zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3 ; III.1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4,5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Thyesat ekuivalente (të barabarta) (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet thyesat si figurë dhe anasjelltas;
- Shkruan thyesat ekuivalente me thyesat e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Së pari diskutohet rreth detyrës së shtëpisë. Nxënësit tregojnë se çfarë kanë vërejtur pasi që kanë ngjyrosur pjesën e figurës që ka treguar thyesa e dhënë.
Pyeten:
- Çfarë mund të përfundojmë lidhur me këto thyesa?
- Çfarë janë thyesat e barabarta?

$$\frac{1}{2} = \frac{2}{4} = \frac{3}{6} = \frac{4}{8} = \frac{5}{10}$$




1 Pjesët e ngjyrosura të figurave i shprehim me thyesa.

2 Ngjyrosim atë pjesë të figurës që e tregon thyesa.

3 Shkruajmë dy thyesa ekuivalente që tregojnë pjesët e ngjyrosura të figurave.

Ushtrojmë

103

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i pëbashkët

Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe te detyra 1 t'i shohin figurat dhe të shkruajnë thyesën që tregon pjesën e ngjyrosur. Pyeten:
- A janë ndonjë nga thyesat që shkruat të barabarta me njëra-tjetrën? Pse?
Detyra 2. Ngjyrosin pjesët e figurës që tregon thyesa. Veçohet njëra prej tyre p.sh., 3/4 dhe rikujtojnë si quhen pjesët përbërëse të këtij numri thyesor, pasi duhet të bëjnë pjesë të fjalorit matematikor termat numërues, emërues dhe me vijë thyesore.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Të pavarur punojnë detyrën 3. Te secila figurë është paraqitur me thyesë pjesa e ngjyrosur. Atë pjesë nxënësit e paraqesin me thyesë tjetër që është ekuivalente me të parën. Për këtë ndihmohen nga mësimdhënësi/ja duke i këshilluar që t'i ndajnë me laps pjesët e ngjyrosura nga të tjerat apo dy nga dy. Tregojnë para klasës se cilat thyesa i kanë gjetur.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e thyesave si figurë ose anasjelltas dhe shkrimin e thyesave ekuivalente me thyesat e dhëna.

Detyrë:

Shkruhen tri thyesa ekuivalente njëra me tjetrën.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 155

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Thyesat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pjesën e një tërësie;
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi në zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3 ; III.1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4,5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Caktimi i pjesës së një tërësie

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet numrat thyesorë - thyesat;
- Cakton pjesën e një tërësie;
- Krahason thyesat me emërues e numërues të njëjtë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Me anë të pyetjeve dhe përgjigjeve të shpejta bëhet një përsëritje e njohurive që kanë për thyesat deri në këtë fazë, p.sh.:
- Çfarë janë thyesat?
- Çfarë paraqesin thyesat?
- Cilat thyesa quhen të barabarta?
- Nga çka përbëhet një thyesë?
- Çfarë tregojnë numëruesi e emëruesi?



5 Në figurë, 24 rrathë janë të renditur në 6 rreshta dhe 4 shtylla.

Është ngjyrosur $\frac{1}{2}$ e rrathëve — $\frac{1}{2}$ e 24 = 12, 24 : 2 = 12

Është ngjyrosur $\frac{1}{3}$ e rrathëve — $\frac{1}{3}$ e 24 = 8, 24 : 3 = 8

Janë ngjyrosur $\frac{3}{4}$ e rrathëve — $\frac{3}{4}$ e 24 = 18, (24 : 4) • 3 = 18

Janë ngjyrosur $\frac{5}{8}$ e rrathëve — $\frac{5}{8}$ e 24 = 15, (24:8) • 5 = 15

Për të përcaktuar pjesën e një numri, atë e pjesëtojmë me emëruesin e thyesës e pastaj e shumëzojmë me numëruesin.

$\frac{3}{4}$ e 60 = (60 : 4) • 3

Të mbajmë mend:
Vija thyesore luan rolin e njëjtë sikur shenja e pjesëtimit

6 Të gjejmë pjesën e një numri.

$\frac{1}{3}$ e 9 = ☐ ose 9 : 3 = ☐ $\frac{1}{6}$ e 480 = ☐ ose 480 : 6 = ☐

$\frac{1}{3}$ e 360 = ☐ ose 360 : 3 = ☐ $\frac{1}{5}$ e 250 = ☐ ose 250 : 5 = ☐

7 Tomori ka vizatuar një segment duke ditur se $\frac{1}{3}$ e segmentit është 3 cm. Si e vizatoi Tomori segmentin?

Nëse $\frac{1}{3}$ e segmentit është 3 cm, gjatësia e segmentit është:

3 • 3 cm = 9 cm

3 cm (1/3) 3 cm (1/3) 3 cm (1/3)

Mësojmë

105

Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Shqyrtim i përbashkët

Së pari u sqarohet edhe një herë fjala tërësi që është diçka e plotë e që mund të ndahet në pjesë, të cilat vetëm nëse janë të barabarta formojnë thyesa.

Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe te detyra 1 t'i shohin figurat dhe të përshkruajnë mënyrën e ndarjes së tortës. Edhe pse ajo është ndarë në dy, katër apo tetë pjesë, asnjë pjesë nuk është hequr, ende është e plotë. Por tani tortën e plotë mund ta paraqesim si thyesë që ka numëruesin dhe emëruesin e njëjtë. Tërësinë (numrin 1) e ndarë e paraqesim si thyesë.



$$1=\frac{2}{2}\ \frac{4}{4}\ \frac{8}{8}$$

Numri 1 mund të shkruhet si thyesë me numërues dhe emërues të barabartë.

Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Veprimtari e pavarur

Të pavarur punojnë detyrat 2 dhe 4. Në detyrën 2 te secila figurë duhet të paraqitet me thyesë pjesa e ngjyrosur. Tërësia paraqitet me thyesë me numërues e emërues të njëjtë.

Detyra 4 është pak më e ndërlikuar dhe nevojitet ndihma dhe sqarimi nga ana e mësimdhënësit/es.

Për t'u bërë një e plotë duhet të bëhen bashkë dy nga dy pjesë të ndara, katër nga katër pjesë të ndara apo tetë nga tetë pjesë të ndara. Plotësohen barazimet në të djathtë duke u bazuar në figurë nga vetë nxënësit.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e thyesave, caktimin e pjesës së një tërësie dhe krahasimin e thyesave me emërues e numërues të njëjtë.

Detyrë:

Detyra 3 (faqe 104).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 156

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Thyesat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pjesën e një tërësie;
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi në zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3 ; III.1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4,5; 2.2; 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Caktimi i pjesës së një tërësie

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet figurat e dhëna në formë thyese;
- Shkruan thyesa të ndryshme që tregojnë një tërësi;
- Cakton pjesën e një tërësie.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Organizues grafik

Në mes të tabelës shkruhet termi *Tërësia* dhe kërkohet nga nxënësit të japin mendimet e tyre lidhur me të. Idetë e nxënësve shkruhen rreth termit të dhënë. Nxiten për të dhënë ide me anë të pyetjeve, p.sh.:
- Çfarë është tërësia?
- Me cilin numër të plotë paraqitet ajo?
- A mund të ndahet tërësia?
- Me çfarë thyesash mund të paraqitet tërësia?




CAKTIMI I PJESËS SË NJË TËRËSIE

1 Tërësinë e ndarë në pjesë të barabarta (numrin 1) e shkruajmë në formë të thyesës.

1 = 2/2 1 = — 1 = —

Numri 1 mund të shkruhet si thyesë me emërues dhe numërues të barabartë.

2 Sasinë e ujit në gotë e paraqesim në formë thyese.

1/6 6/6 = 1

3 Të shkruajmë thyesa të ndryshme që tregojnë një tërësi (numrin 1).

= 1 = 1 = 1 = 1

4 Vështrojmë figurën dhe plotësojmë barazitë.

1 = 2/2 = 4/□ = □/8

1/2 = □/4 = 4/□

1/4 = □/8

3/4 = □/8

Mësojmë

104



5 Në figurë, 24 rrathë janë të renditur në 6 rreshta dhe 4 shtylla.

Është ngjyrosur $\frac{1}{2}$ e rrathëve — $\frac{1}{2}$ e 24 = 12, sepse 24 : 2 = 12

Është ngjyrosur $\frac{1}{3}$ e rrathëve — $\frac{1}{3}$ e 24 = 8, sepse 24 : 3 = 8

Janë ngjyrosur $\frac{3}{4}$ e rrathëve — $\frac{3}{4}$ e 24 = 18, sepse (24 : 4) • 3 = 18

Janë ngjyrosur $\frac{5}{8}$ e rrathëve — $\frac{5}{8}$ e 24 = 15, sepse (24:8) • 5 = 15

Për të përcaktuar pjesën e një numri, atë e pjesëtojmë me emëruesin e thyesës e pastaj e shumëzojmë me numëruesin.

$\frac{3}{4}$ e 60 = (60 : 4) • 3

Të mbajmë mend:
Vija thyesore luan rolin e njëjtë sikur shenja e pjesëtimit

6 Të gjejmë pjesën e një numri.

$\frac{1}{3}$ e 9 = ☐ ose 9 : 3 = ☐ $\frac{1}{6}$ e 480 = ☐ ose 480 : 6 = ☐

$\frac{1}{3}$ e 360 = ☐ ose 360 : 3 = ☐ $\frac{1}{5}$ e 250 = ☐ ose 250 : 5 = ☐

7 Tomori ka vizatuar një segment duke ditur se $\frac{1}{3}$ e segmentit është 3 cm. Si e vizatoi Tomori segmentin?

Nëse $\frac{1}{3}$ e segmentit është 3 cm, gjatësia e segmentit është:

3 • 3 cm = 9 cm

3 cm (1/3) 3 cm (1/3) 3 cm (1/3)

Mësojmë

105

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe t'i shohin figurat dhe të përshkruajnë mënyrën e ndarjes së rrathëve.
Në secilën numri i rrathëve është i njëjtë, 24, dhe i ndarë në 6 rreshta e 4 shtylla, por ngjyrosja e tyre ndryshon. Sqarohet për nxënësit që për të gjetur gjysmën e tërësisë, ajo pjesëtohet me 2, për të gjetur një të tretën tërësia pjesëtohet me 3 sepse vija thyesore luan rolin e njëjtë sikur shenja e pjesëtimit.
Nga shembujt e dhënë përfundojmë se:
Për të përcaktuar pjesën e një numri, atë e pjesëtojmë me emëruesin e thyesës e pastaj e shumëzojmë me numëruesin.
3/4 e 24= (24 : 4) 3 = 6 3=18

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Të pavarur punojnë detyrën 6. Gjejnë pjesët e numrave të dhënë. Ua rikujtojmë se nëse numëruesi është 1 nuk ka nevojë të shumëzojmë por vetëm e pjesëtojmë tërësinë (numrin e dhënë) me emëruesin.
Shembull :

$\frac{1}{5}$ e 300 = 300:5=60

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e figurave të dhëna në formë thyese, shkrimin e thyesave të ndryshme që tregojnë një tërësi dhe caktimin e pjesës së një tërësie.

Detyrë:
Detyra 7 (faqe 105).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 157

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Thyesat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pjesën e një tërësie;
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi në zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3 ; III.1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4,5; 2.2; 7.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Caktimi i pjesës së një tërësie (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Cakton pjesën e një tërësie.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim rreth detyrave të shtëpisë

Bashkë me nxënësit diskutohet rreth detyrës 7 nga faqja 105. Pyeten se pse gjatësia e segmentit doli të jetë 9 cm. Nxënësit komentojnë në mënyrën e tyre zgjidhjen e detyrës. Pastaj diskutohen edhe detyrat e tjera të shtëpisë dhe sqarohen në tabelë ato detyra në të cilat kanë hasur në vështirësi.



1 Në figurë janë dhënë 20 rrathë

- $\frac{1}{2}$ e rrathëve e ngjyrosim me të kaltër.
- $\frac{1}{4}$ e rrathëve e ngjyrosim me të kuqe.
- Sa rrathë kanë mbetur pa ngjyrosur?

Duke analizuar figurën pas ngjyrosjes, gjejmë se:

- $\frac{1}{2}$ e numrit 20 është numri _____.
- $\frac{1}{4}$ e numrit 20 është numri _____.

2 Njehsojmë:

$\frac{1}{2}$ e numrit 320 = 320 : 2 = ☐

$\frac{1}{6}$ e numrit 240 = ☐ : ☐ = ☐

$\frac{1}{3}$ e numrit 720 = ☐ : ☐ = ☐

$\frac{1}{8}$ e numrit 640 = ☐ : ☐ = ☐

3 Njehsojmë:

$\frac{1}{2}$ e 1 km = ☐ m $\frac{1}{10}$ e 1 km = ☐ m $\frac{1}{100}$ e 1 km = ☐ m

$\frac{1}{5}$ e 1 kg = ☐ g $\frac{1}{4}$ e 1 kg = ☐ g $\frac{1}{10}$ e 1 kg = ☐ g.

4 Njehsojmë:

$\frac{1}{2}$ e 1 t = ☐ kg $\frac{1}{4}$ e 1 t = ☐ kg $\frac{1}{10}$ e 1 t = ☐ kg

$\frac{1}{4}$ e 1 km = ☐ m $\frac{1}{5}$ e 1 km = ☐ m $\frac{1}{100}$ e 1 km = ☐ m.

Ushtrojmë

106

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Mendo - Puno në dyshe - Thuaja grupit

Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe ta shohin figurën, të lexojnë kërkesën dhe mendojnë për zgjidhjen. Pastaj punojnë së bashku me shokun/shoqen e bankës për të zgjidhur së bashku detyrën. Zgjidhet një nga klasa për të thënë zgjidhjen para të tjerëve. Nëse ndonjë nga dyshet nuk kanë arritur të gjejnë zgjidhjen, ndihmohen nga të tjerët.

$\frac{1}{2}$ e 20 =20:2=10
$\frac{1}{4}$ e 20 = 20:4= 5

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Të pavarur punojnë detyrat 2 dhe 3. Gjejnë pjesët e numrave të dhënë. Ua rikujtojmë se nëse numëruesi është 1 nuk ka nevojë të shumëzojmë por vetëm e pjesëtojmë tërësinë (numrin e dhënë) me emëruesin.

Te detyra 3 nxënësit udhëzohen të kthejnë km ⟶ m ; kg ⟶ g e pastaj t'i gjejnë pjesët e tërësisë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në caktimin e pjesës së një tërësie.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 106).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 158

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Thyesat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pjesën e një tërësie;
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi në zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3 ; III.1, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4,5; 2.2; 7.1.


KRAHASIMI I THYESAVE

1 Thyesat me numërues të njëjtë.

Është ngjyrosur $\frac{1}{4}$ e rrethit

Është ngjyrosur $\frac{1}{6}$ e rrethit

$\frac{1}{4} > \frac{1}{6}$

Nga dy thyesa me numërues të njëjtë, më e madhe është ajo që e ka emëruesin më të vogël.

2 Thyesat me emërues të njëjtë.

Është ngjyrosur $\frac{4}{9}$ e rrethit

Është ngjyrosur $\frac{7}{9}$ e rrethit

$\frac{4}{9} < \frac{7}{9}$

Nga dy thyesa me emërues të njëjtë, më e madhe është ajo që e ka numëruesin më të madh.

3 Ngjyrosim pjesë të figurave dhe krahasojmë thyesat.

$\frac{3}{4} \square \frac{3}{8}$ $\frac{2}{6} \square \frac{5}{6}$

$\frac{2}{5} \square \frac{2}{4}$ $\frac{4}{5} \square \frac{3}{5}$

4 < = > ?

$\frac{1}{8} \square \frac{1}{10}$ $\frac{3}{10} \square \frac{4}{10}$ $\frac{5}{10} \square \frac{8}{8}$ $\frac{8}{8} \square \frac{10}{10}$ $\frac{4}{10} \square \frac{3}{10}$

Mësojmë

107

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krahasimi i thyesave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet thyesat përmes vizatimit;
- Krahason thyesat me emërues të njëjtë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Nxënësve në grupe me nga katër iu shpërndahen fletë A4 me ngjyrë të bardhë. Secila fletë është e ndarë me vizatim në dy, katër, gjashtë apo tetë pjesë të barabarta. Secila fletë ka madhësi të njëjtë. Nxënësit ngjyrosin një prej pjesëve nga fleta që kanë p.sh., njëri një të dytën, tjetri një të katërtën, tjetri një të gjashtën dhe i fundit një të tetën. Pasi t'i kenë ngjyrosur i vendosin fletët njërën afër tjetrës. Cila pjesë ka më shumë hapësirë të ngjyrosur themi që është thyesë më e madhe.





KRAHASIMI I THYESAVE

1 Thyesat me numërues të njëjtë.

Është ngjyrosur $\frac{1}{4}$ e rrethit

Është ngjyrosur $\frac{1}{6}$ e rrethit

$\frac{1}{4} > \frac{1}{6}$

Nga dy thyesa me numërues të njëjtë, më e madhe është ajo që e ka emëruesin më të vogël.

2 Thyesat me emërues të njëjtë.

Është ngjyrosur $\frac{4}{9}$ e rrethit

Është ngjyrosur $\frac{7}{9}$ e rrethit

$\frac{4}{9} < \frac{7}{9}$

Nga dy thyesa me emërues të njëjtë, më e madhe është ajo që e ka numëruesin më të madh.

3 Ngjyrosim pjesë të figurave dhe krahasojmë thyesat.

$\frac{3}{4} \square \frac{3}{8}$ $\frac{2}{6} \square \frac{5}{6}$

$\frac{2}{5} \square \frac{2}{4}$ $\frac{4}{5} \square \frac{3}{5}$

4 < = > ?

$\frac{1}{8} \square \frac{1}{10}$ $\frac{3}{10} \square \frac{4}{10}$ $\frac{5}{10} \square \frac{8}{8}$ $\frac{8}{8} \square \frac{10}{10}$ $\frac{4}{10} \square \frac{3}{10}$

Mësojmë

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Vëzhgo - Analizo - Zbato

Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe t'i shohin figurat dhe të analizojnë se sa pjesë të figurës janë ngjyrosur dhe cila thyesë tregon atë. Po ashtu duke shikuar thyesat tregojnë se çfarë kanë të njëjtë ato thyesa.

1/4 > 1/6

Përfundojmë që nga dy thyesa me numërues të njëjtë më e madhe është ajo me emërues më të vogël.
Te detyra 2 vazhdojnë njëjtë sikur në të parën, analizojnë figurat dhe thyesat, krahasojnë pjesët e ngjyrosura.
Përfundojmë që dy thyesa me emërues të njëjtë më e madhe është ajo me numëruesin më të madh.

4/9 < 7/9

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Të pavarur punojnë detyrat 3. Ngjyrosin pjesët që tregon thyesa dhe në bazë të pjesës së ngjyrosur dhe rregullës së mësuar vendosin shenjën për të treguar se se cila thyesë është më e madhe.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e thyesave përmes vizatimit dhe krahasimin e thyesave me emërues të njëjtë.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 107).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 159

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Thyesat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pjesën e një tërësie;
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi në zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3 ; III.1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4,5; 2.2; 7.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krahasimi i thyesave (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Krahason thyesat me emërues të njëjtë
- Gjen numrin e panjohur që të fitohet jobarazi e saktë

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh
Nxënësve iu drejtohen pyetjet:
- Si krahasohen thyesat me numërues të njëjtë dhe si krahasohen thyesat me emërues të njëjtë?
Nxënësit mendojnë, përgjigjen në pyetje dhe japin ndonjë shembull konkret.
Përgjigjet dhe shembujt shkruhen në tabelë.

Dy thyesa me numërues të njëjtë më e madhe është ajo me emërues më të vogël.
$\frac{1}{2} > \frac{1}{3}$

Dy thyesa me emërues të njëjtë më e madhe është ajo me numëruesin më të madh.
$\frac{2}{5} < \frac{4}{5}$



1 Analizojmë figurat dhe krahasojmë thyesat.

$\frac{4}{5} \square \frac{3}{5}$

$\frac{3}{6} \square \frac{4}{6}$

$\frac{1}{2} \square \frac{3}{6}$

2 Përse $\frac{5}{7}$ është më shumë se $\frac{3}{7}$?

Përgjigjja:

3 Kosovarja ka lexuar $\frac{3}{4}$ e një libri, kurse Erindi $\frac{7}{8}$ e të njëjtit libër. Kush ka lexuar më shumë?

Përgjigjja:

4 Në katror shkruajmë një numër që të fitojmë jobarazi të saktë.

$\square < \frac{2}{7}$ $\quad \frac{1}{5} < \square$ $\quad \square < \frac{7}{8}$ $\quad \square < \frac{8}{10}$ $\quad \frac{3}{6} < \square$

Ushtrojmë

108

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Vëzhgo - analizo - zbato

Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe t'i shohin figurat dhe të analizojnë se sa pjesë të figurës janë ngjyrosur dhe cila thyesë tregon atë. Po ashtu duke shikuar thyesat dhe pjesën e ngjyrosur të figurave tregojnë se cila nga thyesat është më e madhe.

$\frac{4}{5} > \frac{3}{5}$

$\frac{3}{6} < \frac{4}{6}$

$\frac{1}{2} = \frac{3}{6}$

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Të pavarur punojnë detyrat 2 dhe 3. Analizojnë thyesat, krahasojnë pjesët e ngjyrosura, vendosin shenjat dhe japin arsyetimet e veta se pse njëra thyesë është më e madhe apo më e vogël se tjetra.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në krahasimin e thyesave me emëues të njëjtë dhe gjetjen e numrit të panjohur që të fitohet jobarazi e saktë.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 108).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 160

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Thyesat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pjesën e një tërësie;
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi në zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2,7; II.3 ; III.1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4,5; 2.2; 7.1.


MBLEDHJA E THYESAVE ME EMËRUES TË NJËJTË

1 Babai mbolli $\frac{4}{7}$ e arës me misër dhe $\frac{2}{7}$ e arës me perime. Ta shprehim me thyesë pjesën e arës që mbolli ai.
Për të shprehur me thyesë pjesën e arës që mbolli ai, njehsojmë shumën:

$\frac{4}{7} + \frac{2}{7} = \square$

Njehsojmë:
Një mënyrë: Modeli thyesor.

Mënyra tjetër:

$\frac{4}{7} + \frac{2}{7} = \frac{4+2}{7}$ ← mbledhim numëruesit, përshkruajmë emëruesin

$= \frac{6}{7}$

Pra, babai mbolli $\frac{6}{7}$ e arës.

Mbledhja e thyesave me emërues të njëjtë bëhet duke i mbledhur numëruesit, kurse emëruesi përshkruhet.

$\frac{4}{7} + \frac{2}{7} = \frac{4+2}{7} = \frac{6}{7}$

2 Të njehsojmë shumën:

$\frac{2}{5} + \frac{3}{5} = \square$

Një mënyrë: Modeli thyesor.

Mënyra tjetër:

$\frac{2}{5} + \frac{3}{5} = \frac{5}{5} = 1$

Mendojmë $1 = \frac{5}{5}$

Të mbajmë mend:
Nëse një thyesë ka emëruesin dhe numëruesin të barabartë, në vend të tyre shkruajmë numrin 1.

$\frac{5}{5} = 1$

Mësojmë

109

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbledhja e thyesave me emërues të njëjtë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën e thyesave me emërues të njëjtë;
- Shkruan barazi duke analizuar paraqitjen e thyesave në bosht numerik;
- Gjen vlerën e ndryshores x në barazimet e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Para nxënësve paraqiten dy shirita të letrës të ndarë në 6 pjesë të barabarta. Te shiriti i parë janë ngjyrosur tri pjesë të cilat kur paraqiten me thyesë tregojnë thyesën 3/6. Te shiriti i dytë janë ngjyrosur dy pjesë që tregojnë thyesën 2/6. Pyeten nxënësit:
- A paraqet thyesa e parë një tërësi? Po e dyta?
Pastaj pyeten nëse mund të bashkohen këto dy thyesa për ta krijuar një më të madhe. Nxënësit mund të kenë dyshime por mësimdhënësi/ja bashkon pjesë të ngjyrosura te të dyja figurat (shiritat) duke formuar një pjesë më të madhe të figurës apo një thyesë më të madhe.





$\frac{3}{6}+\frac{2}{6}=\frac{3+2}{6}=\frac{5}{6}$ - emëruesi përshkruhet, numëruesit mblidhen.

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Vëzhgo - Analizo - Zbato

Mësimdhënësi/ja lexon tekstin te detyra 1. Udhëzohen nxënësit t'i vëzhgojnë figurat dhe sipas modelit thyesor të kuptojnë se pjesët e tërësisë mund të mblidhen nëse janë të njëjta. Atë çka shohim te modeli thyesor mund ta paraqesim me mënyrë tjetër. Bazuar në të dyja mënyrat vijmë në përfundim se:
Mbledhja e thyesave me emërues të njëjtë bëhet duke i mbledhur numëruesit dhe duke përshkruar emëruesit.
Detyra 2. Duke vëzhguar modelin thyesor shohim se pas bashkimit të këtyre dy thyesave formohet një tërësi dhe pasi janë të ndara në 5 pjesë, pas bashkimit formohet thyesa 5/5 që ka numëruesin dhe emëruesin e barabartë dhe në vend të saj shkruajmë 1.



Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Punë e pavarur

Të pavarur punojnë detyrat 3 dhe 4. Para se të fillojnë u sqarohet se boshti numerik është i ndarë në 9 pjesë të barabarta dhe se çdo hapësirë paraqet 1/9 e tij. Te detyra 4 bazohen te pjesët e ngjyrosura të figurave.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e shumës së thyesave me emërues të njëjtë, shkrimin e barazimeve duke analizuar paraqitjen e thyesave në bosht numerik dhe gjetjen e vlerës së ndryshores x.

Detyrë:

Detyrat 6 dhe 7 (faqe 110).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 161

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Thyesat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pjesën e një tërësie;
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi në zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.5, ; II.4 ; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5; 2.4; 3.2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e thyesave me emërues të njëjtë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet thyesat përmes vizatimit;
- Njehson ndryshimin e thyesave me emërues të njejtë;
- Njehson ndyshimin sipas modelit thyesor dhe modelit tjetër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Para nxënësve paraqitet një shirit letre i ndarë në 6 pjesë të barabarta. Te shiriti janë ngjyrosur 5 pjesë të cilat kur paraqiten me thyesë tregojnë thyesën 5/6.
Pyeten nxënësit:
- A mund ta zvogëlojmë këtë thyesë apo ta zbresim me ndonjë thyesë tjetër? Për të thjeshtuar si mund të ndodhë kjo me një stilolaps vizatohet nga një vijë në dy pjesë të ngjyrosura. Pyeten:
- Sa pjesë mbetën tani?



3 Duke zbatuar paraqitjen e thyesave në boshtin numerik, njehsojmë.

$\frac{7}{10} - \frac{2}{10} = \frac{\square}{\square}$ $\frac{3}{5} - \frac{1}{5} = \frac{\square}{\square}$ $\frac{3}{4} - \frac{1}{4} = \frac{\square}{\square}$

4 Ngjyrosim dhe njehsojmë.

$\frac{3}{4} - \frac{1}{4} = —$ $\frac{6}{7} - \frac{2}{7} = —$ $\frac{5}{8} - \frac{3}{8} = —$ $1 - \frac{5}{8} = —$

5 Njehsojmë.

$\frac{5}{7} - \frac{2}{7} = \frac{\square}{\square}$ $\frac{9}{10} - \frac{2}{10} = \frac{\square}{\square}$ $\frac{8}{11} - \frac{2}{11} = \frac{\square}{\square}$

$\frac{8}{9} - \frac{2}{9} = \frac{\square}{\square}$ $\frac{10}{12} - \frac{1}{12} = \frac{\square}{\square}$ $\frac{7}{14} - \frac{2}{14} = \frac{\square}{\square}$

6 Ta gjejmë vlerën e ndryshores *x*.

$\frac{4}{5} - \frac{x}{5} = \frac{1}{5}$ $x = \square$ $\frac{x}{8} - \frac{2}{8} = \frac{5}{8}$ $x = \square$

7 Erindi bleu një çokollatë. Në shkollë ai hëngri $\frac{3}{5}$ e çokollatës. Sa çokollatë i mbeti atij?

Duhet të njehsojmë $1 - \frac{3}{5}$.

$1 - \frac{3}{5}$ Mendojmë $1 = \frac{5}{5}$

$\frac{5}{5} - \frac{3}{5} = \frac{2}{5}$

Pra, Erindit i mbeti edhe $\frac{2}{5}$ e çokollatës.

Mësojmë

112



$$\frac{5}{6} - \frac{2}{6} = \frac{5-2}{6} = \frac{3}{6}$$

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit udhëzohen ta lexojnë kërkesën e detyrës 1. Ata duhet t'i vëzhgojnë figurat dhe sipas modelit thyesor të kuptojnë se pjesët e tërësisë mund të zbriten nëse janë të njëjta. Atë çka shohim te modeli thyesor mund ta paraqesim me mënyrën tjetër. Bazuar në të dyja mënyrat përfundojmë se:
Zbritja e thyesave me emërues të njëjtë bëhet duke i zbritur numëruesit dhe duke përshkruar emëruesit.

$$\frac{4}{5} - \frac{3}{5} = \frac{4-3}{5} = \frac{1}{5}$$

Detyra 2. Lexohet kërkesa e detyrës. Vëzhgohet boshti numerik i cili është ndarë në tetë pjesë të barabarta, duke formuar thyesën 2/2.

Çdo hapësirë është 1/2 e boshtit. Në vendin ku fillon shigjeta ndodhet thyesa e parë e cila zbritet për aq hapësira sa kalon shigjeta. Fitohen barazimet:

$$\frac{5}{8} - \frac{3}{8} = \frac{2}{8} \quad \text{dhe} \quad \frac{4}{8} - \frac{4}{8} = \frac{0}{8} = 0$$

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Lapsat në mes

Nxënësve u shpërndahet një fletë pune me pesë detyra, në të cilat duhet të llogarisin ndryshimin e thyesave me emëues të njëjtë.
Pas përfundimit, nga grupi tërhiqet një laps dhe nxënësi përgjegjës tregon zgjidhjen e detyrës përkatëse.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e thyesave përmes vizatimit, njehsimin e ndryshimit të thyesave me emërues të njëjtë.

Detyrë:
Zgjidhen katër detyra në lidhje me ndryshimin e thyesave me emërues të njëjtë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 162

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Thyesat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pjesën e një tërësie;
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi në zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.5, ; II.4 ; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5; 2.4; 3.2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e thyesave me emërues të njëjtë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e thyesave me emërues të njëjtë, argumentimin e paraqitjes së tyre në bosht numerik dhe gjetjen e ndryshores x në barazimet e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit udhëzohen që të njehsojnë ndryshimin e dy thyesave me emërues të njëjtë. Pastaj e paraqesin atë në bosht numerik. I shkëmbejnë fletoret dhe secili punon detyrat që ka krijuar shoku/shoqja e bankës. I rikthejnë dhe korrigjojnë punën e njëri-tjetrit.
Nxënësit pyeten:
Si e njehsojmë ndryshimin e thyesave me emërues të njëjtë?
Si mund t'i paraqesim ato në bosht numerik?
Nxënësit nxiten t'i argumentojnë përgjigjet e dhëna.



3 Duke zbatuar paraqitjen e thyesave në boshtin numerik, njehsojmë.

$\frac{7}{10} - \frac{2}{10} = \frac{\square}{\square}$ $\frac{3}{5} - \frac{1}{5} = \frac{\square}{\square}$ $\frac{3}{4} - \frac{1}{4} = \frac{\square}{\square}$

4 Ngjyrosim dhe njehsojmë.

$\frac{3}{4} - \frac{1}{4} = —$ $\frac{6}{7} - \frac{2}{7} = —$ $\frac{5}{8} - \frac{3}{8} = —$ $1 - \frac{5}{8} = —$

5 Njehsojmë.

$\frac{5}{7} - \frac{2}{7} = \frac{\square}{\square}$ $\frac{9}{10} - \frac{2}{10} = \frac{\square}{\square}$ $\frac{8}{11} - \frac{2}{11} = \frac{\square}{\square}$

$\frac{8}{9} - \frac{2}{9} = \frac{\square}{\square}$ $\frac{10}{12} - \frac{1}{12} = \frac{\square}{\square}$ $\frac{7}{14} - \frac{2}{14} = \frac{\square}{\square}$

6 Ta gjejmë vlerën e ndryshores *x*.

$\frac{4}{5} - \frac{x}{5} = \frac{1}{5}$ $x = \square$ $\frac{x}{8} - \frac{2}{8} = \frac{5}{8}$ $x = \square$

7 Erindi bleu një çokollatë. Në shkollë ai hëngri $\frac{3}{5}$ e çokollatës. Sa çokollatë i mbeti atij?
Duhet të njehsojmë $1 - \frac{3}{5}$.

$1 - \frac{3}{5}$ Mendojmë $1 = \frac{5}{5}$

$\frac{5}{5} - \frac{3}{5} = \frac{2}{5}$

Pra, Erindit i mbeti edhe $\frac{2}{5}$ e çokollatës.

Njësojmë

112

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Në këtë njësi do të punohen së pari detyra 6 dhe 7, pasi te këto detyra nxënësit mund të kenë vështirësi dhe në këto dy detyra ka informacione të reja. Detyra 6 përmban dy shembuj ku kemi edhe ndryshoren x. Iu kërkohet nxënësve të rikujtojnë rregullën e zbritjes së thyesave me emërues të njëjtë e pastaj do ta kenë më të lehtë gjetjen e x-it. Duke e ditur që numëruesit zbriten, pyeten se cilin numër duhet t'ia heqim numrit 4 për të fituar 1 (3) prej nga del se x=3.

Te shembulli i dytë gjejnë se cilit numër duhet hequr 2 për të mbetur 5 (7) prej nga del se x=7

Detyra 7. Lexohet kërkesa e detyrës. Për të zbritur një thyesë nga një numër i plotë, në këtë rast nga 1, atëherë numrin 1 duhet ta kthejmë në thyesë me emërues dhe numërues të njëjtë. Në këtë rast, pasi thyesa tjetër e ka emëruesin 5 atëherë edhe numri 1 kthehet në thyesë me emërues 5, respektivisht në thyesën 5/5.

Në tabelë mund t'iu sqarohet kjo zbritje edhe grafikisht.

		X	X	X

$$1 - \frac{3}{5} = \frac{5}{5} - \frac{3}{5} = \frac{2}{5}$$

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Të pavarur punojnë detyrat 3 dhe 4. Te detyra 4 së pari paraqesin thyesat me ngjyrosje të figurës, duke lehtësuar zbritjen e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e ndryshimit të thyesave me emërues të njëjtë, argumentimin e paraqitjes së thyesave në bosht numerik dhe gjetjen e ndryshores x në barazimet e dhëna.

Detyrë:

Detyra 5 (faqe 112).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 163

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Thyesat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Cakton pjesën e një tërësie;
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi në zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.5; II.4 ; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5; 2.4; 3.2.


1 Për modelet e dhëna shkruajmë barazi me mbledhje:

1 Njehsojmë.

$\frac{1}{8}+\frac{4}{8}$ $\frac{1}{6}+\frac{4}{6}$ $\frac{1}{4}+\frac{3}{4}$ $\frac{2}{3}+\frac{1}{3}$

$\frac{1}{3}+\frac{1}{3}$ $\frac{2}{5}+\frac{2}{5}$ $\frac{1}{7}+\frac{4}{7}$ $\frac{3}{9}+\frac{2}{9}$

$\frac{2}{9}+\frac{7}{9}$ $\frac{4}{10}+\frac{6}{10}$ $\frac{2}{10}+\frac{7}{10}$ $\frac{7}{12}+\frac{4}{12}$

3 Një sipërfaqe rrethore është ndarë në 9 pjesë të barabarta. Me të kuqe janë ngjyrosur 4 pjesë dhe me të gjelbër 2 pjesë. Shpreheni me thyesë pjesën e ngjyrosur të sipërfaqes rrethore.
Për ta zgjidhur detyrën, vizatojmë figurën:
Njehsojmë: _____

4 Një sipërfaqe rrethore është ndarë në 9 pjesë të barabarta dhe janë ngjyrosur 2 pjesë. Ngjyrosim edhe aq pjesë të tjera të sipërfaqes rrethore, në mënyrë që pjesa e tërësishme e ngjyrosur e sipërfaqes së rrethit të shprehet me thyesën $\frac{7}{9}$.
Për ta zgjidhur detyrën, vizatojmë figurën:

Ushtrojmë

113

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbledhja dhe zbritja e thyesave me emërues të njëjtë (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen vlerën e thyesave bazuar në figura;
- Njehson shumën dhe ndryshimin e thyesave me emërues të njëjtë;
- Përdor boshtin numerik për të kryer mbledhje dhe zbritje të thyesave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Organizuesi grafik

Kërkohet nga nxënësit që të përgjigjen në pyetjen:
- Çfarë kanë të përbashkët e me çfarë ndryshojnë mbledhja dhe zbritja e thyesave me emërues të njëjtë?
Nxënësit përgjigjen dhe përgjigjet e tyre shkruhen në tabelë.

Të përbashkët: Te mbledhja dhe te zbritja e thyesave me emërues të njëjtë, emëruesit përshkruhen.

Dallimet: Te mbledhja e thyesave me emërues të njëjtë numëruesit mblidhen ndërsa te zbritja ata zbriten.



5 Për modelet e dhëna shkruajmë barazi me zbritje:

1 | 1/5 1/5 1/5 1/5 1/5 1/5 1/5 | □/□ − □/□ = □/□

1 | 1/5 1/5 1/5 | □/□ − □/□ = □/□

6 Ndryshimin e thyesave e paraqesim në bosht numerik dhe njehsojmë.

5/6 − 1/6 = 5 − 1 / 6 = 4/5

6/7 − 4/7 = _____

8/9 − 7/9 = _____

7 Mollëkuqja është duke shkuar te gjethi. E shprehim me thyesë rrugën që ka kaluar ajo dhe rrugën që duhet ta kalojë.

0 – – – – – – – 1 = 8/8

Rruga e kaluar: □/□

Rruga që duhet ta kalojë: _____

8 Një picë është ndarë në 8 pjesë të barabarta. Jani mori 2 pjesë, kurse Thana 3 pjesë. Shprehni me thyesë pjesën e picës që morën ata dhe pjesën që mbeti.
Për të zgjidhur detyrën, vizatojmë figurën:

2/8 … 3/8

Pjesa që morën: 2/8 + 3/8 = _____

Pjesa që mbeti: _____

Ushtrojmë

114

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Vëzhgo - Analizo - Zbato

Udhëzohen nxënësit që me kujdes të lexojnë kërkesat e detyrës 3 dhe 4.
Ata duhet t'i analizojnë të dhënat dhe të fillojnë ta njehsojnë shumën pasi t'i vëzhgojnë figurat. Rezultatet e fituara i tregojnë para të tjerëve dhe përshkruajnë ecurinë e punës.

Më pas vazhdohet me detyrën 6, ku duke u bazuar te shembulli i parë, kryejnë zbritjet në mes të thyesave të dhëna. Ndryshimin e paraqesin edhe në boshtin numerik.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Të pavarur punojnë detyrat 1, 2 dhe 5. Te detyrat 1 dhe 5 bazohen te paraqitja grafike e thyesave për të shkruar pastaj barazi me mbledhje dhe zbritje. Detyrën 2 e punojnë drejtpërdrejt bazuar në rregullën për mbledhjen e thyesave me emërues të njëjtë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e vlerës së thyesave bazuar në figura, njehsimin e shumës dhe ndryshimit të thyesave me emëues të njëjtë dhe pëdorimin e boshtit numerik për të kryer mbedhjen dhe zbritjen e thyesave.

Detyrë:

Detyrat 7 dhe 8 (faqe 114).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 164

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Thyesat

Rezultatet e të nxënit të temës:
Jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin e figurave gjeometrike në jetën e përditshme;
Emërton figurat gjeometrike;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3,13,14; III.1,5,7,8; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.2; 1.4.1.



MATJA E SIPËRFAQES

SIPËRFAQJA DHE PERIMETRI

1 Në një fletë të bardhë i vizatojmë katër katrorë dhe katër trekëndësha. I ngjyrosim ata dhe i presim me gërshërë.

Duke i radhitur këta katrorë dhe trekëndësha, formojmë figurat:

Tri figurat e mësipërme kanë sipërfaqe të barabarta. Pse?

Kjo sipërfaqe është sa 7 sipërfaqe të katrorit.

Kjo sipërfaqe është sa 14 sipërfaqe të trekëndëshit.

F

Nëse figurën *F* e matim, duke marrë për njësi matëse katrorin, atëherë themi se masa e figurës *F* është 7.

Nëse figurën *F* e matim, duke marrë për njësi matëse trekëndëshin, atëherë themi se masa e figurës *F* është 14.

Për të matur një sipërfaqe, e krahasojmë atë me një sipërfaqe, të cilën e quajmë sipërfaqe njësi.
Numri që tregon se sa herë përmbahet sipërfaqja njësi në sipërfaqen e dhënë quhet masë e sipërfaqes.

Mësojmë

115

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sipërfaqja dhe perimetri

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Vizaton dhe ngjyros katrorët dhe trekëndshat e dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Pasi që në këtë orë mësimore dallon teknika nga orët e kaluara, mësimdhënësi/ja shfrytëzon rastin për të nxitur një diskutim në lidhje me figurat e ndryshme gjeometrike, format e tyre, e kështu me radhë.



MATJA E SIPËRFAQES

SIPËRFAQJA DHE PERIMETRI

1 Në një fletë të bardhë i vizatojmë katër katrorë dhe katër trekëndësha. I ngjyrosim ata dhe i presim me gërshërë.

Duke i radhitur këta katrorë dhe trekëndësha, formojmë figurat:

Tri figurat e mësipërme kanë sipërfaqe të barabarta. Pse?

Kjo sipërfaqe është sa 7 sipërfaqe të katrorit.

Kjo sipërfaqe është sa 14 sipërfaqe të trekëndëshit.

F

Nëse figurën *F* e matim, duke marrë për njësi matëse katrorin, atëherë themi se masa e figurës *F* është 7.

Nëse figurën *F* e matim, duke marrë për njësi matëse trekëndëshin, atëherë themi se masa e figurës *F* është 14.

Për të matur një sipërfaqe, e krahasojmë atë me një sipërfaqe, të cilën e quajmë sipërfaqe njësi.
Numri që tregon se sa herë përmbahet sipërfaqja njësi në sipërfaqen e dhënë quhet masë e sipërfaqes.

Mësojmë

115

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Punë praktike

Kjo orë do të karakterizohet me aktivitete të ndryshme të cilat janë edhe zbavitëse për nxënësit.
Fillimisht, nxënësit udhëzohen që t'i hapin librat në faqe 115, dhe të analizojnë detyrën e vetme që ndodhet në këtë faqe, e cila ka një sërë aktivitetesh:
Në një fletë të bardhë i vizatojnë katër katrorë dhe katër trekëndësha. I ngjyrosim ato dhe i prejmë me gërshërë.

Duke i radhitur këto katrorë dhe trekëndësha formojmë figura të ndryshme të cilat kanë numër të njëjtë të katrorëve.
Vizatimet, prerjet dhe radhitjet e kërkuara marrin shumë kohë, por me rëndësi është që nxënësit të kuptojnë rëndësinë e katrorëve dhe trekëndëshave prej të cilëve pastaj krijohen figura të tjera gjeometrike, dhe se nga ato pastaj mund të matet edhe sipërfaqja e tyre.
Për t'u përgjigjur në pyetjen e vendosur në libër, mësimdhënësi/ja mund të nxitë diskutim me nxënësit për të marrë sa më shumë mendime nga ata/ato.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Punë e pavarur

Në fletore shkruajnë informacionet e reja që morën për masën e sipërfaqes dhe njësitë matëse të sipërfaqes.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në vizatimin dhe ngjyrosjen e katrorëve dhe trekëndëshave të dhënë.

Detyrë:

Vizatohen objekte duke përdorur katrorët në fletore si njësi matëse.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 165

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin e figurave gjeometrike në jetën e përditshme;
Emërton figurat gjeometrike;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3,13,14; III.1,5,7,8; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.2; 1.4.1.



CENTIMETRI KATROR

1 Zakonisht, njësi për matjen e sipërfaqeve merret katrori me gjatësi të brinjës 1 cm dhe quhet centimetër katror.

1 cm
1 cm - centimetri katror

Figura e mëposhtme është formuar nga katrorët me gjatësi të brinjës 1 cm. Ta gjejmë masën e sipërfaqes së saj.

1 cm
1 cm - centimetri katror

2 Shprehim me centimetra katrorë sipërfaqet e secilëve nga katrorët e mëposhtëm.

1 cm
1 cm
Katrori me gjatësi të brinjës 2 cm.
Katrori me gjatësi të brinjës 3 cm.
Katrori me gjatësi të brinjës 4 cm.

Një katror me gjatësi të brinjës 2 cm përbëhet prej 4 katrorëve me gjatësi të brinjës 1 cm.
Masa e sipërfaqes së katrorit me gjatësi të brinjës 2 cm është 4 centimetra katrorë.
2 · 2 = 4

Pyetje:
1. Sa është masa e sipërfaqes së katrorit me gjatësi të brinjës 5 cm?
Përgjigjja:
2. Sa është masa e sipërfaqes së katrorit me gjatësi të brinjës 10 cm?
Përgjigjja:

Mësojmë
116

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Centrimetri katror

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përcakton masën e sipërfaqes së figurave të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Nxënësit pyeten:
Çka është sipërfaqja njësi?
Po masa e sipërfaqes?



3 Të përcaktojmë masën e sipërfaqes së secilës nga figurat.

1. Cila nga figurat ka sipërfaqe më të madhe?
2. Cila nga figurat ka sipërfaqe më të vogël?

A - centimetri katror
B - centimetri katror
C - centimetri katror
D - centimetri katror
E - centimetri katror
F - centimetri katror

Përgjigjet: 1. _____

2. _____

4 Të përcaktojmë masat e sipërfaqeve të figurave të mëposhtme.

1 cm

Sipërfaqja e figurës *B* është sa 3 sipërfaqe të katrorit me gjatësi të brinjës 1 cm. Pra, masa e sipërfaqes së figurës *A* është 3 centimetra katrorë.

Figura	A	B	C	D	E	F
Masa e sipërfaqes		3				

Mësojmë

117

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Në pjesën kryesore të orës trajtohen detyrat në faqe 200. Në këtë orë nuk preferohet që të ketë aktivitet sikur në orën e kaluar për shkak të shfrytëzimit sa më racional të kohës.

Detyra e parë mund të shfrytëzohet nga mësuesi/ja që t'i japë sqarimet në lidhje me centimetrin katror, e pastaj figurës gjeometrike të dhënë, bashkërisht me nxënësit i gjendet masa e sipërfaqes së saj.

Detyra e dytë jep tre katrorë: katrori me gjatësi të brinjës 2 cm, katrori me gjatësi të brinjës 3 cm, katrori me gjatësi të brinjës 4 cm, dhe duke pasur për bazë centimetrin katror si dhe gjatësinë e brinjës së katrorit përkatës, masa e sipërfaqes mund të gjendet edhe me anë të shumëzimit (siç ilustrohet në libër) përveç numrit të katrorëve njësi.
Nxënësit mund të fillojnë një provë të tillë por shpejt do ta kuptojnë që katrori me gjatësi të brinjës 40 cm nuk ka mundësi të vizatohet në fletore.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Rishikim në grup

Nxënësit llogarisin individualisht masën e sipërfaqes së figurave të dhëna, duke ditur raportin në mes dy trekëndëshave dhe një katrori.
Pastaj zgjidhja e detyrës diskutohet në grup.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përcaktimin e masës së sipërfaqes së figurave të dhëna.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 201).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 166

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin e figurave gjeometrike në jetën e përditshme;
Emërton figurat gjeometrike;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3,13,14; III.1,5,7,8; IV.5

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.2; 1.4.1;


1 T`i përcaktojmë madhësitë e sipërfaqeve të figurave të dhëna.

Sipërfaqja e figurës A është sa 9 sipërfaqe të trekëndëshit.

Figura	A	B	C	D	E
Masa e sipërfaqes	9				

2 T`i përcaktojmë madhësitë e sipërfaqeve të figurave të dhëna.

Sipërfaqja e figurës A është sa 5 sipërfaqe të katrorit.

Figura	A	B	C	Ç	D	Dh
Masa e sipërfaqes	5					

Ushtrojmë

118

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Centimetri katror (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përcakton madhësinë e sipërfaqeve të figurave të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Shkëmbe një detyrë

Punë në dyshe: Nxënësit vizatojnë një drejtkëndësh dhe u kërkohet ta njehsojnë masën e sipërfaqes së tij. Për ta njehsuar atë, udhëzohen ta përdorin katrorin e fletores, si njësi matëse. Pastaj dyshet e nxënësve kontrollojnë zgjidhjen e njëri-tjetrit dhe zgjidhja diskutohet me tërë klasën.



Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Punë në grupe

Në vazhdim të orës, nxënësit udhëzohen të hapin librin në faqe 202 dhe të shikojnë fillimisht detyrën e parë ku kërkohet përcaktimi i masës së sipërfaqes së figurave të dhëna në libër, ku njësi matëse tani nuk është centimetri katror për trekëndëshin. Pra, këtu nxënësit duhet të llogaritin madhësinë e sipërfaqeve duke numëruar se sa trekëndësha përmban një figurë përkatëse, e pastaj në fund e plotësojnë edhe tabelën e dhënë në libër.

Rezultatet e fituara mund t'i shkëmbejnë në grupet e tjera.

Detyra e dytë është e ngjashme me detyrën e parë, por dallimi këtu është se njësi matëse është katrori.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Mendo/ Krijo grupe/ Diskuto

Në pjesën e fundit të orës, mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të vizatojnë një rrjet koordinativ në disa rreshta dhe disa shtylla (mund të jenë 10 rreshta dhe 14 shtylla), dhe pastaj secili prej grupeve të nxënësve të ngjyrosë katrorë të caktuar për të formuar figura të ndryshme gjeometrike. Në fund nevojitet të llogaritin masën e sipërfaqeve të tyre ku si njësi matëse merret katrori.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përcaktimin e madhësive të sipërfaqeve të figurave të dhëna.

Detyrë:

Caktohet madhësia e sipërfaqës së librit të matematikës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 167

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin e figurave gjeometrike në jetën e përditshme;
Emërton figurat gjeometrike;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3,13,14; III.1,5,7,8; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.2; 1.4.1.


METRI KATROR

1 Në figurë është dhënë një katror me gjatësi të brinjës 1 m.

1 m
1 m
- metri katror

Metri katror paraqet gjithashtu një njësi për matjen e sipërfaqes.

2 Masën e sipërfaqeve të figurave të mëposhtme e shprehim me metra katrorë.

1 m
1 m
A
B
C

1. Cila nga figurat ka sipërfaqe më të madhe?
Përgjigjja:
2. Cila nga figurat ka sipërfaqe më të vogël?
Përgjigjja:

3 Masat e sipërfaqeve të figurave të mëposhtme i shprehim me metra katrorë.

50 cm
50 cm
25 cm
25 cm

Një metër katror përmban ___ katrorë me gjatësi të brinjës 50 cm.

Një metër katror përmban ___ katrorë me gjatësi të brinjës 25 cm.

- metër katror
- metër katror

Hësojmë

119

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Metri katror

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson masën e sipërfaqes së figurave të dhëna;
- Krahason figurat ndërmjet vete.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Në këtë orë mësimore nevojitet të bëhet një diskutim i njohurive të fituara deri më tani për këtë tematikë, por që nuk merr shumë kohë.


METRI KATROR

1 Në figurë është dhënë një katror me gjatësi të brinjës 1 m.

1 m
1 m
- metri katror

Metri katror paraqet gjithashtu një njësi për matjen e sipërfaqes.

2 Masën e sipërfaqeve të figurave të mëposhtme e shprehim me metra katrorë.

A B C

1. Cila nga figurat ka sipërfaqe më të madhe?
Përgjigjja:
2. Cila nga figurat ka sipërfaqe më të vogël?
Përgjigjja:

3 Masat e sipërfaqeve të figurave të mëposhtme i shprehim me metra katrorë.

50 cm
25 cm

Një metër katror përmban ___ katrorë me gjatësi të brinjës 50 cm.

Një metër katror përmban ___ katrorë me gjatësi të brinjës 25 cm.

- metër katror
- metër katror

Masat

119

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e orientuar

Detyra 2: Nxënësit udhëzohen që të njehsojnë masën e sipërfaqeve të figurave të dhëna dhe t'i krahasojnë ato.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Vëzhgo/ Analizo/ Gjej rezultatin

Në pjesën e fundit të orës mbetet detyra e tretë. Kjo detyrë është pak më specifike, dhe udhëzimet duhen patjetër të jepen nga ana e mësuesit/es. Pra, këtu kemi dy figura të ndryshme dhe në fund duhet llogaritur masën e sipërfaqes të tyre të shprehura me metër katror. Mirëpo, njësia matëse e tyre nuk është e njëjtë (shiko se sa është gjatësia e brinjëve së katrorit në të dyja rastet).

Që të gjendet (llogaritet) masa e sipërfaqes së figurës së parë, fillimisht duhet ditur se sa katrorë të tillë bëjnë një metër katror. Meqë metri katror është katrori me gjatësi të brinjëve 100 cm, atëherë duhet 4 katrorë të tillë (të dhënë nga detyra). Mësuesi/ja mund t'i pyes nxënësit pse është një gjë e tillë. Pas këtyre sqarimeve, fillojmë zgjidhjen e detyrave.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e masës së sipërfaqeve të figurave të dhëna dhe krahasimin e tyre.

Detyrë:

Llogaritet masa e sipërfaqes së një figure me përmasë 45cm me 60cm.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 168

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin e figurave gjeometrike në jetën e përditshme;
Emërton figurat gjeometrike;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3,13,14; III.1,5,7,8; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.2; 1.4.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Perimetri

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson masën e sipërfaqes së figurave gjeometrike;
- Llogarit perimetrin e figurave të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Shkëmbe një detyrë

Nxënësit udhëzohen që të vizatojnë një figurë gjeometrike (trekëndësh, katror, drejtkëndësh...). Në dyshe shkëmbejnë detyrën, në të cilën pastaj duhet të njehsojnë perimetrin e figurës.
Dyshet e nxënësve kontrollojnë detyrën e njëri-tjetrit, pastaj dikutimi bëhet me gjithë klasën.



2 Figurat *A* dhe *B* janë formuar nga numri i njëjtë i katrorëve me gjatësi të brinjës 1 cm.

A *B*

1. Figurat *A* dhe *B* kanë sipërfaqe të barabarta.
   Masat e sipërfaqeve të tyre janë të barabarta me ___ centimetra katrorë.
2. Figurat *A* dhe *B* nuk kanë perimetra të barabartë.
   Perimetri i figurës *A* është i barabartë me ___ cm.
   Perimetri i figurës *B* është i barabartë me ___ cm.

3 Figurat *A*, *B* dhe *C* janë formuar nga numri i njëjtë i katrorëve me gjatësi të brinjës 1 cm.

A *B* *C*

Figura	*A*	*B*	*C*
Perimetri			
Masa e sipërfaqes			

1. A kanë figurat *A*, *B* dhe *C* sipërfaqe të barabartë?
   Përgjigjja: _____
2. A kanë figurat *A*, *B* dhe *C* perimetër të barabartë?
   Përgjigjja: _____

Mësojmë

121

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e orientuar

Në pjesën kryesore e orës nxënësit udhëzohen të analizojnë detyrën e parë në faqe 120, dhe duke pasur për bazë centimetrin katror si njësi matëse për sipërfaqen, ne kuptojmë se gjatësia e katrorit të tillë është 1 cm. Mësuesi/ja jep sqarimet shtesë se përveç masës së sipërfaqes, na duhet të dimë se edhe sa është gjatësia e të gjitha brinjëve të asaj figure gjeometrike, të cilën e quajmë perimetër.

Në detyrën e lartcekur thuhet se të gjitha figurat e prezantuara kanë perimetër të njëjtë. Në këtë rast, mësuesi/ja mund të kërkon nga nxënësit të argumentojnë pse është një gjë e tillë, e pastaj se sa është perimetri i tyre.

Detyra e dytë në faqe 121 ka për qëllim se përveç llogaritjeve përkatëse, të tregojë edhe një rast specifik ku dy figura mund të kenë masën e sipërfaqeve të tyre të barabartë por jo edhe perimetrin e tyre. Detyra e tillë është mirë që të zgjidhet bashkërisht me nxënësit duke diskutuar (pyetje-përgjigje) vazhdimisht me ta.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Punë në grupe

Për pjesën e fundit të orës, nxënësit mund të ndahen në grupe dhe të provojnë zgjidhjen e detyrës së tretë në të njëjtën faqe, ku gjenden tri figurat gjeometrike, dhe kërkohet llogaritja e masës së sipërfaqeve të tyre së bashku me perimetrat përkatës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e masës së sipërfaqes së figurave gjeometrike dhe llogaritjen e perimetrit të tyre.

Detyrë:

Matet perimetri i librit të Matematikës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 169

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin e figurave gjeometrike në jetën e përditshme;
Emërton figurat gjeometrike;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3,13,14; III.1,5,7,8; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.2; 1.4.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sipërfaqja e drejtkëndëshit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson masën e sipërfaqes së drejtkëndëshit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Pjesa e parë e orës shfrytëzohet për përsëritje të mësimit të mësuar nga ora e kaluar në lidhje me sipërfaqen njësi dhe masën e sipërfaqes.


SIPËRFAQJA E DREJTKËNDËSHIT

1 Sa është masa e sipërfaqes së drejtkëndëshave?

1 cm

1 cm

A

B

C

D

Drejtkëndëshi A ka gjatësinë 4 cm dhe gjerësinë 2 cm. Drejtkëndëshi A përbëhet nga 8 katrorë me gjatësi të brinjës 1 cm.

2 • 2 = 4

Masa e sipërfaqes së drejtkëndëshit A është 8 centimetra katrorë.

4 • 2 = 8

Për të gjetur masën e sipërfaqes së drejtkëndëshit, shumëzojmë gjatësinë me gjerësinë.

Përgjigjja:

Masa e sipërfaqes së drejtkëndëshit A është ____ centimetra katrorë.

Masa e sipërfaqes së drejtkëndëshit B është ____ centimetra katrorë.

Masa e sipërfaqes së drejtkëndëshit C është ____ centimetra katrorë.

Masa e sipërfaqes së drejtkëndëshit D është ____ centimetra katrorë.

Matja

123

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Në pjesën kryesore të orës trajtohet detyra në faqe 123. Në këtë detyrë mësuesi/ja jep sqarimet në lidhje me centimetrin katror, e pastaj kërkon nga nxënësit të gjejnë masat e sipërfaqeve të figurave të dhëna. Bashkërisht me nxënësit i gjendet masa e sipërfaqes së tyre.



Për të gjetur masën e sipërfaqes udhëzohen të masin gjatësinë dhe gjerësinë e pastaj t'i shumëzojnë ato.
5◦3=15 centimetra katrorë.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Pjesën e fundit të detyrës e kryejnë individualisht, duke gjetur kështu masën e sipërfaqes të katër figurave të dhëna.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e masës së sipërfaqes së drejtkëndëshit.

Detyrë:

Njehsohet masa e sipërfaqes së tre drejtkëndëshave të ndryshëm.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 170

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin e figurave gjeometrike në jetën e përditshme;
Emërton figurat gjeometrike;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3,13,14; III.1,5,7,8; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.2; 1.4.1.


1 Sa është masa e sipërfaqes së drejtkëndëshit?

4 njësi gjatësie

5 njësi gjatësie

Drejtkëndëshi i dhënë ka gjatësinë 5 njësi dhe gjerësinë 4 njësi. Prandaj, masa e sipërfaqes së tij është:

5 • 4 = 20 njësi katrore

2 Ta gjejmë masën e sipërfaqes së drejtkëndëshave.

1 cm

1 cm

gjatësia: cm
gjerësia: cm
masa e sipërfaqes:
4 • 3 = centimetra katrorë

1 m

1 m

gjatësia: m
gjerësia: m
masa e sipërfaqes:
• = metra katrorë

4 m

6 m

3 m

9 m

masa e sipërfaqes:
• = metra katrorë

masa e sipërfaqes:
• = metra katrorë

Ushtrojmë

124

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sipërfaqja e drejtkëndëshit (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson masën e sipërfaqes së figurave gjeometrike;
- Përdor shumëzimin për llogaritjen e masës së sipërfaqes së drejtkëndëshit;
- Identifikon dallimet ndërmjet figurave gjeometrike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Për të bërë një përsëritje të gjetjes së masës së sipërfaqes, nxënësve iu parashtrohen disa pyetje, p.sh.:
- Si gjendet masa e sipërfaqes së drejtkëndëshit?
- A është masa e sipërfaqes e njëjtë me perimetrin?
- A gjendet njëjtë edhe masa e sipërfaqes së katrorit?


1 Sa është masa e sipërfaqes së drejtkëndëshit?

4 njësi gjatësie

5 njësi gjatësie

Drejtkëndëshi i dhënë ka gjatësinë 5 njësi dhe gjerësinë 4 njësi. Prandaj, masa e sipërfaqes së tij është:

5 • 4 = 20 njësi katrore

2 Ta gjejmë masën e sipërfaqes së drejtkëndëshave.

1 cm

1 cm

gjatësia: cm

gjerësia: cm

masa e sipërfaqes:

4 • 3 = centimetra katrorë

1 m

1 m

gjatësia: m

gjerësia: m

masa e sipërfaqes:

• = metra katrorë

4 m

6 m

3 m

9 m

masa e sipërfaqes:

• = metra katrorë

masa e sipërfaqes:

• = metra katrorë

Ushtrojmë

124

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Te detyra 1 lexohet kërkesa dhe diskutohet mënyra e gjetjes së masës së sipërfaqes.



Për të gjetur masën e sipërfaqes duhet të maten gjatësia dhe gjerësia e pastaj të shumëzohen ato. 5◦4=20 centimetra katrorë.
Në dyshe punojnë detyrën 2.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Detyrën 3 e kryejnë individualisht, duke gjetur kështu masën e sipërfaqes të të dyja figurave të dhëna.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e masës së sipërfaqes së figurave gjeometrike dhe identifikimin e dallimeve në mes figurave gjeometrike.

Detyrë:

Njehsohet masa e sipërfaqes së dy drejtkëndëshave të ndryshëm.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 171

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Trupat gjeometrikë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin e trupave gjeometrikë në jetën e përditshme;
Emërton trupat gjeometrikë;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3,13,14; III.1,5,7,8; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.2; 1.4.1.


TRUPAT GJEOMETRIKË

TRUPAT ME QOSHE

Drejtkëndëshi dhe katrori janë figura të rrafshëta.
Drejtkëndëshi ka dy dimensione: gjatësinë dhe gjerësinë.
Katrori ka dy dimensione të barabarta.

Kuboidi (prizmi drejtkëndor) është një trup gjeometrik që ka 6 faqe, 12 brinjë dhe 8 kulme.

brinjë, faqe, kulm

- Faqet e kuboidit janë sipërfaqe drejtkëndëshe.
- Segmenti ku takohen dy faqe të kuboidit quhet brinjë e kuboidit.
- Tri brinjë që takohen formojnë një kulm të kuboidit.

Kuboidi		
numri i faqeve	numri i kulmeve	numri i brinjëve

Rrjeta (hapja) e kuboidit:

Kubi është një kuboid që ka të gjitha brinjët e barabarta.

brinjë, faqe, kulm

Një faqe e kubit është një sipërfaqe katrore.

Kubi		
numri i faqeve	numri i kulmeve	numri i brinjëve

Rrjeta (hapja) e kubit:

Mësojmë

125

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Trupat me qoshe

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton trupat gjeometrikë;
- Përcakton faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Në pjesën e parë të orës mësuesi/ja shfrytëzon rastin që të diskutojë me nxënësit lidhur me objektet e ndryshme (kuti të ndryshme, dollapë), pastaj për materiale mësimore që i ngjasojnë trupave gjeometrikë si shkumësi, shpuza etj.



Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Veprimtari e drejtuar

Nxënësit pajisen me fletë A4 dhe u kërkohet që në fletë të vizatojnë hapjen e trupave gjeometrikë që janë paraqitur në tekst. Nxënësit pyeten:

Sa faqe ka kubi? (6 faqe)
Sa kulme ka kubi? (8 kulme)
Sa brinjë ka kubi? (12 brinjë)
Sa baza ka prizmi pesëfaqësor? (2 baza)
Sa faqe ka prizmi pesëfaqësor? (5 faqe)
Sa kulme ka prizmi pesëfaqësor? (10 kulme)
Sa brinjë ka prizmi pesëfaqësor? (15 brinjë)
Nxënësit pyeten edhe për trupat e tjerë gjeometrikë.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Të pavarur punojnë detyrat 1 dhe 2 në faqë 127.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në emërtimin e trupave gjeometrikë dhe përcaktimin e faqeve, brinjëve dhe kulmeve të tyre.

Detyrë:

Detyra 3 (faqe 127).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 172

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Trupat gjeometrikë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin e trupave gjeometrikë në jetën e përditshme;
Emërton trupat gjeometrikë;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3,13,14; III.1,5,7,8; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.2; 1.4.1.


1 Në figurë janë vizatuar rrjeta të kubit dhe të kuboidit. Me të gjelbër është ngjyrosur faqja e poshtme (baza) e kubit ose kuboidit. Ngjyrosim me të kuqe faqen e sipërme (faqen e përballshme me të).

2 Shenjojmë me ✓ figurën që paraqet rrjet të kubit ose të kuboidit.

3 *a*) Sa kube të vogla nevojiten për ta plotësuar kuboidin?
b) Sa kube të vogla përmbahen në kuboid?

a) 16
b)

a)
b)

a)
b)

Mësojmë

127

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Trupat me qoshe (ushtrime)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Vizaton kubin dhe kuboidin;
- Plotëson trupin e nisur me kube për të formuar kuboidë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diagrami i Venit

Për të krahasuar kubin dhe kuboidin plotësojnë Diagramin e Venit.




1 Vizatojmë një kub dhe një kuboid.

2 Plotësojmë me kub derisa të fitojmë kuboid. Sa kube janë të nevojshme?

3 Në figurë janë vizatuar tri rrjeta të kubeve. Tregojmë sa herë përmbahet kubi i ndërtuar me rrjetën e ngjyrosur në secilin nga kubet e ndërtuara nga dy rrjetat e tjera.

a) b)

Ushtrojmë

128

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Mendo - Puno në dyshe - Thuaja grupit

Në detyrën 1 kërkohet të vizatojnë kubin dhe kuboidin. Mësuesi/ja jep sqarimet në lidhje me këtë e pastaj nxënësit punojnë në dyshe. Modelet më të mira paraqiten para klasës.

Në dyshe vazhdojnë edhe detyrën 2 për të gjetur edhe sa kube duhet shtuar trupit të nisur për të formuar kuboid. Zgjidhjet janë:

6	4	7	32

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Zbatimi i njohurive

Detyrën e fundit e kryejnë individualisht, duke numëruar katrorët në figurën e ngjyrosur dhe duke treguar sa herë përmbahet ai në dy rrjetat e paraqitura.

Zgjidhjet janë 4 herë dhe nëntë herë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në vizatimin e trupave gjeometrikë (kubit dhe kuboidit) dhe plotësimin e kuboidit me kuba.

Detyrë:

Modelohet njëri nga trupat gjeometrikë (kubi a kubiodi) me material që zgjidhet sipas dëshirës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 173

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Trupat gjeometrikë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin e trupave gjeometrikë në jetën e përditshme;
Emërton trupat gjeometrikë;
Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2,4; II.3,13,14; III.1,5,7,8; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.2; 1.4.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Trupat e rrumbullakët

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton trupat e rrumbullakët;
- Përshkruan trupat e rrumbullakët;
- Analizon trupat gjeometrikë pas prerjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kuti kartoni, trupa gjeometrikë prej druri ose plastike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake

Kërkohet nga nxënësit të tregojnë dallimet në mes të trupave me qoshe dhe atyre të rrumbullakët. Tregojnë emrat e atyre trupave të rrumbullakët që iu kujtohen.

Në një kuti futen trupa të ndryshëm dhe nxënësit fusin dorën, prekin trupat dhe mundohen t'ia qëllojnë se cilët janë pa i parë.


TRUPAT E RRUMBULLAKËT

▶ **Trupat e rrumbullakët**: këta trupa kanë 0 brinjë dhe 0 kulme, por, secili nga ta ka sipërfaqe të lakuar.

sipërfaqe e rrafshët
sipërfaqe e lakuar

Cilindri
2 sipërfaqe të rrafshëta

Koni
1 sipërfaqe të rrafshët

Sfera
0 sipërfaqe të rrafshëta

▶ Nëse ne e presim një cilindër, sipërfaqet e rrafshëta që fitohen janë:

2 rrathë

2 drejtkëndësha

▶ Emërtojmë format e sipërfaqeve të rrafshëta, që fitohen me prerjet e trupave:

drejtkëndësh

Mësojmë

129

Ndërtimi i njohurive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shqyrtim i përbashkët

Hapen librat. Para nxënësve paraqiten cilindri, koni e sfera e nga ata kërkohet që t'i përshkruajnë dhe t'i analizojnë ata.

Tregojnë nëse kanë kulme, brinjë, kënde etj. Punohen detyrat 1 dhe 2 në dyshe.

Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënit
Veprimtari e pavarur

Detyrën e fundit e kryejnë individualisht duke emërtuar figurat që formohen pas prerjes së trupave gjeometrikë të dhënë.

Trupat gjeometrikë të marrë nga libri faqe 129 të emërtohen në vijat e zbrazëta afër trupave.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në emërtimin e trupave të rrumbullakët, përshkrimin e tyre dhe analizën e trupave gjeometrikë pas prerjes së tyre.

Detyrë:

Modelohet njëri nga trupat gjeometrikë. (Materiali zgjidhet sipas dëshirës).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

LITERATURA

Musai, Bardhyl. *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë (2014).

Temple, Charles & L. Steele, Jeannie & S. Meredith, Kurtis. *Reading & writing for critical thinking Project. (1998)*

Woolfolk, Anita. *Educational Psychology*. Pearson Education (Edicioni: 13) (2015).

Zejnullahu, Ramadan. *Matematika 3*: ushtrime kontrolluese. Shtëpia botuese "Dukagjini" (2023).

Zejnullahu, Ramadan. *Matematika 3a*. Shtëpia botuese "Dukagjini" (2023).

Zejnullahu, Ramadan. *Matematika 3b*. Shtëpia botuese "Dukagjini" (2023).

Materiale

Strategji të reja të mësimdhënies dhe të nxënit, KEC.

Vrapi, Asllan. *Mësimdhënia e diferencuar dhe ndikimi i saj në mësimnxënie në klasa heterogjene*. (2015)